

TABELA E LËNDËS

HYRJE 4

Përkufizime 8

I. TITUJT EKZEKUTIV

- 1.1 Vendimet civile të gjykatës si tituj ekzekutiv 13
- 1.2 Vendimet civile për sigurimin e padisë si titull ekzekutiv 16
- 1.3 Vendimet me ekzekutim të përkohshëm si tituj ekzekutiv 20
- 1.4 Vendimet penale të formës së prerë si tituj ekzekutiv 24
- 1.5 Vendimet e gjykatave dhe arbitrazheve të huaja 26
- 1.6 Ekzekutimi i vendimit për marrjen e provës tek të tretët 26
- 1.7 Parashkrimi 28
- 1.8 Akti noterial si titull ekzekutiv 31
- 1.9 Kambialet, Çeqet si tituj ekzekutiv 35
- 1.10 Urdhri i ekzekutimit
36
- 1.11 Ndërhyrja e Gjykatës në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm
39

II. EKZEKUTIME TË VECANTA

- 2.1 Llojet e detyrimeve të ekzekutueshme dhe ekzekutimi i tyre 44
- 2.2 Subjekti debitor 45
- 2.3 Mjetet e ekzekutimit 46
2
- 2.4 Ekzekutimi i detyrimeve në të holla 47
 - 2.4.1 Rregulla të përgjithshme të ekzekutimit në të holla 47
 - 2.4.2 Përjashtimi i sendeve nga sekuestrimi 50
 - 2.4.3 Ekzekutimi i sekuestrimit 50
 - 2.4.4 Rregullat e njoftimit të vendimeve të përmbauesit gjyqësor 52
 - 2.4.5 shtyrja e ekzekutimit dhe ndarja me këste 56
 - 2.4.6 Bashkimi i ekzekutimeve 57
 - 2.4.7 Projekti i ndarjes së shumave të nxjerra nga ekzekutimi 60
 - 2.4.8 Rregulla të përgjithshme për ekzekutimin e detyrimeve në të holla 61
- 2.5 Ndalimet e blerjes së ankand 62
- 2.6 Kryreja e ekspertimit 63
- 2.7 Ekzekutimi i detyrimeve në të holla në fusha të veçanta 64
 - 2.7.1 Ekzekutimi në shumat e llogarive në banka 64
 - 2.7.2 Ekzekutimi mbi pagën e debitorit 67
 - 2.7.3 Ekzekutimi i detyrimeve në të holla ndaj institucioneve buxhetore 68
- 2.8 Ekzekutimi që kryhet mbi sende të tjera me qëllim realizimin e detyrime të tjera 72
 - 2.8.1 Ekzekutimi mbi sendet e luajtshme 72
 - 2.8.2 Ekzekutimi mbi sendet e paluajtshme 78
 - 2.8.3 Ekzekutimi mbi sendet me gjëndje juridike të ndërmjetme 86
 - 2.8.4 Ekzekutimi i sendeve në bashkëpronësi 91
3
 - 2.8.5 Ekzekutimi mbi kreditë e debitorit dhe mbi sendet e personave të tretë 94
 - 2.8.6 Ekzekutimi mbi kredinë e siguruar 97
 - 2.8.7 Ekzekutimi ndaj personit juridik që shpërndahet ose likuidohet 98

2.8.8 Ekzekutimi mbi sigurimin e sendeve 99

2.9 Ekzekutimi për dorëzimin e sendit 100

2.9.1 Ekzekutimi për vënien në posedim për sendin e luajtshëm 102

2.10 Ekzekutimi i titujve ekzekutiv me objekt kredi bankare 103

III. PËRGJEGJËSIA E SUBJEKTEVE NË EKZEKUTIM 108

IV. MJETET E MBROJTJES KUNDËR EKZEKUTIMEVE TËVENDIMEVE 110

4.1 Pezullimi i ekzekutimit 110

4.2 Mjetet e mbrojtjes ndaj ekzekutimeve të detyrimeve 113

V. HAPJA E DOSJES 120

VI. MARRËDHËNIET E SHËRBIMIT PËRMBARIMOR ME INSTITUCIONET E PËRFSHIRA NË PROCESIN E EKZEKUTIMIT 120

VII. ANEKS A

Formate të dokumenteve që lëshohen nga përmbaruesi gjyqësor 128

ANEKS B

Ligjet kryesore dhe aktet normative në fushën e shërbimit përmbarimor gjyqësor 176

4

HYRJE

Me qëllim përmbushjen e misionit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor, për ekzekutimin e të gjithë titujve ekzekutive duke u mbështetur në rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile, si dhe duke marrë shkas dhe nga liberalizimi që iu krye këtij shërbimi me miratimin e ligjit nr. 10 031/2008 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privatë”, lindi nevoja e hartimit të këtij manuali.

Ky manual përmban një përmbledhje të rregullave të ligjit procedural civil në bazën e të cilit udhëhiqet e gjithë veprimtaria e përmbaruesve gjyqësor, në funksion të përmbushjes së detyrës së tyre për ekzekutimin e titujve të detyrueshëm për ekzekutim. Këto të fundit përcaktojnë bazën mbi të cilën kryhet ekzekutimi, subjektet e ekzekutimit, llojet e veprimeve dhe afatet e kryerjes së veprimeve të caktuara, rastet e kundërshtimit të ekzekutimit, mbrojtja në gjykatë dhe efektet që lindin nga zbatimi i ekzekutimit.

Gjithashtu në këtë manual përshkruhen dhe marrëdhëniet që krijohen midis shërbimit përmbarimor dhe institucioneve të tjera shtetërore, veprimtaria e të cilëve lidhet me ekzekutimin e titujve të detyrueshme për zbatim. Ekzekutimi i saktë dhe efikas i këtyre titujve, si pjesë e procesit të rregullt gjyqësor, bëhet i mundur nga zbatimi i veprimeve konkrete të përcaktuara në ligj, afatet procedurale të ekzekutimit, duke shmangur zvarritjet në ekzekutim, si dhe duke siguruar zbatueshmëri të njëjtë të titujve ekzekutiv.

Ekzekutimi i një vendimi të formës së prerë dhënë nga cdo gjykatë duhet të konsiderohet si një pjesë integrale e "gjykimit" për përmbushjen e të cilit shteti ka detyrim për të organizuar një sistem për zbatimin e vendimeve i cili është efektiv si në ligj dhe në praktikë dhe siguron zbatimin e tyre duke shmangur vonesat e panevojshme.

E drejta për një proces të rregullt gjyqësor parashikohet në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Element i këtij procesi është edhe ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Për këtë, duhet theksuar se dispozitivi i vendimit duhet të

5

jetë i qartë, në mënyrë që të bëhet i kuptueshëm për përmbaruesin apo për organe të tjera të ngarkuara për ekzekutimin e tij. Pra, qëllimi është që të ekzekutohet sa më lehtë dhe të mos krijojë konflikte edhe gjatë kësaj faze. Kështu në një vendim të sajini, Gjykata e Lartë, ndër të tjera, shprehet se “...vendimi duhet të prishet..... Nuk janë specifikuar se cilat defekte të sendit duhet të riparohë pala e paditur.... Vendimi bëhet praktikisht i paekzekutueshëm.”

Po kështu, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, në jurisprudencën e saj ka konsoliduar qëndrimin se ekzekutimi i një vendimi gjyqësor është pjesë përbërëse e konceptit të gjykimit të drejtë, parashikuar nga neni 6 i Konventës. Kjo gjë u elaborua më së miri në çështjen *Hornsby kundër Greqisë*. Në nenin 6 të Konventës flitet për gjykim të drejtë, pra, për barazi palësh dhe mjetësh në dispozicion të tyre, gjykatë të krijuar me ligj dhe të pavarur e të paanshme, të drejtë për avokat edhe kryesisht ose për tu mbrojtur vetë, gjykim të shpejtë dhe publik, paraqitje provash dhe dëshmitarësh, të drejtë për përkthim në gjuhën e preferueshme, dhe elementë të tjerë të konsideruar si përbërës të nenit 6. Megjithatë nuk ka asgjë për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore si element më vehte të procesit të rregullt gjyqësor.

Në vendimin e sipërcituar, Gjykata shprehet se: **“Kjo e drejtë (e drejta për një proces të rregullt ligjor) do të ishte iluzion në qoftë se rendi juridik i një shteti anëtar të Konventës do të lejonte që një vendim gjyqësor me karakter përfundimtar dhe të detyrueshëm të ngelej pa u zbatuar në dëm të ndonjërës nga palët. Në fakt, nuk mund të pretendohet që Neni 6 § 1 të përshkruante në detaje garancitë procedurale – barazinë, karakterin publik dhe zhdërvjelltësinë – që u njihen palëve dhe të mos mbrojnë vënien në jetë të vendimeve gjyqësore; në qoftë se ky Nen do të kishte të bënte vetëm me të drejtën për t’iu drejtuar gjykatave dhe me mënyrat e zhvillimit të proceseve gjyqësore kjo gjë do të rrezikonte të krijonte situata të papajtueshme me parimin e përparësisë të së drejtës (se shtetit të së drejtës) të cilin shtetet palë janë angazhuar ta respektojnë duke ratifikuar Konventën. (...) Ekzekutimi i një vendimi, i cilësdo gjykatë qoftë, duhet konsideruar si pjesë përbërëse e ‘procesit’ në kuptimin e Nenit 6 § 40.”**

Për ta qartësuar më tej këtë botëkuptim të saj in në paragrafin vijues Gjykata shton se **“në qoftë se organet e administratës refuzojnë ose nuk veprojnë për ekzekutimin e një vendimi ose**

i Vendimi nr. 509, datë 23/03/2000 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

6

vonojnë ta bëjnë këtë gjë, garancitë e Nenit 6 nga të cilat përfitojnë palët gjatë fazës gjyqësore të procedurës do të humbisnin çdo arsye të ekzistencës së tyre”.

Këtë qëndrim Gjykata e ka përforcuar edhe më tej në vendimin e saj *Immobiliare Saffi kundër Italisë*, ku ajo shton se kur organet shtetërore të cilave u takon me ligj të ekzekutojnë vendime gjyqësore **“ndërhyjnë në një procedurë ekzekutimi të një vendimi gjyqësor, një ndërhyrje e tillë nuk mund të ketë për pasojë pengimin, shfuqizimin ose vonesën në mënyrë të tepruar të ekzekutimit, dhe aq më pak, të verë në dyshim thelbin e këtij vendimi”**.

Në një vendim të 26 tetorit 2000 në lidhje me çështjen *Hassan dhe Tchaouch kundër Bullgarisë* Gjykata e Strasburgut është më e drejtpërdrejtë me organet shtetërore duke iu referuar vendimeve që nuk zbatohen prej tyre. Ajo shprehet se **“Shteti i së drejtës, njëri prej parimeve themelore të një shoqërie demokratike është pjesë përbërëse e tërësisë së Neneve të Konventës dhe kupton detyrën e çdo shteti ose autoriteti publik që të bindet ndaj një vendimi gjyqësor që i drejtohet atyre.”**

Në vendimin e saj të parë kundër Ruisë më 7 maj 2002, në lidhje me çështjen *Burdov* ashtu edhe në vendimin tjetër të 23 tetorit 2003 në lidhje me çështjen *Timofeyev kundër Ruisë*, Gjykata shprehet se duke zvarritur zbatimin e vendimeve gjyqësore autoritetet vendase shkelin parimin e shtetit të së drejtës të cilin kanë marrë përsipër të respektojnë që në momentin kur kanë ratifikuar Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Nga ana tjetër, është shumë domethënës shembulli i Komisionit European i cili vendosi t’i kërkojë *Gjykatës së Luksemburgut të gjobisë Italinë* me 309.730 € gjobë për ditë deri në ekzekutimin e një vendimi të kësaj Gjykate që ka të bëjë me trajtimin diskriminues të ish lektorëve të gjuhëve të huaja në disa universitete italiane.

Vendimi i 2 tetorit 2003 në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës të *Qufaj Co. Shpk kundër Shqipërisë*, ku shteti shqiptar kishte dështuar në ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, e dëshmon edhe një herë faktin e qënies së ekzekutimit element i procesit të drejtë, parashikuar nga neni 6 i Konventës. Në këtë rast, mosdhënia për një kohë të gjatë e lejes së ndërtimit nga KRRT-ja për shoqërinë *Qufaj Co. Shpk*, duke u interpretuar nga kjo e fundit si një detyrim ligjor pas miratimit të lejes për shesh ndërtimi, bëri që gjykata të pranonte padinë e shoqërisë për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vonesa deri në mosmarrjen asnjëherë të kësaj

7

leje. Ky vendim, i cili mori formë të prerë pas lënies në fuqi nga gjykatat e shkallëve më të larta e u kthye në titull ekzekutiv, nuk u ekzekutoi për shkak të një konflikti ndërmjet Bashkisë dhe Ministrisë së Financave, lidhur me parashikimin e fondit të nevojshëm për këtë ekzekutim.

Gjykata e Strasburgut, në këtë rast dhe raste të tjera, ka shprehur qartë qëndrimin se **kur debitor në një titull ekzekutiv është shteti, nuk mund t'i kërkohej kreditorit të ndërmarrë procedura për ta ekzekutuar atë, por vetë shteti ka detyrimin pozitiv të ekzekutojë kryesisht vendimin a titullin ekzekutiv.**

Edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në frymën e jurisprudencës së Strasburgut, në një vendim të sajën të vitit 2006, mbi një çështje ku kërkohej konstatimi i cënimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, që kishte të bënte me kthimin e kërkuarit në vendin e mëparshëm të punës dhe pagimin e pagës për të gjithë këtë periudhë, shprehet se **“I gjithë procesi gjyqësor shpesh herë i vështirë e problematik nuk do të kishte vlerë nëqoftëse nuk do të pasohej nga një proces që lidhet drejtpërdrejt me veprimtarinë e organeve të përmbarimit, me ekzekutimin e vendimit ose të realizimit të së drejtës së fituar.”** E megjithatë, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, ndonëse ka konstatuar në vijimësi cënimin e së drejtës për një proces të rregullt, për shkak mosekzekutimi, përsëri është cilësuar si mjet joefektiv nga GJEDNJ, sa i takon këtyre rasteve. Kjo pasi Gjykata Kushtetuese, referuar ligjit ku bazohet veprimtaria e saj, nuk e ka për kompetencë dhënien e shpërblimin për dëmin e shkaktuar nga mosekzekutimi ose vonesa në ekzekutim e një titulli ekzekutiv.

Angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë po bëhen gjithnjë e më konkrete sidomos në planin e të drejtave të njeriut dhe të integritetit evropian. Këto angazhime po shoqërohen edhe me struktura administrative dhe juridiksionale vendimet e të cilave janë ndërkaq dhe do të jenë në të ardhmen drejtpërdrejt të detyrueshme dhe tituj ekzekutivë në sistemin juridik shqiptar. Shembulli shqiptar në këtë drejtim përdoret për keq në manualin e së drejtës ndërkombëtare duke patur parasysh mosrespektimin e vendimit të Gjykatës së Hagës mbi incidentin e Kanalit të Korfuzit. Dhe ka rrezik që referenca të mund të përsëritet po të kemi parasysh sidomos Gjykatën e Strasburgut apo edhe etapat e ardhshme të integritetit evropian.

Pra, vendimet e gjykatave ndërkombëtare, siç është Gjykata e Drejtësisë në Luksemburg dhe ajo e të Drejtave të Njeriut në Strasburg, në kuptimin procedural civil, nuk përbejnë tituj ekzekutivë

8

që vihen në zbatim drejtpërdrejt nga zyrat e përmbarimit. Shteti shqiptar ka përgjegjësi politike për zbatimin e këtyre vendimeve, referuar angazhimeve të marra përsipër në planin ndërkombëtar.

Është fakt se shumë shtete anëtare të Këshillit të Europës, nisur nga fakti që vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut nuk janë tituj ekzekutivë, në kuptimin që të jenë drejtpërdrejtë të zbatueshëm në vendet e tyre, kanë parashikuar statusin e një vendimi të tillë në legjislacionet e tyre proceduriale, duke i dhënë, p.sh. natyrën e një shkaku rishikues të vendimit të autoriteteve kombëtare etj.

Lidhur me vendimet e gjykatave të shteteve të huaja, neni 398 i Kodit të Proçedurës Civile parashikon se ato zbatohen në Republikën e Shqipërisë vetëm në bazë të vendimit të gjykatës së apelit që, nëpërmjet njohjes, i jep fuqi këtyre vendimeve, të cilat më pas ekzekutohen në përputhje me dispozitat e Kodit të Proçedurës Civile për ekzekutimin e detyrueshëm. E njëjta rrugë ndiqet edhe për vendimet e arbitrazhit të shtetit të huaj. Pra, **që këto vendime të përbëjnë tituj ekzekutivë e të vihen në ekzekutim nga zyra e përmbartimit, duhet që më parë të shprehet gjykata e apelit lidhur me to dhe, nëqoftëse ajo gjykatë bën njohjen formale të këtyre vendimeve, atëherë lëshon dhe urdhrin e ekzekutimit.**

PËRKUFIZIME

“Gjykatë” institucioni i vetëm shtetëror që ushtron pushtetin gjyqësor në përputhje me Kushtetutën dhe kompetencat e ngarkuara me ligj.

“Titull ekzekutiv”, është akti i lëshuar nga gjykatat ose organet kompetente shtetërore, i cili vërteton qënien e së drejtës subjektive të kreditorit dhe përcakton detyrimin e debitorit, i cili vihen në ekzekutim në mënyrë të detyrueshme nga shërbimi përmbartimor gjyqësor, pas lëshimit të urdhrin të ekzekutimit.

“Ekzekutim i detyrueshëm”, është procesi i ndërmarrë për vënien në ekzekutim të titujve ekzekutiv kur këto të fundit nuk ekzekutohen në mënyrë vullnetare nga subjektet pjesëmarrëse në konfliktin e zgjidhur nga akti i lëshuar nga organi kompetent shtetëror, të cilit këto të fundit i janë drejtuar për zgjidhjen e tij.

9

“Urdhër ekzekutimi”, është urdhri që lëshon gjykata pas kërkesës së paraqitur nga kreditori, me qëllim vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv.

“Dublikatë e urdhrin të ekzekutimit”, urdhri i lëshuar nga gjykata pas kërkesës së kreditorit për herë të dytë, në bazë të titullit ekzekutiv, kur urdhri i parë i ekzekutimit humbet ose zhduket.

“Kërkesë për vënien në ekzekutim” - kërkesa drejtuar përmbartuesit gjyqësor nga kreditori, për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv.

“Vënie në ekzekutim” - fillimi i procedurave të ekzekutimit të titullit ekzekutiv nga shërbimi përmbartimor gjyqësor, shtetëror ose privat, në bazë të kërkesës së kreditorit.

“Përmbartues gjyqësor” - është personi i ngarkuar me ligj për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Proçedurës Civile.

“Kreditor” - subjekt aktiv në marrëdhënien e detyrimit, me kërkesën e të cilit fillon ekzekutimi i detyrueshëm i titullit ekzekutiv.

“Debitor” - subjekt pasiv në marrëdhënien e detyrimit, ndaj të cilit fillon ekzekutimi i detyrueshëm.

“Tarifë e vënies në ekzekutim” - tarifë e detyrueshme për tu paguar për fillimin e ekzekutimit të urdhrin të ekzekutimit, e cila parapaguhet nga kreditori dhe pas përfundimit të procedurës së ekzekutimit i ngarkohet debitorit.

“Kompetence ekzekutimi”, Juridiksioni i përmbartuesit për ekzekutimin e urdhrin të ekzekutimit.

“Regjistër qendror”, regjistri i administruar nga Ministria e Drejtësisë, i cili pasqyron informacionin mbi çdo dosje për ekzekutim.

“Ekzekutimin vullnetar” - ekzekutimi i titullit ekzekutiv nga vet debitorit, brenda afatit të përcaktuar në lajmërimin për ekzekutim vullnetar të titullit ekzekutiv;

“Lajmërim për ekzekutim vullnetar” - lajmërimi i bërë nga përmbartuesi gjyqësor, debitorit, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban urdhri i ekzekutimit, brenda një afati të caktuar që nuk mund ti kalojë 10 ditët.

“Gjendje pasurore e debitorit” – Informacion mbi aftësitë paguese dhe pasuritë e debitorit, i

përfutur sipas verifikimeve të kryera pranë organeve përkatëse.

“*Afati i ekzekutimit*” – afati i përcaktuar në ligj për realizimin e ekzekutimit të plotë të titullit ekzekutiv.

10

“*Person i tretë*” (ose ekzekutim ndaj personit të tretë) - person i cili pretendon të jetë pronar i sendit mbi të cilin kryhet ekzekutimi.

“*Procesverbali*” - akti i mbajtur nga përmbauesi gjyqësor, për të faktuar çdo veprim të kryer prej tij, në të cilin përmenden dita dhe vendi i kryerjes së veprimit, kërkesat dhe deklaratimet e bëra nga palët, sendet e marra, shuma e nxjerrë dhe shpenzimet e bëra për ekzekutimin.

“*Shpenzime ekzekutimi*” - vlera akumulative e shpenzimeve të shërbimeve të kryera nga përmbauesit duke përfshirë tarifën e vënies në ekzekutim dhe pagesat e tjera që bëhen për kryerjen e veprimeve të caktuara të ekzekutimit, kur është e nevojshme.

“*Mjete ekzekutimi*”, veprimet që kryen përmbauesi gjyqësor me anën e të cilave realizohet ekzekutimi i detyrueshëm, kur ekzekutimi kryhet kundër vullnetit të debitorit.

“*Person i Huaj*”, është çdo person, me ose pa shtetësi, i cili, sipas legjislacionit shqiptar, nuk është shtetas shqiptar.

“*Person fizik*”, është personi fizik që gëzon zotësi të plotë për të pasur të drejta dhe detyrime civile, brenda kufijve të caktuar me ligj.

“*Person juridik*” - janë institucionet e ndërmarrjet shtetërore, që financohen vetë ose nga buxheti i shtetit, si dhe entet e tjera publike të njohura nga ligji si person juridik, si dhe shoqëritë, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji.

“*Sekuestro*”, heqja e së drejtës për të disponuar lirisht sendet e lidhura me sekuestrimin e pronarit të sendeve, deri në përfundimin e ekzekutimit të një titulli ekzekutiv.

“*Send i vënë në sekuestro*”, send i bllokuar për qarkullimin juridik-civil, deri në përfundimin e procedurës së ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

“*Llogari bankare*”, çdo llogari rrjedhëse në bankat e nivelit të dytë, që përdoret nga klienti debitor në marrëdhëniet me bankën dhe që mund të përdoret për kryerje pagesash në ngarkim të debitorit, llogari rrjedhëse, krediti, depozitë, llogari buxhetore etj.

“*Minimum jetik*”, niveli i të ardhura i përcaktuar me ligj, nën të cilin individët apo familjet konsiderohen të varfër, i cili shërben dhe si kriter për tu kualifikuar si përfitues i asistencës sociale.

“*Vendim i përmbauesit gjyqësor*” Akt procedural i përmbauesit gjyqësor.

“*Kredi me preferim*” janë kreditë e përcaktuara në nenin 605 të Kodit Civil.

11

“*Inventarizim*”, procesi i pasqyrimin të pasurisë së debitorit (përfshin vetëm sendet që ndodhen në shtëpinë e debitorit, si dhe ato që ndodhen në një ambient tjetër që është i përbashkët për debitorin dhe personat e tretë, përveç se kur del se ato janë të një personi tjetër) në procesverbalin përkatës.

“*Vlerësim*”, përcaktimi i vlerës së sendeve nga përmbauesi, i kryer sipas vlerësimeve të ekspertëve, të bazuara tek çmimet e tregut, duke u zbritur përqindja përkatëse e konsumimit ose e vjetërsisë së tyre.

“*Sende në bashkëpronësi*”, sende, pronësia dhe të drejtat e tjera reale mbi to, u përkasin bashkërisht dy ose më shumë personave.

“*Sende të çmuara*”, janë sendet me një vlerë të caktuar monetare të njohur botërisht, ku nuk përfshihen paratë dhe letrat me vlerë.

“*Dyqanet me shitje të lirë*”, dyqane pa kufizim blerësish apo ofertash.

“*Çmim*”, vlera e sendit të sekuestruar, e përcaktuar nga përmbaruesi, në bashkëpunim me kreditorin dhe debitorin dhe kur ka kundërshtime të përcaktuar nga eksperti i thirrur nga përmbaruesi.

“*Shitja e lire*”, shitja e sendeve dyqane e shitjes së lirë.

“*Ankand*”, procedura e shitjes nëpërmjet të cilës përcaktohen të drejtat e pronësisë që transferohen, në formën e ofertës së hapur, në bazë të çmimit më të lartë.

“*Ankand i dytë*”, procedura e shitjes së sendit me ofertë të hapur, që kryhet pas dështimit të ankandit të parë.

“*Blerës*”, personi ofertues që ka ofruar çmimin më të lartë për blerjen e sendit dhe kryen likuidimin e menjëhershëm të tij ose personi i cili në shitje në dyqanet e shitjes së lirë ka paguar vlerën e sendit.

“*Pasuri e paluajtshme*”, toka, burimet e rrjedhjet e ujërave, drurët, ndërtesat, ndërtimet e tjera notuese të lidhura me tokën dhe çdo gjë që është e trupëzuar në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose ndërtesën dhe e regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

“*Mjet lundrimi*”, është çdo anije apo barkë ose çdo strukturë që është e aftë për të lundruar.

“*Mjet fluturimi*”, është çdo lloj makinerie që siguron mbështetje në atmosferë nga reagimet e ajrit, ku përfshihet trupi i makinerisë, por nuk përfshihet motori i makinerisë.

12

“*Verifikim i së drejtës së pronësisë së debitorit*”, verifikimi i situatës juridike të pasurisë së debitorit pranë institucioneve shtetërore të cilave ligji i ka ngarkuar me kryerjen e veprimtarisë së administrimit të të dhënave mbi pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme dhe mbajtjen e regjistrave publik.

“*Kredi ndaj të tretit*”, është marrëdhënia juridike e detyrimit të krijuar midis debitorit dhe një personi të tretë, në bazë të së cilës është lëvruar një shumë monetare në favor të personit të tretë nga debitori, në këmbim të së drejtës së ripagimit të shumës së lëvruar dhe të interesit ose komisioneve të tjera mbi këto shuma.

“*Posedim*”, është sundimi efektiv i një personi mbi një send dhe mbi të drejtat e tjera reale mbi atë, i cili mund të ushtrohet drejtpërsëdrejti ose nga një person që mban sendin.

“*Dorëzim sendi*”, vendosja në posedim të sendit nga kreditorit.

“*Barre siguruese*”, është një e drejte reale mbi pasuri të paprekshme ose pasuri të luajtshme të prekshme, si të tashme ashtu dhe të ardhme, që siguron një ose me shume detyrime që kanë lindur përpara ose pas lidhjes së marrëveshjes siguruese.

“*Kreditor ekzekutues*” - është kreditori i pasiguarur i cili ka marrë masat e nevojshme për marrjen e kolateralit nga zyra e përmbarimit në zbatim të një urdhri ekzekutimi sipas Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

I. KUPTIMI I TITUJVE EKZEKUTIVË. RASTET.

Me tituj ekzekutiv kuptohen të gjithë ato akte, për të cilat ligji në mënyrë të shprehur përcakton se përmbajtja e tyre vihet në zbatim nëpërmjet ekzekutimit të detyrueshëm, pra nëpërmjet forcës shtrënguese të shtetit. Se cilat akte përbejnë tituj ekzekutivë, kjo përcaktohet në nenin 510 të Kodit të Procedurës Civile, ku thuhet :

"Ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv.

Janë tituj ekzekutivë:

a. vendimet civile të gjykatës që kanë marrë formë të prerë, vendimet e dhëna prej tyre për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm;

b. vendimet penale të formës së prerë në pjesën që bëjnë fjalë për të drejta pasurore;

c. vendimet e gjykatave e të arbitrazheve të shteteve të huaja që u është dhënë fuqi sipas dispozitave përkatëse të këtij Kodi;

ç. vendimet e një gjykate arbitrazhi në Republikën e Shqipërisë;

d. aktet noteriale që përmbajnë detyrim në të holla, si dhe aktet për dhënien e kredive bankare ose aktet për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare;

dh. kambialet, çequet e letrat me urdhër që barazohen me ato;

e. aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përbarimit për ekzekutimin e tyre."

Edhe nga leximi i kësaj dispozite, natyrshëm kuptohet se ekzekutimi i detyrueshëm dallohet në ekzekutim të detyrueshëm të zakonshëm, i cili realizohet në bazë të një titulli ekzekutiv-vendim gjyqësor dhe ekzekutim të detyrueshëm të posaçëm, i cili është ai që nuk realizohet në bazë të një vendimi gjyqësor, por në bazë të një akti tjetër të sanksionuar nga ligji si titull ekzekutiv.

Këto akte janë ato që përcaktohen në mënyra taksative nga pika d) dhe dh) e nenit 510 të K.Pr.C, si dhe ato, që sipas pikës e) të nenit 510, përcaktohen si tituj ekzekutiv nga vetë ligjet e veçanta.

1.1 Vendimet civile te gjykatës, si tituj ekzekutivë.

Siç dihet, gjykimi civil, në një kuptim të gjerë të fjalës, përbëhet nga dy faza: së pari, nga gjykimi në themel i çështjes, e cila ka për mision deklarin e shkeljes apo cënimit të së drejtës, me një vendim përfundimtar dhe, së dyti, nga ekzekutimi i detyrueshëm që ka për qëllim rivendosjen e plotë të saj, nëpërmjet forcës shtrënguese të shtetit.

Rastet kur një vendim gjyqësor civil merr formë të prerë përcaktohen në nenin 451 të Kodit të Procedurës Civile dhe janë: kur ndaj vendimit nuk mund të bëhet ankim; ndaj vendimit nuk është bërë ankim brenda afatit ligjor, ose ankesa është tërhequr; ankesa e paraqitur nuk është pranuar, si dhe kur vendimi i gjykatës është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë. Megjithatë shtrohet çështja nëse janë apo jo të gjitha vendimet gjyqësore civile të formës së prerë tituj ekzekutivë, të tillë që zbatimi i tyre të realizohet nëpërmjet procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm.

14

Nëse gjykimi civil vihet në lëvizje nga paditësi, ekzekutimi i detyrueshëm vihet në lëvizje nga kreditori ose gjyqfituesi, i cili, për të investuar zyrën e përbarimit, i duhet më parë të kërkojë nga gjykata të lëshojë urdhrin e ekzekutimit për vendimin gjyqësor-titull ekzekutiv. Pas kësaj, ai me kërkesë i drejtohet përbaruesit gjyqësor. Megjithatë, ka disa raste përjashtimore, të përcaktuara në mënyrë taksative nga ligji, kur nuk është nevoja për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit nga gjykata, pasi titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim drejtpërdrejt nga përbaruesi gjyqësor, siç do ta shohim më poshtë. Kjo del e qartë në nenin 511/1 të K.Pr.C., ku thuhet :

"Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim me kërkesën e kreditorit. Për këtë qëllim lëshohet urdhri i ekzekutimit..."

Ashtu siç mund të kuptohet dhe nga kjo dispozitë, por edhe siç ka konsoliduar qëndrimin e saj dhe praktika gjyqësore e shumë viteve, mund të lëshohet urdhri i ekzekutimit, që i hap rrugë ekzekutimit të detyrueshëm, vetëm për ato vendime gjyqësore civile të formës së prerë, të cilët kanë disponuar mbi një padi detyrimi, pra, që përmbajnë në dispozitivet e tyre urdhërime detyruese për njërën ose të dyja palët në gjykim. Pra, jo çdo vendim gjyqësor i formës së prerë përbën titull ekzekutiv, në kuptimin që të jetë objekt i ekzekutimit të detyrueshëm. **Detyrimi përmbajtur në këto vendime duhet të jetë:**

a) përfundimtar, që do të thotë që vendimi të ketë marrë formë të prerë;

b) i plotë, kur detyrimi është i kërkueshëm, i saktë dhe i caktuar;

Përcaktimi i elementëve që e bëjnë detyrimin, e përmbajtur në vendimin gjyqësor-titull

ekzekutiv, të plotë, është mjaft i rëndësishëm. P.sh., lind problemi në rastin kur në vendimin e saj, gjykata, veç përcaktimit të detyrimit kryesor, në terma konkrete, disponon edhe për detyrimin për pagimin e kamatëvonesës apo interesit deri në ditën e ekzekutimit të vendimit. Në një rast të tillë, detyrimi do të ishte i përcaktuar në mënyrë të plotë dhe të saktë, nëse gjykata do të fiksonte në dispozitivin e vendimit mënyrën, formulën apo normën e interesit ose kamatëvonesës, në mënyrë që përmbartuesit gjyqësor t'i mbetej si detyrë në fazën e ekzekutimit vetëm përlllogaritja në bazë të kësaj formule, mënyrë a norme interesi. Në mungesë të këtij parashikimi në vendim, përparuesi mund të vendosë/përzgjedhë në diskrecionin e tij, por kjo veprimtari ngelet e ekspozuar ndaj kundërshtimit në gjykatë. Për ta ilustruar idenë mund të përmendim mënyrën e formulimit të dispozitivit të vendimit të Gjykatës Europiane të Drejtave

15

të Njeriut në Strasburg, e cila, veç masës së shpërblimit të dëmit, përcakton edhe normën konkrete të interesit që do të përdoret për llogaritjen e kamatëvonesës nga dita kur duhet të ekzekutohet vendimi, deri në ditën kur ai ekzekutohet efektivisht.

Nisur nga sa më lart, duhet kuptuar se puna e përmbartuesit gjyqësor nuk mund të konceptohet kaq mekanike dhe automatike sa të përjashtohet edhe nga një punë e tillë përlllogaritëse, mbi bazën e "formulës" së parashikuar nga gjykata në vendim. Kjo nuk përjashton, në çdo rast apo rast pas rasti, angazhimin edhe të një eksperti përkatës, mjaft që kjo punë të mos çënojë vullnetin e gjykatës për zgjidhjen e çështjes, vullnet i shprehur në vendimin përfundimtar të saj. Madje kjo do të ishte mënyra më saktë dhe jo ajo siç është vërejtur në mjaft raste të praktikës gjyqësore, ku gjykata llogarit interesin apo kamatëvonesën deri në ditën e dhënies së vendimit. Kjo do të linte "zbuluar" periudhën deri sa vendimi të marrë formë të prerë dhe atë deri në vënien në ekzekutim të tij, gjë që eventualisht mund të zgjasë në mënyrë të konsiderueshme.

Gjithashtu, në një rast pjesëtimi pasurie, njëra nga palët mund të kërkojë që, për t'i dhënë rrugë pa pengesa ekzekutimit të vendimit, pasi ky të ketë marrë formë të prerë, t'i lihet asaj një pjesë e caktuar e pasurisë, duke hequr dorë nga e drejta për kompensim nga pala tjetër. Pra, në një mënyrë apo një tjetër, kërkon caktimin e një pjesë konkrete të pasurisë, në këmbim të faljes së detyrimit të palës tjetër për ta kompensuar atë, sipas projektit të pjesëtitimit, i cili e parashikon një gjë të tillë për efekt të barazimit të pjesëve takuese. Në këtë rast nuk mund të pranohet kjo mënyrë e shuarjes së detyrimit me falje, siç përcakton Kodi Civil, pasi detyrimi ende s'ka lindur, deri sa vendimi i pjesëtitimit të marrë formë të prerë. Një gjë e tillë i lihet fazës së ekzekutimit të vendimit, nëse çmohet nga palët.

Një rast tjetër është ai i parashikuar nga neni 395 i Kodit të Procedurës Penale, ku thuhet se kur provat e marra nuk mundësojnë saktësimin e dëmit, gjykata disponon për të drejtën e shpërblimit të dëmit në tërësi dhe ia dërgon aktet gjykatës civile. Në këtë rast, titullin ekzekutiv që do vihej në ekzekutim do ta përbënte vendimi i gjykatës civile dhe jo vendimi penal.

c) i pakushtëzuar, kur ekzekutimi i tij nuk është i lidhur as me afat, as me kusht dhe as me ndonjë kufizim tjetër;

Kur flasim për detyrim të pakushtëzuar ose pa kufizime, kemi parasysh se ekzekutimi i detyrueshëm, kur ekzistojnë kufizime të tilla, do të fillojë vetëm kur këto kufizime të mos

16

ekzistojnë më. Janë vendime të tilla detyruese të pakushtëzuara ato që kanë të bëjnë me detyrimin e palës për pagimin e një shume të hollash, dorëzimin e një sendi, shembjen e një ndërtimi, kthimin në vendin e mëparshëm të punës, pagimit të pensionit ushqimor etj.

Nisur nga sa më lart kuptohet se nuk mund të lëshohet urdhër ekzekutimi dhe as të investohet përmbartuesi gjyqësor për vendimet gjyqësore për vërtetimin e një fakti juridik, ato të dhëna mbi padi njohjeje, për vendimet gjyqësore që anulojnë apo shfuqizojnë një akt administrativ (me

përbashkë të vendimit të ndërmjetëm për pezullimin e zbatimit të aktit administrativ, sipas nenit 329 të K.Pr.C) apo ndryshojnë një vendim të autoritetit të kthimit dhe kompensimit të pronave, si dhe të gjitha ato vendime që, për nga natyra e tyre, kanë karakter deklarativ. Vendime të tilla njihëse mund të shërbejnë më vonë si bazë për dhënien e vendimeve me karakter detyrues.

d) të përmbushë kushtet e formës (p.sh. duhet të përmbajë nënshkrimin e gjyqtarit/gjyqtarëve, vulën e gjykatës etj.).

1.2 Vendimet civile për sigurimin e padisë, si titull ekzekutiv.

Kur flasim për vendimet civile të dhëna për sigurimin e padisë, kemi parasysh ato të dhëna mbi bazën e rregullimit ligjor të parashikuar nga nenet 202-208 të Kodit të Procedurës Civile, neni 329, 609/3, si dhe neni 418 për rastin kur vendimi për sigurimin e padisë është dhënë nga gjykata e arbitrazhit. Në nenin 206 të K.Pr.Civile, ndër të tjera, thuhet:

"Sigurimi i padisë bëhet:

a) me sekuestrimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe të kredive të debitorit;

b) me marrjen nga ana e gjykatës të masave të tjera të përshtatshme, duke përfshirë edhe pezullimin e ekzekutimit."

Këtu i duhet kushtuar rëndësi e veçantë formulimit të dispozitivit të vendimit për sigurimin e padisë, në mënyrë që ai të jetë i ekzekutueshëm. Për këtë, gjykata duhet të ketë paraprakisht të dhëna të sakta, të bazuara në prova lidhur me, p.sh., ekzistencën e një pasurie të paluajtshme (faktin e regjistrimit në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nëpërmjet vërtetimit përkatës), pasurinë e luajtshme (një automjet i regjistruar në Drejtorinë e Shërbimit të Transportit Rrugor), llogarinë bankare etj. Barrën e paraqitjes së këtyre të dhënave kuptohet që e ka

17

kërkuesi. Gjithsesi, kur çështja është e ngutshme dhe koha nuk premt për sigurimin e këtyre të dhënave apo këtij informacioni, në mënyrë të saktë dhe të plotë, mund të ndodhë që gjykata të disponojë në mënyrë të përgjithshme vënien e sekuestros apo bllokimit të shumave a pasurive deri në një masë të caktuar, që i korrespondon masës së detyrimit të pretenduar, që përbën dhe objektin material të padisë. Në këtë rast të fundit përmbartuesi gjyqësor duhet të jetë i kujdesshëm që të mos tejkalojë përmbajtjen e vendimit gjyqësor, por ta konkretizojë atë nëpërmjet procesit të ekzekutimit.

Nga ana tjetër shtrohet çështja se si do të veprohet përse i përket disponimit të gjykatës lidhur me vendosjen e garancisë, për rastet kur kërkuesi i masës së sigurimit të padisë jep garanci sipas përcaktimit të nenit 202/b të Kodit të Procedurës Civile. Është i thjeshtë dhe lehtësisht i kuptueshëm rasti kur kërkuesi ka depozituar paraprakisht një shumë të hollash, si në rastin e garancisë pasurore, si masë e sigurimit personal në procesin penal, ose ka hipotekuar një pasuri të paluajtshme për llogari të përfundimit të procesit dhe gjykata, pas paraqitjes së vërtetimit të depozitës bankare apo vërtetimit të pronësisë, urdhëron ngurtësimin e parave ose moslejimin e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për kryerjen e veprimeve juridike lidhur me këtë pasuri të paluajtshme.

Por ndodh që gjykata të pranojë kërkesën për sigurimin e padisë dhe njëkohësisht të urdhërojë kërkuesin që, brenda një afati të caktuar, të paguajë një shumë të caktuar si garanci. Si veprohet nëse kjo garanci nuk ofrohet nga kërkuesi/paditësi brenda afatit të përcaktuar në dispozitivin e vendimit të gjykatës që ka pranuar kërkesën për sigurimin e padisë? Në këtë rast, ndonëse vendimi për sigurimin e padisë është titull ekzekutiv dhe i ka prodhuar efektet në mënyrë të menjëhershme, masa e sigurimit e vendosur nëpërmjet tij bie, nëse nuk është plotësuar kushti/detyrimi i vendosur nga gjykata. Pra, nuk ka nevojë që gjykata të shprehet sërish për revokimin apo zëvendësimin e masës për sigurimin e padisë, por është përmbartuesi që vepron kryesisht ose me kërkesën e personit të interesuar, me të konstatuar situatën e përshkruar më lart.

Po këtu duhet përmendur dhe parashikimi i nenit 211/3 të Kodit të Procedurës Civile, ku thuhet se garancia e dhënë sipas nenit 202, i kthehet paditësit, vetëm atëherë kur brenda 15 ditëve pasi vendimi të ketë marrë formë të prerë, pala tjetër nuk ka paraqitur padi për shpërblimin e dëmit për një shkak të tillë. Pra, nëse pala tjetër, brenda 15 ditësh nga dita që vendimi i rrëzimit të padisë ose pushimit të gjykimit ka marrë formë të prerë, paraqet padi për shpërblimin e dëmit të

18
shkaktuar për shkak të sigurimit të padisë, atëherë garancia e dhënë nga paditësi nuk i kthehet atij. Kuptimi i këtij parashikimi është se mosdhënia e kësaj garancie paditësit, duhet konsideruar si një mase për sigurimin e padisë se re për shpërblimin e dëmit, që tashmë ka ngritur pala tjetër ndaj paditësit të parë (tashmë i paditur).

Gjithashtu vlen të theksohet se përbëjnë tituj ekzekutive vetëm ato vendime të gjykatës që lejojnë marrjen e masave për sigurimin e padisë, pasi ankimi ndaj tyre nuk e pezullon ekzekutimin. Ndërkohë nuk janë tituj ekzekutivë dhe nuk ekzekutohen pa marrë formë të prerë, vendimet për heqjen ose zëvendësimin e masës së sigurimit të padisë, sipas nenit 207 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo pasi ankimi ndaj këtyre vendimeve pezullon ekzekutimin e tyre, gjë që përcaktohet në nenin 210 të Kodit të Procedurës Civile.

Vendimi për marrjen e masës për sigurimin e padisë qëndron në fuqi edhe pas përfundimit të shqyrtimit në themel të çështjes dhe dhënies së vendimit nga gjykata e shkallës së parë, deri sa të shprehet gjykata e apelit, nëse ka ankim dhe në varësi të vendimit të kësaj të fundit. Kështu nëse pranohet padia, ligjërohet masa; nëse rrëzohet padia, hiqet masa, por ajo mbetet në fuqi deri sa gjykata e apelit të vendosë, eventualisht, lënien në fuqi të vendimit të rrëzimit të padisë të dhënë nga gjykata e shkallës së parë; e njëjta gjë ndodh nëse pushohet gjykimi i çështjes. Pra, siç shikohët, bëhet fjalë për rastet kur ndaj vendimit të shkallës së parë ushtrohet ankim nga njëra ose të dyja palët. Në të kundërt, vendimi merr formë të prerë, duke përcaktuar edhe fatin e masës së sigurimit, me kalimin e afatit ligjor. Vlen të theksohet se masa e sigurimit, nëse është pranuar padia, qëndron në fuqi deri ditën kur vendimi gjyqësor përfundimtar ekzekutohet plotësisht.

Një moment mjaft i rëndësishëm që meriton trajtim është dhe ai nëse vendimet e gjykatës, sipas nenit 329 të Kodit të Procedurës Civile, për pezullimin e zbatimit të aktit administrativ, si dhe ato sipas nenit 609/3 të Kodit të Procedurës Civile, për pezullimin e titullit ekzekutiv për të cilin kërkohet pavlefshmëria, janë apo jo masa për sigurimin e padisë apo kanë karakterin e tyre dhe, si të tilla, përbëjnë tituj ekzekutivë, në kuptim të nenit 510/a të Kodit të Procedurës Civile.

Ndonëse këto raste nuk parashikohen në kreun IV të Kodit të Procedurës Civile, “Sigurimi i padisë”, referuar situatave që janë bërë shkak për parashikimet e këtyre dispozitave, mënyrës së formulimit të këtyre të fundit, frymës së ligjit, në thelb, natyra e këtyre vendimeve është ajo e masave për sigurimin e padisë, që përbëjnë titull ekzekutiv dhe vihen në ekzekutim nga zyra e përbarimit, ndonëse nuk parashikohen si të tilla shprehimisht në nenin 510/a të Kodit të

19
Procedurës Civile. Edhe argumentimi duke u nisur nga e kundërta të çon në njëjtin konkluzion: nuk do të kishte asnjë kuptim, nëse pezullimi i zbatimit të aktit administrativ apo pezullimi i ekzekutimit të vendimit do të hynin në fuqi e do të ekzekutoheshin pasi këto vendime të ishin lënë në fuqi nga gjykata e apelit, pas shqyrtimit të ankimit të palës së interesuar?! Edhe praktika gjyqësore ka ecur në këtë drejtim.

Përsa i përket pezullimit të zbatimit të aktit administrativ, Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrimin unifikues se një gjë e tillë mund të kërkohet, duke përdorur si bazë ligjore nenin 329 dhe jo 202 të Kodit të Procedurës Civile. Shpesh herë në praktikë është diskutuar nëse mund të pezullohet zbatimi i aktit administrativ të policisë së ndërtimit që disponon për prishjen e një objekti. Në ligjin përkatës thuhet se ankimi i këtij akti në gjykatë, në vetvete nuk pezullon zbatimin e tij.

Kjo do të thotë se gjykata duhet të disponojë me vendim të veçantë nëse pezullon ose jo zbatimin e një akti të tillë, nëse ka kërkesë nga pala e interesuar.

Lidhur me rastin kur kërkohet me padi pavlefshmëria e një titulli ekzekutiv, në nenin 609/3 të Kodit të Procedurës Civile, thuhet se gjykata shqyrton shpejt çështjen dhe mund të vendosë pezullimin e vendimit me ose pa garanci. Mendojmë që edhe në këtë rast duhet përdorur si bazë ligjore pikërisht kjo dispozitë. Kjo pasi, edhe pse nëpërmjet këtyre dispozitave palët, në thelb, synojnë të arrijnë pak a shumë të njëjtin rezultat me atë të sigurimit të padisë, përsëri çdo rast mund të paraqesë veçanti dhe, për rrjedhojë, merr rëndësi të bazuarit në një dispozite konkrete dhe specifike.

Siç nënvizohet dhe më lart, neni 609/3 përdor termin pezullim vendimi. Por a kuptohet me këtë vetëm vendimi gjyqësor si titull ekzekutiv apo më gjerë, çdo titull ekzekutiv. Gjykatat kanë çmuar se, nisur nga titulli i dispozitës, që është pavlefshmëria e titullit ekzekutiv, interpretimi logjik dhe sistematik ndërmjet paragrafëve të së njëjtës dispozitë, bëhet fjalë për titujt ekzekutivë në përgjithësi. Paragrafi i tretë i nenit 609 të sipërcituar i referohet dispozitës në tërësi dhe jo thjesht paragrafit të dytë.

Një rast që do të na vinte në ndihmë të interpretimit të mësipërm, do të ishte ai kur një subjekt kërkon me padi në gjykatë deklarimin e pavlefshmërisë së titujve ekzekutive-akte te autoriteteve doganore mbi borxhet doganore të subjektit, të cilat, sipas Kodit Doganor, përbëjnë tituj ekzekutive. Për këtë, subjekti kërkon pezullimin e zbatimit të tyre, zbatim për të cilin autoritetet

20
doganore kanë vendosur moslejimin e kryerjes se veprimeve të import-eksportit nga ana e subjektit, deri në shlyerjen e borxhit doganor nga ky i fundit.

Ndërkohë autoritetet doganore kanë pretenduar nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, në kuptim të nenit 60/1 të Kodit të Procedurës Civile. Në nenin 60/2 të K.Pr.C sanksionohet se në këtë rast gjykimi i filluar pezullohet, deri sa Gjykata e Lartë të japë vendim për zgjidhjen e mosmarrëveshjes për juridiksionin dhe gjykata mund të marrë vetëm masa për sigurimin e padisë. Në rast se gjykata do të vendoste pezullimin e zbatimit të titullit ekzekutiv, atëherë a do të përbënte kjo një masë për sigurimin e padisë, siç formulon vetë neni i sipërcituar? Referuar edhe asaj që u parashtrua më lart, përgjigja në këtë rast do të ishte pozitive.

Vlen të theksohet se rast tjetër që mund të konsiderohej masë për sigurimin e padisë ishte dhe ai i parashikuar nga neni 365 i Kodit të Procedurës Civile (shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Kodit të ri të Familjes), si "Marrja e masave të përkohshme", që kishte të bënte me detyrimin për ushqim, sigurimin e banesës etj. Një gjë e tillë parashikohet tashmë në nenin 139 të Kodit të Familjes. Në këtë dispozitë thuhet se këto masa të përkohshme kanë fuqi deri në marrjen e vendimit përfundimtar. Pra, ndonëse nuk përcaktohen në mënyrë taksative si masa për sigurimin e padisë dhe as nuk përmenden në nenin 510/a të Kodit të Procedurës Civile, këto vendime janë tituj ekzekutive. Kuptimi i tyre si masa për sigurimin e padisë i bën të tilla dhe krijon shtratin ligjor që të vihen në ekzekutim nga zyra e përmbarimit. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për ato që parashikohen si masa urgjente në nenin 61 të Kodit të Familjes.

1.3 Vendimet me ekzekutim të përkohshëm, si tituj ekzekutivë.

Këto vendime janë ato të përcaktuara në nenin 317 të Kodit të Procedurës Civile, ku thuhet:

"Vendimi i gjykatës mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm, kur është vendosur:

a) detyrimi për ushqim;

b) për shpërblimin nga puna;

c) për rivendosjen në posedimin e banesës bashkëshortore.

Vendimi mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm edhe kur nga vonesa e ekzekutimit, paditësi mund të pësojë dëme të rëndësishme, që nuk mund të vihen në vend, ose kur

ekzekutimi i vendimit do të bëhej i pamundur, ose do të vështirësohej së tepërmi. Në këtë rast gjykata mund të kërkojë që paditësi të japë një garanci."

Siç mund të kuptohet dhe nga paragrafi i fundit, veç rasteve të përmendura në mënyrë taksative, kushtet që një vendim përfundimtar të jepet me ekzekutim të përkohshëm, pra, ende pa marrë formë të prerë, janë të njëjta me ato për marrjen e masës së sigurimit të padisë. Një rast tjetër kur vendimi jepet me ekzekutim të përkohshëm nga gjykata është dhe ai i parashikuar nga neni 396 i Kodit të Procedurës Penale, ku thuhet se "***Me kërkesën e paditësit civil, kur ekzistojnë shkaqe të përligjura, detyrimi për kthimin e sendit dhe shpërblimin e dëmit shpallet i ekzekutueshëm përkohësisht."***

Siç shihet, kjo dispozitë ka karakter indikativ e jo shterues, në kuptimin që pasi jep disa raste se kur vendimi mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm, parashikon se gjykata ka diskrecion ligjor ta bëjë një gjë të tillë edhe në raste të tjera, kur nga vonesa e ekzekutimit, paditësi mund të pësojë dëme të rëndësishme, që nuk mund të vihen në vend, ose kur ekzekutimi i vendimit do të bëhej i pamundur, ose do të vështirësohej së tepërmi. Dhënia e garancisë në këtë rast nuk është e detyrueshme, por vetëm nëse vlerësohet prej gjykatës.

Megjithatë, dy nga tre rastet e parashikuara në mënyrë taksative nga kjo dispozitë, kanë të bëjnë me çështje familjare, siç është detyrimi për ushqim dhe rivendosja në posedim e banesës bashkëshortore. Duke marrë shkas edhe nga fakti se Shqipëria është dënuar nga Gjykata e Strasburgut për shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, në rastin Bajramaj kundër Shqipërisë, pasi ka dështuar në ekzekutimin e vendimit lidhur me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe së drejtës për takimin e fëmijës, është me rëndësi trajtimi i ekzekutimit të detyrueshëm në çështjet familjare. Kjo merr rëndësi veçanërisht në rastet kur bashkëshorti, të cilit i është besuar fëmija për rritje dhe edukim, nuk jeton në Shqipëri.

Në fakt, ekzekutimi i vendimeve në fushën e së drejtës familjare nuk i nënshtrohet dispozitave të veçanta, të ndryshme nga ato që parashikon Kodi i Procedurës Civile për të gjithë titujt ekzekutivë, përfshi edhe vendimet gjyqësore për çështje familjare. Kështu, sa i takon pagesës së shumës në të holla, që përbën detyrimin për ushqim, ekzekutimi ndjek rregullat e kreut I, të titullit II, të Kodit të Procedurës Civile, "***Ekzekutimi i detyrimeve në të holla kundrejt personave fizikë e juridikë"***, por edhe krerëve të tjerë, siç mund të jetë rasti kur debitori ka shuma të

22

depozituara në llogari bankare (kreu VI); sa i takon rivendosjes në posedim të banesës bashkëshortore, zbatohen rregullat e parashikuara në nenin 602, "***Vënia në posedim e sendit të paluajtshëm"***; sa takon realizimit të së drejtës së takimit me fëmijën, janë të aplikueshme, ndër të tjera, rast pas rasti, dispozitat e kreut VIII, "***Ekzekutimi i detyrimit për kryerjen e një veprimi të caktuar"***, por jo vetëm.

Në rastet kur debitori nuk ndodhet në Shqipëri, përmbaruesi gjyqësor duhet të shfrytëzojë të gjitha parashikimet e instrumenteve ndërkombëtarë të ratifikuara prej vendit tonë dhe që janë në fuqi, në mënyrë që të bëhet i mundur zbatimi i vendimit gjyqësor, qoftë nëpërmjet dorëzimit të akteve a njoftimeve autoriteteve respektive të shtetit të kërkuar, qoftë duke kërkuar nga këto të fundit ekzekutimin vetë të vendimit. Këto janë instrumente dypalëshe ose shumëpalëshe. Për qëllime të këtij manuali, po i përmendim (gjithashtu bashkangjitur gjendet dhe tekstet e tyre), në mënyrë që përmbaruesit t'i referohen e të bazohen gjatë veprimtarisë së tyre, për të përmbushur misionin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

Tek instrumentet dypalëshe, që janë relevante për fushën civile, përfshi edhe çështjet familjare, janë: *Konventa ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Greqisë për ndihmën gjyqësore në fushën civile dhe penale*, e ratifikuar me ligjin nr. 7760, datë 14/10/1993; *Marrëveshja ndërmjet*

Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Bullgarisë për ndihmë të ndërsjellët juridike në çështjet civile, ratifikuar me ligjin me nr. 9348, datë 24/02/2005; *Marrëveshja ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Maqedonase për ndihmën juridike në fushën civile dhe penale*, ratifikuar e ligjin me nr. 8304, datë 12/03/1998; *Konventa për ndihmën e ndërsjellët gjyqësore në fushat civile, tregtare dhe penale ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë*”, ratifikuar e ligjin me nr. 8036, datë 22/11/1995.

Sa i takon instrumenteve ndërkombëtare shumëpalëshe veçojmë: *Konventa e Konferencës së Hagës “Për procedurën civile”*, në të cilën Shqipëria ka aderuar nëpërmjet ligjit me nr. 10 182, datë 29/10/2009; *Marrëveshja Europiane për Transmetimin e Kërkesave të Ndihmës Gjyqësore*, ratifikuar me ligjin me nr. 8705, datë 01/12/200; *Konventa Për Njoftimin dhe Dorëzimin Jashtë Shtetit të Dokumenteve Gjyqësore dhe Jashtëgjyqësore*, ku Shqipëria ka aderuar me ligjin me nr. 9554, datë 08/06/2006; *Konventa Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit*, ku Shqipëria ka aderuar me ligjin me nr. 8688, datë 09/11/2000; *Konventa Për*

23
Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja në fushën Civile dhe Tregtare, ku Shqipëria ka aderuar me ligjin me nr. 10 194, datë 10/12/20009.

Në çështjet familjare është shumë e rëndësishme që diapozitivi i vendimit të gjykatës të jetë i plotë, i qartë dhe të parashikojë në shkallën më të madhe të mundshme detajet e përgjegjësive prindërore, të drejtën e takimit, detyrimin për ushqim etj. Gjykata duhet të bëjë vlerësimin e mundësisë konkrete të ekzekutimit të vendimit të dhënë nga ana e saj në mënyrë që interesi më i lartë fëmijës të bëhet realitet. Vlen të mbahet në vëmendje se me ndryshimet që ka pësuar Kodi i Procedurës Civile në këtë drejtim, kur bëhet fjalë për ekzekutimin e titulli ekzekutiv-vendim gjyqësor me objekt “Takim dhe kujdestari fëmije”, përmbaruesi gjyqësor duhet të kërkojë asistencën e psikologut (n. 523/4 i K.Pr.C).

Një nga çështjet me të cilën është marrë në mënyrë sasiore GJEDNJ-ja, janë ato që kanë të bëjnë me pyetjen e vështirë lidhur me mjaftueshmërinë e masave të ndërmarra nga gjykatat kombëtare ose autoritetet të tjera me qëllim që të ekzekutohen këto vendime dhe të garantohet e drejta e prindërve për të pasur marrëdhënie me fëmijët e tyre në funksion të interesit më të lartë të fëmijës. *M.C. kundër. Bullgarisë* dhe raste të tjera janë shembuj tipikë të rritjes së tendencës së GJEDNJ-së për të vënë gishtin mbi interpretimin dhe zbatimin e legjislacionit të brendshëm nga gjykatat kombëtare dhe autoritetet e tjera, por gjithashtu në mjaftueshmërinë e masave konkrete të ndërmarra prej tyre me qëllim që të sigurohet zbatimi i vendimit të tyre. Këto hapa adekuate të ndërmarra nga autoritetet vendase përgjithësisht janë analizuar nga GJEDNJ në kontekstin e detyrimeve pozitive që duhet të ndërmerren nga shtetet.

Çështja e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, dhe e respektimit të nenit 6 dhe 8 të KEDNJ-së, në kontekstin e masave adekuate të ndërmarra nga autoritetet për të realizuar marrëdhëniet prind fëmijë, ka qenë një çështje e gjykuar disa herë në GJEDNJ. Kështu në çështjen *Pini dhe të tjerë kundër Italisë*, ndërsa gjykata konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ, nuk arriti në po këtë konkluzion lidhur me nenin 8. Duke marrë për bazë interesin e fëmijëve dhe kundërshtimin që këta kishin bërë për birësimin, gjykata vlerësoi se nuk kishte një detyrim absolut të autoriteteve për të siguruar që fëmijët të linin vendin kundër vullnetit të tyre dhe të injoronin pezullimin e procesit në rastin kur ishte kundërshtuar (apeluar) vendimi parë.

24

Sa i përket të drejtës së banimit pas zgjidhjes së martesës, një vendim i fundit i gjykatës Kushtetuese të Italisë (vendimi me nr. 308, datë 30.7.2008), ka nënvizuar se banesa familjare i lihet në përdorim prindit të cilit i është lënë kujdestaria e fëmijës pas zgjidhjes së martesës. Kjo gjykatë ka quajtur të pabazuar vendimin e dhënë nga disa gjykata, të cilat kanë disponuar

ndryshe mbi të drejtën e banimit pas zgjidhjes së martesës, nisur nga fakti se bashkëshorti të cilit i janë lënë fëmijët ka lidhur një martesë apo bashkëjetesë të re. Në këtë mënyrë, Gjykata Kushtetuese thekson se “në këtë rast, qëllimi i legjislatorit ka qenë mbrojtja e interesit të të miturit dhe nuk ka të bëjë me ndryshimin e statusit të prindit”. Kur bashkëshortët zgjidhin martesën, gjyqtarit i paraqitet problemi i të drejtës së banimit të prindërve dhe të fëmijëve. Marrëdhëniet me fëmijët në rast zgjidhjeje martese dhe lënia e fëmijëve njërit prind kanë qenë çështje të sjella në GJEDNJ. Fokusi i tyre ka qenë në efektivitetin e masave dhe të mjeteve të ndërmarrë nga gjykatat e shteteve dhe autoritetet administrative, siç është zyra e përmbarimit, me qëllim që të sigurohet kujdestaria e fëmijës dhe mbajtja e marrëdhënieve me prindin. Këto çështje kanë pasur shpesh herë edhe një element ndërkufitar dhe kanë përfshirë edhe zbatimin e Konventave të Hagës. Të tilla janë çështjet e vitit 2005: *Zaëadka kundër Polonisë; Bove kundër Italisë dhe Reigado Ramos kundër Portugalisë*. Që të gjitha që kanë lidhje me të drejtën e atit për marrëdhënie me fëmijët: rasti *H.N. kundër Polonisë*, i cila ka të bëjë me urdhërimin për kthimin e fëmijës tek i ati; *Karadžić kundër Kroacisë*, lidhur me masat adekuate të marra nga autoritetet Kroate për kthimin e një fëmije pranë nënës në Gjermani; rasti Bajramaj kundër Shqipërisë.

1.4 Vendimet penale të formës së prerë, si tituj ekzekutivë.

Lidhur me vendimet penale të formës së prerë, siç del dhe nga formulimi i dispozitës, ato do të konsiderohen tituj ekzekutive vetëm për atë pjesë ku disponohet për të drejta pasurore. Tre janë rastet kur vendimi penal i formës së prerë disponon mbi të drejta pasurore. Së pari, kur është disponuar mbi padinë civile të paraqitur dhe të pranuar për shqyrtim në procesin penal. Në këtë rast është vetë personi që i janë njohur të drejta pasurore, pra, kreditori (i dëmtuari civil), ai që do të kërkojë lëshimin e urdhrit të ekzekutimit nga gjykata dhe, më pas, vënien në ekzekutim nga zyra e përmbarimit, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile.

Në rast se pala e dëmtuar gjyqfituese është shteti, atëherë organi kompetent shtetëror vepron sipas mënyrës së sipërcituar dhe, në mungesë të tij, prokurori ka të drejtë të urdhërojë

25

drejtpërdrejt ekzekutimin e vendimit nga zyra e përmbarimit. Sa më lart parashikohet në nenin 15 të Ligjit 8331, datë 21/04/1998, "*Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale*". Përderisa ky përbën një ligj specifik, mund të themi se nuk çënohet parashikimi i nenit 511/a të Kodit të Procedurës Civile, që përcakton gjykatën si kompetente për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit.

Nga ana tjetër, në nenin 395/1 të Kodit të Procedurës Penale, thuhet se në rast pamundësie të saktësisimit të dëmit, gjykata disponon për të drejtën e shpërblimit të dëmit në tërësi dhe ia dërgon aktet gjykatës civile. Në këtë rast, ky vendim nuk mund të ekzekutohet për pjesën që disponon për të drejtën civile, pa u shprehur më parë gjykata civile lidhur me dëmin konkret, në përmbushje të elementëve të sipërpërmendur të titullit ekzekutiv, të ekzekutueshëm mbi bazën e lëshimit të urdhrit të ekzekutimit.

Në paragrafin e dytë të kësaj dispozite shkohet më tej, kur parashikohet se me kërkesën e paditësit civil në procesin penal, i pandehuri dhe/ose i padituri civil mund të detyrohen të paguajnë një shumë të përafërt me dëmin që çmohet se është provuar gjerë atëherë. Madje ky detyrim ekzekutohet menjëherë, pa kërkuar që vendimi të ketë marrë formë të prerë. Në këtë rast, statusin e një vendimi me ekzekutim të përkohshëm, këtij vendimi ia jep ligji e jo gjykata. Kuptimi është që për pretendime të mëtejshme, dëmi saktësohet a plotësohet nëpërmjet dërgimit të akteve gjykatës civile.

Ndryshon fjala kur bëhet fjalë për situatën e parashikuar nga neni 396 të Kodit të Procedurës Penale. Në rastin kur edhe padia civile zgjidhet plotësisht nga gjykata penale, me kërkesë të paditësit civil, kur ekzistojnë shkaqe të përligjura, gjykata penale vepron si gjykata civile, duke urdhëruar kthimin e sendit apo shpërblimin e dëmit në mënyrë të menjëhershme, pa pritur që

vendimi të marrë formë të prerë. Pra, në këtë rast, është gjykata që i jep vendimit statusin e vendimit me ekzekutim të përkohshëm.

Së dyti, përbëjnë tituj ekzekutivë vendimet penale për pjesën që përmban si dënim plotësues atë të "Konfiskimit të mjetëve të kryerjes së veprës penale dhe përfitimeve prej saj", parashikuar nga pika 2 e nenit 30 të Kodit Penal. Kjo parashikohet në nenin 17 dhe 40 të Ligjit 8331, datë 21/04/1998, "Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale". Këto vendime vihen në ekzekutim nga zyra e përmbartimit mbi bazën e urdhrimit të ekzekutimit jo më të lëshuar nga gjykata, por nga prokurori. Mendojmë se në këtë mënyrë duhen kuptuar dhe interpretuar edhe vendimet e tjera penale për

26 pjesët ku disponojnë për provat materiale (neni 190 i K.Pr.P), ato që kanë të bëjnë me ekzekutimin e masës së sekuestros të parashikuar nga neni 273 i K.Pr.Penale dhe neni 17 i ligjit nr. 9284, datë 30/09/2004, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar".

Së treti, janë gjithashtu tituj ekzekutivë vendimet penale që përmbajnë dënim penal me gjobë. Në nenin 467/1 të K.Pr.Penale, si dhe nenet 17, 32 dhe 33 të Ligjit 8331, datë 21/04/1998, "Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale", parashikohet se këto vendime vihen në ekzekutim nga zyra e përmbartimit mbi bazën e urdhrimit të ekzekutimit të lëshuar nga prokurori, ku përcaktohen dhe modalitetet përkatëse.

Së fundi, vendimet penale për pjesën që bën fjalë për shpenzimet gjyqësore (n.17 i ligjit "Për ekzekutimin e vendimeve penale). Edhe në këtë rast është zyra e përmbartimit që ekzekuton vendimin mbi bazën e urdhrimit të ekzekutimit të lëshuar nga prokurori. Lidhur me faktin e lëshimit të urdhrimit të ekzekutimit, që vë në lëvizje zyrën e përmbartimit, duhen parë dhe interpretuar lidhur me njëri-tjetrin neni 511/a të K.Pr.Civile me nenet 463/1, 467/1 dhe 471/1 të K.Pr.Penale, si dhe dispozitat e ligjit "Për ekzekutimin e vendimeve penale".

1.5 Vendimet e gjykatave dhe arbitrazheve të shteteve të huaja.

Përsa i përket vendimeve të gjykatave dhe të arbitrazheve të shteteve të huaja, ekzekutimi i tyre bëhet mbi bazën e urdhrimit të ekzekutimit të lëshuar nga gjykata e apelit, e cila bën dhe njohjen e tyre, duke i dhënë fuqi juridike brenda territorit të R.SH (n.395 dhe 399 i K.Pr.C).

1.6 Lidhur me ekzekutimin e vendimit për marrjen e provës tek të tretët.

Një problem që ka dalë në praktikën gjyqësore është ai që ka të bëjë me ekzekutimin e vendimit të ndërmjetëm të gjykatës, i cili ka për qëllim të detyrojë palën ndërgjyqëse ose një person të tretë, përfshi këtu edhe ndonjë organ të administratës shtetërore, për paraqitjen e një prove të caktuar në gjykim. Në nenin 223 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se:

"Gjykata, me kërkesën e palës së interesuar, mund të urdhërojë palën tjetër ose një person të tretë që nuk merr pjesë në çështje, të paraqesë në gjykim një dokument ose një send tjetër, kur çmohet e nevojshme prej saj.

27

Në këtë rast gjykata jep udhëzimet e nevojshme për kohën, vendin dhe mënyrën e paraqitjes së tyre. Pala që ka kërkuar marrjen e dokumentit është e detyruar të tregojë me hollësi të gjitha rrethanat që bëjnë të besueshme se ku ndodhet dokumenti, karakteristikat e tij, si dhe faktet që do të provohen me këtë dokument.

Shpenzimet e nevojshme parapagohen nga pala që ka bërë kërkesën."

Kjo dispozitë, por edhe nenet 224 e 264 të K.Pr.C, që shtjellojnë më tej idenë e marrjes së provave dhe të dhënave me shkrim, edhe nga organet e administratës shtetërore, përcaktojnë vetëm rregullin. Fare ndodh nëse pala ndërgjyqëse apo personi i trete nuk zbaton vendimin e gjykatës për paraqitjen e provës? Kësaj situate, në K.Pr.Civile, i japin përgjigje dy dispozita të ndryshme, në mënyra të ndryshme, por që, në analizë të fundit, konvertojnë përsa i përket mënyrës finale të realizimit të qëllimit.

Së pari, është neni 167 i K.Pr.C, në të cilin sanksionohet : "**Kur një person i tretë, që nuk është palë, nuk pranon të paraqesë një dokument ose një send, që provohet se ndodhet pranë tij dhe që i është kërkuar nga gjykata dënohet me gjobe deri në 30 000 lekë.**" Zbatimi i kësaj dispozite në një rast të tillë duket mjaft adekuat, aq më tepër po të kemi parasysh parashikimin e paragrafit të fundit të nenit 510, në të cilin thuhet : "**Gjobat e dhëna nga gjykata, të përcaktuara në këtë Kod, ekzekutohen drejtpërdrejt nga zyra e përmbarimit pas njoftimit të vendimit. Për këtë qëllim nuk lëshohet urdhër ekzekutimi.**" I vetmi problem qëndron në faktin se veprimi i nenit 167 të K.Pr.C ka një shtrirje të kufizuar përse i përket subjekteve të cilave i drejtohet, pasi i referohet vetëm personave të tretë, që nuk janë palë në gjykim.

Së dyti, është neni 265 i K.Pr.C, ku parashikohet se : "**Ekzekutimi i vendimit që urdhëron paraqitjen e shkresës bëhet sipas dispozitave që kanë të bëjnë me ekzekutimin për dorëzimin e sendit ose kryerjen e veprimit. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur shkresat ndodhen në një organ shtetëror ose te personat juridikë shtetërore, përveç kur shkresa përben sekret shtetëror.**" Kjo dispozitë, e parë lidhur ngushtë edhe me nenin 264 të K.Pr.C, i referohet jo vetëm personave të tretë pale ose jo, por edhe vetë palëve ndërgjyqëse. A do të konsiderohet ky vendim i gjykatës titull ekzekutiv, ndonëse nuk parashikohet shprehimisht si i tillë? Natyrisht që ky vendim është i zbatueshëm drejtpërsëdrejti. Dispozita flet qartë për një ekzekutim të detyrueshëm sipas

28

rregullave që kanë të bëjnë me ekzekutimin për dorëzimin e sendit ose kryerjen e veprimit, të parashikuara, respektivisht, nga nenet 601-604 dhe 605-606 të K.Pr.C.

Kur thamë që neni 167 dhe 265 i K.Pr.C konvertojnë përse i përket mënyrës finale të realizimit të qëllimit, kishim parasysh që faktin se nëse detyrimi për paraqitjen e një prove, veçanërisht nga një organ shtetëror palë ndërgjyqëse ose jo, apo nga një person i tretë, do të konsiderohet si një detyrim për kryerjen e një veprimi te caktuar. Në këto kushte relevant do të ishte neni 606 i K.Pr.C, në paragrafin e parë të të cilit parashikohet se "**Ndaj debitorit që refuzon, kryen në mënyrë të parregullt, nuk respekton afatet ose kryen të kundërtën e asaj që me vendim të gjykatës është i detyruar, kur nuk ka vend për përgjegjësi penale, përmbaruesi gjyqësor ka të drejtën e gjobitjes deri 50 000 lekë në çdo rast deri në ekzekutimin e detyrimit.**" E njëjta gjë parashikohet në paragrafin e tretë të këtij neni edhe për personat e tjerë, të cilët kanë të njëjtin detyrim.

Si përfundim, mund të themi se kur bëhet fjalë për një person të tretë që nuk është palë në gjykim, është më e thjeshtë dhe më e përshtatshme që gjykata të veprojë sipas nenit 167 të K.Pr.C, sa kohë që bëhet fjalë për gjobë dhe procedura është më e shkurtër dhe e drejtpërdrejt. Në rastin e palës ndërgjyqëse, e vetmja mënyrë mbetet ajo sipas nenit 265 të K.Pr.C.

Po në këtë optikë, shtrohet dhe problemi i ekzekutimit të vendimit për nxjerrjen e detyrueshme të shpenzimeve, siç parashikon neni 105/2 i Kodit të Procedurës Civile, ku thuhet se "**Kur një palë është e detyruar të paguajë shpenzimet gjyqësore dhe nuk i paguan vullnetarisht, gjykata urdhëron me vendim nxjerrjen e tyre të detyrueshme.**"

Edhe në këtë rast, mendojmë se me njoftimin e këtij vendimi, zyra e përmbarimit fillon edhe ekzekutimin e tij, ashtu sikurse parashikohet për pagimin e gjobës, sipas parashikimit të paragrafit të fundit të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile. Gjithë sa më lart, referuar parapagimit të shpenzimeve gjyqësore për dëshmitarët, ekspertët etj, nga pala që i ka kërkuar, në shumën që ka caktuar gjykata, në kuptim të nenit 105/1. Edhe në këtë rast, një vendim i tillë nuk parashihet shprehimisht si titull ekzekutiv në nenin 510, ndonëse efektet janë të njëjta dhe duhet interpretuar si i tillë.

29

1.7 Çështje të parashkrimit.

Gjithashtu, një problem që meriton trajtim, nga pikëpamja e interesit që shfaq praktika gjyqësore, është dhe ai i parashkrimit të kërkesës për vënien në ekzekutim të një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Në Kodin Civil të vitit 1981, në nenin 61 të tij thuhej :

"E drejta për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm të një vendimi të formës së prerë të gjykatës ose të një titulli tjetër ekzekutiv parashkruhet me kalimin e një viti, kur palët janë persona juridike dhe, me kalimin e tre vjetëve, në të gjitha rastet e tjera."

Në Kodin Civil dhe atë të Procedurës Civile, që janë në fuqi, nuk gjejmë një parashikim të kësaj natyre, i cili në mënyrë eksplicite të përcaktojë një afat parashkrimi për kërkimin e vënies në ekzekutim të një titulli ekzekutiv. Megjithatë, lidhur me këtë çështje, në Kodin Civil paraqiten relevante dy dispozita, neni 113/2 dhe 131/ç.

Në nenin 113/2 të K.C thuhet : **"Nuk parashkruhen edhe kërkesat për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimeve që janë të lidhura me padi, për të cilat nuk zbatohet parashkrimi."**Në interpretim të kësaj dispozite, rezulton se, si rregull, kërkesat për ekzekutim të detyrueshëm i nënshtrohen afateve të parashkrimit, përveç rastit të vendimeve të dhëna mbi padi që nuk parashkruhen. E megjithatë nuk parashikohen afate parashkrimi për këto kërkesa. Mendojmë që, në këto kushte, për sa kohë nuk parashikohet ndryshe, kërkesat për ekzekutim të detyrueshëm do i nënshtrohen të njëjtave afate parashkrimi me ato të padive mbi bazën e të cilave janë dhënë vendimet gjyqësore-tituj ekzekutive. Gjithashtu duhet patur parasysh se duke qenë afat parashkrimi kërkesë për vënien në ekzekutim të një titulli ekzekutiv dhe jo afat parashkrimi padie, përmbaruesi duhet të konstatojë atë jo vetëm me kërkesë të palës së interesuar, por edhe kryesisht. Kjo për të mos i dhënë shkak kundërshtimit të veprimeve përmbarimore.

Një argument i fundit në këtë drejtim është edhe rasti që parashikon neni 211 i Kodit të Familjes, që parashikon se **"Kur një vendim, që përmban një detyrim për ushqim, vihet në ekzekutim pas 6 muajve nga data që ka marrë formë të prerë, detyrimet e prapambetura për ushqim janë të kërkueshme vetëm për 6 muajt e fundit."** Pra, shprehja "janë të kërkueshme", nënkupton se kërkesa për vënien në ekzekutim të detyrimit për ushqim i nënshtrohet parashkrimit.

30

Dy janë problemet që mund të shtrohen për diskutim në këtë rast: së pari, është ai që ka të bëjë me atë se cila do të konsiderohet kërkesë për ekzekutim të detyrueshëm, kërkesa për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit nga gjykata apo kërkesa drejtuar zyrës së përmbarimit, sipas nenit 515 të K.Pr.Civile. Mendojmë se kërkesa për ekzekutim të detyrueshëm do të konsiderohet ky rast i fundit, pra, kërkesa drejtuar zyrës së përmbarimit për vënien në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit.

Së dyti, problemi që ka të bëjë me faktin se kur do të fillojnë të ecin këto afate. Pra, nëse afati parashkrimit për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm do të fillojë nga dita kur subjektit i ka lindur e drejta e padisë, nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë, nga dita që është lëshuar urdhri i ekzekutimit apo nga dita që është paraqitur në zyrën e përmbarimit kërkesa për ekzekutim të detyrueshëm.

Nisur nga ky rast i fundit vlen të kujtojmë përmbajtjen e nenit 131/ç të K.C, ku thuhet :

"Parashkrimi i padisë ndërpritet:

ç) me paraqitjen e kërkesës për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor apo arbitrazhit përkatës, si dhe të çdo titulli ekzekutiv tjetër."

Përcaktimi i këtij momenti paraqet rendësi të veçantë pasi, siç do ta shikojmë dhe më poshtë tek mjetët e mbrojtjes ndaj ekzekutimit të vendimeve, në varësi të kalimit të këtij afati, debitori mund të kërkojë në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit që titulli ekzekutiv të deklarohet se është i pavlefshëm për shkak se detyrimi është shuar më pas (neni 609 i K.Pr.C).

Duke e parë nenin 131/ç në lidhje me nenin 134 të K.C, sipas të cilit pas zhdukjes së shkakut ndërprerës fillon një afat i ri parashkrimi, arrijmë në konkluzionin se në momentin e paraqitjes së kërkesës për ekzekutim të detyrueshëm afati i parashkrimit i filluar më parë ndërpritet dhe fillon të ecë nga e para. Pra, lëshimi i urdhrin të ekzekutimit nuk e ndërpret ecjen e afatit të parashkrimit. Nëse në këtë analizë do të mbajmë parasysh edhe parashikimin e nenit 135/1 të K.C, sipas të cilit "**Kur parashkrimi i padisë është ndërprere për shkak të paraqitjes së padisë ose të kundërpadisë, afati i ri i parashkrimit fillon nga dita që ka marrë formë të prere vendimi me të cilin është zgjidhur çështja në themel**", atëherë del që afati i parashkrimit për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm fillon që nga dita që vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë.

31

Së fundi, në kontekstin e kësaj analize vlen të përmendet edhe parashikimi i nenit 617/3 të K.Pr.C, ku thuhet: "**Kur vendimi i pushimit të ekzekutimit merr formë të preerë përmbaruesi gjyqësor e heq sekuestron e vënë mbi sendet e luajtshme ose të paluajtshme dhe në rastet e parashikuara nga shkronjat "b" dhe "d" të nenit 616 të këtij Kodi i kthen urdhrin e ekzekutimit kreditorit, i cili ka të drejtë të paraqesë kërkesë të re për ekzekutim brenda kohës së parashkrimit. në këtë rast parashkrimi i ri fillon nga dita që vendimi për pushimin e ekzekutimit ka marrë formë të prerë.**".

Këtu është vendi të evidentohet një praktikë e gabuar, ku konstatohet se përmbaruesi nuk kthen urdhrin e ekzekutimit, që lëshohet nga gjykata në një kopje të vetme. Kjo ka shkaktuar që kreditori në kohë të ndryshme t'i drejtohet gjykatës për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit dhe në dosjen përmbarimore të gjenden disa urdhra ekzekutimi për të njëjtin titull ekzekutiv. Pra, kur merr formë të prerë vendimi i përmbaruesit për pushimin e ekzekutimit, ky i fundit duhet t'ia kthejë kopjen e vetme të urdhrin të ekzekutimit, kreditorit, i cili, brenda afatit të parashkrimit të trajtuar më lart, ka të drejtë t'i drejtohet sërish përmbaruesit gjyqësor, më kërkesë të re, për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv.

1.8 Akti noterial si titull ekzekutiv. Kushtet që duhet të plotësojë akti noterial që të konsiderohet titull ekzekutiv.

Në nenin 510/d të K.Pr.C parashikohën si tituj ekzekutive edhe aktet noteriale që përmbajnë detyrim në të holla. Ky formulim që është aktualisht në fuqi është ndryshuar disa herë, respektivisht, me ligjin me nr. 8812, datë 17/05/2001 dhe ligjin me nr. 9953, datë 14/07/2008. Kështu, me parë aktet noteriale-tituj ekzekutive formuloheshin si "**aktet noteriale me të cilat autorizohet shlyerja e një detyrimi kontraktual, ose e çdo detyrimi tjetër të mëparshëm, drejtpërdrejtë nga depozitat bankare ose nga paga e autorizuesit dhe në kreditë e tij tek të tretët;**".

Në kohën që ishte në fuqi ky parashikim ligjor, kur bëhej fjalë për akte noteriale që përmbajnë detyrime në të holla, kiheshin parasysh aktet noteriale të thjeshta, d.m.th, ato që përmbanin detyrimin vetëm të njëjës pale, pa u varur apo kushtëzuar kjo nga kryerja e ndonjë detyrimi nga ana e palës tjetër. Lidhur me këtë çështje ka mbajtur qëndrimin e saj dhe Gjykata e Lartë në vendimin e saj unifikues me nr. 980, dt. 29/09/2000. Në referim të këtij vendimi unifikues, që

32

bazohej në ligjin procedural të kohës, të pandryshuar, që akti noterial të konsiderohej titull ekzekutiv, duhej të plotësonte këto kushte:

1) të konsistonte në një veprim juridik të njëanshëm, i cili të përmbajë një detyrim të njëanshëm për pagimin e një shume në të holla, ku detyrimi mund të ishte:

- a) abstrakt, në rastin ku përcaktohet thjesht shuma e detyrimit, pa u treguar origjina e tij, ose,
- b) konkret, kur tregohet se detyrimi buron, p.sh., nga një kontratë e mëparshme.

2) Detyrimi të ishte i përcaktuar saktë, pra, të mos kishte ekuivokë lidhur me masën e tij.
3) Detyrimi të ishte i kërkueshëm. Kjo do të tregonte që detyrimi i përmbajtur në aktin noterial të mos lidhej me plotësimin e afateve të caktuara dhe as të ishte i kushtëzuar nga rrethana apo detyrime të tjera të ndërsjellat. Pra, bëhej fjalë për një detyrim të marrë përsipër nga debitori në mënyrë të njëanshme dhe pa kushte, i cili, ndonëse në raste të caktuara mund të shuante një detyrim të mëparshëm, përbente një detyrim të ri, që ka një ekzistencë të mëvetësishme, të pavarur nga detyrimi që shuan.

Këto kushte të trajtuara më lart duhet të konkurronin, në mënyrë që akti noterial të konsiderohej titull ekzekutiv. në të kundërt, nëse akti noterial do të përmbante një detyrim që nuk do ishte përcaktuar saktë, apo nuk do ishte i kërkueshëm, apo do të varej nga plotësimi i ndonjë afati a detyrimi ose kushti nga një pale tjetër, atëherë verifikimi i këtyre rrethanave do të kërkonte domosdoshmërisht shqyrtimin dhe gjykimin e çështjes në themel, mbi bazën e pretendimeve dhe prapësimeve, si dhe të provave të paraqitura nga palët.

Pas ndryshimeve që pësoi Kodi i Procedurës Civile, ka ndryshuar edhe praktika gjyqësore në këtë drejtim. Kështu, me vendimin nr. 427, datë 11/04/2006, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dritën e këtyre ndryshimeve, ka ndryshuar edhe praktikën gjyqësore në këtë drejtim. Në këtë vendim, ndër të tjera, thuhet se:

“Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë çmon të rëndësishëm interpretimin e një vendimi unifikues të Kolegjeve të Bashkuara, të dhëne në kohë, me parë se ndryshimi që i behet ligjit nga ligjvënësi. në rastin konkret Vendimi Unifikues nr.980, datë 15.09.2000 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë është dhëne në kushtet kur formulimi i

33

dispozitës së nenit 510/d të Kodit të Procedurës Civile ka qënë si vijon: *"Janë tituj ekzekutive .. .d) aktet noteriale me të cilat autorizohet shlyerja e një detyrimi kontraktual ose çdo detyrim tjetër të mëparshëm, drejtpërdrejt nga depozitat bankare ose nga paga e autorizuesit dhe në kreditë e tij te të tretët"*.

Ndërkohë, ligjvënësi nëpërmjet nenit 105, të ligjit nr.8812, datë 17.05.2001 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, datë 29.03.1996 Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë" ka ndryshuar përmbajtjen e dispozitës së nenit 510/d në këtë mënyrë: *"Janë tituj ekzekutiv .. .d) aktet noteriale që përmbajnë detyrim në të holla, si dhe aktet për dhënien e kredive bankare"*.

Në interpretim të dispozitës së ndryshuar të nenit 510/d të Kodit të Procedurës Civile kontrata e huas në rastin konkret është një akt noterial. Ndërkohë, neni 1050 i Kodit Civil ka dhënë kuptimin e kontratës së huas: *"Me kontratën e huas njëra palë (huadhënësi) i jep në pronësi palës tjetër (huamarrësit) një shumë të hollash ose sende që përcaktohen në numër, me peshë ose me masë dhe huamarrësi detyrohet t'i kthejë huadhënësit aq të holla, ose aq sende të atij lloji dhe të asaj cilësie, brenda afatit të caktuar në kontratë ose, kur nuk është caktuar afat, me kërkesën e huadhënësit"*. **në referencë të përmbajtjes së dispozitës së mësipërme detyrimi i huamarrësit konsiston në kthimin e shumës së të hollave ose sendit në kushtet e parashikuara në kontratë.**

Bazuar në kuptimin që sanksionon neni 419 i Kodit Civil "Detyrimi është një marrëdhënie juridike me anën e së cilës një person (debitori) detyrohet të japë diçka ose të kryejë apo të mos kryejë një veprim të caktuar në dobi të një personi tjetër (kreditore), i cili ka, gjithashtu, të drejtë të kërkojë t'i jepet diçka, ose të kryhet apo të moskryhet veprimi". **Duke iu referuar kontratës së huas, si akt noterial, lidhur mes palëve, detyrimi në të holla i huamarrësit ka lindur për shkak të kësaj kontrate, në mbështetje të dispozitës së nenit 420 të Kodit Civil. Në lidhje me shkakun e ligjshëm të lindjes së detyrimit, Kolegjet e Bashkuara në**

vendimin e tyre nr.35, datë 30.05.2002 shprehen: "Nga përmbajtja e akt-marrëveshjes se mësipërme, lidhur mes palëve, nuk del shkaku i lindjes se marrëdhënies juridike të detyrimit, që mund të jetë detyrim kontraktor apo i përcaktuar me ligj të veçantë në kuptim të nenit 419 dhe 420 të Kodit Civil. Pra, që akt marrëveshja e mësipërme të jetë titull ekzekutiv, në kuptim të

34

nenit 510 shkronja "d" të ndryshuar të Kodit të Procedurës Civile, ky akt, duhet të përmbajë edhe shkaku e ligjshëm të lindjes se detyrimit".

Në vijim të këtij argumentimi, Kolegji Civil i Gjykatës se Lartë çmon se ka qënë vullneti i ligjvënësit, që me ndryshimin e dispozitës së nenit 510/d të Kodit të Procedurës Civile, të parashikonte si titull ekzekutiv të gjitha ato akte noteriale që përmbajnë detyrime në të holla, e si të tillë dhe kontratën e huas, e redaktuar nga noteri. Është e rëndësishme të konstatohet se e njëjta mbrojtje ligjore që i rezervohet me ligj ekzekutimit të akteve për dhënien e kredive bankare (dhënie hua në formë kredie) duhet të njihet dhe të zbatohet dhe në marrëdhëniet kontraktuale mes personave me objekt dhënien në pronësi të një shume të hollash në kushtet e parashikuara nga neni 1050 i Kodit Civil në aktin noterial.”.

Në të njëjtën pikë të nenit 510 të K.Pr.C, parashikohen si tituj ekzekutive edhe "*aktet për dhënien e kredive bankare dhe akte për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare*". Problemet që ka shtruar praktika gjyqësore lidhur me këtë rast kanë të bëjnë, se pari, me atë se cilat akte do të konsiderohen të tilla dhe, se dyti, nëse do të konsiderohen të tilla edhe ato akte që për nga natyra janë të njëjta me to, por që janë lidhur përpara se të hynte në fuqi ky parashikim i ri në K.Pr.C.

Lidhur me problemin e parë, në praktikën gjyqësore janë vënë re raste kur janë konsideruar tituj ekzekutive dhe është lëshuar urdhri i ekzekutimit për akte për dhënien e kredive, por jo nga institucione të licensuara si banka në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, por nga subjekte të tjera, të cilat mund të kenë për objekt të veprimtarisë së tyre, ndër të tjera, edhe kryerjen e veprimeve apo operacioneve të natyrës bankare, siç është kreditimi. Një rast i tillë është p.sh., ai i kredive të dhëna nga fondacioni "Besa". Mendojmë se kjo praktike është legjitimuar edhe me plotësimet që i janë bërë Kodit të Procedurës Civile në këtë drejtim.

Persa i përket problemit tjetër, atij nëse do të konsiderohen si tituj ekzekutive edhe kontratat për dhënien e huave nga bankat, të cilat mbajnë një datë të mëparshme nga ajo e hyrjes në fuqi të ligjit që i konsideron ato tituj ekzekutive, kjo është një çështje që ngrihet në këndvështrimin e parimit të njohur që ligji nuk ka fuqi prapavepruese. Shume gjykata, nisur nga ky parim, nuk i kanë konsideruar ato tituj ekzekutive, por kanë zgjidhur çështjet në rrugën e padive të themelit.

35

Në raste të tjera, duke u bazuar në parimin se në kohën e gjykimit gjykata zbaton ligjin procedural në fuqi në atë kohë, mjaft gjykata i kanë dhënë këtij problemi një zgjidhje të ndryshme, duke i konsideruar këto akte si tituj ekzekutive. E vërteta është se dispozita që i parashikon këto akte si tituj ekzekutivë është e natyrës materiale, ndonëse gjendet si parashikim në Kodin e Procedurës Civile. Në këtë kontekst, nuk mund të përbëjë titull ekzekutiv akti para hyrjes në fuqi të ligjit që e konsideron si të tillë. Kjo gjë vlen për të gjitha dispozitat me karakter material, si shprehje e parimit të sigurisë juridike në shoqëri.

1.9 Kambialet, çeqet e letrat me urdhër që barazohen me ato, si edhe aktet e tjera të përcaktuara nga ligje të veçanta si tituj ekzekutivë.

Nëse është lehtësisht i kuptueshëm cilësimi i këtyre letrave me vlerë si tituj ekzekutivë, mendojmë të shtrojmë se fundi edhe një problem tjetër. Është fjala për aktet, që sipas pikës "e" të nenit 510 të K.Pr.C, quhen në baze të ligjeve të veçanta si tituj ekzekutive dhe ngarkohet

zyra e përmbarimit për ekzekutimin e tyre. Cila është pasoja nëse, nga pikëpamja e teknikes legjislative janë lejuar emetime të tilla, siç është mosparashikimi i ekzekutimit të këtyre akteve nga zyra e përmbarimit. Pra, behet fjalë për rastin kur, ndonëse ligji i veçantë e përcakton një akt si titull ekzekutiv, nuk parashikon që ngarkohet zyra e përmbarimit me ekzekutimin e tij. Pika "e" e përcakton si kusht një gjë të tillë.

Vlen të theksohet se praktika gjyqësore, ndoshta në mënyrë jo të bazuar, ka anashkaluar këtë fakt, duke i konsideruar këto akte tituj ekzekutive, ndonëse ligji që i parashikon si të tillë nuk ngarkon zyrën e përmbarimit për ekzekutimin e tyre. të tilla janë, p.sh., vendimet e këshillave të komunave e bashkive për zënien e përdorimin e tokës forcërisht (neni 21 i Ligjit 7501, datë 19/07/1991, "Për Token"); akti që përmban detyrimin për pagesën e kontributit për sigurimet shoqërore (neni 2 i Ligjit 8392, datë 02/09/1998, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 7703, datë 11/05/1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë"); fatura tatimore e konsumit të energjisë elektrike (neni 1 i Ligjit 8662, datë 18/09/2000, "Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike); akti që përmban përcaktimin e borxhit doganor, siç parashikohet në nenin 245 të Kodit Doganor; akti me të cilin administratori i një shoqërie huamarrës shpall një subjekt debitor, neni 5 i ligjit 8471, datë 08/04/19999, "Për nxjerrjen e detyrimeve debitorë dhe rikthimin e vlerave pasurore në llogarite e personave juridike, jobankare që kanë marrë hua nga publiku i gjere" etj.

36

Gjithsesi, në analizë të fundit, është gjykata ajo që, kur shqyrton kërkesën për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, të verifikojë plotësimin e këtij kushti ligjor dhe, nëse mungon parashikimi i detyrimit të zyrës së përmbarimit për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, të refuzojë lëshimin e urdhrin të ekzekutimit. Nëse gjykata e ka kapërcyer këtë moment ligjor dhe ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit, atëherë përmbaruesi gjyqësor është i detyruar ta ekzekutojë atë.

Ashtu siç përmendem dhe pak më lart kur trajtuam aktet për dhënien e kredive bankare, i njëjti problem shtrohet përsëri, nëse do të konsiderohen si tituj ekzekutive edhe aktet e tjera të parashikuara si të tilla në ligje të veçanta, të cilat mbajnë një datë të mëparshme nga ajo e hyrjes në fuqi të ligjit që i konsideron ato tituj ekzekutive. P.sh., a do të konsiderohen si tituj ekzekutive faturat e konsumit të energjisë elektrike që mbajnë një datë të mëparshme nga ajo e hyrjes në fuqi të Ligjit 8662, datë 18/09/2000, "Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike"? Edhe kësaj pyetje praktika gjyqësore i ka dhënë përgjigje pozitive, për mendimin tone pa të drejte. Kjo pasi është e vërtete që gjykata zbaton ligjin proçedural në fuqi në kohën e gjykimit, por kjo i referohet rregullave proçeduriale të gjykimit dhe jo edhe dispozitave me karakter material, nga të cilat gjejmë edhe në Kodet e Procedurave. Këto dispozita nuk mund të zbatohen sikur të kishin efekt prapaveprues, pra, që rregullojnë marrëdhënie juridike të lindura para hyrjes në fuqi të tyre. Edhe në këtë rast i takon gjykatës të interpretojë nëse një akt do të konsiderohet si titull ekzekutiv, ndonëse nuk ka qenë i tillë në kohën e krijimit të tij. Nëse gjykata e njeh si të tillë dhe lëshon urdhrin e ekzekutimit, atëherë përmbaruesi gjyqësor është i detyruar ta zbatojë.

1.10 Urdhri i ekzekutimit.

Në nenin 511/1 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se **“Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim me kërkesën e kreditorit. Për këtë qëllim lëshohet urdhri i ekzekutimit, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së kreditorit,...”**. Është me rëndësi të theksohet se pavarësisht vendit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor, për të gjitha titujt ekzekutivë që janë vendime gjyqësore dhe parashikohen nga pika “a” dhe “b” e nenit 510, si dhe për ato që janë vendime të gjykatave të arbitrazhit në Republikën e Shqipërisë, sikurse parashikohet nga pika “ç”, kompetente për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit është gjykata që ka dhënë vendimin që

përbën titullin ekzekutiv dhe gjykata e vendit të vendimit të arbitrazhit, në rastin e një gjykate arbitrazhi. Këtu bëjnë përjashtim vendimet e gjykatave të shteteve të huaja dhe gjykatave të

37

arbitrazhit të huaj, për të cilat urdhri i ekzekutimit lëshohet nga gjykata e apelit që ka vendosur njohjen e tyre.

Vendi i ekzekutimit të titullit ekzekutiv merr rëndësi në rastin e akteve noteriale që përmbajnë detyrime në të holla, kambialeve, çeqeve etj dhe akteve që përcaktohen si tituj ekzekutivë nga ligje të veçanta, të parashikuara, përkatësisht nga pika “d”, “dh” dhe “e” e nenit 510 të K.Pr.C. Në këto raste, kompetente për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit është pikërisht gjykata e vendit ku është caktuar ose parashikohet të bëhet ekzekutimi. Në këtë pikë është me rëndësi të theksohet se, siç është përmendur edhe më lart në këtë material, nuk është e nevojshme të lëshohet urdhër ekzekutimi, ndër të tjera, për vendimin për sigurimin e padisë dhe për gjrobat e dhëna nga gjykata. Këto, ashtu sikurse parashikohet në nenin 511/2 të K.Pr.C, ekzekutohen drejtpërdrejt nga zyra e përbarimit, pas njoftimit të vendimit të gjykatës.

Nëse gjykata, për një ndër arsytet e parashtruara më lart, që kanë të bëjnë me elementët e titullit ekzekutiv, refuzon dhënien e urdhrin të ekzekutimit, ndaj këtij vendimi mund të bëhet ankim i veçantë në gjykatën e apelit, brenda 5 ditëve nga dita e vendimit të refuzimit. Kjo parashikohet në nenin 512 të K.Pr.C. Nëse kërkesa për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit pranohet, ai lëshohet vetëm në një kopje. Vetëm nëse duhet të dorëzohen disa pasuri të veçanta ose kur titulli ekzekutiv është dhënë në dobi ose kundër disa personave, gjykata mundet, pra, jo detyrimisht, të lëshojë urdhra ekzekutimit të veçantë, duke shënuar se cila pjesë e titullit duhet të ekzekutohet për çdo urdhër ekzekutimi (n. 513 i K.Pr.C).

Lidhur me urdhrin e ekzekutimit, kreditori mbetet i lidhur me gjykatën për çdo problem që mund të lindë lidhur me të. Kështu, nëse urdhri i ekzekutimit humbet ose zhduket, kreditori mund t’i kërkojë gjykatës kompetente lëshimin e dublikatës së urdhrin të ekzekutimit, në bazë të titullit ekzekutiv. Është e rëndësishme që në këto raste të mos ndodhë siç ka treguar praktika gjyqësore, që të kërkohej lëshimi i një urdhri të ri ekzekutimi, por i dublikatës së tij. Për këtë është e rëndësishme t’i parashtruhet gjykatës fakti i lëshimit njëherë të urdhrin të ekzekutimit dhe rrethanave që e bëjnë të besueshme zhdukjen ose humbjen e tij.

Edhe vetë gjykata, kryesisht, në sajë të regjistrave elektronikë që duhet të ketë si pjesë e sistemeve informatike të menaxhimit të çështjeve, por, sa është e mundur, edhe të regjistrave manualë, duhet të bëjë verifikimin nëse jemi para një kërkesë për lëshimin e një urdhri të ri

38

ekzekutimi apo një dublikate. Referuar nenit 514/2 të K.Pr.C, kërkesa për lëshimin e dublikatës së urdhrin të ekzekutimit shqyrtohet nga gjykata në dhomë këshillimi dhe përbën një gjykim mbi aktet, pasi të jetë njoftuar më parë debitori, si dhe t’i jetë dhënë mundësia atij për të depozituar parashtresat ose çdo akt që vlerësohet prej tij.

Në harmoni të plotë me këto parashikime është edhe ai i nenit 617/3 të K.Pr.C, sipas të cilit, kur vendimi i pushimit të ekzekutimit merr formë të prerë, në rastin kur kreditori heq dorë me shpresë nga ekzekutimi (n. 616/1, “b” i K.Pr.C), përbaruesi gjyqësor i kthen urdhrin e ekzekutimit kreditorit, i cili ka të drejtë të paraqesë kërkesë të re për ekzekutim brenda kohës së parashkrimit. Ndryshon krejtësisht situata kur ka humbur ose është zhdukur jo urdhri i ekzekutimit, por vetë titulli ekzekutiv. Nëse përmbajtja e këtij të fundit nuk ka mundësi të nxirret në ndonjë mënyrë tjetër nga aktet e organeve që e kanë lëshuar titullin ekzekutiv, atëherë kreditori duhet të ngrejë padi të re themeli kundër debitorit, sipas rregullave të përgjithshme. Pas lëshimit të urdhrin të ekzekutimit, kreditori i drejtohet me kërkesë përbaruesit gjyqësor shtetëror ose privat. Përbaruesi gjyqësor privat, në bazë të ligjit për shërbimin përbarimor

privat, ka kompetencë për të vepruar në të gjithë territorin e republikës, pra, kërkesa mund t'i drejtohet çdo përbaruesi gjyqësor privat. Ndryshon situata kur kreditori vendos t'i drejtohet përbaruesit të shërbimit përbarimor shtetëror. Në këtë rast, kompetenca tokësore përcaktohet nga neni 516 i K.Pr.C, ku parashikohet se: në rastin e sendeve të luajtshme, sendeve të paluajtshme ose parave, kërkesa për zbatimin e urdhrin të ekzekutimit i drejtohet përbaruesit gjyqësor të vendit ku ndodhen ato; në rastin kur ekzekutimi shtrihet mbi kredinë që ka debitori ndaj personave të tretë, atëherë kërkesa i drejtohet përbaruesit gjyqësor të vendit të banimit të personit të tretë; lidhur me kryerjen ose moskryerjen e një veprimit të caktuar, kompetent është përbaruesi gjyqësor i vendit ku do të kryhet ose jo ky veprim.

Që në këtë fazë, që lidhet me përcaktimin e kompetencës, mund të nevojitet investimi i gjykatës. Në nenin 516/2 parashikohet e drejta e përbaruesit gjyqësor të shërbimit përbarimor shtetëror që, nëse konstaton që nuk është kompetent për të vënë në ekzekutim kërkesën, ia dërgon atë përbaruesit gjyqësor kompetent, pasi të ketë vënë më parë sekuestër mbi sendin ose kredinë e debitorit. Në paragrafin e tretë të së njëjtës dispozite sanksionohet se nuk lejohet konflikti për kompetencë, por përbaruesi gjyqësor, të cilit i është dërguar çështja për ekzekutim, mund të

39
parashtrijë moskompetencën e tij, me kërkesë drejtuar gjykatës së shkallës së parë ku ushtron veprimtarinë. Kjo e fundit e shqyrton çështjen si gjykim mbi aktet, në dhomë këshillimi. Gjykata mund të investohet gjithashtu që në krye të fazës së ekzekutimit të detyrueshëm, atëherë kur, pas lajmërimit për ekzekutim vullnetar, sipas nenit 517/1 të K.Pr.C, debitori i drejton një kërkesë gjykatës së shkallës së parë të vendit të ekzekutimit, duke i kërkuar shtyrjen e afatit të ekzekutimit të detyrimit në të holla ose ndarjen e tij në këste. Kjo parashikohet në nenin 517/3 të K.Pr.C dhe vërtetë që gjykata, në raste të veçanta, përjashtimore, duke marrë parasysh gjendjen pasurore të debitorit ose rrethanat e tjera të çështjes, natyrisht pasi të ketë dëgjuar edhe kreditorin, mund të vendosë të pranojë kërkesën e debitorit. Në interpretim të kësaj dispozite, kuptohet se në këtë gjykim thirren për të marrë pjesë si palë, veç debitorit që ka bërë kërkesën, edhe kreditori dhe përbaruesi gjyqësor.

1.11 Ndërrhyrja e gjykatës në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm.

Edhe pas lëshimit të urdhrin të ekzekutimit nga gjykata dhe fillimit të procesit të ekzekutimit të detyrueshëm, veprimtaria e përbaruesit gjyqësor mund të jetë objekt i mbikëqyrjes gjyqësore. Në këtë kontekst, përbaruesi gjyqësor duhet të jetë në dijeni dhe të ketë një informacion të plotë rreth “brisqeve” që e ekspozojnë punën e tij para ndërhyrjes së gjykatës edhe në këtë fazë fundore të procesit të rivendosjes së plotë të së drejtës së cenuar apo shkelur.

Gjykata mund të bëhet përcaktuese dhe e momenteve apo hapave të fazës së ekzekutimit të vendimit. Janë disa momentet kur gjykata mund të investohet në këtë fazë, të cilat parashikohen në mënyrë eksplicite përgjatë gjithë Kodit të Procedurës Civile, veçanërisht në pjesën e katërt, “Ekzekutimi i detyrueshëm”. Kështu, p.sh., në nenin 311 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se, kur objekt i një detyrimi është dorëzimi i një sendi në natyrë apo kryerja e një veprimi të caktuar, gjykata mund të tregojë në vendim vendin dhe afatin për ekzekutimin e vendimit.

Gjithashtu, në paragrafin e dytë të po kësaj dispozite, parashikohet se kur objekt i detyrimit është një shume në të holla, gjykata mund të caktojë një afat për pagimin e saj apo ta ndajë atë në këste. Nëse gjykata nuk e bën këtë në vendimin përfundimtar të themelit, pra, në diapozitivin e vendimit gjyqësor që zgjidh konfliktin objekt gjykimi, atëherë sërish mbetet mundësia që, ashtu siç është shpjeguar më lart, këtë ta bëjë gjykata e vendit të ekzekutimit, me kërkesë të

40
paraqitur prej debitorit, sipas nenit 517/3 të K.Pr.C. Natyrisht që kjo nuk mund t'i refuzohet

debitorit thjesht dhe vetëm me arsyen se ai nuk e ka bërë këtë kërkesë gjatë gjykimit të themelit. Kjo edhe për faktin se, gjendja pasurore apo rrethanat e tjera që e kushtëzojnë debitorin në këtë kërkim, mund të jenë shfaqur pasi vendimi ka marrë formë të prerë dhe ka filluar procesi i ekzekutimit, periudhë që mund të ndodhë të jetë e shtrirë në kohë.

Nuk ekziston nevoja për ndërhyrjen e gjykatës, pasi ligji është i qartë, kur bëhet fjalë për shtrirjen e ekzekutimit mbi pasuritë e trashëgimtarëve të debitorit, në masën që kjo pasuri është trashëguar prej debitorit trashëgimtarës (n. 520 i K.Pr.C); si dhe në rastin kur procesi i ekzekutimit duhet të prekë edhe pasurinë e personit të tretë, i cili, për sigurimin e detyrimit të debitorit, ka dalë garant, duke ngarkuar me barrë sipas ligjit një send të tijin (n. 521 i K.Pr.C). Në praktikë është vërejtur rëndom që, në kushtet edhe të mungesë së një sistemi të mirëpërcaktuar adresash në vend, debitorit të mos i dihet apo të mos i gjendet banimi. Në këtë rast është sërish gjykata që, me kërkesë të përmbartuesit gjyqësor, vihet në lëvizje dhe brenda 10 ditëve i cakton debitorit një përfaqësues. Këtë përfaqësues, për lehtësi të kuptuari, mund të krahasojmë me avokatin që caktohet kryesisht nga gjykata për mbrojtjen e të pandehurit në mungesë, në çështjet penale. Ky përfaqësues ka të gjitha tagrat e përfaqësuesit të debitorit, referuar normave që rregullojnë përfaqësimin dhe ngjan me kujdestarin e pasurisë trashëgimore apo përfaqësuesin ligjor të të miturit etj.

Një rast tjetër i investimit të gjykatës në fazën e ekzekutimit është dhe ai që ka të beje me ekzekutimin e detyrimeve në të holla kundrejt personave fizike e juridike, rast i parashikuar nga neni 539 i K.Pr.C. Ky është rasti kur marrin pjese me shume se një kreditor dhe, duke qenë se shuma e nxjerrë nga ekzekutimi nuk mjafton për t'i paguar të gjithë kreditorët, përmbartuesi ka hartuar një projekt mbi ndarjen e shumave. Përmbartuesi gjyqësor ia njofton këtë projekt kreditorëve dhe secili prej tyre mund ta kundërshtojë projektin nëpërmjet një ankese, brenda 5 ditëve nga dita e paraqitjes prej përmbartuesit të projektit të ndarjes së shumave.

Që në këtë moment, përmbartuesi gjyqësor nuk shkon më tej, por ia paraqet ankesën, së bashku me aktet, gjykatës së vendit të ekzekutimit. Kjo e fundit vendos pasi të ketë thirrur e dëgjuar si palë në gjykim, qoftë debitorin, qoftë kreditorët. Një ndër arsyet e kundërshtimit mund të jetë mosrespektimi prej përmbartuesit gjyqësor të radhës së referimit (n. 535 i K.Pr.C); ndarja

41

jopropocionale e shumave ndërmjet kreditorëve të ndryshëm (n. 537 i K.Pr.C); ose mospranimi prej tij i kërkesës për përfshirje në ekzekutim të ndonjë kreditori tjetër, sa nuk është hartuar projekti i ndarjes (n. 534 i K.Pr.C) etj.

Gjithashtu kur ekzekutimi bëhet mbi sendet e luajtshme që janë në bashkëpronësi të debitorit dhe personave të tjerë, përmbartuesi i kërkon gjykatës së vendit të ekzekutimit veçimin e pjesës takuese të debitorit (neni 546 i K.Pr.Civile). Pra, është përmbartuesi gjyqësor që i bën kërkesë gjykatës, e cila thërret si palë në gjykim, përveç debitorit, edhe të gjithë bashkëpronarët e tjerë. Kjo pasi ky gjykim ndjek rregullat e gjykimit për pjesëtimin gjyqësor, të parashikuar nga nenet 369-374 të K.Pr.Civile. Natyrisht që është detyrimi i përmbartuesit t'i parashtrijë e bëjë të ditur gjykatës se cilët janë të gjithë bashkëpronarët e sendit të luajtshëm, si dhe adresat e tyre.

Kreu ku përmbahet dispozita e nenit 546 të lartpërmendur bën fjalë për ekzekutimin mbi sendet e luajtshme, por e njëjta gjë parashikohet edhe nga neni 578, i cili bën fjalë për sendet e paluajtshme në bashkëpronësi, për të cilat ndiqet e njëjta rrugë. Nuk parashikohet e njëjta gjë, madje nuk parashikohet fare se s'ndodh nëse nga fillimi i ekzekutimit mbi shumat e llogarive në banka, rezulton se këto shuma janë në bashkëpronësi të debitorit me persona të tjerë. Edhe në këtë rast mendohet të vepohet në të njëjtën mënyrë si me sendet e luajtshme në bashkëpronësi. Gjithashtu këtu është me vend të trajtohet edhe problemi disponimit prej debitorit të sendeve të luajtshme, mbi të cilat përmbartuesi gjyqësor ka vënë sekuestro, në funksion të ekzekutimit. Kjo

situatë parashikohet nga neni 547 i K.Pr.C, ku sanksionohet se ky diskonim është i pavlefshëm. Bëhet fjalë për një veprim juridik absolutisht të pavlefshëm, pasi është një veprim juridik që vjen në kundërshtim me ligjin. Në këtë kontekst, veç kreditorit, legjitimohet të ngrejë padinë e kërimit të kthimit të këtij sendi edhe përmbaruesi gjyqësor.

Ky aksion ligjor do të dështonte vetëm në kushtet e fitimit me mirëbesim të sendit të luajshëm prej personit të tretë, sipas nenit 166 të Kodit Civil. Po në këtë frymë gjendet edhe parashikimi i nenit 559, sipas të cilit blerësi i sendit të luajshëm të shitur në dyqanin e shitjes me shitje të lirë ose i shitur në ankand, është i mbrojtur dhe bëhet pronar i sendit edhe nëse ky të rezultojë që nuk ka qenë në pronësi të debitorit. Pra, jemi në kushtet e përjashtimit të rregullit që vjen që nga e drejta romake, sipas të cilit askush nuk mund të kalojë një të drejtë që nuk e ka apo më shumë të drejta se çka.

42

Po kështu është i pavlefshëm edhe çdo veprim i debitorit që përbën diskonim të sendit të paluajshëm pas regjistrimit të sekuestro në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajshme (n. 566 i K.Pr.C). Kur bëhet fjalë për shitje të sendit të paluajshëm, nëse debitori dhe kreditori nuk arrijnë një marrëveshje për vlerën e sendit, mbi të cilin është vënë sekuestroja, përmbaruesi gjyqësor mund ta vendosë atë me vendim, bazuar në aktin e ekspertimit, të realizuar nga një ekspert i licensuar, duke u bazuar në vlerën e tregut, në çastin e vënies së sekuestro (n. 564/1 i K.Pr.C).

Megjithatë, nëse debitori dhe kreditori nuk bien dakord për këtë vlerë të shitjes së sendit, për arsye të ndryshme, siç mund të jetë, p.sh., mospërfaqësimi i vlerës reale të tregut për sendin, mund të kundërshtojnë këtë vendim të përmbaruesit. Në nenin 564/2 thuhet se palët mund të bëjnë ankim të veçantë, por pa specifikuar se ku. Në këtë rast, ashtu sikurse është kuptuar drejt edhe nga praktika gjyqësore, ankimi bëhet në gjykatën e shkallës së parë të vendit të ekzekutimit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit prej përmbaruesit gjyqësor të vendimit të vlerësimit të sendit. Pasi kalon edhe kjo fazë, zhvillohet ankandi, ku ndalohen të marrin pjesë debitori, përfaqësuesi i tij ligjor, si edhe personat që përcaktohen në mënyrë taksative në nenin 709 të Kodit Civil. Në të kundërt, nëse ndonjë nga këta persona merr pjesë në ankand dhe bëhet blerës i sendit, kjo shitje është absolutisht e pavlefshme, si veprim juridik që bie në kundërshtim me ligjin. Me pagimin e çmimit dhe taksës mbi aktet për shitjen e sendit, përmbaruesi gjyqësor merr vendim për kalimin e sendit në pronësi të blerësit (n. 574/2 i K.Pr.C). Është pikërisht ky akti, që nga pikëpamja formale, shënon kalimin e pronësisë mbi sendin, nga debitori tek blerësi.

Natyrisht që shitja e sendit të paluajshëm në ankand, ndërkohë që ankandi nuk ka përfunduar, nuk e pengon personin e tretë, që pretendon se është pronar i sendit, që ta kërkojë atë me padi rivendikimi (n. 580/1 i K.Pr.C). Në këtë kontekst, në të njëjtën kohë, ndaj kësaj shitjeje mund të bëhet ankim në gjykatën e vendit të ekzekutimit, në formën e kundërshtimit të veprimeve përmbarimore. Nëse ankandi ka përfunduar dhe shitja është kryer, vlefshmëria e saj mund të kundërshtohet me padi, për mosrespektim të kushteve të nenit 556 të K.Pr.C.

Një rast tjetër është ai i parashikuar nga neni 585 i K.Pr.C, kur personi i trete refuzon që sendet apo kreditë mbi të cilat përmbaruesi gjyqësor ka vënë sekuestro, për efekt ekzekutimi, t'i takojnë debitorit. në këtë rast ekzekutimi nuk mund të vazhdojë, por kreditori duhet të ngrejë

43

padi në gjykatën e vendit të ekzekutimit për të vërtetuar se kredia ose sendet që ka personi i tretë janë të debitorit të tij. Kjo është një padi themeli me karakter njohës/vërtetues, me palë kundërshtare debitorin dhe personin e tretë.

Në rastet e ekzekutimit të detyrimit për dorëzimin e një sendi të caktuar, që parashikohet në pjesën IV, titulli II, kreu VII, kur sendi i luajshëm, për të cilin është dhënë një vendim, nuk është

dorëzuar vullnetarisht prej debitorit dhe nuk gjendet pranë këtij të fundit ose është prishur, merret vleftha e sendit ose e pjesës që mungon. Kur kjo vlefthë nuk është përcaktuar në urdhrin e ekzekutimit, atëherë ajo përcaktohet nga gjykata e shkallës së parë të vendit të ekzekutimit, pasi dëgjohen të gjitha palët, pra, debitori, kreditori dhe përmbartuesi, si edhe, nëse është rasti, edhe dëshmitarë a ekspertë (n. 601/2 i K.Pr.C).

Po kështu, veprimtaria e përmbartuesit gjyqësor mund të jetë objekt kundërshtimi në gjykatë edhe në rastet e gjobave të vëna prej tij, si mjete që i ka dhënë ligji në funksion të realizimit të misionit të tij për ekzekutimin me sukses, plotësisht, saktësisht dhe me shpejtësi të titullit ekzekutiv. Këtu përmendim rastet e parashikuara nga neni 583/2, 588/1, 598/3 dhe 606/1 të K.Pr.C. Në të gjitha këto raste, objekt gjykimi do të jetë ligjshmëria e vendosjes së gjobës nga ana e përmbartuesit gjyqësor. Ndonëse K.Pr.C shprehet për të drejtën e ankimit në gjykatë ndaj këtyre gjobave, brenda 5 ditëve nga njoftimi i tyre, bëhet fjalë që kundërshtimi të ndërtohet në formën e një padie themeli kundër përmbartuesit gjyqësor, me objekt anulimin e gjobës. Këto gjykime kanë natyrën e gjykimeve administrative.

Së fundi, gjykata mund të shfuqizojë vendimin e përmbartuesit gjyqësor për pezullimin e ekzekutimit dhe të urdhërojë vazhdimin e tij, nëse kjo është vendosur në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në nenin 615 të K.Pr.C, si dhe vendimin e pushimit të ekzekutimit, kur ky vendim nuk është marrë nga përmbartuesi gjyqësor në respekt të kushteve të parashikuara në nenin 616 të K.Pr.C.

44

II. EKZEKUTIME TË VECANTA

2.1 Llojet detyrimeve të ekzekutueshme dhe e ekzekutimi i tyre.

Ekzekutimi i detyrueshëm mund të kryhet vetëm për detyrime të cilat për nga natyra janë të ekzekutueshme. Janë të ekzekutueshme detyrimet, objekti i të cilave është i mundshëm për tu realizuar sipas dispozitave për ekzekutimin e detyrueshëm.

Sipas kuptimit juridik të detyrimit, të ekzekutueshme janë:

a) *Detyrimet për të dorëzuar një send.* Këto detyrime kanë në përmbajtje të tyre dhënien nga ana e debitorit në favor të kreditorit të një sendi material. Këtu përfshihen detyrimet për të dorëzuar një send, detyrimet për të kthyer diçka si psh (një send të marrë të marrë hua, me qira apo në përdorim).

b) *Detyrimet për të kryer një veprim* të caktuar nga ana e debitorit në favor të të kreditorit. Këtu përfshihen detyrimet për të kryer një veprim aktiv të caktuar (një apo disa veprime konkrete që lidhen me kryerjen e një shërbimi në favor të kreditorit). Këto detyrime ndahen në detyrime të lidhura me shërbimin dhe detyrime të lidhura me rezultatin. Në këtë kategori përfshihen dhe detyrimet për të mos kryer një veprim të caktuar, që quhen ndryshe “*detyrime për të mos bërë asgjë*” dhe kanë përmbajtje ndaluese ose pësuese, të cilat quhen ndryshe dhe *detyrime negative*.

Në varësi të llojit të detyrimit që duhet të përmbushet, përcaktohet dhe procedura e ekzekutimit të tij në zbatim të titullit ekzekutiv, e cila përbën dhe të ashtuquajturën veprimtari procedurale ekzekutimi. Kjo veprimtari procedurale e ekzekutimit në fusha të veçanta, ndahet në tre kategori kryesore, sipas llojit të detyrimit objekt i ekzekutimit: Ekzekutime që kryhen për realizimin e detyrimeve në të holla, të cilat përbëjnë dhe pjesën më të gjerë të ekzekutimeve në fusha të veçanta, dhe në varësi të objektit mbi të cilin kryhet ekzekutimi mund të grupohen në dy nënkategori:

Ekzekutime që kryhen drejtpërdrejtë mbi të hollat ku përfshihen ekzekutimi i shumave të depozituara në llogari bankare, ekzekutimi mbi pagën e

debitorit, mbi kreditë e debitorit etj;

45

Ekzekutime që kryhen mbi sende të tjera me qëllim realizimin e detyrimeve në të holla, në të cilat përfshihen ekzekutimi ndaj sendeve të luajtshme, ekzekutimi ndaj sendeve të paluajtshme, ekzekutimi mbi mjetet e lundrimit dhe të fluturimit dhe ekzekutimi i sendeve në bashkëpronësi.

Ekzekutimet me objekt detyrimet për dorëzimin e sendit të caktuar, të cilat në varësi të llojit të sendit objekt dorëzimi grupohen në:

Ekzekutime për dorëzimin e sendit të paluajtshëm;

Ekzekutime për dorëzimin e sendit të luajtshëm.

b) Ekzekutime me objekt detyrim për të kryer një veprim të caktuar, të cilat në varësi të llojit të veprimit objekt ekzekutimi grupohen në:

Ekzekutime për kryerjen e veprimeve aktive;

Ekzekutime për moskryerjen e veprimeve të caktuara.

2.2 Subjektet debitorë.

Subjektet debitorë në ngarkim të cilave kryhet ekzekutim janë dy llojesh:

Persona fizik, është personi i cili gëzon zotësi të plotë për të pasur të drejta dhe detyrime civile, brenda kufijve të caktuar me ligj;

Persona juridik të cilët ndahen në:

a) Personat juridik privat, ku përfshihen shoqëritë, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji.

b) Persona juridik publik, janë institucionet e ndërmarrjet shtetërore, që financohen vetë ose nga buxheti i shtetit, si dhe entet e tjera publike të njohura nga ligji si person juridik. Personat juridik publik ndahen në:

i. Persona juridik publik shqiptar

ii. Persona juridik publik të huaj

46

Në varësi të llojit të subjektit debitor ndaj të cilit adresohet ekzekutimi i titullit ekzekutiv, ekzekutimet ndahen në:

Ekzekutime që kryhen ndaj personave fizik

Ekzekutime që kryhen ndaj personave juridik. Privat ose publik, shqiptar apo të huaj.

2.3 Mjetet e ekzekutimit

Në varësi të llojit të detyrimeve objekt i ekzekutimit, përcaktohen dhe veprimet e ndërmarra nga përmbaruesi gjyqësor për realizimin e ekzekutimit të detyrueshëm, kur ky i fundit kryhet kundër vullnetit të debitorit, të cilat përbëjnë të ashtuquajtura *mjete të ekzekutimit*.

Mjetet e ekzekutimit janë të lidhura me llojet e detyrimeve që përbëjnë dhe objektin e ekzekutimit, në varësi të cilit ndahen në:

a) Mjete për ekzekutimin e detyrimeve në të holla tek të cilat përfshihen:

Sekuestrimi i kredisë së debitorit dhe kalimi i kredisë së sekuestruar në favor të kreditorit;

Sekuestrimi dhe shitja e detyruar e sendeve të luajshme apo të paluajshme të debitorit, me qëllim transformim e tyre në të holla për realizimin e përmbushjes së kredisë ekzekutive;

Sekuestrimi dhe kalimi i sendeve të debitorit në këmbim të kredisë, tek kreditori kur ky i fundit e pranon këtë kalim.

b) Mjete për ekzekutimin e detyrimeve për dorëzimin e sendit tek të cilat përfshihen;

Marrja forcërisht e sendit të luajshëm nga debitori dhe dorëzimi i tij kreditorit;

Vënia e kreditorit në posedim të sendit të paluajshëm të debitorit.

c) Mjete për ekzekutimin e detyrimeve për kryerjen e një veprimi të caktuar tek të cilat përfshihen kryerja e veprimeve të poshtëshënuara:

Lejimi i kreditorit që të kryejë vetë veprimin, kur ky i fundit për shkak të natyrës së tij mund të kryhet dhe nga persona të tretë;

47

Vendosija e gjobës ekzekutive, kur veprimi për shkak të natyrës së tij mund të kryhet vetëm nga debitori dhe jo nga persona të tretë.

d) Mjet tjetër i ekzekutimi është dhe ai i ekzekutimit mbi kreditë e debitorit dhe sendet që personat e tretë i detyrohen këtij të fundit për shkak të marrëdhënieve juridike të krijuara midis këtij të fundit dhe personave të tretë në bazë të së cilës është lëvruar një shumë monetare apo është dhënë një send, në favor të personit të tretë nga debitori, në këmbim të së drejtës së kthimit të shumës së lëvruar dhe të interesit ose komisioneve të tjera mbi këto shuma apo objekte;

2.4. Ekzekutimi i detyrimeve në të holla.

2.4.1 .Rregulla të përgjithshme të ekzekutimit në të holla

Në rastet kur kërkohet ekzekutimi i detyrimit në të holla, përmbaruesi gjyqësor, fillimisht lajmëron debitorin për ekzekutimin vullnetar të këtij detyrimi, me anë të lajmërimit për ekzekutim vullnetar sipas formatit, të paraqitur në Shtojcën A që i bashkëlidhet këtij manuali. Lajmërimi për ekzekutim vullnetar duhet të përmbajë:

një shkurtim të përmbajtjes së urdhrit të ekzekutimit;

vendin dhe adresën e kreditorit;

afatin brenda të cilit duhet të përmbushet vullnetarisht detyrimi që përmban urdhri i ekzekutimit, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 5 ditë, kur objekti i tij është pagë ose detyrim për ushqim dhe prej 10 ditësh në të gjitha rastet e tjera;

paralajmërimin që i bëhet debitorit se do të fillojë ekzekutimi i detyrueshëm, në qoftë se ekzekutimi nuk ekzekutohet vullnetarisht prej tij brenda afatit të caktuar në lajmërim. Me marrjen e njoftimit për ekzekutimin vullnetar të urdhrit të ekzekutimit, debitori është i detyruar të japë informacion me shkrim, mbi gjendjen e tij pasurore, si dhe sendet ose kredi që persona të tretë i detyrohen, nëse kjo kërkohet nga përmbaruesi gjyqësor.

48

Me kalimin e afatit të përcaktuar në lajmërimin për ekzekutim vullnetar, në rast të mospërmbushjes së detyrimit nga debitori, përmbaruesi fillon ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestro mbi kreditë e debitorit dhe mbi sendet e luajshme dhe të paluajshme të tij, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Sekuestrimi është një akt i përmbaruesit gjyqësor, në funksion të ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv, i cili kufizon të drejtën e pronësisë së debitorit mbi sendin duke i hequr këtij të fundit dhe tagrin e disponimit të sendit.

Qëllimi i sekuestrimit është zhvillimi i ekzekutimit të detyrimit mbi një pasuri tjetër të debitorit, kur ky i fundit nuk përmbush vullnetarisht detyrimin në të holla objekt ekzekutimi, i shmangët ose e kundërshton këtë ekzekutim.

Objekt i sekuestrimit mund të jenë të gjitha llojet e sendeve që përbëjnë gjendjen pasurore të debitorit ku përfshihen dhe:

mjetet monetare në formën e llogarisë, depozitës ose kredive të debitorit në banka, kreditë e tij të të tretët, paga që ai merr si shpërblim për punën e kryer nga punëdhënësi; pensionet dhe shpërblimet e ndryshme;

sendet e luajtshme ku përfshihet çdo send organik që çmohet se ka vlerë përdorimi dhe mund të shitet;

sendet e paluajtshme si banesa e debitorit, çdo ndërtesë tjetër e tij, toka truall, toka bujqësore dhe çdo pasuri tjetër e paluajtshme në pronësi debitorit;

tituj që përmbajnë të drejta pronësie në formën e aksioneve, obligacione etj;

si dhe çdo e drejtë tjetër pasurore që mund të burojë nga pronësia intelektuale e debitorit si e drejta e patentës, e autorit, e shpikjes etj,

në qoftë se sendet e sekuestruara janë të siguruara, sekuestrimi shtrihet edhe në shpërblimin që u takon nga sigurimi.

49

Sekuestrimi shtrihet mbi sendet që janë në pronësi të debitorit dhe pjesët takuese të tij mbi sendet në bashkëpronësi më të tretët. Konsiderohet se janë të debitorit të gjitha sendet të cilat gjenden në banesën ose ndërtesën tij në momentin e ekzekutimit të sekuestrimit.

Personi i tretë i cili pretendon se është pronar i sendit ose i disa prej sendeve duhet ti paraqesë përmbaruesit gjyqësor dokumentet që vërtetojnë se sendi i sekuestruar është në pronësi të tij dhe jo të debitorit. Në rast pamundësie të provimit të një fakti të tillë, personi i tretë mund të mbrojë pretendimin e tij mbi pronësinë e sendeve të sekuestruara vetëm duke ju drejtuar gjykatës.

Sekuestrimi vetëm kryhet me një akt të përmbaruesit gjyqësor ose me vendim gjyqësor dhe në varësi të pasurisë mbi të cilën lëshohet akti i sekuestrimit (urdhër për vënien e sekuestro konservative apo ekzekutive), dhe është dy llojesh:

Sekuestrim pjesor kur me sekuestrimin lidhen disa sende të veçanta nga pasuria e debitorit, të mjaftueshme për plotësimin e detyrimit në të holla objekt ekzekutimi;

Sekuestrim i përgjithshëm kur ky shtrihet në të gjithë sendet që përbëjnë pasurinë e debitorit, i cili zakonisht gjen zbatim kur detyrimi në të holla është një shumë e madhe .

Sendet dhe vendndodhja e sendeve që janë objekt ekzekutimi, tregohen nga kreditori, megjithatë kërkesa e kreditorit nuk është përcaktuese. Me kërkesën e debitorit, sekuestroja mund të vihet edhe mbi një pasuri tjetër të tij të ndryshme nga ajo që ka treguar kreditori, kur përmbaruesi gjyqësor çmon se kjo plotëson kërkesën e kreditorit. Në këto raste përmbaruesi gjyqësor duhet të

marri në konsideratë nëse sendi i ofruar nga pala debitorë e përmbush masën e detyrimit apo jo. Për këtë është nevojshme që pala debitorë në momentin e ofrimit të pasurisë së palujtshme të sigurojë përmbaruesin gjyqësor me dokumentacionin e pasurisë si dhe nëse është e mundur dhe me vlerësim të drejtë perdrejtë të pronës ose dhe të pasurisë së përafërt në vendodhje si dhe në përbërje të ngjashme. Në këtë rast përmbaruesi gjyqësor mbasi krijon bindjen e tij se pasuria e ofruar mund të përmbushë kënaqshëm detyrimin e përcaktuar në titullin ekzekutiv shtrinë sekuestron mbi këtë pasuri të ofruar nga pala debitorë.

50

2.4.2. Përrjashtimi i sendeve nga sekuestrimi

Gjatë ekzekutimit të detyrimeve në të holla debitorit i sigurohet mbrojtje ekonomike, intelektuale dhe morale, duke i garantuar një minimum të mjeteve jetesën e tij dhe familjes së tij, në përmbushje të objektivave të shtetit social të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, për ti siguruar shtetasve kushtet me minimale dhe të nevojshme për jetesë. Sa sipër, përjashtohen nga sekuestrimi i pasurisë së debitorit:

- sendet e përdorimit personal të debitorit dhe të familjes së tij si: veshjet, shtresat, mbulesat, mobiljet për aq sa ato janë të nevojshme për jetesën e tyre;
- ushqimet dhe lëndët djegëse që i nevojiten debitorit dhe familjes së tij për tre muaj;
- dekoratat dhe sende kujtimi, letra, shkresa të familjes dhe librat profesionalë;
- librat, veglat muzikore, mjetet e artit që nevojiten për veprimtarinë shkencore dhe artistike të debitorit dhe të familjes së tij;
- deri 3 dynymë tokë, 2 kafshë për punimin e tokës, 1 lopë, 6 dele ose 6 dhi, fara për mbjelljen e ardhshme, si dhe ushqimi i këtyre kafshëve për 3 muaj për personat që jetojnë me punë bujqësore ose blegtorale;
- ndihma që u jepet nënave me shumë fëmijë ose të vetme, pensionet e pleqërisë, të invaliditetit ose familjarë ose bursa e studimit përveç kur detyrimi është për ushqim. **Në këtë rast nuk mund të sekuestrohet më shumë se 1/2 e shumës së pensionit ose të bursës;**
- frutat natyrore një muaj para se ato të piqen;
- Sendet e nevojshme të punës për sigurimin e jetesës.

2.4.3. Ekzekutimi i sekuestrimit

Sekuestrimi ekzekutohet në dy mënyra:

a) *me anë të inventarizimit*, kur objekt sekuestrimi janë sendet e luajtshme. Sendet e luajtshme individualizohen në lloj dhe gjini dhe quhen të sekuestruara kur inventarizohen nga përmbaruesi gjyqësor dhe pasqyrohen në procesverbalin e inventarizimit. Gjithashtu në momentin e

51

inventarizimit të sendit të luajtshëm përmbaruesi gjyqësor duhet të vendosi mbi pjesën e dukshme të tij shenjen dalluese të sekuestrimit të sendit. Sendi i luajtshëm pasi inventarizohet lihet në ruajtje palës debitorë e cila në përputhje me nenin 545 i cili ka të drejtë ti përdori atë por me kushtin e vetëm që nuk duhet të pakësojë vlerën e tyre. Në rast se pala debitorë nuk mund të mbaje në ruajtje pasurinë e luajtshme ose refuzon ruajtjen e sendit përmbaruesi gjyqësor ka të drejtë që për ruajtjen e kësaj pasurie të emëroj në këtë detyrë një person tjetër duke i caktuar atij një shpërblim.

b) *me anë të regjistrimit*, kur objekt sekuestrimi janë pasuritë e paluajtshme dhe aksionet e

debitorit në një shoqëri tregtare. Sendet e paluajtshme quhen të sekuestruara kur akti i sekuestrimit të tyre regjistrohet në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të vendit ku është regjistruar pasuria. Në ligj është përcaktuar që sekuestrimi i pasurisë së paluajtshme të behet duke u vendosur shënimi i sekuestro në regjistrin e ZVRPP si dhe duke u bërë sekuestrimi faktik i pasurisë së paluajtshme. Nëse do të shikojmë në K.Pr.Civile është parashikuar që vetëm për pasurin e luajtshme ligjvënësi ka lejuar që pala debitorë të përdori sendin ndërsa në pasurin e palujtshme një veprim i tillë nuk është parashikuar, cka do të thotë që në ligj është parashikuar që përmbaruesi gjyqësor të bëjë sekuestrimin e sendit duke e privuar palën debitorë nga përdorimi i pasurisë së paluajtshme. Me këtë veprim përmbaruesi nuk shkel asnjë të drejtë të palës debitorë në cënimin e të drejtës së pronësisë pasi në këtë rast nuk kemi tjetërsim të pasurisë por e detyron atë (debitorin) në mënyra të shpejtë të kërkoj dhe të kryej veprime për shlyerjen e detyrimit të tij. Nga praktika e deritanishme është vërejtur që nga ana e përmbaruesve gjyqësor duke mos kryer drejt veprimin e sekuestrimit të pasurisë së palujtshme kemi parë që vetë palët debitorë që megjithëse në gjendje të mirë pasurore nuk kanë kryer veprime për shlyerjen e detyrimit të tyre. Pra në këtë rast nuk është arritur nga përmbaruesit që të bëjnë të mundur ekzekutimin e titujve ekzekutiv.

Një veprim tjetër i sekuestrimit me regjistrim janë aksionet e debitorit në një shoqëri tregtare, të cilat quhen të sekuestruara në momentin e regjistrimit të aktit të sekuestrimit, në librin e aksioneve të shoqërisë. Gjithashtu praktika përmbarimore ka përcaktuar që dhe sekuestrimi i mjeteve të lundrimit si dhe atyre të fluturimit të bëhet me anë të vendosjes së masës së sekuestros duke u bërë shënimi përkatës për mjetet e lundrimit në Regjistrin Tregtar të anijeve si dhe për

52
mjetet e fluturimit në komandën e aeroportit ku është bërë sekuestrimi. Në të dy rastet kur vendoset masa e sekuestro mjetet bllokohen dhe sekuestrimi nuk lejon lundrimin ose fluturimin pra në këtë rast kemi të bëjmë me sekuestro ekzekutive.

Në varësi të llojit të pasurisë së sekuestruar hartohet dhe akti i sekuestrimit të lëshuar nga Përmbaruesi gjyqësor, sikurse janë ilustruar në formatin 2 të shtojcës A të këtij manuali. Në rastin e pasurisë së luajtshme sekuestrimi kryet me ane të procesverbalit ndërsa në rastin e sekuestrimit të pasurisë së palujtshme kemi vendimin e përmbaruesit për vendosjen e sekuestro si dhe procesverbalin në momentin e sekuestrimit dhe lënies në ruajtje të objektit të sekuestruar.

Sekuestrimi mund të shtrihet tek e gjithë pasuria e mundshme e debitorit e tashme dhe e ardhme kudo ku ajo gjendet, përveç përjashtimeve të sipërcituara në ligj. Megjithatë sekuestrimi shtrihet mbi pasuritë e debitorit në masën që vlerësohet se nga shitja e një ose disa prej tyre mund të nxirren shumat e nevojshme për pagimin e detyrimit në të holla të përcaktuar në urdhrin e ekzekutimit.

Kur sekuestrimi kryhet pa njoftimin paraprak të debitorit, ose kur ai nuk merr pjesë në ekzekutim sekuestrimi i njoftohet detyrimisht debitorit nga përmbaruesi gjyqësor, sipas rregullave mbi njoftimin e akteve gjyqësore (nenet 130-144 të KPrC).

Nga çasti i vënies së sekuestro, debitori apo personat që kanë në posedim sendin e debitorit nuk ka të drejtë të disponojë sendin e luajtshëm ose të paluajtshëm ose kredinë apo të ndryshojë, dëmtojë ose të zhdukë sendin, përndryshe ka përgjegjësi, sipas dispozitave të nenit 320 të Kodit Penal.

Të njëjtat detyrime ka dhe personi të cilit i janë lënë në ruajtje sendet e sekuestruara, për shpenzimet dhe të ardhurat e të cilave ai jep llogari dhe përgjigjet në rast dëmtimi, disponimi apo shkatërrimi të tyre.

2.4.4 Rregullat e njoftimit të vendimeve të përmbaruesit gjyqësor

Një nga elementet e rëndësishme për ekzekutimin e titujve ekzekutiv është dhe mënyra e komunikimit të palëve si dhe mjetet që do të përdorin përmbaruesit gjyqësor për të dërguar në drejtim të palës debitorë ose të palëve të tjera në proces ekzekutimi njoftimet e tyre.

Ne ligj është parashikuar mënyra e dorëzimit që i behet palëve në adresën ku ato banojnë për personat fizik ashtu dhe për subjektet juridike në objektin ku ato kane selinë dhe që ushtrojnë veprimtarin e tyre.

Ne nenin 144/a të K.Pr.Civile përcaktohet që shërbimi përmbarimor për njoftimin e akteve përdor të njëjtat rregulla si dhe gjykata të cilat do të shtjellohen më poshtë.

Pra në këto kushte flete porosia është akti që tregon mënyrën se si subjektet debitorë ose palët në proces ekzekutimi marrin dijeni lidhur me komunikimet që përgatiten nga përmbaruesit gjyqësor.

Ne shume procese gjyqësore është vërejtur që përmbaruesit gjyqësor nuk kane arritur të bindin gjykatën në dërgimin e njoftimit të tyre.

Është e rëndësishme që përmbaruesi ketë fakt ta marrë shume në konsiderate dhe në mungese të dokumentimit të komunikimit të njoftimit të mos kryejë veprime përmbarimore. Është e këshillueshme që në ketë rast përmbaruesi gjyqësor duhet të përsëris njoftimin e tij se sa të kryej veprimin përmbarimor dhe ky veprim ti kundërshtohet në gjykate dhe gjykate të vendose anulimin e tij. Një veprim i tille përben shkak që përmbaruesi gjyqësor të zvarrisë procesin përmbarimor dhe e mos respektoje afatet ligjore të ekzekutimit.

Ne kapitullin e templates në ju kemi dhënë një format të fletës se porositur ku mendojmë se plotëson kënaqshëm kërkesat e parashikuar nga ligji për komunikimin e akteve. Në përdorimin e tij shoqëritë përmbarimore ose vete përmbaruesit gjyqësor duhet të plotësojnë rubrikat sakte duke dhënë se kush është subjekti përmbarimor që ka dërguar aktin, kush është pala që i drejtohet njoftimi si dhe cfare përmban ky njoftimi dhe adresën e plote të palës ku është dorëzuar akti.

Në pjesën e dytë fletë porosia plotësohet nga vetë pala debitorë ose personi që merr njoftimin ku ai shënon datën e marrjes si dhe vendos emrin mbiemrin dhe firmën e tij.

Në rast se personi refuzon firmën ftuesi ose personi i përdorur nga përmbaruesi gjyqësor duhet të bëjë shënimin përkatës që zarfi ju dorëzua por subjekti refuzojë firmën.

Ne disa raste njoftimet e katve të përmbarimit u dorëzohen dhe familjareve të tjerë të familjes ose dhe komshinjve të tyre në ketë rast personi që merr njoftimin duhet të shënoj që merr përsipër njoftimin e palës të çilet i drejtohet njoftimi.

Njoftimi i personave fizik

Njoftimi i vendimeve të përmbaruesit gjyqësor, bëhet nëpërmjet dorëzimit nga nëpunësi gjyqësor, të kopjes së vendimit që përmban disponimet e përmbaruesit (ku përfshihen njoftimi për ekzekutim vullnetar, njoftimi për vënien e sekuestro etj), debitorit, kudo ku ai gjendet brenda territorit të juridiksionit të gjykatës, ku është në marrëdhënie pune nëpunësi gjyqësor.

Në qoftë se debitori apo personit të cilit i adresohet njoftimi i vendimeve të përmbaruesit gjyqësor refuzon marrjen në dorëzim, të aktit të përmbaruesit, nëpunësi gjyqësor bën shënimin përkatës në fletë-njoftimin për mosmarrjen në dorëzim nga personi të cilit i adresohet. Kur është e mundur e vërteton këtë me nënshkrimin e një dëshmitari të pranishëm në momentin e dorëzimit të aktit .

Kur njoftimi i aktit të përmbaruesit gjyqësor nuk arrihet të njoftohet debitorit apo apo çdo personit tjetër të adresuar për njoftim, njoftimi bëhet në vendbanimin apo vendqëndrimin e

debitorit apo në zyrën apo vendin ku debitori ushtron veprimtarinë e tij tregtare, industriale ose të artizanatit.

Në goftë se debitori nuk gjendet në asnjërën nga këto vende, njoftimi i aktit të përmbauesit i dorëzohet një personi të familjes që ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç. Përveç rasteve kur i thirruri është i mitur, nën gjashtëmbëdhjetë vjeç ose është i pazoti për të vepruar, në rast të pamundësisë së njoftimit nëpërmjet familjarëve të tij të cilët duhet të kenë mbushur moshën 16 vjeç, njoftimi mund të bëhet edhe nëpërmjet:

fqinjëve, që pranojnë t'ia dorëzojnë atë debitorit apo personit të njoftuar,

zyrës ose qendrës së punës së tij.

Në të gjitha rastet kur njoftimi i debitorit nuk i komunikohet drejtpërsëdrejti atij, personi që merr njoftimin e aktit, duhet të nënshkruajë origjinalin ose kopjen e saj, duke marrë përsipër detyrimin që kopjen tjetër t'ia dorëzojë personit të thirrur. Gjithashtu në kopjen që mban nëpunësi i

55

gjykatës bëhen shënimet për të treguar marrëdhëniet e personit që ka marrë përsipër njoftimin me personin që i drejtohet njoftimi.

Njoftimi quhet i kryer dhe kur nuk i komunikohet dot debitorit, duke bërë shënimi në kopjen e tij, duke u nënshkruar të paktën edhe nga një dëshmitar në rastet kur:

Debitori ose njerëzit e familjes së tij nuk pranojnë të marrin në dorëzim njoftimin për aktet e përmbauesit gjyqësor,

Njerëzit e familjes së debitorit, dhe fqinjët që u jepet njoftimi për t'ia dorëzuar debitorit, nuk dinë ose nuk mund të nënshkruajnë.

Gjithashtu njoftimi i aktit të përmbauesit gjyqësor, i bëhet debitorit nëpërmjet afishimit të kopjes së aktit në gjykatën e vendit, ku është lëshuar titulli ekzekutiv, si dhe në vendin e afishimit, ku ka pasur vendbanimin e fundit në rastet kur:

nuk i gjendet apo nuk i dihet vendbanimi ose vendqëndrimi në Republikën e Shqipërisë,

ose nuk ka zgjedhur një banesë,

apo nuk ka caktuar një përfaqësues të tij,

Njoftimi për personat juridik

Njoftimi i institucioneve, ndërmarrjeve dhe personave të tjerë juridikë shtetëror, të cilët rezultojnë të jenë në cilësinë e debitorit apo personit të cilit i adresohet njoftimi i aktit të përmbauesit gjyqësor, bëhet nëpërmjet dorëzimit të kopjes së aktit në zyrën së titullarit dhe personave të ngarkuar për të pranuar akte.

Njoftimi për personat juridikë joshtetërorë bëhet në qendrën e tyre, nëpërmjet dorëzimit të kopjes së aktit të përmbauesit ose personit të ngarkuar për të marrë njoftimin dhe në mungesë të tyre, një personi tjetër që punon në këtë qendër të personit juridik. Kur ky njoftim nuk është i mundur, ky njoftim bëhet nëpërmjet afishimit të tij pranë adresës së regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Njoftimet e veçanta

a) Kur debitori rezulton të jetë në shërbim në ushtri ose në repartet e Ministrisë së Rendit Publik, njoftimi i akteve të përmbauesit gjyqësor i bëhet me anë të komandës së repartit nga i cili varet.

56

b) Njoftimi i akteve të përmbauesit gjyqësor mund të kryhet edhe nëpërmjet shërbimit postar. Në rastin e kryerjes së njoftimit me postë, nëpunësi gjyqësor duhet të shënojë mbi origjinalin

dhe mbi kopjen e njoftimit të aktit të përmbauesit gjyqësor dhe zyrën e postës nëpërmjet së cilës i është dërguar kopja marrësit, me dërgesë të porositur. Dëftesa e marrjes në dorëzim duhet t'i bashkohet origjinalit të aktit.

c) Forma të tjera të njoftimit të akteve të përmbauesit gjyqësor janë dhe ato nëpërmjet nëpërmjet telegramit me përgjigje, me faks, kur vërtetohet me shkrim marrja e tij, me shkresë dorazi e me mënyra të tjera që garantojnë një njoftim të rregullt, kur e kërkojnë rrethana të veçanta ose nevoja e një njoftimi të shpejtë.

2.4.5 Shtyrja e ekzekutimit dhe ndarja me këste

Në rastet kur objekt ekzekutimi është pagesa e një shume në të holla, debitori brenda afatit të ekzekutimit vullnetar (prej 10 ose 5 ditësh) mund ti kërkojë gjykatës:

a) të shtyjë afatin e ekzekutimit të detyrimit në të holla ose

b) ta ndajë këtë detyrim në këste.

Gjykata e shkallës së parë duke marrë parasysh gjendjen pasurore të debitorit ose rrethanat e tjera të çështjes, pasi dëgjon edhe kreditorin mund të pranojë kërkesën e debitorit duke vendosur:

a) të shtyjë afatin e ekzekutimit duke i caktuar debitorit një afat të ri për përmbushjen e detyrimit,

b) shlyerjen e detyrimit në të holla nga ana e debitorit me këste, duke përcaktuar shumën që do të paguhet për çdo këst dhe kohën e shlyerjes së çdo kësti.

Vendimi i gjykatës i cili shtyn afatin e ekzekutimit të detyrimit nga debitori e pezullon ekzekutimin. Vendimi i gjykatës që ndan pagesën e detyrimit në këste, kur merr formë të prerë anulon veprimet e mëparshme të caktuara për tu ekzekutuar. Ky vendim i bashkohet titullit ekzekutiv dhe bëhet pjesë e pandashme e tij dhe ekzekutimi rifillon sipas disponimeve të bëra

57

në këtë vendim. Vendimi që rrëzon kërkesën e debitorit nuk pezullon ekzekutimin e titullit ekzekutiv.

Duhet të kihet parasysh që shtyrja e afatit të ekzekutimit dhe ndarja e detyrimit në të holla në këste, është një përjashtim nga rregulli dhe jo rregull më vete.

2.4.6 Bashkimi i ekzekutimeve

Në çastin e fillimit të procedurës së ekzekutimit, përmbauesi gjyqësor regjistron, në regjistrin qendror pranë Ministrisë së Drejtësisë, çdo kërkesë për vënie në ekzekutim të një titulli ekzekutiv. Ky regjistrim behet me anë të një kërkesë sipas formatit të paraqitur në shtojcën nr.1, bashkëlidhur këtij manuali.

Në rast se me fillimin e procedurës me objekt "*Ekzekutim detyrimesh në të holla*" përmbauesi gjyqësor, nga të dhënat e marra nga regjistri qendror, vëren se kreditorë të tjerë janë në procedurë ekzekutimi ndaj të njëjtit debitor, me të njëjtin objekt, atëherë pezullon procedurën e nisur dhe drejton kreditorin e tij të përmbauesi gjyqësor, i cili ka regjistruar i pari kërkesën për ekzekutim. Në këtë rast, përmbauesi gjyqësor, që ka regjistruar i pari kërkesën, vijon procedurën e ekzekutimit, të detyrimit në të holla.

Me pezullimin e procedurës së ekzekutimit, tarifa e vënies në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit, së bashku me dokumentacionin, i kthehen kreditorit. Kjo procedurë nuk ndiqet kur në cilësinë e palës debitorë është shteti.

Kreditorët e tjerë të debitorit, i bashkohen ekzekutimit të filluar duke kërkuar ekzekutimin e njëkohshëm të kredive së bashku me kredinë që ka filluar e para ekzekutimin. Bashkimi i kreditorëve të tjerë në ekzekutim bëhet me kërkesë e cila i drejtohet përmbauesit gjyqësor i cili ka regjistruar i pari kërkesën për ekzekutim dhe kryen ekzekutimin. Kjo kërkesë mund të bëhet në çdo fazë të ekzekutimit, deri sa nuk është përgatitur nga përmbauesi gjyqësor

projekti i ndarjes së shumave të nxjerra. Kësaj kërkesë i bashkëngjitet dhe urdhri i ekzekutimit ose një vendim nga përmbauesi gjyqësor kur urdhri i ekzekutimit i është bashkëngjitur një çështjeje tjetër që është në ekzekutim. Kundër vendimit të përmbauesit për bashkimin e kreditorëve mund të bëhet ankim në formën e kundërshtimit të veprimeve përmbaimore.

58

Shteti në cilësinë e kreditorit gjatë bashkimit të ekzekutimeve

Në ekzekutim merr pjesë dhe “Shteti”, në cilësinë e kreditorit që thirret kryesisht në ekzekutim nga përmbauesi gjyqësor, kur debitori ka detyrime në të holla ndaj tij, të cilët rrjedhin nga tatimet dhe nga kredi të tjera, shuma e të cilëve i është njoftuar përmbauesit gjyqësor, para se të bëhet ndarja e shumave të tjera. Me marrjen e njoftimit përmbauesi gjyqësor ka detyrë të njoftojë seksionin përkatës të financës në qendrën administrative ku e ushtron veprimtarinë e tij për çdo ekzekutim të filluar prej tij dhe për çdo projekt ndarje shumash të dala nga ekzekutimi.

Vlefshmëria e veprimeve të kryera gjatë bashkimit të ekzekutimeve

Kreditori që merr pjesë në ekzekutim bashkë me kreditorët e tjerë ka po ato të drejta që ka edhe kreditori, i cili ka vënë i pari sekuestron mbi sendet e debitorit, përveç kur ekzistojnë shkaqe të ligjshme të referimit. Veprimet e ekzekutimit, të kryera para se kreditori të marrë pjesë bashkë me kreditorët e tjerë, krijojnë të drejta edhe për ata.

Konkurimi i kredive gjatë bashkimit të ekzekutimit

Kreditë e bashkuara në ekzekutim konkurrojnë në shlyerje sipas rendit të preferimit të përcaktuar si më poshtë vijon, pavarësisht se cila ka filluar e para ekzekutimin. Në qoftë se kredia që i bashkohet ekzekutimit është në radhë prefrimi mbi kredinë për ekzekutimin e së cilës është vënë sekuestroja mbi sendet apo kreditë e debitorit ajo zë radhë në shlyerje dhe paguhet para saj.

Referuar përcaktimeve të bëra në nenin 604 e 605 të Kodit Civil, paguhen me preferim, sipas radhitjes së tyre kreditë e mëposhtme:

- a) kreditë që rrjedhin nga transaksionet financiare të siguruara me barrë siguruese për çmimin e blerjes së një objekti të veçantë;
- b) kreditë që rrjedhin nga pagat në marrëdhëniet e punës ose të shërbimit dhe detyrimet për ushqim, por jo më shumë se për 12 muaj;
- c) kreditë e sigurimeve shoqërore për kontributet e papaguara së bashku me kamatat, si dhe kreditë e punonjësve për dëmet e pësuar nga mospagimi prej punëdhënësit të kontributeve të mësipërme;

59

- ç) kreditë që rrjedhin nga shpërblime për shkak vdekjeje e dëmtimi të shëndetit;
- d) kreditë e autorëve dhe të trashëgimtarëve të tyre për shpërblimet që rrjedhin nga tjetërsimi i plotë ose i pjesshëm i të drejtave të tyre në fushën intelektuale për detyrimet e lindura gjatë dy vjetëve të fundit;
- dh) kreditë e shtetit, që rrjedhin nga detyrimet ndaj buxhetit dhe kreditë e institutit të sigurimeve shtetërore për sigurimet e detyrueshme, të përcaktuara me ligj;
- e) kreditë, që rrjedhin nga transaksionet financiare, të siguruara me barrë siguruese, sipas kritereve të përcaktuara me ligj;
- ë) kreditë, që rrjedhin nga pagat në marrëdhëniet e punës ose të shërbimit dhe detyrimet për ushqim tej kufirit të caktuar në shkronjën “b” të këtij neni;
- f) shpërblimi i ndërmjetësimit që rrjedh nga kontrata e agjencisë, kur ai rrjedh gjatë vitit të fundit të shpërblimit;
- g) kreditë e siguruara me hipotekë ose me peng që nuk krijojnë barrë siguruese, sipas

- ligjit, nga vlefata e sendeve në hipotekë ose të lëna peng;
- gj) kreditë që rrjedhin nga shpenzimet e gjyqit për ruajtjen e sendit dhe ato për veprime ekzekutive, të bëra në interesin e përbashkët të kreditorëve, nga vlefata e shitjes së sendeve;
- h) kreditë e dhëna nga bankat, të cilat nuk përfshihen në shkronjën “e” dhe kreditë që rrjedhin nga sigurimet vullnetare;
- i) kreditë për furnizimin me farëra, plehra kimike, insekticide, ujë për ujitje dhe për punimet e kultivimit e të mbledhjes së prodhimeve bujqësore, mbi prodhimin (frytet) bujqësor të vitit, për të cilin janë përdorur kreditë.

Kur ka disa kredi sipas shkronjës “a” dhe shkronjës “e” të këtij neni, radha e referimit, përcaktohet sipas kriterëve të përcaktuar me ligj të veçantë. Kur ligji i veçantë nuk i jep një kredie sipas shkronjës “a” preferim mbi kreditë sipas shkronjës “e”, kredia sipas shkronjës “a” do të preferohet sipas shkronjës “e”.

Përjashtohen nga radha e referimit sipas këtij neni kreditë sipas shkronjës “e”, që janë dhënë aktualisht, të cilat do të preferohen përpara kredive sipas shkronjës “dh” në rastet që vijnë:

- kredia sipas shkronjës “e” është regjistruar sipas ligjit, ndërsa kredia sipas shkronjës “dh” nuk është regjistruar;

60

- kredia sipas shkronjës “e” është regjistruar sipas ligjit, përpara regjistrimit të kredisë sipas shkronjës “dh”.

2.4.7 Projekti i ndarjes së shumave të nxjerra nga ekzekutimi.

Projekti i ndarjes së shumave ka në përmbajtje ndarjen e shumave të nxjerra nga ekzekutimi, kur këto të fundit të nxjerra nga ekzekutimi nuk mjaftojnë për të paguar të gjithë kreditorët. Projektin e ndarjes, përgatitet nga përbaruesi gjyqësor duke veçuar më parë shumat që nevojiten për kreditë që paguhen me preferim (**neni 605 i K.Civil**) dhe nga pjesa tjetër që mbetet, paguan kreditë e tjera në përpjesëtim me shumat e tyre.

Njoftimi

Përbaruesi gjyqësor njofton për përgatitjen e projektit të ndarjes së shumave të nxjerra debitorin dhe kreditorët, të cilët i thërret për këtë qëllim në një ditë të caktuar prej tij. Në qoftë se brenda 5 ditëve nga dita e paraqitjes prej përbaruesit gjyqësor të projektit të ndarjes nuk bëhet ankim, ndarja quhet përfundimtare dhe përbaruesi gjyqësor i dorëzon çdo kreditori shumën që i takon.

Ankimi

Në rast se kundër projektit të ndarjes së shumave të nxjerra bëhet ankim, çështja së bashku me ankesën i dërgohet gjykatës së shkallës së parë e cila vendos në seancë gjyqësore, duke thirrur debitorin dhe kreditorët. Kundër vendimit të gjykatës për ndarjen e shumave të nxjerra mund të bëhet ankim i veçantë në gjykatën e apelit.

Pagimi i kredive të bashkuara për ekzekutim sipas projektit të ndarjes së shumave bëhet kur :

a) Kundër projektit të ndarjes së shumave nuk është bërë ankim brenda 5 ditëve nga paraqitja e tij

b) Ankimi kundër projektit nuk pranohet nga gjykata

Kalimi i shumave në llogarinë e përbaruesit gjyqësor.

61

Shumat e nxjerra në para, me rastin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv ndaj:

debitorit,

personit të tretë që i detyrohet debitorit,

□ blerësit të sendit të shitur në dyqanet me shitje të lirë ose në ankand, derdhen në bankë në llogari të zyrës së përmbarrimit ose në llogari të përmbarruesit gjyqësor. Për këtë qëllim përmbarruesi gjyqësor apo zyra e përmbarrimit apo zyra e i bën me dije ekzekutim llogarinë e tituj në çdo rast. Llogaria bankare e zyrës së përmbarrimit apo përmbarruesit privat është një llogari depozitë, që rregullohet nga parimet dhe rregullat e përgjithshme të kontabilitetit. Në kredi të llogarisë regjistrohen shumat e nxjerra nga ekzekutimi ndërsa në debi të saj regjistrohen pagimet e shumave në emër të përfituesve të kredive ekzekutive, kur përmbarruesi gjyqësor kryen ekzekutimin e tyre .

2.4.8 Rregulla të përgjithshme për ekzekutimin e detyrimeve në të holla.

Lloji i monedhës

Kur ekzekutimi ka si objekt detyrimin për të paguar një shumë parash, kjo e fundit ekzekutohet në vleftën e vet nominale, përveç kur rezulton ndryshe në titullin ekzekutiv. Detyrimi në të holla ekzekutohet në monedhën që është në qarkullim në shtetin ku bëhet ekzekutimi ose me monedhën e përcaktuar në titullin ekzekutiv.

Kur detyrimi në të holla për shkak të rrethanave në ekzekutim duhet të ekzekutohet në një monedhë të ndryshme nga ajo e pranuar, bëhet konvertimi me kursin zyrtar të këmbimit të ditës së pagimit, në vendin e ekzekutimit.

Vendi i ekzekutimit

Pagesa e detyrimit në të holla kryhet në vendbanimin e kreditorit në datën e pagesës. Kreditori mund të caktojë një vend tjetër brenda kufijve të shtetit ku ka vendbanimin në kohën e pagimit ose të lindjes së detyrimit. Pagesa quhet e kryer në momentin e kreditimit të saj në llogari.

62

Radha e shlyerjes

Ekzekutimi i detyrimit në të holla sipas titullit ekzekutiv kryhet sipas kësaj radhe:

- a) Shlyerja e shpenzimeve të ekzekutimit
- b) Shlyerja e kamatave të arrira
- c) Shlyerja e vetë detyrimit së bashku me kamatat e zakonshme.

Mosrespektimi i kësaj radhe në ekzekutim i jep të drejtë kreditorit që të refuzojë pagesën e ekzekutimit të detyrimit sipas një radhe tjetër .

Shpërblimi i dëmit nga vonesa

Vonesat në ekzekutimin e detyrimit në të holla, detyrojnë debitorin që të përgjigjet për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vonesat. Shpërblimi për dëmin e shkaktuar si rrjedhim i vonesës në pagimin e një detyrimi në të holla, përbëhet nga kamatat e arrira, prej datës së fillimit të vonesës së debitorit, me monedhën zyrtare të vendit ku bëhet pagimi. Përqindja e kamatës caktohet me ligj. Në mbarim të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës së detyruar mbi bazën e të cilës është bërë llogaritja e tyre. Kamata ligjore paguhet pa qenë i detyruar kreditori të provojë ndonjë dëm. Kur kreditori provon se ka pësuar një dëm më të madh se kamata ligjore, debitori detyrohet t'i paguajë atij pjesën tjetër të dëmit.

2.5. Ndalimet e blerjes në ankand

Sendet e sekuestruara që shiten në ankand nuk mund të blihen drejtpërdrejt apo me anë të një tjetri nga personat e poshtëshënuar:

- a) debitori ose përfaqësuesi i tij ligjor;
- b) personat që administrojnë ose ruajnë sende të huaja në bazë të ligjit ose të emërimit nga shteti, sendet që administrojnë ose ruajnë;
- c) personat zyrtarë që janë të ngarkuar të bëjnë shitje me ekzekutim të detyrueshëm, sendet që këta shesin;

d) gjyqtarët, prokurorët, përmbauesit, noterët dhe avokatët, sendet për të cilat ka grindje përpara gjykatës në të cilën bëjnë pjesë ose ushtrojnë funksionet e tyre, përveç kur këta janë bashkëpronarë mbi ato.

Kundër shitjes së sendit në ankand mund të mund të bëhet ankim në formën e kundërshtimit të veprimeve përmbaimore , i cili shqyrtohet nga gjykata e rrethit gjyqësor ku kryhet ekzekutimi. Në rast se sendet e debitorit blihen nga persona për të cilat ligji parashikon ndalime, ankandi është i pavlefshëm dhe me kërkesën e çdo personi të interesuar, mund të bëhet një ankand i ri për shitjen e sendeve.

2.6 Kryerja e Ekspertimit

Ekspertimi në procedurën e vënies në ekzekutim të titujve ekzekutiv është i kufizuar, pasi në këtë fazë një akt ekspertimi mund të kryhet vetëm në rastet e parashikuara në ligj, konkretisht:

a) Për vlerësimin e sendeve të luajtshme mbi të cilat kryhet ekzekutimi, me qëllim përcaktimin e çmimit në bazë të cilit do të kryhet shitja e sendit në ankand kur për çmimin e shitjes ka kundërshtime midis përmbauesit gjyqësor dhe debitorit dhe kreditorit.

b) Për pasuritë e paluajtshme me qëllim përcaktimin e çmimit nga ana e përmbauesit gjyqësor, kur debitori dhe kreditori nuk arrijnë një marrëveshje për vlerën e sendit, i cili i referohet aktit të ekspertimit, të paraqitur nga një ekspert i licencuar bazuar në vlerën reale të pasurisë në treg, në çastin e vënies së sekuestro mbi të. Në rastin e pasurive të palujtshme përmbauesi gjyqësor në përputhje me ligjin i fton palët në proces ekzekutimi të caktojnë me marrëveshje midis tyre Çmimin e sendit. Nëqoftese palët brenda afatit ligjor prej 7 ditësh nuk paraqesin ose depozitojnë pranë përmbauesit gjyqësor një marrëveshje me shkrim për caktimin e çmimit të sendit të sekuestruar përmbauesi cakton ekspert duke e thërritur atë me vendim. Eksperti i thirrur nga përmbauesi mban përgjegjësi për aktin e ekspertimit. Për të caktuar çmimin e sendit ai duhet ti referohet gjendjes aktuale të pasurisë, vendodhjes së saj si dhe çmimeve të tregut. Akti i ekspertimit duhet të jete i shkruar dhe përmbauesi gjyqësor mbasi merr mendimin

64

e specializuar përcakton me vendim çmimin e pasurisë të cilën ja komunikon palëve në proces ekzekutimi.

c) Kur përmbushja e detyrimit në të holla që përcaktohet në titullin ekzekutiv, është e ngarkuar me kamatëvonesa, gjoba apo kusht penal.

2. 7 EKZEKUTIMI I DETYRIMEVE NË TË HOLLA NË FUSHA TË VECANTA

2.7.1 Ekzekutimi në shumat e llogarive në banka

Kuptimi i llogarisë bankare

Me llogari bankare do të kuptojmë, llogarinë që përdoret nga klienti debitor në marrëdhëniet me bankën dhe që mund të përdoret për kryerje pagesash në ngarkim të debitorit, llogari rrjedhëse, krediti, depozitë, llogari buxhetore etj.

Identifikimi i llogarisë së debitorit.

Banka, pas njoftimit të bërë nga përmbauesi gjyqësor apo zyra e përmbaimit është e detyruar të informojë këto të fundit , kur kanë llogari, depozita ose kredi në emër të debitorit, në të kundërt përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal. Njoftimi që përmbauesi i drejton bankës me qëllim marrjen e informacionit të nevojshëm, për vijimin e procedurave të ekzekutimit, referuar dhe përcaktimeve të bëra në nenin 3 të Udhëzimit nr. 2, datë 24.09.2003 të Bankës së Shqipërisë “Për mënyrën e zbatimit të ekzekutimit të detyrimeve mbi shumat e llogarive në Banka”, sipas formatit të shtojcës bashkëlidhur, duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

a) Të dhëna të sakta për identifikimin e klientit:

- emrin, mbiemrin, atësinë, datëlindjen dhe adresën e banimit (për individët);
- emërtimin dhe numrin e vendimit të regjistrimit në regjistrin tregtar (për personat fizikë dhe për shoqëritë tregtare);
- emërtimin, si dhe numrin e aktit përkatës për njohjen e personalitetit juridik (për personat e tjerë juridikë).

b) Shumën maksimale të detyrimit për t'u paguar.

65

Banka është e detyruar, menjëherë, por jo me vonë se 10 ditë kalendarike nga marrja e kërkesës

a) të informojë me shkrim zyrën e përbarimit dhe të bllokojë llogarinë e debitorit deri në shumën e kërkuar dhe;

b) të informojë me shkrim zyrën e përbarimit për rastet kur klientët nuk kanë llogari pranë saj.

Sekuestrimi

Ekzekutimi mbi shumat e llogarive në banka fillon me sekuestrimin e llogarisë, i cili kryhet në bazë të urdhrin të lëshuar nga përbaruesi gjyqësor, kur debitori nuk kryen ekzekutimin vullnetar të detyrimit, brenda afatit të përcaktuar në lajmërimin për ekzekutim vullnetar. Në kuptim të këtij fakti na vjen dhe kuptimi korrekt i fjalës sekuestrim që sipas terminologjisë në gjuhën shqipe do të thotë privimi i pronarit nga përdorimi i sendit. Me qëllim ekzekutimin e detyrimit në të holla, përbaruesi gjyqësor lëshon urdhrin për vënie sekuestro mbi llogaritë bankare (sipas formatit nr.2b të shtojcës nr 1), i cili duhet të përmbajë:

a) Të dhëna të sakta për identifikimin e klientit:

- emrin, mbiemrin, atësinë, datëlindjen dhe adresën e banimit (për individët);
- emërtimin dhe numrin e vendimit të regjistrimit në regjistrin tregtar (për personat fizikë dhe për shoqëritë tregtare);
- emërtimin, si dhe numrin e aktit përkatës për njohjen e personalitetit juridik (për personat e tjerë juridikë).

b) Shumën maksimale të detyrimit për t'u paguar.

c) Afatin e vlefshmërisë për bllokimin e llogarisë.

Përbaruesi gjyqësor mund të fillojë menjëherë sekuestrimin e llogarisë në bankë nëse ka arsye të bazuara se debitori mund të lëvizë mjetet monetare nga banka ose e dobëson llogarinë, duke e mbajtur atë në minimum.

Veprimet e bankës

66

Banka, me të marrë urdhrin e ekzekutimit, vë sekuestro mbi llogarinë, depozitat dhe kreditë e debitorit në masën e nevojshme për ekzekutimit e detyrimit, pa pezulluar pagimin e kredive që sipas nenit 605 të Kodit Civil paguhen me preferim ndaj kredisë për të cilën është vënë sekuestro.

Kur përbaruesi ka bazë të dyshojë se banka:

- nuk e ekzekuton detyrimin tërësisht ose pjesërisht,
- shkel afatet e ekzekutimit, ose
- nuk respekton radhën e referimit,

përbaruesi ka të drejtë të verifikojë në vend dokumentacionin bankar në prani të punonjësit të ngarkuar nga organi drejtues i bankës, duke mbajtur procesverbalin përkatës dhe në rast të konstatimit të shkeljeve apo parregullsive përbaruesi fikson në procesverbal veprime dhe afate të detyrueshme për bankën.

Në rastet e konstatimit të shkeljeve apo parregullsive përmbaruesi ka të drejtë të zbatojë masat e dënimit me gjobë deri në 50.000 lekë, ndaj punonjësit bankar fajtor ose ndaj organit drejtues të saj, që ka urdhëruar veprime të parregullta. Kundër vendimit të përmbaruesit gjyqësor për vënien e gjobës, punonjësi i bankës ka të drejtën e ankimit në gjykatë, brenda 5 ditëve nga marrja dijani e vendimit dhe vendimi i dhënë nga gjykata e shkallës së parë të vendit ku kryhet ekzekutimi është i formës së prerë.

Ekzekutimi

Kur debitori nuk i përgjigjet njoftimit për përmbushjen e detyrimit në të holla, në mënyrë vullnetare, përmbaruesi gjyqësor urdhëron ekzekutimin mbi shumat e sekuestruara në bankë. Shumat e nxjerra nga llogaria, depozitat dhe kreditë e debitorit kalojnë në llogarinë e kreditorit në të njëjtën bankë ose në një bankë tjetër ose kur nuk ka të tilla në llogari të zyrës së përmbarimit ose në llogari të përmbaruesit gjyqësor. Kur kreditë ekzekutive janë disa dhe shumata e llogarisë/llogarive, depozitave ose kredive nuk është e mjaftueshme për të shlyer detyrimet e paraqitura për ekzekutim, përmbaruesi gjyqësor respekton radhën e referimit që përcaktohet në nenin 605 të Kodit Civil.

67

Me qëllim zbatimin e dispozitave të ekzekutimit të detyrimit në të holla mbi shumat e llogarive në banka, Banka e Shqipërisë nxjerr udhëzimet e nevojshme të detyrueshme për të gjithë sistemin bankar. Aktualisht rregullat për zbatimin e ekzekutimit mbi shumat e llogarive në Banka, janë të përcaktuara në vendimin nr. 43, datë 11.6.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

2.7.2 Ekzekutimi mbi pagën e debitorit

Detyrimet në të holla mund të ekzekutohen mbi pagën e debitorit në rastet kur, detyrimi është një shumë e vogël dhe mund të përmbushet shpejt, nëpërmjet ndalesave nga paga e debitorit, përfshi dhe rastin e detyrimit për ushqim që për nga vetë natyra e tij duhet të përmbushet në mënyrë periodike.

Rregulli i përgjithshëm

Ekzekutimi mbi pagën e debitorit, nga përmbaruesi gjyqësor bëhet, pasi zbritet kontributi për sigurimet shoqërore dhe taksat mbi të ardhurat, por pa cenuar minimumin jetik, të përcaktuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Sekuestrimi

Ekzekutimi fillon me vënien e sekuestro mbi pagën që debitori merr nga punëmarrësi i tij, bazuar në marrëdhënien juridiko-civile, të krijuar midis këtyre të fundit. Sekuestrimi shtrihet jo vetëm në pagën punë ose nga një punë tjetër, në të njëjtin person fizik apo juridik, shtetëror apo privat.

Sekuestrimi i pagës i njoftohet punëdhënësit të debitorit sipas rregullave të njoftimit të akteve gjyqësore dhe duhet të përmbajë:

- a) Tregimin e urdhrit të ekzekutimit mbi bazën e të cilit kryhet ekzekutimi;
- b) emrin, atësinë, dhe mbiemrin e debitorit;
- c) shumën e plotë të detyrimit në të holla, objekt ekzekutimi;
- d) numrin e llogarisë së kreditorit ose numrin e llogarisë së përmbaruesit gjyqësor ku duhet të derdhen shumat dhe ndalesat;
- e) mënyrën e ekzekutimit të detyrimit me ndalesa periodike dhe kohëzgjatjen se saj;
- f) shumën e pagës së debitorit që duhet të ekzekutohet për çdo ndalesë.

68

Detyrimet e punëdhënësit

Punëdhënësi i debitorit ka pozitën e personit të tretë që mban kreditë e debitorit. Punëdhënësi

kryen ndalesat e pagës së debitorit sipas përcaktimit të bërë në urdhrin e ekzekutimit apo njoftimin e ekzekutimit deri kur përmbaruesi gjyqësor njofton ndalimin e ekzekutimit apo kur ekzekutimi përmbushet plotësisht.

Punëdhënësi është i detyruar të lajmërojë përmbaruesin gjyqësor, brenda 5 ditëve, nga realizimi i njërës prej ngjarjeve të mëposhtme:

- a) rritet paga e debitorit
- b) debitori ndërron vendin e punës
- c) debitori pushohet nga puna

Kur debitori ndërron vendin e punës, lajmërimi i sekuestrimit i dërgohet qendrës së re të punës nga qendra ku punonte më parë debitori dhe quhet se i është dërguar nga përmbaruesi gjyqësor. Punëdhënësi i ri kryen ndalesat e pagës së debitorit aty ku ato janë ndërprerë nga punëdhënësi i mëparshëm.

Punëdhënësi ka përgjegjësi kur nuk kryen ekzekutimin mbi pagën e punëmarrësit sipas njoftimit të ekzekutimit të përcjellë nga përmbaruesi gjyqësor dhe dënohet me gjobë deri në 30 000 lekë kur:

- nuk bën ndalesat nga paga e debitorit, sipas lajmërimit të përmbaruesit gjyqësor ose
- nuk lajmëron përmbaruesin gjyqësor për kalimin e debitorit në një punë tjetër
- nuk lajmëron përmbaruesin gjyqësor për pushimin e tij nga puna.

Kundër vendimit të përmbaruesit, punëmarrësi mund të bëjë ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga komunikimi i tij dhe ka të drejtë të kërkojë shkarkimin e tij nga dënimi, sipas rregullave të caktuara në nenin 169 të këtij Kodi. Vendimi i gjykatës së rrethit gjyqësor të vendit ku kryhet ekzekutimi është i formës së prerë.

2.7.3 Ekzekutimi i detyrimeve në të holla ndaj institucioneve buxhetore.

69

Me qëllim sqarimin e procedurës së ndjekur për ekzekutimin e detyrimeve në holla nga institucionet buxhetore lind e nevojshme të përcaktohet se cilët do të konsiderohen instucione buxhetore. Referuar përcaktimeve të bëra në ligjin nr. Nr.9936, datë 26.6.2008

“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, institucione buxhetore, të ardhurat dhe shpenzimeve e të cilave përbëjnë buxhetin e shtetit janë:

- "*Njësi të qeverisjes qendrore*", të cilat përfaqësojnë njësitë e pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, të krijuara me Kushtetutë, ligj ose vendim të Këshillit të Ministrave, që kanë si veprimtari të tyre parësore përmbushjen e funksioneve të qeverisjes qendrore.

- "*Njësi të qeverisjes vendore*" janë njësitë e niveleve të ndryshme vendore, të krijuara me ligj, që kanë si veprimtari të tyre parësore përmbushjen e funksioneve të qeverisjes vendore, brenda një territori të caktuar.

- "*Njësi e fondeve speciale*" është njësia e krijuar me ligj për të ushtruar funksione specifike të qeverisjes qendrore dhe vendore. Ndërkohë që më njësi shpenzuese, kuptohet njësia më e vogël organizative e njësive të qeverisjes së përgjithshme, për të cilën janë detajuar fondet buxhetore.

Ndërkohë Ministria e Financave është autoriteti përgjegjës për hartimin dhe miratimin e një sistemi rregullash, standardesh dhe procedurash, që sigurojnë administrimin ekonomik, eficient dhe efektiv të burimeve financiare publike.

Kur debitori është institucion shtetëror, ekzekutimi i detyrimeve në të holla kundër tij i nënshtrohet kufizimit normativ. Ndalohet ekzekutimi me sekuestrim mbi sendet pasurinë e luajtshme e të paluajtshme të të institucionit buxhetor , për llogari të shlyerjes së detyrimeve në të holla, në ngarkim të tij.

Ekzekutimi

Ekzekutimi i detyrimeve në të holla ndaj institucioneve buxhetore bëhet vetëm në llogarinë e tyre përkatëse bankare, në kredi që ata kanë të të tretët dhe kur nuk ka të tilla në llogari të thesarit. Kur institucioni buxhetor nuk ka gjendje në llogarinë bankare, as kredi të të tretët dhe as në thesar, i kërkohet organit epror financiar përkatës të caktojë fondin e nevojshëm në

70

kapitullin e buxhetit të subjektit nga do të shlyhet detyrimi ose financim të veçantë nga Buxheti i Shtetit.

Kur detyrimi i shtetit është në metale të çmuara, ekzekutimi bëhet me pëlqimin paraprak të Ministrisë të Financave. Këshilli i Ministrave nxjerr udhëzim për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit.

Deri më tani rregullimi i procedurave të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore nga institucionet shtetërore, kryhej nëpërmjet Vendimit nr. 335, datë 02.06.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e zbatimit të vendimeve gjyqësore që prekin Buxhetin e shtetit”, i cili në pikën 1 të tij parashikon se “*Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore ndjekin zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet e institucioneve buxhetore të vartësisë së tyre. Detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore përballohen nga vete institucioni brenda fondeve të miratuara për vitin buxhetor, sipas kriterëve e procedurave që do të përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave*”.

Ndërkohë në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. nr. 9636, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se Ministri i Financave nxjerr udhëzim për zbatimin e buxhetit, ku përcaktohen rregullat, procedurat dhe afatet, që duhet të përmbushin nëpunësit, autorizues dhe zbatues, të të gjitha niveleve, në procesin e zbatimit të buxhetit. Ky udhëzim është në formën e një udhëzimi të përhershëm ose përgatitet e miratohet për secilin vit buxhetor. Në rastet kur udhëzimi është i përhershëm, një udhëzim plotësues miratohet për secilin vit buxhetor, ku përcaktohen rregullat, procedurat dhe afatet specifike ose të papërcaktuara në udhëzimin e përhershëm, për zbatimin e Buxhetit të Shtetit. Udhëzimi, i cili përgatitet për secilin vit buxhetor, duhet të miratohet dhe të hyjë në fuqi para datës së fillimit të vitit buxhetor dhe, në rast të miratimit me vonesë të ligjit të buxhetit vjetor, jo më vonë se 10 ditë pas hyrjes në fuqi të ligjit të buxhetit vjetor, dhe të nenit 19 të ligjit nr. 10355, datë 02.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, Ministri i Financave ka nxjerrë udhëzimin nr. 4, datë 27.01.2011 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011”. Në pikën 6.1 të cilit përcaktohet se për vendimet gjyqësore do të veprohet në përputhje me VKM nr. 335, datë 02.06.1998 “Për procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet që prekin buxhetin e shtetit” dhe në paragrafin e tretë të këtij Udhëzimi është përcaktuar se “Vendimet gjyqësore zbatohen me buxhetin e miratuar të institucioneve, pasi njoftohet titullari i Ministrisë/institucionit qendror

71

nga varet institucioni. Në rast pamjaftueshmërie të fondeve, institucioni parashikon zbatimin pjesor të detyrimit në përputhje me mundësitë buxhetore, duke vazhduar shlyerjen e detyrimeve me fondet e vitit/viteve në vijim.

Gjithashtu në zbatim të nenit 589 pika 4 të Kodit të Procedurës Civile aktualisht është ndërmarrë iniciativa e Ministrisë së Financave për hartimin e Vendimit “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit” i cili parashikon se:

Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme janë përgjegjëse për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe për shlyerjen e detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore, që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë, në llogari të thesarit. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore do të

realizohet nga njësia shpenzuese përgjegjëse me:

a) Fondet buxhetore të akorduara në ligjin vjetor të buxhetit përkatës;

b) Me të ardhurat e tjera të siguruar në bazë të legjislacionit përkatës.

Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme do të planifikojnë në artikullin 602 “ Mallra dhe shërbime të tjera” një nënartikull të veçantë ku do të përfshihen të gjitha shpenzimet që do të kryej institucioni për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Në udhëzim parashikohet gjithashtu procedura që duhet të ndjek përmbaruesi gjyqësor në rast se do të kërkoj vendosjen e sekuestro konservative në llogarinë që ka në thesar institucioni buxhetor debitor.

Në rastet kur njësia shpenzuese debitorë me fondet buxhetore që ka në dispozicion nuk është në gjendje të shlyej të gjithë detyrimin sipas vendimit gjyqësor, në baze të nenit 517 të kodit të Procedurës Civile i drejtohet gjykatës për shlyerjen pjesore të detyrimit me fondet e vitit/viteve në vijim duke bërë edhe njoftimin përkatës pranë përmbaruesit gjyqësor.

Njëkohësisht, njësia shpenzuese planifikon fondet e nevojshme për shlyerjen e këtyre detyrimeve, me prioritet në vitet e ardhshme, duke ndjekur procedurat përkatëse të planifikimit të fondeve buxhetore të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Ekzekutimi i detyrueshëm ndaj debitorit të huaj

72

Ndërkohë që ekzekutimi i detyrueshëm ndaj kredive të caktuara të debitorit të huaj bëhet vetëm kur nuk ka ndalim ose kufizim me ligj të veçantë ose me marrëveshje ndërkombëtare shtetërore. Në rast se pala debitorë është një person i huaj publik ekzekutimi i titullit ekzekutiv në mënyre të detyrueshme nuk mund të filloje pa mare me parë leja nga Ministri i Drejtësisë. Për këtë përmbaruesi gjyqësor me depozitimin e praktikës përmbarimore mbasi sigurohet që ka të beje me person të huaj publik si psh , banka botërore ose përfaqësi të shtetit të akredituar në vend etj është i detyruar të paraqes pranë ministrit të Drejtësisë kërkesën për lejimin e kryerjes se ekzekutimit të detyrueshëm. Në mungese të kësaj leje përmbaruesi gjyqësor nuk mund të kryej ekzekutim të detyrueshëm ndaj personit të huaj publik.

Përgjegjësia e institucionit buxhetor

Organet e institucionit shtetëror debitor duhet të tregojnë kujdesin e duhur për përmbushje të detyrimeve në të holla në ngarkim të tij, sipas përcaktimeve të bëra në urdhrin e ekzekutimit, pasi në rast se organi shtetëror pa shkaqe nuk kryen ekzekutimin e detyrimit mund të dënohet me gjobë deri në 30.000 lekë. Kundër vendimit për vendosjen e gjobës institucioni shtetëror debitor ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga komunikimi i tij dhe ka të drejtë të kërkojë shkarkimin e tij nga dënimi, sipas rregullave të caktuara në nenin 169 të këtij Kodi. Vendimi i gjykatës së rrethit gjyqësor të vendit ku kryhet ekzekutimi është i formës së prerë.

2.8 Ekzekutimi i që kryhet mbi sende të tjera me qëllim realizimin e detyrimeve të tjera.

2.8.1. Ekzekutimi mbi sendet e luajtshme

Ekzekutimi i detyrimit në të bolla, mbi sendet e luajtshme të debitorit kryhet kur pas njoftimit për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv dhe fillimit të procedurave nga përmbaruesi gjyqësor për ekzekutimin e detyrueshëm të tij, konstatohet se:

a) Debitorit nuk i gjenden mjete monetare të sekuestrueshme

b) kredia ekzekutive është një shumë jo e madhe, e cila mund të përmbushet me vlerën e shitjes së disa sendeve të luajtshme të debitorit

73

Ekzekutimi mbi sendet e luajtshme kryhet me sekuestrimin e tyre, i cili kryhet pas lëshimit të vendimit të përmbaruesit gjyqësor apo gjykatës kompetente që ka gjykuar mosmarrëveshjen

përkatëse.

Objekt sekuestrimi janë sendet e luajtshme të cilat:

- a) nuk janë të përjashtuara nga ekzekutimi (shiko pikën 2.4.2);
- b) kanë një vlerë përdorimi sipas një destinacioni ekonomik dhe mund të shiten.

Ekzekutimi i sekuestrimit

Përmbaruesi gjyqësor i njofton debitorit ditën dhe orën kur do të kryhet sekuestrimi i sendeve duke e lajmëruar që të qëndrojë në banesë ose në ndërtesën tjetër të tij ku gjenden sendet.

Njoftimi bëhet sipas rregullave mbi njoftimin e akteve gjyqësore.

Në sekuestrim përfshihen vetëm sendet e luajtshme të debitorit. Konsiderohen si sende të luajtshme në pronësi të debitorit, sendet që ndodhen në shtëpinë e debitorit, si dhe ato që ndodhen në një lokal tjetër që është i përbashkët për debitorin dhe personat e tretë, përveç se kur del se ato janë të një personi tjetër.

Në sekuestrim përfshihen ato sende, çmimi i shitjes së të cilave, vlerësohet se mund të përmbushë pagesën e kredisë ekzekutive. Kur kredia ekzekutive është detyrim për ushqim sekuestrimi shtrihet si mbi sendet që i takojnë debitorit mbi pasurinë bashkëshortore ashtu dhe mbi sendet personale të tij, përveçse atyre që janë të përjashtuara nga sekuestrimi.

Kur ekzekutimi kryhet ndaj një anëtarit të familjes bujqësore, mund të sekuestrohet vetëm pjesa e të ardhurave që takon anëtarit debitor dhe jo pjesë të tjera të pasurisë së familjes bujqësore.

Inventarizimi

Sekuestrimi i sendeve të luajtshme bëhet me inventarizimin e tyre nga përmbaruesi gjyqësor, i cili vendos një etiketë të shërbimit të përmbarimit në momentin e sekuestrimit. Për inventarizimin mbahet procesverbal, i cili duhet të përmbajë:

- a) shënimin e urdhrin të ekzekutimit, në bazë të të cilit vihet sekuestroja;
- b) emrin, emrin e atit dhe mbiemrin e përmbaruesit gjyqësor, të debitorit, kreditorit dhe të personave të tjerë që janë të pranishëm në inventarizim;

74

- c) vendin ku kryhet inventarizimi dhe koha e kryerjes së tij;
- ç) pretendimet e personave të tretë në lidhje me sendet e inventarizuara;
- d) përshkrimin e hollësishëm të sendeve dhe vlerësimin e tyre;
- dh) kujt i lihen për ruajtje sendet;
- e) nënshkrimin e personave që marrin pjesë në inventarizim.

Nëpërmjet inventarizimit bëhet dhe individualizimi i sendeve në lloj ose gjini.

Inventarizimi i sendeve që sekuestrohen në bazë të vendimit të përmbaruesit gjyqësor bëhet në prani të debitorit. Në mungesë të debitorit, inventarizimi kryhet në prani të një personi madhor të familjes së tij dhe, kur nuk ndodhet një person i tillë, në prani të një përfaqësuesi të njësisë së qeverisjes vendore ku ka vendbanimin debitori. Në çdo rast inventarizimi bëhet duke qenë të pranishëm edhe dy dëshmitarë.

Inventarizimi i kryer në mungesë të debitorit dhe në prani të përfaqësuesit të qeverisjes vendore dhe të dy dëshmitarëve, pasi debitori ishte njoftuar rregullisht për vendin dhe orën e kryerjes së tij, i njoftohet këtij të fundit sipas rregullave mbi njoftimin e akteve gjyqësore.

Pretendimet e personit të tretë.

Personi i tretë që pretendon pronësinë mbi sendet e luajtshme të sekuestruara në posedim faktik të debitorit, duhet ti paraqesë përmbaruesit dokumentet përkatëse që provojnë këtë pretendim.

Kur nga verifikimi i këtyre të fundit nuk krijohet bindja se sendet e pretenduara janë të personit të tretë sendet mbahen në sekuestrim.

Ndalimi i disponimit

Pas ekzekutimit të sekuestrimit, çdo diskonim i sendit të luajtshëm nga debitori është i

pavlefshëm kundrejt kreditorëve, të cilët e kanë kërkuar ekzekutimin. Bën përjashtim rasti kur, në bazë të një veprimi juridik për kalimin e pronësisë dhe kundrejt shpërblimit, sendi ka kaluar në pronësi të një personi, i cili ka qenë në mirëbesim. Në mirëbesim quhet blerësi, i cili nuk e dinte, se sendi i blerë prej tij ishte i sekuestruar.

Vlerësimi i sendeve dhe caktimi i ruajtësit.

Me inventarizimin bëhet edhe vlerësimi paraprak i sendeve të sekuestruara. Sendet e luajtshme vlerësohen fillimisht në gjendje inventarizimi. Vlerësimi bëhet nga përmbaruesi në bazë të

75

vlerësimeve të ekspertëve, në bazë të çmimeve të tregut, duke u zbritur përqindja përkatëse e konsumimit ose e vjetërsisë së tyre.

Sendet e lidhura me sekuestrim mund t'i lihen në ruajtje debitorit, me qëllim mos ngarkimin e tyre me shpenzime ekzekutimi. Kur debitori refuzon, përmbaruesi gjyqësor emëron një person tjetër, si ruajtës të sendeve. Në këtë rast, sendet e sekuestruara merren nga debitori dhe dërgohen pranë ruajtësit të caktuar. Për ruajtjen e sendeve të sekuestruara caktohet shpërblim, i cili paguhet fillimisht, nga kreditori.

Debitori ose personi i tretë, të cilëve u janë lënë në ruajtje sendet e inventarizuara, japin llogari për të ardhurat dhe shpenzimet e bëra për sendin dhe janë përgjegjës, sipas dispozitave të Kodit Penal (neni 320), për disponimin, dëmtimin ose shkatërrimin e tyre.

Sendet e çmueshme

Kur objekt sekuestrimi janë sendet e çmueshme si ari, argjendi, platini dhe metalet e grupit të platinit në shifra, copë, monedha dhe artikuj të bëra prej tyre, guri të çmueshëm, margaritarët dhe artikujt e bërë prej tyre, si dhe valuta e huaj, dokumentet e pagesës në valutë të huaj, si kambiale, çeqe, mandate e letra të tjera të kësaj natyre, si dhe tituj të huaj me vleftë, si aksione, obligacione e kuponët përkatës, ato i jepen në mbajtje një banke. Sekuestrimi i sendeve të tilla shoqërohet me marrjen e tyre nga debitori dhe depozitimin e tyre në bankë.

Shitja e sendeve të luajtshme.

Me qëllim realizimin e pagesës së kredisë ekzekutive, përmbaruesi gjyqësor njofton debitorin, duke paralajmëruar këtë të fundit se sendet e luajtshme të sekuestruara në zbatim të titullit ekzekutiv do të shiten nëse brenda 5 ditëve ai nuk shlyen detyrimin në të holla objekt ekzekutimi.

Shitja e sendeve të luajtshëm kryhet në dy mënyra:

a) Shitja në dyqanin me shitje të lirë

b) Me ankand.

Shitja e lirë e sendit të luajtshëm

76

Kur debitori nuk e përmbush detyrimin në të holla brenda afatit të përcaktuar, përmbaruesi gjyqësor i dërgon sendet sekuestruara në dyqanin me shitje të lirë. Caktimi i shpërblimit për shitjen bëhet në marrëveshje ndërmjet përmbaruesit gjyqësor dhe shitësit. Shpërblimi nxirret nga vlera e sendit të sekuestruar pas shitjes së tij. Ndërsa caktimi i çmimit të sendit të sekuestruar bëhet nga përmbaruesi, në bashkëpunim me kreditorin dhe debitorin. Kur ka kundërshtime ndërmjet tyre për caktimin e çmimit, thirret një ekspert.

Në qoftë se brenda 2 muajve sendi nuk shitet në shitje të lirë, përmbaruesi gjyqësor, duke marrë edhe pëlqimin e palëve, vendos nëse duhet të vazhdojë me shitjen e lirë edhe për 30 ditë të tjera apo të kalojë në procedurë ankandi.

Nëse merret vendimi për vazhdimin e shitjes së lirë dhe për 30 ditë të tjera, çmimi nuk ndryshon dhe vijon mbajtja e sendit në dyqanin me shitje të lirë deri në kalimin e afatit 30 ditor. Nëse pas kalimit të këtij afati sendet e luajtshme nuk arrihet të shiten në dyqanin me shitje të lirë, do të

fillojë procedura e shitjes së sendeve në ankand.

Shitja sendet e çmueshme si ari, argjendi, platini dhe metalet e grupit të platinës në shufra, copë, monedha dhe artikuj të bërë prej tyre, gurët e çmueshëm, margaritarët dhe artikujt e bërë prej tyre, si dhe valuta e huaj, dokumentet e pagesës në valutë të huaj si kambiale, çeqe, mandate e letra të tjera të kësaj natyre, si dhe tituj të huaj me vleftë, si aksione, obligacione e kuponët përkatës, të depozituara në bankë, i shiten asaj dhe merret kundërvlera e tyre nga përmbaruesi gjyqësor, në bazë të kursit zyrtar në kohën e pagesës së tyre.

Shitja me ankand e sendit të luajtshëm

Send i luajtshëm shitet me ankand kur:

a) për shkak të natyrës ose të gjendjes, nuk mund të pranohet në shitje të lirë nga dyqanet e shitjes së lirë;

b) ku përmbaruesi gjyqësor vendos për shitjen në ankand të tij, pasi ka kaluar afati 2 mujor i lajmërimit të shitjes së lirë dhe nuk rezulton të jetë paraqitur ndonjë ofertues gjatë kësaj kohe.

77

Përmbaruesi gjyqësor organizon shitjen me ankand të sendit, sipas çmimit të përcaktuar nga përmbaruesi, në bashkëpunim me kreditorin dhe debitorin dhe kur midis tyre ka kundërshtime thirret një ekspert.

Lajmërimi për shitjen me ankand të sendit të luajtshëm, shpallet në zyrën e përmbaruesit gjyqësor, në vendin ku ndodhet sendi ose në vendin e caktuar për shitjet me ankand, kur ka të tilla. Lajmërimi duhet të tregojë çmimin, me të cilin do të fillojë shitja e sendit, vendin, ditën, dhe orën kur do të kryhet shitja. Çmimi fillestar i ankandit të parë është 80 për qind e çmimit të caktuar sipas nenit 552 të këtij ligji.

Procedura e Shitjes

Ankandi për shitjen e sendit, nuk mund të fillojë me para, se të kenë kaluar pesë ditë nga shpallja. Në ditën dhe orën e caktuar, përmbaruesi gjyqësor shpall të hapur ankandin, para pjesëmarrësve. Ai përshkruan sendin që do të shitet dhe deklaron çmimin, me të cilin fillon shitja i cili është 80 për qind e çmimit të përcaktuar nga përmbaruesi, në bashkëpunim me kreditorin dhe debitorin apo nga një ekspert kur midis tyre ka patur kundërshtime.

Zhvillimi i ankandit dhe shpallja e fituesit

Kur me ankand është caktuar të shiten disa sende, debitori ka të drejtë të caktojë radhën, sipas të cilës do të shiten sendet.

Përmbaruesi gjyqësor fton pjesëmarrësit të paraqesin ofertat e tyre. Ofertat për blerjen e sendit regjistrohen, sipas radhës së paraqitjes së tyre. I njëjti ofertues, mund të paraqesë oferta të ndryshme. Për zhvillimin e ankandit mbahet procesverbal.

Mbyllja e ankandit përfundon, me mbarimin e orarit zyrtar të ditës kur zhvillohet ankandi përfundon edhe kur nga shitja e një ose disa sendeve, nxirret shuma e nevojshme për shlyerjen e kredisë ekzekutive, si dhe shpenzimet e bëra për ekzekutimin. Në këtë rast, sendet e tjera nuk shiten dhe i kthehen debitorit.

Blerës quhet ofertuesi që ka dhënë çmimin më të lartë, i cili duhet ta paguaj menjëherë nga blerësi. Me pagimin e menjëhershëm të çmimit sendi i dorëzohet blerësit. Në ankand nuk mund

78
të marrin pjesë personat që tregohen në nenin 709 të Kodit Civil, të trajtuar në pikën 2.5 më sipër.

Me shumën e nxjerrë nga shitja e sendit në ankand, paguhet kredia ekzekutive, sipas radhës së caktuar për shlyerjen e detyrime në të holla. Kur janë disa kredi ekzekutive dhe shuma e nxjerrë nga shitja në ankand nuk mjafton për shlyerjen e tyre, përmbaruesi gjyqësor përgatit projektin e

ndarjes së shumave (shih pikën 2.4.6).

Ankandi i dytë

Kur në ankandin e parë nuk është paraqitur asnjë ofertues, për shitjen e sendeve zhvillohet një ankand i dytë.

Brenda 10 ditëve nga përfundimi i ankandit të parë, përmbaruesi gjyqësor përcakton çmimin e ri, jo më të ulët se 30 për qind të çmimit fillestar, të caktuar në ankandin e parë. Ankandi i dytë për shitjen e pasurive të luajtshme zhvillohet sipas rregullave të përcaktuara për ankandin e parë (njoftime, procesverbal, e drejtë radhitje etj)

Në rast se në ankandin e dytë nuk është paraqitur asnjë ofertues, përmbaruesi i propozon në fillim kreditorit, që, kundrejt kredisë, të marrë sendin me çmimin e ankandit të dytë. Në rast se kreditori nuk pranon ta marrë sendin, përmbaruesi heq sekuestron mbi këtë send, duke ia kthyer atë debitorit dhe vijon procedurat përmbarimore mbi pasuri të tjera të tij.

Kalimi i pronësisë së sendit të shitur

Blerësi i sendit të shitur në dyqanin e shitjes me shitje të lirë ose në ankand bëhet pronar i tij edhe sikur sendi të mos ishte në pronësi të debitorit. Kundër shitjes nuk mund të bëhet ankand dhe as të kundërshtohet vlefshmëria e saj, përveç rastit kur në ankand kanë marrë që tregohen në nenin 709 të Kodit Civil parashikuar nga paragrafi i tretë i nenit 556 të këtij Kodi.

2.8.2 Ekzekutimi mbi sendet e paluajtshme

Kushtet e ekzekutimit

79

Ekzekutimi për llogari të shlyerjes së një detyrimi në të holla, kryhet mbi pasurinë e paluajtshme të debitorit, në rastet kur:

a) debitori nuk ka mjete monetare të sekuestrueshme, që e plotësojnë shumën në të holla objekt ekzekutimi;

b) detyrimi në të holla është një shumë e madhe, që nuk mund të nxirret nga ekzekutimi mbi sendet e luajtshme.

Verifikimi i pronësisë

Kur ekzekutimi kryhet mbi sendin e paluajtshëm, përmbaruesi gjyqësor sigurohet më parë, se sendi është në pronësi të debitorit. Kreditori duhet të paraqesë tek përmbaruesit gjyqësor dokumentet që vërtetojnë, se sendi i paluajtshëm treguar është në pronësi të debitorit. Kur të dhënat e nevojshme nuk mund të sigurohen nga kreditori, përmbaruesi gjyqësor kërkon vetë informata nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ku është i regjistruar sendi. Në rast se sendi i paluajtshëm nuk është i regjistruar, informatat merren nga organet financiare dhe të pushtetit lokal të vendit, ku ndodhet sendi.

Sekuestrimi

Ekzekutimi i vendimit të gjykatës apo të titujve të tjerë ekzekutivë mbi sendet e paluajtshme të debitorit bëhet me vendosjen e sekuestro mbi to.

Sekuestrimi mbi sendin e paluajtshëm kryhet në bazë e për zbatim të aktit të lëshuar nga përmbaruesi gjyqësor Akti i përmbaruesit gjyqësor që urdhëron vënien e sekuestro duhet të ketë të përcaktuar:

lloji, natyra dhe të paktën tre kufij të sendit të paluajtshëm,

vendi i ndodhjes së tij,

si dhe hipotekat dhe të drejtat reale që mund të jenë vënë mbi të.

80

Sekuestroja konsiderohet e vënë me regjistrimin e saj në zyrën e regjistrimit të pasurive të

paluajtshme të aktit të përmbauesit gjyqësor, i cili duhet të regjistrohet brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së tij.

Një kopje e aktit të përmbauesit gjyqësor i komunikohet debitorit duke e vënë në dijeni për fillimin e procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm.

Kufizimet e sekuestrimit

Objekt sekuestrimi janë sendet e paluajtshme, që nuk janë të përjashtuara nga ekzekutimi. Kur sendi i paluajtshëm është banesa e debitorit, ekzekutimi nuk shtrihet në atë pjesë të banesës, që është e nevojshme për jetesën e debitorit dhe familjen e tij, në rast se debitori nuk ka ose nuk mund të sigurojë banesë tjetër.

Kur sendi i paluajtshëm mund të ndahet në pjesë pa u dëmtuar, sekuestrimi shtrihet në atë pjesë që vlerësohet, se me shitjen e tyre nxirren shumat e nevojshme, për shlyerjen e kredisë ekzekutive.

Kur debitori është anëtar i familjes bujqësore, mund të sekuestrohet pjesa në natyrë që i takon anëtarit debitor, me kusht që detyrimi në të holla objekt ekzekutimi të jetë pasojë e veprimeve të paligjshme të anëtarit debitor, gjatë ushtrimit të detyrave që rrjedhin nga veprimtaria ekonomike e vetë familjes bujqësore. Sasia e tokës që i mbetet familjes bujqësore, ku bën pjesë debitori, të mos jetë nën minimumin e njësisë minimale të kultivimit, sipas kushteve natyrore të krahinës apo zonës, ku banon familja bujqësore dhe të përfshihet në kufizimet e sekuestrimit (neni 260, 258 i Kodit Civil).

Ekzekutimi i sekuestrimit

Sekuestrimi i sendit të paluajtshëm bëhet me regjistrimin e aktit, që vendos sekuestrimin, në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të vendit, ku ndodhet sendi. Akti i sekuestrimit duhet të regjistrohet brenda 10 ditëve nga paraqitja e tij në ZRPP dhe duhet të përmbajë:

81

a) urdhrin e ekzekutimit, mbi bazën e të cilit kryhet ekzekutimi;

b) emrin, atësinë dhe mbiemrin e debitorit;

c) shumën e kredisë apo kredive ekzekutive, kur ato janë disa;

d) llojin, natyrën dhe të paktën tre kufij të sendit të paluajtshëm, vendi i ndodhjes së tij, si dhe hipotekat dhe të drejtat reale që mund të jenë vënë mbi të.

Në të gjitha rastet, një kopje e aktit të sekuestrimit i njoftohet debitori, sipas rregullave mbi njoftimin e akteve gjyqësore.

Ndalimi i disponimit

Pas ekzekutimit të sekuestrimit, çdo veprim i debitorit, që përbën diskonim të sendit të paluajtshëm, është i pavlefshëm kundrejt kreditorëve, të cilët kanë kërkuar ekzekutimin.

Caktimi i ruajtësit

Sendi i paluajtshëm i lidhur me sekuestrim i lihet në ruajtje debitorit, derisa të bëhet shitja, duke qenë i detyruar debitori të kujdeset për të, si për sendin e tij. Kur debitori refuzon ose nuk kujdeset si duhet për sendin, përmbauesi gjyqësor emëron një person tjetër, për ruajtjen e tij.

Në këtë rast, sendi i paluajtshëm lirohet nga sendet e debitorit dhe i dorëzohet ruajtësit. Për dorëzimin e sendit të paluajtshëm, mbahet procesverbal. Për ruajtjen e sendit të paluajtshëm caktohet një shpërblim. Caktimi i shpërblimit bëhet me marrëveshje, midis përmbauesit gjyqësor dhe ruajtësit. Shpërblimi për ruajtësin paguhet fillimisht nga kreditori dhe nxirret nga vlera e sendit të paluajtshëm, pas shitjes së tij. Kur gjatë kohës së ruajtjes, nga sendi i paluajtshëm vilen dobi ekonomike, ruajtësi apo debitori duhet të jap llogari për të ardhurat e realizuara dhe shpenzimet e bëra. Ata përgjigjen sipas nenit 320 të Kodit Penal për veprime që bëhen pengesë për ekzekutimin e vendimit të gjykatës.

Caktimi i çmimit të shitjes

Çmimi i shitjes së sendit të paluajjtshëm të sekuestruar për realizimin e një kredie ekzekutive, caktohet me marrëveshje të kreditorit dhe debitorit, e cila duhet të arrihet brenda një jave nga dita e vendosjes së sekuestro.

Nëse brenda një jave, nuk arrijnë një marrëveshje për vlerën e sendit, mbi të cilin është vendosur sekuestroja, përmbartuesi gjyqësor, brenda 15 ditëve, përcakton me vendim vlerën e tij, bazuar në aktin e ekspertimit, të paraqitur nga një ekspert i licencuar dhe në vlerën reale të pasurisë në treg, në çastin e vënies së sekuestro mbi të.

Vendimi i përmbartuesit gjyqësor, për caktimin e vlerës së shitjes së sendit të paluajjtshëm në ankand, i njoftohet brenda 10 ditëve kreditorit dhe debitorit. Kundër këtij vendimi të përmbartuesit palët mund të bëjnë ankim të veçantë në gjykatën e rrethit gjyqësor ku ndodhet sendi.

Shitja

Sendi i paluajjtshëm i sekuestruar shitet vetëm me ankand. Para se të shpall shitjen, përmbartuesi gjyqësor njofton debitorin, duke e paralajmëruar, se sendi i paluajjtshëm i sekuestruar do shitet me ankand, në qoftë se brenda 10 ditëve nga njoftimi, ai nuk e përmbush detyrimin në të holla objekt ekzekutimi.

Me kalimin e afatit të mësipërm, përmbartuesi gjyqësor bën shpalljen për shitjen e sendit në ankand.

Shpallja për shitjen në ankand afishohet në zyrën e përmbartuesit gjyqësor dhe në vendin ku ndodhet sendi i paluajjtshëm gjykatë, komunë, bashki, njësitë bashkiake dhe në një vend apo vende të tjera publike, që përmbartuesi çmon të përshtatshme me qëllim informimin e personave të interesuara dhe realizimin e shitjes së sendit.

Shpallja për shitjen në ankand të sendit të paluajjtshëm duhet të përmbajë:

- a) tregimin e urdhrimit të ekzekutimit, mbi bazën e të cilit kryhet ekzekutimi;
- b) emrin, atësinë dhe mbiemrin e pronarit të sendit;
- c) Nëse sendi është vënë në hipotekë, shumën e kredisë për të cilën sendi është vënë hipotekë,
- d) çmimin e sendit me të cilin do të fillojë shitja,
- e) vendi, dita kur do të përfundojë shitja në ankand;
- f) detyrimin e ofertuesve për të të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në ankand, për të parapaguar garancinë e pjesëmarrjes;

Çmimi fillestar në ankand është 80 për qind i çmimit të përcaktuar, sipas procedurës së cituar më lart.

Për shpalljen e shitjes në ankand duhet të njoftohen edhe kreditorët që kanë hipotekë apo të drejta të tjera reale mbi sendin objekt ankandi, sipas rregullave për njoftimin e akteve gjyqësore. Secili ofertues që është pjesëmarrës në ankand, përpara fillimit të ankandit duhet të depozitojë si garanci në zyrën e përmbartimit një shumë të hollash të barabartë me 10 për qind të çmimit të sendit të caktuar në shpallje. Shuma e garancisë duhet të depozitohet në llogarinë e përmbartuesit gjyqësor. Kreditori nuk lë garanci, në rast se kredia e tij e kalon masën e garancisë.

Çelja e ankandit

Shitja e sendit të paluajjtshëm në ankand do të mund të fillojë pasi të kenë kaluar 15 ditë nga shpallja e ankandit. Vendi i kryerjes së shitjes në ankand është zyra e përmbartuesit gjyqësor ose në një vend tjetër publik, nëse është i përshtatshëm për zhvillimin e ankandit.

Përmbartuesi gjyqësor fillimisht verifikon pjesëmarrjen në ankand, duke lexuar emrat e ofertuesve pjesëmarrës, të regjistruar sipas listës së pagesës së garancive të depozituara nga

pjesëmarrësit në llogarinë e tij. Në rast se ofertuesi përfaqësohet nga një person i autorizuar, ky i fundit duhet të paraqesë dhe aktin e përfaqësimit në momentin e zhvillimit të ankandit.

Përmbartuesi gjyqësor u tregon pjesëmarrësve të drejtat dhe detyrimet e ofertuesit, të dhënat mbi sendin që do të shitet, shpall shumën fillestare të fillimit të shitjes, shumën e kredive ekzekutive për realizimin e të cilave do të shitet sendi i paluajtshëm, hipoteka apo të drejta të tjera reale mbi sendin objekt ankandi, nëse ka si dhe shumat e kredive të siguruara me hipotekë nga sendi i paluajtshëm që shitet me ankand.

Zhvillimi i ankandit

84

Për zhvillimin e ankandit mbahet procesverbal. Përmbartuesi gjyqësor fton ofertuesit të paraqesin ofertat e tyre. Ofertat pranohen vetëm nga ofertuesit të cilët kanë depozituar shumën e garancisë së pjesëmarrjes. Ofertuesit kundrejt nënshkrimit, shënojnë në procesverbalin e ankandit, çmimin që japin për blerjen e sendit. Ofertat regjistrohen sipas radhës së paraqitjes së tyre. I njëjti ofertues mund të paraqesë oferte të re pavarësisht çmimit të ofruar më parë. Rregulli është që oferta më e madhe në vlerë rrëzon ofertën më të vogël. Në ankand nuk zbatohet e drejta e parablerjes.

Mbyllja e ankandit

Gjatë zhvillimit të ankandit konkurrojnë ofertat për blerjen e sendit që shitet. Ankandi për shitjen e sendit të paluajtshëm përfundon me mbarimin e orarit zyrtar, të ditës së fundit që tregohet në shpalljen për shitjen me ankand.

Në përfundim të ankandit, përmbartuesi gjyqësor shpall fituesin. Blerësi i sendit është ofertuesi, i cili ka dhënë çmimin më të lartë. Pronësia mbi sendin i kalon blerësit vetëm pasi të ketë paguar të gjithë çmimin, duke zbritur prej tij shumën e lënë si garanci. Garancitë e lëna nga persona të tjerë që kanë marrë pjesë në ankand, u kthehen atyre menjëherë pas përfundimit të ankandit. Blerësi duhet të paguajë çmimin e sendit të blerë në ankand brenda 15 ditëve nga mbarimi i ankandit. Blerësi vihet në posedim të sendit nga përmbartuesi gjyqësor brenda 10 ditëve nga pagimi i çmimit të sendit si kundrejt debitorit ose personit të cilit i është lënë në ruajtje, ashtu edhe kundrejt çdo personi të tretë që ka në posedim sendin. Personi i tretë për heqjen e sendit nga posedimi, mund të mbrohet vetëm me padinë për njohjen e së drejtës së pronësisë mbi sendin. Në qoftë se blerësi, që nuk paguan çmimin brenda afatit të caktuar më sipër, humbet të drejtën e kthimit të shumës së lënë si garanci, e cila kalon në dobi të shtetit dhe për shitjen e sendit bëhet një ankand i ri, duke vepruar sipas rregullave të caktuara në këtë kre.

Pagimi i kredive ekzekutive

Me shumën e nxjerrë nga shitja e sendit të paluajtshëm, paguhet kredia ekzekutive sipas rregullave të përcaktuara në nenin 470 të Kodit Civil (Ekzekutimi në para për llogari të një detyrimi të caktuar, përmban në fillim shlyerjen e shpenzimeve, pastaj atë të kamatave të arrira dhe pastaj të vetë detyrimit e të kamatave të zakonshme ndaj tij). Kur kreditë ekzekutive janë

85

disa dhe shuma e nxjerrë nga shitja, nuk mjafton për shlyerjen e tyre, përmbartuesi gjyqësor kryen pagimin e tyre, në bazë të projektit të ndarjes së shumave.

Ndalimet

Sendi i paluajtshëm i sekuestruar, nuk mund të blihet në ankand nga debitori, përfaqësuesi i tij ligjor, si dhe nga personat, për të cilët ka ndalime të veçanta të blerjes. Në qoftë se sendi blihet nga këta persona, shitja është e pavlefshme.

Ankandi i zhvilluar anulohet, në rast se:

- a) blerësi i sendit nuk paguan çmimin e blerjes, brenda 15 ditëve, nga mbarimi i ankandit;
- b) sendi është blerë nga persona, për të cilët ka ndalime të veçanta të blerjes në ankand.

Në këto raste, për shitjen e sendit zhvillohet një ankand i ri, me të njëjtat kushte, si ankandi i anuluar.

Anullimi bëhet me kërkesë të kreditorit, debitorit, çdo kreditori të siguar, ose edhe kryesisht nga organi i ekzekutimit.

Ankandi i dytë

Për shitjen e sendit të paluajtshëm mund të bëhet ankand i dytë, në rastet kur në ankandin e parë nuk është paraqitur asnjë ofertues. Në këtë rast, brenda 10 ditëve nga përfundimi i ankandit të parë përmbaruesi gjyqësor përcakton çmimin e ri të sendit, jo më të ulët se 20 për qind të çmimit fillestar të caktuar në ankandin e parë.

Ankandi i dytë për shitjen e sendit zhvillohet jo më vonë se 15 ditë nga data e caktimit të çmimit të ri nga ana e përmbaruesit.

Në rast se dhe në ankandin e dytë nuk është paraqitur asnjë ofertues, atëherë përmbaruesi i propozon në fillim kreditorit që, kundrejt kredisë, të marrë sendin me çmimin e ankandit të dytë. Në rast se kreditori nuk pranon ta marrë sendin, përmbaruesi gjyqësor heq sekuestron mbi sendin e sekuestruar dhe vijon procedurat përmbarimore mbi pasuri të tjera të debitorit.

86

Kur kreditorët që kërkojnë të marrin sendin kundrejt kredisë janë disa, përmbaruesi gjyqësor deklaron blerës kreditorin që brenda 3 ditëve nga propozimi jep çmimin më të lartë se çmimi i caktuar për ankandin e dytë.

Kur kreditori që merr sendin me çmimin e caktuar në shitjen e dytë dhe ky i fundit është më i vogël se vlera e kredisë ekzekutive, kreditori ruan të drejtën që të kërkojë një ekzekutim të ri për plotësimin e kredisë së tij. Ndërsa kur shumica e realizuar nga shitja në ankand është më e madhe se shumica e kredisë së kreditorit apo kreditorëve, diferenca i kthehet debitorit, pasi zbriten shpenzimet e bëra për ruajtjen e sendit apo për zhvillimin e ankandit.

Shitja e sendit të paluajtshëm në ankand nuk ndalon personin e tretë i cili pretendon se është pronari i tij që ta kërkojë sendin me padi. Kundër shitjes në ankand mund të bëhet ankand në gjykatë në formën e kundërshtimit të veprimeve të përmbaruesit gjyqësor. Vlefshmëria e shitjes në ankand mund të kundërshtohet me anë padie, sipas rregullave të përgjithshme, vetëm për rastin kur në ankand kanë marrë pjesë personat që tregohen në nenin 709 të Kodit Civil.

2.8.3 Ekzekutimi mbi sende me gjendje juridike të ndërmjetme (mjetet lundrimi dhe fluturimi)

Sende me gjendje juridike të ndërmjetme, janë sende të luajtshme por që për shkak të natyrës së përdorimit (kryesisht transport) ligji parashikon regjistrimin e tyre në regjistrat publik. Pikërisht për shkak se statusi juridik i këtyre sendeve është ai i sendeve të luajtshme, ndërkohë që parashikohet regjistrimi i veprimeve juridike mbi këto sende në regjistrat përkatës publik, sipas rregullave të parashikuara tashmë për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, këto sende konsiderohen si sende me gjendje juridike të ndërmjetme.

Tek sendet me sende me gjendje juridike të ndërmjetme, për të cilat parashikohet detyrimi i regjistrimit të kalimit të pronësisë nëpër regjistrat publik, përfshihen:

- a) mjetet e lundrimit,
- b) mjetet e fluturimit,
- c) si dhe automjetet e ndryshme.

87

a. Ekzekutimi i mjetet të lundrimit

Mjetet e lundrimit

Referuar përcaktimeve të bëra Kodin Detar të Republikës së Shqipërisë të miratuar me Ligjin nr. 9251, datë 08.07.2004, mjetet lundruese janë të gjitha mjetet lundruese, me përjashtim të mjeteve, të cilat përdoren të fiksuara në trupin e njeriut, duke përfshirë: a) anijet që plotësojnë të

dhënat teknike për regjistrim në Regjistrin e Mjeteve Lundruese; b) mjetet e vogla lundruese, c) mjetet detare; ç) mjetet ujore, të cilat shërbejnë për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e detarisë. Mjetet e lundrimit regjistrohen në pronësi të personave fizike ose juridike, në regjistrin e mjeteve lundruese shqiptar ose institucioni përkatës i një shteti të huaj. Regjistri i mjeteve lundruese, në Shqipëri administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme Detare³ e cila është në varësi të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit. Ky regjistër shërben për regjistrimin e mjeteve motorike me fuqi me të madhe se 76 KF dhe mjete jomotorike mbi 80 BT ose mbi 80 tonë ujë zhvendosje. Në këtë regjistër përveç emrit dhe të dhënave identifikuese të anijes duhet të pasqyrohen dhe hipotekat apo privilegjet në pronësinë e tyre.

Sekuestrimi

Ekzekutimi mbi sendet e lundrimit fillon me sekuestrimin e tyre. Sekuestrimi i mjetit të lundrimit, kruhet vetëm vetëm pas lëshimit të vendimit të përmbauesit gjyqësor, përveç rastit kur është marrë një vendim gjykate i cili urdhëron vendosjen e këtij sekuestrimi.

Përpara se të vendos sekuestrimin e mjetit lundrues, përmbauesi gjyqësor siguron të dhënat e nevojshme, për të vërtetuar nëse mjeti është në pronësi të debitorit. Ky verifikim kryhet nëpërmjet dërgimit të kërkesës për informacion pranë zyrës së regjistrit të mjeteve lundruese, me të dhënat e të cilit mund të njihen pronaret, trashëgimtarët e pronarëve, përfaqësuesit e tyre ligjore ose me prokurë, si dhe organet shtetërore, të cilave u njihet kjo e drejtë në bazë të ligjit. Menjëherë pas sekuestrimit të mjetit të lundrimit, mbahet procesverbali i sekuestrimit. Në këtë proces verbal sekuestrimi shënohen:

a) emri, atësia, mbiemri dhe kombësia e pronarit të anijes;

³Shiko nenin 14 të ligjit 10109, datë 02.04.2009 "Për administratën detare"

88

b) emri i anijes;

c) përshkrimi i kapacitetit të saj;

d) të dhënat e tjera, lidhur me regjistrimin e saj.

Proces verbali i sekuestrimit të anijes i dorëzohet personit, i cili mban regjistrin e mjeteve lundruese, pranë drejtorisë së përgjithshme detare, në kohën e ekzekutimit të sekuestrimit. Sekuestrimi i njoftohet edhe policisë kufitare, që vepron në atë port. Një kopje e proces verbalit të sekuestrimit i jepet edhe drejtorit të portit, ku është ekzekutuar sekuestrimi, i cili është i detyruar të njoftojë pronarin e mjetit të lundrimit, për sekuestrimin e mjetit. Sekuestrimi i njoftohet detyrimisht debitorit sipas rregullave mbi njoftimin e akteve gjyqësore.

Përdorimi dhe shitja e sendit pas sekuestrimit

Për shkak të natyrës dhe funksionit që ato kryejnë, mjetet e lundrimit janë të lëvizshme dhe mund të bëhen të paarrtshme nga ekzekutimi, në rastet e debitorit në keqbesim. Gjithësesi parashikohet që mjeti i lundrimit i lidhur me sekuestrim ti lihet në mbajtje debitorit, derisa të bëhet shitja e tij. Debitori detyrohet të kujdeset për të si për sendin e tij. Në rast se debitori refuzon ose nuk kujdeset si duhet për mjetin, përmbauesi gjyqësor emëron një person tjetër për ruajtjen e mjetit të lundrimit të sekuestruar, i cili mban përgjegjësi për veprime me mjetin, që bëhen pengesë për ekzekutimin. Ai përgjigjet për disponimin, dëmtimin ose shkatërrimin e mjetit në ruajtje, në bazë të dispozitave të Kodit Penal.

Sekuestrimi ndalon lundrimin e mjetit, i cili gjatë sekuestrimit nuk mund të përdoret nga debitori ose personi i caktuar për ruajtjen e tij. Ky ndalim bëhet me qëllim evitimin e shfrytëzimit të lëvizjes së mjetit në keqbesim, për fshehjen e tij.

Shitja e mjeteve të lundrimit, të sekuestruara bëhet me ankand. Për shitjen e mjeteve lundruese zbatohen rregullat e caktuara, për me ankandin e sendeve të paluajtshme.

b. Ekzekutimi mbi mjetet e fluturimit

Mjetet e fluturimit

89

Referuar përkufizimeve të përcaktuara në Kodin ajror të Republikës së Shqipërisë të miratuar me ligjin nr. 10040, datë 22.12.2009 me mjet fluturues do të kuptojmë çdo makinë, që përfiton qëndrimin në atmosferë nga kundërveprimi i ajrit, përveç kundërveprimit të ajrit kundrejt sipërfaqes së tokës, të cilat mund të përdorin hapësirën ajrore, me kusht që të veprojnë në një lartësi më të lartë se tridhjetë metra mbi nivelin e detit ose të tokës. Kështu konsiderohen si avionë civil, pra mjetet fluturues: a) xhiroplanët; b) helikopterët; c) balonat me motor (dirigibles); ç) deltaplanët ose mjetet fluturuese pa motor (gliders);d) hidroplanët; dh) aeroplanët; e) balonat me fluturim të lirë dhe ato të kontrolluara/të lidhura me tokën; ë) deltaplanët ose mjetet fluturuese, që manovrohen nga toka; f) parashutat; g) modelet fluturuese; gj) pajisjet sportive fluturuese.

Mjetet fluturues regjistrohen në regjistrin e administruar nga Autoriteti i Aviacionit Civil (ACC), i cili është një ent publik në varësi të ministrit, i cili është përgjegjës në fushën e transportit ajror. Avioni regjistrohet në Republikën e Shqipërisë vetëm nëse:

a) nuk është i regjistruar në një shtet tjetër;

b) është në pronësinë e:

i) personave me shtetësi shqiptare, personave me shtetësi të një shteti anëtar të marrëveshjes shumëpalëshe, por që kanë leje qëndrimi të përhershme në Republikën e Shqipërisë;

ii) një sipërmarrjeje, që ka vendin e saj kryesor të veprimtarisë në Republikën e Shqipërisë, me objekt kryesor të veprimtarisë transportin ajror;

iii) një shoqërie të formuar në përputhje me ligjin e një shteti anëtar të Bashkimit Europian ose të një shteti palë në marrëveshjen shumëpalëshe, regjistrimi i së cilës, administrata qendrore ose vendi kryesor i veprimtarisë ndodhen në atë shtet.

Ekzekutimi mbi mjetet e fluturimit, me qëllim realizimin e kredisë ekzekutive fillon me sekuestrimin e tyre. Sekuestrimi kryhet pas lëshimit të vendimit për sekuestrim të mjetit nga përmbartuesi gjyqësor, përveç rastit kur është sekuestrimi është parashikuar në disponimet e një vendimi gjyqësor. Para lëshimit të urdhrimit të sekuestrimit, përmbartuesi gjyqësor siguron të dhënat e nevojshme për të vërtetuar se mjeti i fluturimit është në pronësi të debitorit. Një nga format e sigurimit të informacionit përveç atij të siguruar tashmë nga kreditori është ajo e sigurimit të informacionit nga regjistri i administruar nga Autoriteti i Aviacionit civil.

90

Ekzekutimi i sekuestrimit të mjetit të fluturimit

Sekuestrimi i mjetit të fluturimit bëhet me regjistrimin e mjetit, në proces verbalin e sekuestrimit. Një kopje e procesverbalit të sekuestrimit i dorëzohet Autoritetit të Aviacionit Civil ku është regjistruar të aeroportit ku ndodhet mjeti fluturues në kohën e ekzekutimit të sekuestrimit. Sekuestrimi i komunikohet detyrimisht debitorit, nga ACC-ja. Njoftimi bëhet sipas rregullave për njoftimin e akteve gjyqësore të trajtuar anë pikën 2.4.4 të këtij kreu.

Kur mjeti i fluturimit i sekuestruar është i huaj, Autoriteti i Aviacionit Civil njofton menjëherë zyrën e vendit ku është regjistruar mjeti fluturues.

Në momentin e ekzekutimit të sekuestrimit, përmbartuesi gjyqësor mban procesverbalin e sekuestrimit, i cili duhet të përmbajë:

emri dhe kombësia e pronarit të mjetit fluturues,

shenjat dalluese të mjetit fluturues,

- vendin e regjistrimit të mjetit,
- kapacitetin,
- e të dhëna të tjera të kësaj natyre.

Përdorimi dhe shitja e mjetit lundruar pas sekuestrimit

Për shkak të natyrës së mjetit fluturues parashikohet që mjete fluturues i sekuestruar ti lihet në mbajtje debitorit, derisa të bëhet shitja e tij. Debitori detyrohet të kujdeset për të dhe në rast se refuzon ose nuk kujdeset si duhet për mjetin, përmbaruesi gjyqësor emëron një person tjetër për ruajtjen e mjetit të fluturimit të sekuestruar, i cili mban përgjegjësi për veprime me mjetin, që bëhen pengesë për ekzekutimin. Ai përgjigjet për disponimin, ose shkatërrimin e mjetit në ruajtje, në bazë të dispozitave të Kodit Penal.

Sekuestrimi i mjetit fluturues e ndalon lundrimin e mjetit, i cili gjatë sekuestrimit nuk mund të përdoret nga debitori ose personi i caktuar për ruajtjen e tij. Shitja e mjeteve të lundrimit, të sekuestruara bëhet me ankand, i cili zhvillohet sipas rregullave të caktuara, për rregullimin e ankandi të sendeve të paluajtshme.

91

c. Ekzekutimi mbi automjetet

Referuar përcaktimeve të bëra në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë të miratuar me Ligjin nr. 8373, datë 22.07.1998, do të kuptojmë mjete me motor me të paktën katër rrota, me përjashtim të autokarrove, ku përfshihen: a) ciklomotori; b) motomjete; c) automjete; d) trolejbusë; e) rimorkio; f) makina bujqësore; g) makina teknologjike; h) mjete rrugore të veçanta. Automjetet regjistrohen pranë degëve përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, dhe pajisen me leje qarkullimi. Degët e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor marrin masa për regjistrimin dhe lëshojnë lejen e qarkullimit ndaj atij që vërteton se është pronar i mjetit, duke treguar, kur duhet, edhe gjeneralitetet e shfrytëzuesit ose të qiramarrësit me të drejtë blerjeje ose të shitësit me marrëveshje me të drejtë rikthimi, kur nuk paguhen këstet.

Ekzekutimi i sekuestrimit të automjeteve

Ekzekutimi i vendimit të gjykatës apo të titujve të tjerë ekzekutivë mbi automjetin e debitorit bëhet me vendosjen e sekuestro mbi të. Sekuestrimi mbi automjetin kryhet në bazë e për zbatim të aktit të lëshuar nga përmbaruesi gjyqësor që urdhëron vënien e sekuestro. Me vendosjen e sekuestro mbahet procesverbali i sekuestrimit, e një kopje e këtij procesverbali i dorëzohet Degës rajonale të Drejtorisë së Transportit Rrugor, ku është regjistruar automjeti. Sekuestrimi i komunikohet detyrimisht debitorit, nga përmbaruesi gjyqësor. Njoftimi bëhet sipas rregullave për njoftimin e akteve gjyqësore të trajtuara në pikën 2.4.4 të këtij kreu.

2.8.4 Ekzekutimi i sendeve në bashkëpronësi

Një send i luajtshëm apo i paluajtshëm i përket gjendjes juridike të bashkëpronësisë kur ai dhe të drejtat reale që lidhen më të u përkasin bashkërisht dy ose më shumë personave.

Bashkëpronësia mund të shtrihet mbi disa apo një send, dhe mund të shtrihet si mbi sendet e luajtshme ashtu dhe mbi ato të paluajtshme. Bashkëpronësia mbi sendet ekziston në dy forma: a) bashkëpronësi në pjesë kur pjesët e secilit bashkëpronar konsiderohet se janë të pandara dhe të

92

barabarta, gjersa nuk vërtetohet e kundërta; dhe b) bashkëpronësi në tërësi, ku pjesët takuese të bashkëpronarëve nuk rezultojnë të jene të barabarta dhe duhet të caktohen me vendim gjykate.

Ekzekutimi mbi sendet e luajtshme në bashkëpronësi

Në funksion të ekzekutimit të një titulli pronësie, me objekt detyrimi shlyerjen e një shumë të

hollash, ekzekutimi mbi sendet në bashkëpronësi shtrihet vetëm mbi pjesën takuese të bashkëpronarit debitorit të sendit.

Ekzekutimi mbi sendet e luajtshme kryhet nëpërmjet sekuestrimit. Sekuestrimi mbi sendet në bashkëpronësi kryhet vetëm pas vlerësimit të tyre nga përmbaruesi gjyqësor. Sekuestrimi i njoftohet të gjithë bashkëpronarëve, kur këto nuk janë të pranishëm.

Pas vënies së sekuestrimit të sendit në bashkëpronësi, duhet të kryhet veçimi i pjesës takuese të debitorit tij me qëllim ekzekutimit e kredisë ekzekutive. Veçimi i pjesës takuese të debitorit, mbi sendet e përbashkëta të sekuestruar kryhet:

me marrëveshje të bashkëpronarëve, kur këta të fundit bien dakord që të ndajnë sendet në bashkëpronësi me kusht që marrëveshja të mos rëndojë pozitën e kreditorit.

me vendim gjyqësor, kur palët nuk bien dakord të pjesëtojnë sendin e përbashkët apo kur marrëveshja rëndon pozitën e kreditorit dhe nuk mund të pranohet.

Pjesëtimi gjyqësor i pjesëve të veçanta të debitorit i sendit në bashkëpronësi kryhet me kërkesë të përmbaruesit gjyqësor, pasi të jetë bërë inventarizimi i gjithë pasurisë së përbashkët, nga ky i fundit. Kërkesa për pjesëtim i paraqitet gjykatës kompetente të vendit ku kryhet ekzekutimi.

Veçimi i pjesës takuese të sendit të sekuestruar ndjek rregullat e përgjithshme të pjesëtimit të parashikuar në nenet 369-374 të Kodit të Procedurës Civile.

Ekzekutimi mbi sendet e përbashkëta të sekuestruara mund të kryhet dhe në tërësi nëse plotësohet të paktën njëri nga kushtet:

- a) të gjithë bashkëpronarët janë debitor solidarë;
- b) nëse të gjithë bashkëpronarët kanë dhënë pëlqimin e tyre .

Ekzekutimi mbi sendet e paluajtshme në bashkëpronësi

93

Ekzekutimi i sendeve të paluajtshme në bashkëpronësi me qëllim zbatimin e një titulli ekzekutiv, kryhet nëpërmjet sekuestrimit të sendit. Përmbaruesi gjyqësor para vendosjes së sekuestro mbi sendin e paluajtshëm në bashkëpronësi, duhet të verifikojë pronësinë e sendit, nëpërmjet komunikimit me zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të përcaktuar më pas rrethin e bashkëpronarëve në emër të cilëve figuron i regjistruar sendi. Sekuestrimi i sendit të paluajtshëm në bashkëpronësi kryhet sipas rregullave të sekuestrimit të sendeve të paluajtshme të përshkruara në pikën 4.8.2.

Pas vendosjes së sekuestrimit me qëllim vijimin e ekzekutimit të kredisë ekzekutive, bëhet veçimi i pjesës takuese të debitorit bashkëpronar mbi sendin e paluajtshëm në bashkëpronësi. Veçimi i pjesës takuese mbi sendin e sekuestruar në bashkëpronësi, kryhet:

me marrëveshje të bashkëpronarëve, kur këta të fundit bien dakord që të ndajnë sendet në bashkëpronësi me kusht që marrëveshja të mos rëndojë pozitën e kreditorit;

me vendim gjyqësor, kur palët nuk bien dakord të pjesëtojnë sendin e përbashkët apo kur marrëveshja rëndon pozitën e kreditorit dhe nuk mund të pranohet.

Veçimi i pjesës takuese të debitorit bashkëpronar mbi sendin e paluajtshëm në bashkëpronësi mund të kryhet me marrëveshjen e të gjithë bashkëpronarëve të sendit kur këto të fundit bien dakord dhe arrijnë të përcaktojnë pjesën takuese të debitorit, me kusht që ndarja e saj të mos dëmtojë interesat e kreditorit. Marrëveshja për pjesëtimin e sendit të paluajtshme në bashkëpronësi duhet të kryhet më akt noterial.

Ndërkohë në rast mosarritjes së marrëveshjes midis bashkëpronarëve për veçimin e pjesës takuese, apo kur marrëveshja e tyre të mos pranohet për shkak se ka rënduar pozitën e kreditorit, veçimi i pjesës takuese mund të kërkohet të kryhet në gjykatë nga përmbaruesi gjyqësor.

Kompetente për shqyrtimin e kërkesës së përmbaruesit gjyqësor është gjykata e rrethit gjyqësor të vendit ku kryhet ekzekutimi. Caktimi i pjesës takuese të debitorit bashkëpronar në sendin në bashkëpronësi kryhet sipas të pjesëtimit gjyqësor. Veçimi dhe ndarja e pjesës takuese të debitorit në sendin e paluajtshëm kryhet kur kjo ndarje është e mundshme dhe nuk dëmton qëllimin e përdorimit të sendit.

94

Ekzekutimi në tërësi i sendit të paluajtshëm në bashkëpronësi mund të kryhet kur:

- a) të gjithë bashkëpronarët janë debitorë solidar;
- b) për shitjen kanë dhënë pëlqimin të gjithë bashkëpronarët, pëlqim i cili duhet të shprehet në formën e aktit noterial.

2.8.5 Ekzekutimi mbi kreditë e debitorit dhe mbi sendet që personat e tretë i detyrohen kreditorit

Me qëllim përmbushjen e titullit të detyrueshëm për ekzekutim, ligji parashikon që ekzekutimi të shtrihet dhe mbi kredi apo sende për të cilat persona të tretë i detyrohen debitorit. Persona të tretë që i detyrohen debitorit janë persona të cilët mbajnë sendet e tij dhe nuk janë palë në ekzekutim.

Në cilësinë e personave të tretë që mbajnë kreditë e debitorit janë:

- Bankat, ku mund të jenë depozituar sasi të caktuara mjetesh monetare në emër të debitorit;
- Shoqëritë e sigurimit me të cilat debitori ka lidhur kontrata respektive në përmbushje të të cilave, debitorit përfiton mjete të caktuara monetare;
- Punëdhënësi i debitorit, i cili detyrohet ti japë debitorit shpërblimin për punën e kryer, bazuar në marrëdhënien e punës së krijuar.
- Blerësi, i cili i detyrohet debitorit, për çmimin e shitjes së një malli apo sendi.

Ndërsa persona të tretë që mbajnë sendet e debitorit janë persona fizik apo juridik, të cilët përdorin sendin e debitorit, bazuar në një marrëdhënie juridike të krijuar midis debitorit dhe tyre. Këtu mund të përfshihen: qiramarrësi i sendit, emfiteozmarrësi, depozituesi, transportuesi i mallrave, furnizuesi i tyre etj.

Ekzekutimi

Përpara se të vihet sekuestroja mbi pasuritë e debitorit, përmbaruesi gjyqësor kryen verifikimet e nevojshme për të vërtetuar nëse ekzistojnë ose jo kredi të debitorit apo sende, që personat e tretë i detyrohen atij.

95

Informacioni për ekzistencën e pasurive apo kredive të debitorit, sigurohet nga kreditori dhe përmbaruesi gjyqësor i cili mund ta marrë atë kryesisht. Përmbaruesi gjyqësor njofton me shkresë personin e tretë dhe debitorin në lidhje me fillimin e procedurave të sekuestrimit të sendeve të dhëna personave të tretë. Me marrjen e lajmërimit, debitori deklaron pranë përmbaruesit gjyqësor se informacioni i paraqitur, për pasuritë e tij/saj apo të lëna në posedim personave të tretë, është i saktë e i plotë.

Ekzekutimi mbi kreditë apo sendet e debitorit kryhet nëpërmjet sekuestrimit të tyre, bazuar në vendimin e lëshuar nga përmbaruesi gjyqësor. Kredia dhe sendet, që personat e tretë i detyrohen debitorit quhen të sekuestruara, kur njoftimi i përmbaruesit gjyqësor për sekuestrimin e tyre i njoftohet rregullisht personit të tretë.

Njoftimi i sekuestrimit përmban urdhërimin, sipas të cilit, personi i tretë i ndalohet t'i paguajë kredinë ose t'i dorëzojë sendet e shënuara në njoftimin e sekuestrimit debitorit ose çdo personi

tjetër. Gjithashtu në këtë njoftim duhet të përmbahet dhe paralajmërimi që në rast të mosnjoftimit nga personi i tretë në lidhje me kushtet që e bëjnë kredinë të pa ekzekutueshme, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, këto të fundit dënohen me gjobe nga përmbartuesi gjyqësor me gjobë nga 1 000 deri në 50 000 lekë. Sekuestrimi i njoftohet personi të tretë dhe debitorit sipas rregullave mbi njoftimin e akteve gjyqësore.

Detyrimet e personit të tretë

Personi i tretë mbajtës i kredive të debitorit, brenda **pesë ditëve** nga lajmërimi i sekuestrimit, është i detyruar t'i përgjigjet përmbartuesit gjyqësor:

- a) nëse pranon se kredia ose sendet, mbi të cilat është vendosur sekuestroja, janë të debitorit dhe nëse është gati të shlyejë kredinë ose të dorëzojë sendet;
- b) nëse mbi kredinë ose mbi sendet kanë pretendime edhe persona të tjerë;
- c) nëse mbi kredinë ose mbi sendet është vënë sekuestër edhe në bazë të një urdhri tjetër ekzekutimi.

Me marrjen e njoftimit të sekuestrimit, nga përmbartuesi gjyqësor, personit të tretë i ndalohe të:
96

- a) të përmbush detyrimin për kthimin e kredisë ose dorëzimin e sendeve të sekuestruara, në favor të debitorit;
- b) të paguajë kredinë e një personi tjetër të tretë, tek i cili mund të ketë kaluar kredia, pas sekuestrimit.

Në rast se personi i tretë në përgjigjen e tij pas lajmërimin të ekzekutimit, nuk kundërshton që kredia ose sendet të jenë të debitorit, detyrohet t'ia dorëzojë këto përmbartuesit gjyqësor, i cili vepron sipas rregullave të mësipërme.

Në rast se personi i tretë në përgjigjen e tij kundërshton që kredia ose sendet të jenë të debitorit, ekzekutimi mbi to nuk mund të vazhdojë dhe kreditori duhet të ngrejë padi për të vërtetuar se kredia ose sendet që ka personi i tretë janë të debitorit të tij. Kjo padi ngrihet nga kreditori kundër personit të tretë dhe debitorit, për të vërtetuar që sendet e personit të tretë janë të debitorit të tij. Kompetente për shqyrtimin e kësaj padie është gjykata e vendit ku kryhet ekzekutimi.

Pavlefshmëria e veprimeve të debitorit

Me ekzekutimin e sekuestrimit, kreditori përfiton një të drejtë pengu mbi kredinë ose sendet e debitorit të sekuestruara pranë personit të tretë. Çdo veprim juridik i debitorit që përbën diskonim të kredisë si falja, kompensimi, përtëritja ose zgjatja e afatit të përmbushjes, pas njoftimit të sekuestrimit, është i pavlefshme kundrejt kreditorit, i cili ka kërkuar ekzekutimin.

Kredia ose sendet e debitorit, e sekuestruara pranë personit të tretë, mund të sekuestrohen përsëri në favor të një kreditori tjetër, ndaj të cilit kreditori i parë ishte debitor.

Në rast të kundërshtimit të ekzekutimit nga ana e personit të tretë, ky i fundit përgjigjet sipas dispozitave të kodit penal që parashikojnë sanksione me gjobë për veprime që pengojnë ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Kundër vendimeve të gjykatës për vënien e gjobave në rast pengimi të ekzekutimit, bëhet ankim i veçantë në gjykatën e vendit ku kryhet ekzekutimi.

Vendimi i gjykatës është i formës së prerë kundër tij nuk lejohet ankim.

Kur personi i tretë e kundërshton sekuestrimin mbi kredinë ose sendet pranë tij, sekuestrimi bie. Por sekuestrimi mund të mos hiqet nga përmbartuesi gjyqësor, në rast se kreditori pretendon se ekzekutimi në të ardhmen mbi sendet apo kreditë e personit të tretë do të ishte i pamundur. Në këtë rast, personi i tretë mund kërkojë heqjen e sekuestrimit, në gjykatën e rrethit gjyqësor të vendit të ekzekutimit.

97

2.8.6 Ekzekutimi mbi kredinë e siguruar

Kredi e siguruar quhet kredia përmbushja e së cilës në të ardhmen garantohet nëpërmjet një

garancie të vënë nga kredimarrësi. Garanci për përmbushjen e kredisë janë: a) pengu dhe b) hipoteka.

Pengu vihet mbi një pasuri të luajtshme, mbi një të drejtë ndaj prurësit, ose me urdhër, ose mbi uzufuktin e kësaj pasurie ose të drejtë me qëllim përmbushjen e ekzekutimit në të ardhmen. Ekzekutimi mbi kredinë e siguruar me peng përfshin dhe sendin që e siguron atë. Ekzekutimi kryhet nëpërmjet sekuestrimit, i cili kryhet nëpërmjet njoftimit të personit që mban pengun. Me marrjen e njoftimit për sekuestrimin e sendit të vënë peng, mbajtësi i tij detyrohet të mos ia dorëzojë këtë send asnjë personi pa urdhrin e përmbauesit gjyqësor. Kur sendi i luajtshëm të vënë peng është i regjistrueshëm, akti me të cilin urdhërohet sekuestrimi i njoftohet zyrës ku është kryer regjistrimi.

Ekzekutimi i kredisë së siguruar kryhet mbi sendin e siguruar kur kreditori e kërkon këtë. Ky ekzekutim kryhet nëpërmjet shitjes së sendit të vënë peng duke respektuar rregullat e shitjes së sendeve të luajtshme të sekuestruara dhe atyre të shitjes së pengut.

Hipoteka është një e drejtë reale që vihet mbi pasurinë e debitorit ose të një të treti, në dobi të kreditorit, për të siguruar përmbushjen e një detyrimi. Hipoteka vihet vetëm mbi sendet e paluajtshme dhe krijohet me ligj apo kontratë noteriale.

Kur ekzekutimi kryhet mbi sende mbi të cilat është vënë hipotekë, sekuestrimi i kredisë shtrihet dhe mbi sendin që e siguron atë. Në aktin e sekuestrimit duhet të tregohen me saktësi dhe kredia dhe sendi që e siguron atë. Akti i sekuestrimit regjistrohet në regjistrat e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ku është regjistruar sendi, duke bërë shënim për vënien e sekuestro. Ky akt sekuestrimi i njoftohet dhe personit që ka vënë hipotekë sendin e tij për sigurimin e ekzekutimit të kredisë. Sekuestrimi quhet i ekzekutuar kur vendndodhja e tij i është njoftuar dhe

98 kanë marrë dijeni personi që ka kredinë e siguruar dhe pronarit të sendit që ka vënë në hipotekë sendin e paluajtshëm për të siguruar kredinë e siguruar.

Ekzekutimi i kredisë së siguruar kryhet mbi sendin në hipotekë që e siguron atë, vetëm pasi kreditori e kërkon ekzekutimin mbi këtë send. Për shitjen e sendit në hipotekë zbatohen rregullat për shitjen e sendeve të paluajtshme të sekuestruara.

2.8.7 Ekzekutimi ndaj personit juridik që shpërndahet ose likuidohet

Personat juridik ashtu sikundër personat fizik janë subjekte të ekzekutimit të titujve ekzekutiv. Personi juridik mbaron sipas mënyrës së caktuar në aktin e krijimit, në statut apo në ligj. Kur personi juridik pushon së ushtruari veprimtarinë e tij, ky i fundit quhet se ka mbaruar. Mbarimi i personit juridik pavarësisht shkakut që e ka çuar tek ky mbarim, vihet në likuidim. Mbarimi i personit juridik mund të vijë për shkak të prishjes pa falimentim të tij apo vënies në likuidim. Në referim të përcaktimeve të bëra në Ligji. 9901, datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”, prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Prishja pa falimentin e personit juridik ndodh me ndarjen apo bashkimin e tij. Kur personi juridik mbaron me anë të bashkimit, personi i ri juridik merr përsipër detyrimet e personit juridik të bashkuar me të e për rrjedhojë është përgjegjës për detyrimet e tij. Kur personi juridik ndahet shoqëria përfituese e aksioneve të shoqërisë së ndarë është solidarisht debitorë për detyrimet e shoqërisë së ndarë përveç kur midis palëve që kanë realizuar ndarjen ka një marrëveshje që parashikon ndryshe.

Me fillimin e procedurave të ndarjes apo bashkimit të personit juridik, ekzekutimi i detyrimit pezullohet deri në momentin e fitimit të personalitetit juridik të personave juridik që trashëgojnë personalitetin juridik të personave të ndarë apo të bashkuar.

Urdhri i ekzekutimit mbi personat juridik të ndatë apo të bashkuar, ekzekutohet nga përmbauesi

gjyqësor ndaj personave juridik të cilët përfitojnë personalitetin juridik pas procesit të ndarjes apo bashkimit.

Përsa i përket personave juridik që mbarojnë nëpërmjet falimentit, ekzekutimi i detyrimeve ndaj

99

këtyre të fundit. Procedura e falimentimit hapet vetëm me shkak, dhe gjendja e paaftësisë paguese përbën shkak të përgjithshëm për hapjen e procedurës së falimentimit⁴. Debitori vlerësohet i paaftë për të paguar nëse nuk është në gjendje të paguajë detyrimet në datën e maturimit dhe paaftësia paguese prezumohet se ekziston nëse debitori nuk kryen pagesat. Mbingarkesa me borxhe përbën shkak për hapjen e procedurës së falimentimit në rastin e një personi juridik. Debitori ndodhet në gjendjen e mbingarkesës me borxhe kur vërtetohet se pasuritë e tij nuk mbulojnë detyrimet ndaj të tetëve dhe, në bazë të rrethanave, pas vlerësimit të pasurive të debitorit nuk është më mundësia për vazhdimësinë e veprimtarisë.

Në momentin e hapjes së procedurave të falimentit, ekzekutimi i detyrueshëm ndalet dhe çdo urdhër ekzekutimi i detyrueshëm mbi pasurinë e debitorit bëhet i pavlefshëm derisa plani i zyrës së përbarimit për ndarjen e të ardhurave të marrë formë përfundimtare.

Në çdo rast urdhri i ekzekutimit duhet të regjistrohet në procesin e falimentit të personit juridik debitor dhe pasuria e debitorit që konfiskohet nga përbaruesi gjyqësor dhe shumat e fituara nga shitja e pasurive bëhen pjesë e masës së falimentimit dhe përbaruesi gjyqësor duhet t'ia dorëzojë administratorit të falimentimit.

2.8.8 Ekzekutimi mbi sigurimin e sendeve

Ekzekutimi mbi sendet, për llogari të zbatimit të një titulli ekzekutiv me objekt shlyerjen e një shume të hollash, shtrihet dhe mbi shpërblimin e sigurimit të sendeve kur këto të fundit janë të siguruara. Kur sendi i sekuestruar shitet në funksion të ekzekutimit të një kredie ekzekutive, sigurimi shoqëron sendin dhe shuma e paguar nga debitori për sigurimin llogaritet në vlerën e sendit.

Në momentin që përbaruesi gjyqësor vendos sekuestrimin e sendeve të debitorit, ai duhet të mbledhë informacion nëse sendi i sekuestruar është i siguruar apo jo me qëllim llogaritjen e shpërblimit. Në qoftë se sendet e sekuestruara janë të siguruara, sekuestrimi shtrihet edhe në

⁴ Ligji nr. 8901, datë 23.05.2002 "Për falimentimin". (neni 74)

100

shpërblimin që u takon limit nga sigurimi në vlerën e sendit objekt sekuestrimi. Njoftimi për sekuestrimin e shpërblimit të sigurimit, i njoftohet kompanisë siguroese, sipas rregullave të përshkruar në pikën 2.4.6. Siguruesi në momentin e marrjes së njoftimit për sekuestrimin e sendit të siguruar pranë tij, nuk mund të paguajë debitorin për shpërblimin e sigurimit, pasi ka pozitën e personit që ka kredinë e debitorit.

2.9 Ekzekutimi për titujt ekzekutiv me objekt lirim e dorëzim sendi

Në veprimtarinë e përditshme përbarimore ndeshen dhe ekzekutime të titujve ekzekutiv me objekt lirim e dorëzim sendi. Këta tituj klasifikohen si tituj të vështirë pasi janë të ngarkuar nga pikëpamja sociale, këtë e bën pak të vështirë dhe vështirësia ekonomike që kanë shtresa të ndryshme të popullsisë dhe për rrjedhojë ekzekutimi këtyre titujve ve përpara vështirësisë vetë përbaruesit gjyqësor të cilët në ekzekutimin e titujve duhet të harxhojnë energji për menaxhimin e palëve në proces dhe për këtë duhet të kenë eksperiencë të mjaftueshme për ekzekutimin e tyre.

Pasi pranohet praktika përbarimore kryen veprimet e duhura për regjistrimin e saj dhe lidhet kontrata me palën kreditore në përputhje me nenin 517 të K.Pr.Civile përbaruesi gjyqësor i kërkon me njoftim shkresor palës debitorë të kryejë ekzekutimin e titullit ekzekutiv në mënyra vullnetare duke i vendosur në shkresë dhe afatin ligjor prej 10 ditë për kryerjen e ekzekutimit nga

vetë pala debitorë.

Nga praktika jone këto lloj ekzekutimesh në shumicën e tyre nuk janë kryer në mënyrë vullnetare nga pala debitorë dhe për rrjedhojë ekzekutimi i këtyre titujve ekzekutiv do të kryhet në formën e ekzekutimit të detyrueshëm. Kjo do të kërkojë nga ana e përmbaruesit të bëjë kujdes në mënyrën e përlllogaritjes së shpenzimeve përmbarimore pavarësisht se ato do të përballohen fillimisht nga pala kreditore dhe do të vilen në përfundim të ekzekutimit nga pala debitorë. Gjithashtu përmbaruesi gjyqësor duhet të marri masat e duhura për të bërë të mundur që njoftimin për ekzekutim të detyrueshëm të ruaje afatin ligjor duke e vënë në dijeni palën debitorë për ditën dhe orën e ekzekutimit. Për këtë përmbaruesi gjyqësor të paktën tre ditë më parë se kryerja e ekzekutimit i dërgon njoftimin palës debitorë.

Për kryerjen e ekzekutimit të detyrueshëm për lirim dhe dorëzimin e sendit nëse e gjykon të drejte përmbaruesi gjyqësor njofton dhe kërkon ndihmën e punonjësve të policisë se shtetit si dhe

101
atë të njësisë se pushtetit vendor. Në të njëjtën mënyrë vepron përmbaruesi gjyqësor dhe në rastin e sekuestrimit të pasurisë se palujtshme të palës debitorë.

Ne datën dhe në orën e caktuar në njoftim përmbaruesi gjyqësor sebashku me përfaqësuesit e rendit dhe të njësisë vendore kryen ekzekutimin e titullit duke vendosur palën kreditore në posedimin e sendit. Për këtë përmbaruesi gjyqësor mban një proces verbal duke shënuar të gjitha veprimet kundërveprimet si dhe objeksionet e pretendimeve të palëve në ekzekutim.

Ne procesverbal shënohet dhe masa e shpenzimeve të kryera për lirim dhe dorëzimin e sendit. Ne rast se pala debitorë megjithë njoftimet e mara nuk qëndron në objekt atëherë përmbaruesit gjyqësor i duhet që të hapi me force banesën e palës debitorë dhe të vendosi palën kreditore në posedim të sendit.

Ne banesën e hyre me force në praninë e përfaqësuesve të njësisë se qeverisjes vendore si dhe të dy dëshmitareve përmbaruesi gjyqësor Ben inventarin e sendeve të gjetura në banesë dhe nën përgjegjësin e tij i dorëzon ato palës debitorë ose familjareve të tij.

Kujdes në asnjë rast përmbaruesi gjyqësor nuk duhet të hyjë në banesë pa praninë e përfaqësuesit të pushtetit vendor dhe të dy dëshmitareve

Ne rast se debitori ose familjaret e tij nuk janë të pranishëm përmbaruesi gjyqësor merr masat e duhura për magazinimin e këtyre sendeve në mjediset e liruara nëse pala kreditore pranon për një periudhë 2 mujore.

Ne rast se nuk arin marrëveshje me kreditorin përmbaruesi gjyqësor merr masa për largimin e sendeve të gjetura në objekt duke i magazinuar ato në ambiente të tjera që disponohet nga shërbimi përmbarimor ose në një ambient neutral me një siguri për ruajtjen e tyre. Në të gjitha rastet këto sende mbahen në ruajtje nga shërbimi përmbarimor për një periudhë 2 mujore.

Shpenzimet për magazinimin e sendeve paguhen nga pala debitorëve çastin e dorëzimit të tyre. Nëse brenda dy muajve nga lirimi dhe magazinimi pala debitorë nuk i kërkon sendet e tij ose pala debitorë nuk paguan detyrimin e tij për ruajtjen e sendeve atëherë përmbaruesi gjyqësor për sendet të cilat janë të sekuestrueshme vlerësohen dhe shitjen në përputhje me dispozitat ligjore për shitjen e sendeve të luajtshme në rast se ka sende të cilat nuk mund të jene të sekuestrueshme ato i kthehen palës debitorë. Sendet e luajtshme që nuk mund të shiten ose nuk kërkohen nga pala debitorë asgjësohen apo i kalojnë institucioneve shtetërore ose enteve publike në formën e kalimit kapital.

102

Përmbaruesit gjyqësor në kryerjen e këtyre veprimeve lidhur me sendet e luajtshme të ndodhura brenda sendit të paluajtshëm duhet të mbajnë procesverbale të rregullat ku të pasqyrohen sakte veprimet përmbarimore.

Në rast se pala debitorë mbasi është kryer ekzekutimi i titullit ekzekutiv me objekt lirim dhe dorëzim banese vihet përsëri në mënyre të paligjshme në posedim të sendit përmbaruesi gjyqësor me kërkesë të palës kreditore i heq përsëri posedimin e sendit. Në momentin e ekzekutimit përmbaruesi gjyqësor i Ben me dije palën se në rast se përsëritet një veprim i tillë përgjegjësia e tyre është përgjegjësi penale dhe ata do të përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal.

Një moment tjetër i parashikuar nga ligji është dhe momenti kur sendi i paluajjtshëm ka kaluar në posedim të personit të trete. Nga ana e përmbaruesit gjyqësor në këtë rast duhet të kryen në radhe të pare veprime verifikuese duke konstatuar me vendim mënyrën e fitimit të posedimit të sendit nga pala e trete dhe me ane veprimeve përmbarimore e vendos palën kreditore në posedim të sendit.

2.9.1 Ekzekutimi për vënien në posedim për sendin e luajjtshëm

Përmbaruesit gjyqësor në ekzekutimin e titujve ekzekutiv mbasi ka regjistruar praktikën përmbarimore si dhe ka kryer veprimet e duhura procedurale si për hapjes e dosjes përmbarimore fillimisht njofton palën debitorë për kryerjen e ekzekutimit të titullit në mënyre vullnetare dhe me pas në rast se pala debitorë nuk e kryen ekzekutimin në mere vullnetare kalon ekzekutimin e titullit në ekzekutim të detyrueshëm.

Përmbaruesi gjyqësor për ekzekutimin e detyrueshëm njofton palën debitorë dhe ditën dhe orën e caktuar për ekzekutim të detyrueshëm në vendin ku ndodhet sendi shkon dhe kryen veprimin e duhur duke i mare sendin palës debitorë dhe dorëzimin e tij kreditorit. Në rast se sendi nuk ndodhet me pranë palës debitorë ose është prishur ose pranë palës debitorë ndodhet një pjese e sendit dhe në rast se gjykata në vendimin e saj ka caktuar dhe vleftën e sendit përmbaruesi gjyqësor merr nga pala debitorë kundervleften e sendit ose të pjesës që mungon .

103

Përmbaruesi gjyqësor për të gjitha veprimet që kryen mban procesverbalin e ekzekutimit ku në të cilin pasqyrohen të gjitha veprimet procedurale që ai kryen.

Ne rast se në vendimin e gjykatës nuk është përcaktuar vlefta e sendit si dhe sendi është dëmtuar ose i mungon pjesa e tij në këtë rast përmbaruesi gjyqësor Ben bllokimin e pjese që gjendet ose dhe në rast mos ekzistence i pasqyron ato në procesverbal dhe caktimin e vleftës se sendit e Ben gjykata e vendit të ekzekutimit. Në këtë rast gjykata pasi dëgjon palët përcakton vlerën ose në rast nevoje ajo theret dëshmitarë dhe ekspert për caktimin e vlerës se sendit.

Ne ligj nuk është parashikuar se kush mund të beje kërkesën për caktimin e vlerës se sendit dhe mendojmë se këtë kërkesë mund ta beje pala e interesuar ose pala kreditore e cila në këtë rast mbron interesat e veta.

Por dhe bërja e kërkesës nga ana e përmbaruesit gjyqësor që kryen veprimet përmbarimore për ekzekutimin e titullit nuk mund të konsiderohet shkelje

Kundra vendimit të gjykatës për caktimin e vlerës se sendit të luajjtshëm mund të behet ankim i veçante.

2.10 Ekzekutimi i titujve ekzekutiv me objekt kredi bankare

Ne baze të nenit 510 e 511 të K.Pr.Civile tituj ekzekutiv janë dhe ata tituj që i përkasin Kontratave të Huave Bankare ose në gjuhen e përditshme Kredi Bankare dhe për ekzekutimin e tyre ngarkohet shërbimi përmbarimor. Për këta tituj ekzekutiv lëshohet urdhri i ekzekutimit nga gjykata dhe palët kreditore bankat paraqesin pranë shoqërive përmbarimore ose përmbaruesit gjyqësor privat kërkesën për vënie në ekzekutim. Me pranimin e praktikës si dhe me nënshkrimin e kontratës midis palës kreditore dhe shoqërisë përmbarimore fillon procedura përmbarimore për ekzekutim e tyre. Përmbaruesi gjyqësor paraprakisht bën regjistrimin e dosjes përmbarimore pranë Regjistrisë Qendror pranë ministrisë se Drejtësisë si dhe i dërgon palës

debitorë ose huamarrësit njoftimin për ekzekutim vullnetar. Në rast se në Kontratën e Huasë ka dhe subjekte të tjera të cilët janë me cilësi e dorëzanësit në kuptim të nenit 589 të Kodit Civil dhe dorëzanësi është përgjegjës karshi palës kreditore njëloj si pala debitorë dhe për këto arsye nga ana e përmbaruesit gjyqësor i dërgohet dhe atij për dijeni njoftimi për ekzekutim vullnetar. Me mbarimin e afatit vullnetar në rast se pala debitorë ose pala dorëzanëse nuk kane paraqitur pranë përmbaruesit mandat pagesën e shlyerjes se detyrimit ky i fundit në baze të nenit 527 të 104

K.Pr.Civile kalon ekzekutimin e titullit në mënyre të detyrueshme. Në këtë moment përmbaruesi gjyqësor vendos masën e sekuestro mbi pasuritë e palës debitorë dhe palës dorëzanëse. Për këtë urdhërohet vendosja e masës se sekuestro mbi llogarite bankare që mund të ketë pala debitorë dhe dorëzanësi pranë bankave të nivelit të dyte. Përmbaruesi gjyqësor urdhëron me vendim vendosjen e masës se sekuestro mbi pasurin e paluajtshme të tyre duke kërkuar që konform nenit 560 të K.Pr.Civile pranë ZVRPP të behet shënimi për masën e sekuestro se pasurisë. Në rast se nga llogarit bankare të palëve në proces sigurohet përmbushja e detyrimit përmbaruesi gjyqësor urdhëron kalimin e shumës se plote në llogarinë e palës kreditore dhe mbas këtij veprimi merr në përputhje me nenin 616 të K.Pr.Civile vendimin e pushimit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv. Kur vendimi I pushimit të ekzekutimit merr forme të prere ai heq masën e sekuestro mbi të gjitha pasurit e sekuestruara si dhe mbi hipotekat e vena për këtë titull. Në shumicën e rasteve këto kredi janë siguruar me Kontrata Hipotekimi ndërmjet palëve. Mbasi ka vendosur shënimin e masës se sekuestro në regjistrin e Hipotekës konform nenit 565 të K.Pr.Civile përmbaruesi gjyqësor bën dhe sekuestrimin e sendit duke mbajtur në objektin e sekuestruar procesverbalin e vendosjes se masës se sekuestro. Objekti i sekuestruar i lihet në ruajtje palës debitorë dhe kur ky nuk paraqitet në objekt ose nuk pranon marrjen në ruajtje të objektit të sekuestruar përmbaruesi gjyqësor cakton një përfaqësues të ruajë objektin dhe për këtë i cakton një çmim lidhur me shërbimin e ruajtjes se objektit. Në momentin e sekuestrimit përmbaruesi gjyqësor e ka vene në dijeni palën debitorë nëse nuk shlyen detyrimin e tij pasuria e paluajtshme do të çirret në shitje me ankand dhe për këtë i le afat palës debitorë 10 dite. Me mbarimin e këtij afati dhe kur pala debitorë nuk ka kryer ekzekutimin e titullit përmbaruesi gjyqësor i kërkon palës kreditore dhe palës debitorë që se bashku të caktojnë me mirëkuptim çmimin e pasurisë se sekuestruar. Për këtë në përputhje me ligjin përmbaruesi gjyqësor i cakton një afat prej 7 ditësh duke u kërkuar atyre respektimin e afatit. Me skadimin e këtij afati dhe kur palët nuk kane paraqitur pranë tij një akt marrëveshje për caktimin e çmimit përmbaruesi gjyqësor në baze të nenit 564 të K.Pr.Civile theret ekspert të licencuar për të bere vlerësimin e pasurisë se paluajtshme. Për caktimin e ekspertit përmbaruesi gjyqësor nuk merr mendimin e palëve por ai mbi bazën e listave që janë në funksionim pranë gjykatave të shkallës se pare ose pranë QKL cakton ekspertin. Eksperti duhet që brenda një afati të shpejte (maksimumi 10 dite) të përcaktoje me Akt Vlerësimi vlerën e pasurisë se paluajtshme dhe mbi bazën e këtij akt ekspertimi përmbaruesi gjyqësor merr vendimin e caktimit të çmimit për 105

pasurin e palës debitorë. Përmbaruesi gjyqësor me marrjen e vendimit për përcaktimin e çmimit të pasurisë se palës debitorë brenda 10 ditëve njofton palët si debitorë dhe kreditore për çmimin e sendit. Në njoftimin e vlerësimit të pasurisë se paluajtshme përmbaruesi gjyqësor i Ben me dije palës debitorë se në rast mos shlyerje pasuria do të nxirret në shitje me ankand dhe çmimi fillestar i ankandit do të jete sa 80 përqind e vlerës se përcaktuar nga përmbaruesi gjyqësor. Për vlerësimin e sendit palët kane të drejtën e ankimit të veçante në gjykate. Në baze të nenit 611 të K.Pr.Civile ankim nuk pezullon ekzekutimin e titullit përveç se kur gjykata vendos ndryshe dhe në këtë kontekst përmbaruesi gjyqësor është i detyruar që pavarësisht nga ankimit të paraqitur

të vazhdoje ekzekutimin e titullit. Mbasi janë kryer të gjitha veprimet e mësipërme dhe pala debitorë nuk ka kryer ekzekutimin e titullit përmbaruesi gjyqësor nxjerr në shitje pasurin e paluajtshme të palës debitorë. Për këtë në përputhje me nenin 568 të K.Pr.Civile përmbaruesi gjyqësor Ben publikimin e shpalljes se ankandit duke publikuar në vende të dukshme vendimin e shpalljes se ankandit. Një kopje afishohet pranë selisë së shoqërisë përmbarimore, një kopje afishohet në hyrjen e pasurisë që nxirret në shitje, një kopje afishohet pranë Gjykatës së shkalles së parë, një kopje afishohet pranë njësisë vendore ku ndodhet pasuria e paluajtshme, një kopje mund të afishohet në hyrjen e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ku ndodhet pasuria. Publikimi mund të bëhet dhe në median e shkruar dhe atë vizive ose dhe në faqen elektronike që mund të ketë shoqëria ose përmbaruesi gjyqësor. Në vendimin e shpalljes se ankandit përmbaruesi gjyqësor duhet të bejë të mundur publikimin e të dhënave të plota për pasurinë që nxirret në shitje vend ndodhjen e saj vlerën fillestare të çmimit të ankandit.

Përmbaruesi duhet të caktojë qarte vendin orën e zhvillimit të ankandit . Ai duhet të sqarojë dhe kushtet ligjore që ekzistojnë për pjesëmarrje në ankand, duke dhënë numrin e llogarisë bankare dhe në cilën banke ofertuesit do të paguajnë garancinë prej 10 përqind për pjesëmarrje në ankand. Mënyrën se si do të jete ankandi kush mund të shpallet fitues i ankandit. Ankandi në baze të rregullave për zhvillimin e tij duhet të zhvillohet me një komision ankandi prej 3 vetesh. Në praktikën e përditshme këto komisione ngrihen në mënyre shoqërore nga vete përmbaruesit gjyqësor por duke qene se ekziston një organ përfaqësimi për përmbaruesit gjyqësor privat është e nevojshme që përmbaruesit e praktikave përmbarimore para se të caktojnë datën e zhvillimit të ankandit të konkludojnë me organin drejtues të dhomës për të caktuar përmbaruesit gjyqësor të cilët me caktimin e tyre marrin përsipër dhe përgjegjësin e tyre për zhvillimin e ankandit. Në datën dhe orën e caktuar për zhvillimin e ankandit Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbledhet

106

dhe qëndron i grumbulluar nga ora e publikimit të zhvillimit të ankandit deri në përfundimin e orarit zyrtar. Kryetar i komisionit të vlerësimit të ofertave është përmbaruesi gjyqësor që ka zhvilluar procedurën e ekzekutimit ndërsa dy përmbaruesit e jete të caktuar janë me cilësi e anëtarit të KVO. Në rast se paraqiten ofertues në ankand që me hapjen e ankandit kryesuesi i komisionit bën hapjen e ankandit duke bere prezantimin e KVO si dhe kërkon identifikimin e ofertuesve të paraqitur si dhe të personave të tjerë të pranishëm të cilët janë me cilësi e dëshmitareve. Në ankand përmbaruesi gjyqësor fton të jene të pranishëm dhe palët si kreditore dhe pala debitorë dhe në asnjë rast nuk duhet penguar pjesëmarrja e tyre.Kryetari i komisionit u kërkon personave të paraqitur si ofertues të paraqesin mandat pagesat e tyre për garancinë e paguar për pjesëmarrje në ankand. Këto mandat pagesa depozitohen origjinale pranë KVO. Në këtë moment duhet të bëhet dhe verifikimi nëse ofertuesit që kane paguar garancinë kane pengese ligjore në përputhje me kushtet e parashikuar nga neni 709 i K.Civil . Nëse janë në këto kushte atyre nuk u pranohet pjesëmarrja në ankand si ofertues.Mbasi është bere kjo kryetari pyet të pranishmit nëse kane konflikt interesi ndërmjet tyre dhe nëse janë dakord me KVO nuk kane vazhdon procedurën e mëtejshme të zhvillimit si dhe të gjitha veprimet e deklarimet shënohen në procesverbal. Me tej procedura vazhdon duke u kërkuar që ofertuesit një nga një të deklarojnë ofertimin e tyre për pasurin e paluajtshme. Ankandi duke qene një ankand me vlere progresive fitues shpallet ofertuesi që deklaron se paguan vlerën me të larte. Mbasi kane mbaruar ofertat dhe asnjë ofertues nuk deklaron se paguan vlere me të larte se ofertuesi që ka ofruar vlerën me të larte kryetari KVO pasi ka pyetur mbi dy here ofertuesit deklaron mbylljen e ankandit me ofertën me të larte. Në proces verbalin e zhvillimit të ankandit të hapur që në fillim të ankandit ofertuesit nënshkruajnë vlerën e tyre si dhe nëse janë dakord me procedurën e ndjekur me pas bëhet mbyllja e proces verbalit duke u bere dhe firmosja rregullisht nga KVO ,

Ofertuesit dhe personat e pranishëm nëse ata janë dakord të nënshkruajnë për ndjekjen e ankandit. Nëse janë të pranishëm dhe përfaqësuesit e palëve atyre u kërkohet me detyrim firmosja në procesverbal dhe në rast se refuzojnë firmosen kjo gjë dokumentohet. Për të mos krijuar probleme përmbauesit ose shoqerit përmbaues duke qene se procedura e ankandit është e hapur mund të beje dhe regjistrimin e procedurës gjithmonë duke marrë dhe lejet e palëve të pranishme. Ofertuesi që ka ofertuar vlerën me të larte dhe është shpallur nga KVO fitues duhet që brenda 15 ditëve të beje pagesën e vlerës se deklaruar në rast të kundërt i sekuestrohet nga përmbauesi garancia e paguar për pjesëmarrje në ankand. Kjo shume e sekuestruar kalon në

107

Ilogari të shtetit. Në këtë rast merret nga përmbauesi vendimi i anulimit të ankandit dhe për shitjen e pasurisë se paluajtshme organizohet një ankand i ri. Kur ofertuesi brenda afatit ligjor paguan çmimin e plote të pasurisë përmbauesi gjyqësor merr vendimin për kalimin e pronësisë duke specifikuar në vendim që të gjitha tarifat dhe taksat që shërbejnë për këtë kalim, janë në ngarkim të blerësit si dhe brenda 10 ditëve nga pagimi i çmimit të sendit të shitur vendos palën blerëse në posedim të sendit. Në rast se shuma e nxjerre nga shitja e sendit është me e madhe se detyrimi që I ka pala debitorë palës kreditore, përmbauesi gjyqësor mbasi ka zbritur të gjitha detyrimet si dhe janë paguar tarifat e shërbimit dhe të shërbimeve të tjera të kryera për ekzekutimin e titullit pjesën e mbetur ja kthen palës debitorë. Në rast se për shitjen në ankand të pasurisë se paluajtshme të palës debitorë nuk paraqiten asnjë ofertues nga ana e përmbauesit gjyqësor kryen këto veprime. KVO mblihet në orën e caktuar behet hapja e ankandit dhe pritet deri në orën e deklaruar në përfundimin e ankandit . Për mos paraqitjen e ofertuesve KVO mban procesverbalin e zhvillimit të ankandit duke deklaruar mos shitjen dot të pasurisë se paluajtshme pasi në ankand nuk u paraqit asnjë ofertues. Në përputhje me nenin 577 të K.Pr.Civile përmbauesi gjyqësor përcakton me vendim vlerën e re të pasurisë se paluajtshme e cila është me e ulet se në ankandin e pare. Në uljen e çmimit përmbauesi gjyqësor këshillohet të beje një analize për arsyet e mos shitjes dot të pasurisë. Në uljen e çmimit përmbauesi gjyqësor duhet të marri në konsiderate vend ndodhjen e pronës, çmimi i tregut, kushtet që mund të ekzistojnë për mënyrën e zhvillimit të zonës nga pikëpamja urbanistike ose dhe arsye të ndryshme të cilat ndikojnë drejtpërdrejte në mos shitjen e pasurisë. Përmbauesi gjyqësor brenda 10 ditëve nga përfundimi i ankandit të pare përcakton çmimin e ri të sendit jo me të ulet se 20 për qind të çmimit fillestar të përcaktuar në ankandin e pare. Kjo ulje e çmimit duhet të përdoret me kujdes nga përmbauesit gjyqësor dhe në asnjë rast nuk duhet të shërbej për cenimin e të drejtave të palëve në proces ekzekutimi. Pra mbasi ka mare në konsiderate faktorët e mësipërm përmbauesi gjyqësor përcakton çmimin e ri. Me caktimin e çmimit të pasurisë se paluajtshme përmbauesi organizon zhvillimin e ankandit të dyte duke bere publikimin e ankandit në përputhje me nenin 568 dhe të përshkruar me sipër në këtë material. Ankandi nuk mund të zhvillohet me vone se pesembedhjet dite nga dita e marrjes se vendimit për caktimin të çmimit të ri.

Për zhvillimin e ankandit të dyte përmbauesi gjyqësor ndjek të gjitha procedurat e parashikuara si në ankandin e pare dhe për të gjitha veprimet e tij pasqyrohen në procesverbalet

108

përkatëse. Në rast se dhe në ankandin e dyte nuk paraqitet asnjë ofertues për blerjen e pasurisë se paluajtshme përmbauesi gjyqësor me njoftim shkresor i kërkon palës kreditore marrjen e sendit në pronësi kundrejt detyrimit me çmimin e ankandit të dyte. Pala kreditore në rast se pranon një fakt të tille duhet të shprehet shkreserisht. Me miratimin e palës kreditore për pranimin e sendit kundrejt kredisë dhe mbasi pala ka paguar të gjithë detyrimet financiare ndaj shërbimit përmbauesit behet vendimi për kalimin e pronësisë. Në vendim përmbauesi gjyqësor

specifikon se të gjitha tarifat dhe taksat që shërbejnë për kalimin e pronësisë janë në favor të palës përfituese kreditorit. Në rast se pala kreditore nuk pranon kalimin e pronësisë përmbaruesi gjyqësor heq masën e sekuestro mbi pasurin e palës debitorë dhe vazhdon ekzekutimin mbi pasuri të tjera të palës debitorë. Në rast se brenda afatit ligjor prej 6 muajsh nuk gjenden pasuri të palës debitorë përmbaruesi gjyqësor vendos pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv fakt ky I parashikuar në germën “d” e nenit 615 të K.Pr.Civile.

III. Përgjegjësia e subjekteve në ekzekutim

Gjatë ekzekutimit të detyrueshëm, të titujve ekzekutivë, në rast të mosekzekutimit të tyre në rastet e parashikuara në ligj, debitori ka: a) përgjegjësi civile dhe b) përgjegjësi penale.

a-Përgjegjësia civile e debitorit

Përgjegjësia civile e debitorit lind atëherë kur ky i fundit me anë të veprimeve apo mosveprimeve të tij bëhet shkak për pengimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv. Debitori për shkak të mosekzekutimit mund të dënohet nga organi i ekzekutimit, me gjobë në rastet kur:

- nuk kryen veprimin e caktuar, objekt ekzekutimi, veprim që nga natyra mund të kryhet vetëm nga debitori dhe jo edhe nga personi tjetër;
- refuzon, kryen në mënyrë të parregullt, nuk respekton afatet ose kryen të kundërtën e asaj, që me vendim gjyqësor është i detyruar të kryejë;
- veprimi, objekt ekzekutimi, nga natyra mund kryhet dhe nga persona të tjerë, por kreditori nuk kërkon ta kryejë vet veprimin ose përmbaruesi gjyqësor nuk e lejon kryerjen e veprimit, nga vet kreditori.

109

b-Përgjegjësia penale e debitorit

Debitori në rastet e parashikuara në ligj, mban përgjegjësi penale për mosekzekutimin e detyrimit, kur:

- a) disponon sendin e luajtshëm ose të paluajtshëm ose kredinë e sekuestruar, si dhe fsheh, dëmton apo shkatërron sendin e sekuestruar, objekt ekzekutimi.
- b) kryen veprime, me qëllim mosekzekutimin ose pengimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor;
- c) nuk jep mjetet e nevojshme, për jetesën e fëmijës ose personin tjetër, të cilët janë në ngarkim të tij;
- d) ka detyrim për ushqim, por largohet nga vendbanimi dhe nuk njofton personin e interesuar ose organin e ekzekutimit, brenda një muaji, për ndryshimin e vendbanimit;
- e) merr në mënyrë të padrejtë fëmijën, duke e larguar prej personit, i cili ushtron autoritetin prindëror ose që i është besuar, për rritje dhe edukim;

Përgjegjësia për shpërblimin e dëmit.

Një lloj i veçantë i përgjegjësisë së debitorit është dhe përgjegjësia për shpërblimin e dëmit. Çdo mangësi në ekzekutimin e detyrimit e ngarkon debitorin me përgjegjësi për shpërblimin e dëmit. Përgjegjësia për shpërblimin e dëmit bazohet në rregullin, sipas të cilit, çdo marrëveshje që përjashton ose kufizon palët nga përgjegjësia për mosekzekutimin e detyrimit, është e pavlefshme. Debitori mund të çlirohet nga përgjegjësia për shpërblimin e dëmit vetëm kur provon, se mospërmbushja ka ndodhur jo për fajin e tij.

Një rast tjetër është përgjegjësia e debitorit, për veprimtarinë e të tetëve. Kur në ekzekutimin e detyrimit, debitori përdor punën e personave të tretë, ai përgjigjet për veprimet e tyre të kryera me faj, sikur të ishin kryer prej atij vet.

Gjithashtu ligji parashikon dhe rastet e përgjegjësisë së personave të tretë për përmbushjen e

detyrimet të përcaktuar në titullin ekzekutiv. Subjektet e ekzekutimit, të cilët kanë përgjegjësi në rastet e parashikuara në ligj, janë:

110

- 1) personi i tretë i cili ka kreditë ose sendet e debitorit;
- 2) banka, ku debitori ka llogari, depozita ose kreditë e tij;
- 3) punëdhënësi i debitorit;
- 4) ruajtësi i sendeve të sekuestruara;
- 5) personi i cili ka në posedim sendet e debitorit

IV. PEZULLIMI I EKZEKUTIMIT, MJETET E MBROJTJES KUNDËR EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE

4.1 Pezullimi i ekzekutimit

Janë 6 raste të pezullimit të ekzekutimit të një vendimi gjyqësor të formës së prere-titull ekzekutiv, të parashikuara në 6 dispozita. Përtej këtyre rasteve nuk mund të ketë pezullim të ekzekutimit të një titulli ekzekutiv.

Se pari, është rasti i parashikuar nga neni 609 i Kodit të Procedurës Civile, ku thuhet: "**Debitori mund të kërkojë në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit, që të deklarohet se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm ose se detyrimi nuk ekziston, ose ekziston në një masë më të vogël ose është shuar më pas.**

Kur titulli ekzekutiv është një vendim gjyqësor ose vendim arbitrazhi, debitori mund të kundërshtojë ekzekutimin e titullit vetëm për fakte të ngjara pas dhënies së këtyre vendimeve.

Në këto raste, gjykata shqyrton çështjen brenda 5 ditëve dhe mund të vendosë pezullimin e vendimit me ose pa garanci. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë". Ketë rast e kemi trajtuar dhe me lart, kur folëm për karakterin e vendimeve për marrjen e masave të sigurimit të padisë.

Se dyti, rasti i parashikuar nga neni 611/1 i Kodit të Procedurës Civile, ku thuhet: "**Ankimi kundër veprimeve ose refuzimit të përmbaruesit gjyqësor nuk pezullon ekzekutimin, përveç kur gjykata vendos ndryshe.**". Interpretimi i dispozitës, të le të kuptosh se ai që Ben ankim kundër veprimeve përmbarimore, mund të kërkojë në të njëjtën kohë edhe pezullimin e

111

ekzekutimit, gjë e cila mund të vendoset nga gjykata, nëse shihet me vend. Kushtet e pezullimit në këtë rast mendojmë se janë të njëjta me atë të pezullimit kur kërkohet pavlefshmëria e titullit ekzekutiv.

Se treti, rasti i parashikuar nga neni 612/2 i Kodit të Procedurës Civile, ku thuhet: "**Çdo person i tretë që pretendon se është pronar i sendit mbi të cilin bëhet ekzekutimi, mund të ngrejë padi për të ushtruar të drejtën e tij dhe kur është rasti për të përjashtuar sendin nga sekuestrimi dhe shitja.**

Padia ngrihet kundër kreditorit dhe debitorit në gjykatën e vendit të ekzekutimit të vendimit. Në këto raste, gjykata mund të vendosë si masë të përkohshme pezullimin e ekzekutimit me ose pa garanci.". Edhe në këtë rast, pezullimi i ekzekutimit të titullit ekzekutiv ka karakterin e një mase të përkohshme, me karakter të ngutshëm, në kushte të njëjta me dy rastet e lartpërmendura, pra, kur nga ekzekutimi i titullit ekzekutiv debitorit apo personit të tretë mund t'i vijë dëme të rënda e të pariparueshme.

Tri rastet e lartpërmendura, respektivisht, pavlefshmëria e titullit ekzekutiv, kundërshtimi i veprimeve përmbarimore dhe padia për kërkimin e sendit nga personi i trete, janë njëkohësisht edhe mjetet e mbrojtjes kundër ekzekutimit të detyrueshëm (pra, jo thjesht kundër ekzekutimit të vendimeve, të cilat nuk janë të vetmet tituj ekzekutive), të cilat do t'i trajtojmë me poshtë.

Se katërtri, rasti i parashikuar nga neni 469 i Kodit të Procedurës Civile, ku thuhet:

"Kur priset vendimi i shkallës së parë dhe çështja dërgohet për rigjykim, pezullohet ekzekutimi i vendimit.

Gjykata e apelit me kërkesën e palës mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit edhe kur ajo le në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, kur kundër vendimit të saj bëhet rekurs në Gjykatën e Lartë dhe nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit mund të vijnë pasoja të rënda ose të pariparueshme, si dhe kur pala që ka bërë rekursin jep garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit."

Në interpretim të kësaj dispozite, kuptohet se gjykata e apelit nuk e vendos pezullimin njëkohësisht me vendimin përfundimtar që lë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, por në një seancë të veçantë, të jashtëzakonshme, pasi është kusht që ndaj vendimit të apelit të jetë

112

ushtruar rekurs. Pala e interesuar, me të bërë rekursin, mund të parashtrojë para gjykatës së apelit që ka dhënë vendimin, kërkesën për pezullimin e tij. Edhe në këtë rast, siç e kemi trajtuar dhe me lart, rrethanat, kushtet dhe kriteret e pezullimit janë klasike: kur nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit mund të vijnë pasoja të rënda e të pariparueshme. Natyrisht që barrën e për të argumentuar dhe provuar këto rrethana e ka kërkuesi i pezullimit.

Shtrohet çështja nëse, veç "pasojava të rënda dhe të pariparueshme", kërkohet edhe dhënia e garancisë materiale nga ai që kërkon pezullimin apo mjafton njëra nga këto. Praktika gjyqësore, e pakonsoliduar dhe jo e unifikuar në këtë drejtim, ka pranuar që nuk ka konkurrim ndërmjet këtyre dy kushteve, pra, "pasojava të rënda e të pariparueshme" dhe "garancisë materiale", por mjafton ekzistenca e njërit. Mendojmë se pezullimi i ekzekutimit, si pjese e rivendosjes së plote dhe konkrete të drejtës së shkelur, duke qene një faze mjaft e rëndësishme, kërkon që të interpretohet se kërkon plotësimin e dy kushteve njëkohësisht. Pra, në këtë rast, ndonëse masa e kërkuar, për nga natyra e saj, në thelb, ka natyrën e masës për sigurimin e padisë, pavarësisht se nuk ndjek qëllim të njëjtë me të, situata nuk është identike me atë të sigurimit të padisë. Në këtë rast të fundit, ekzistenca e provave me shkresë nuk konkurren me dhënien e garancisë: kërkesa për vendosjen e masës për sigurimin e padisë mund të pranohet edhe pa dhënien e garancisë.

Por, tashmë, nuk jemi në kushtet që sapo është paraqitur padia dhe ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit mund të bëhet i vështirë ose i pamundur. Tashmë vendimi gjyqësor për të drejtat e paditësit ka marrë formë të prerë, por kërkohet pezullimi i tij, me shpresën se, pas shqyrtimit të rekursit nga Gjykata e Lartë, vendimi i apelit mund të priset ose ndryshohet. Duke qenë se Gjykata e Lartë është juridiksion i ligjit dhe jo i fakteve, si dhe referuar kohës së gjatë që kërkon shqyrtimi i çështjes në këtë gjykatë, pezullimi i ekzekutimit të vendimit, duke qenë se ka pak gjasa që ky të cenohet, përbën një kufizim shumë të rëndë që i bëhet paditësit Ky kufizim mund t'i sjellë atij dëme të mëdha, ndaj në çdo rast pezullimi duhet të vendoset në mënyrë përjashtimore, për rrethana vërtetë të jashtëzakonshme dhe pala që ka bërë rekursin dhe kërkon pezullimin duhet të japë garanci materiale për ekzekutimin e vendimit, pasi Gjykata e Lartë të mos e ketë cenuar vendimin e gjykatës së apelit.

Së pesti, paraqitet e njëjta situatë, kur pala që ka bërë rekursin, nuk e bën kërkesën për pezullimin e vendimit në gjykatën e apelit, por në Gjykatën e Lartë. Kështu në nenin 479 të K.Pr.C, parashikohet se:

113

"Gjykata e Lartë pezullon ekzekutimin e vendimit kur:

- a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme;**
- b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit."**

Se fundi, pezullimi vendoset edhe në rastin e parashikuar nga neni 500 i Kodit të Procedurës Civile, ku thuhet: **"Paraqitja e kërkesës për rishikim nuk pezullon ekzekutimin e vendimit. Por gjykata, me kërkesën e palës, mund të pezullojë ekzekutimin e vendimit, kur vlerëson se ka rrezik që mund të shkaktohet një dëm i madh e i pariparueshëm."**

Po t'i referohemi nenit 497 Kodit të Procedurës Civile, kërkesa për rishikim paraqitet para Gjykatës së Larte, e cila kur e pranon, referuar nenit 498/2 të Kodit të Procedurës Civile, vendos prishjen e vendimit tërësisht ose pjesërisht dhe e dërgon çështjen për rigjykim. Atëherë shtrohet çështja se cila gjykatë pezullon ekzekutimin e vendimit, Gjykata e Larte apo gjykata se çiles i dërgohet çështja për rigjykim. Neni 500 nuk e kushtëzon këtë fakt e, për rrjedhojë, jemi të mendimit që një gjë të tillë mund ta vendose qofte Gjykata e Larte nëse ka kërkesë, qofte gjykata se çiles i është dërguar çështja për rigjykim.

Nga ana tjetër, vërehet mungesa e koherencës në këtë dispozite, krahasuar me nenet 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile, të cilat paraqesin situata pothuaj të njëjta, në këndvështrimin e fazës së ekzekutimit. Kështu, në rastin e pezullimit të ekzekutimit, si rezultat i kërkesës që shoqëron kërkesën për rishikim, pezullimi i ekzekutimit lidhet vetëm me "rrezikun e shkakut të një dëmi të madh e të pariparueshëm", pa u përmendur fare kërkesa për dhënien e një garancie materiale. Megjithatë gjykata nuk mund të thuhet se ka pengesë për të kërkuar këtë të fundit edhe në këtë rast.

4.2 Mjetet e mbrojtjes ndaj ekzekutimit të detyrueshëm.

Mjetet e mbrojtjes ndaj ekzekutimit të detyrueshëm janë padia e deklarimit të pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv, ankimi/kundërshtimi ndaj veprimeve të përmbaruesit gjyqësor dhe padia për kërkimin e sendit nga personi i trete.

114

Se pari, lidhur me padinë për deklarimin të pavlefshëm të titullit ekzekutiv, neni 609 i Kodit të Procedurës Civile, ndër të tjera, parashikon se:

"Debitori mund të kërkojë në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit, që të deklarohet se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm ose se detyrimi nuk ekziston, ose ekziston në një masë më të vogël ose është shuar më pas.

Kur titulli ekzekutiv është një vendim gjyqësor ose vendim arbitrazhi, debitori mund të kundërshtojë ekzekutimin e titullit vetëm për fakte të ngjara pas dhënies së këtyre vendimeve."

Kategorizimi në një nga rastet që përmend dispozita është çështje fakti, që përcaktohet rast pas rasti. Kështu, p.sh., titulli ekzekutiv mund të jetë i pavlefshëm, për shkak se i mungojnë elementët e formës; detyrimi mund të jetë shuar për shkak se debitori e ka shlyer plotësisht ose pjesërisht atë sipas përcaktimit në diapozitivin e vendimit gjyqësor titull ekzekutiv; nuk ekziston atëherë kur debitori për një detyrim, lindja dhe shuarja e të cilit provohet me shkresë, e paraqet këtë të fundit në fazën e ekzekutimit, ndërkohe që në kushtet e mungesës së saj është detyruar me vendim gjykate për një gjë të tillë etj.

Në rastin kur titulli ekzekutiv është vendim gjyqësor, faktet që përbejnë bazën e kërimit të pavlefshmërisë së tij si titull ekzekutiv, duhet të kenë ndodhur pas dhënies së vendimit. Nëse kane ndodhur me pare, atëherë jemi para situatës ligjore ku mund të kërkohe rishikimi i vendimit. Lidhur me pavlefshmërinë e vendimeve gjyqësore, relevant është dhe parashikimi i nenit 123 të Kodit të Procedurës Civile, ku thuhet:

"Pavlefshmëria e vendimeve të gjykatës që mund të shqyrtohen në gjykatën e apelit ose për të cilat mund të behet kërkesë në Gjykatën e Larte, vlerësohet brenda kufijve dhe rregullave të caktuara për këto mjete të kundërshtimit."

Kjo dispozite gjendet e parashikuar në kreun II, "Pavlefshmëria e akteve", ku në nenin 119, në

të cilin jepet dhe kuptimi i përgjithshëm i pavlefshmërisë së aktit, rezultojnë se kjo e fundit i referohet kryesisht formës. Në këtë kuptim vendimi gjyqësor si titull ekzekutiv do të deklarohet i pavlefshëm nëse, p.sh., i mungon nënshkrimi i gjyqtarit. Behët fjalë kur vendimi ka marrë

115

forme të prera, pa mundur të konstatohet një gjë e tillë në gjykatën e apelit, në kuptim të nenit 467/b të Kodit të Procedurës Civile.

Një rast tjetër që është hasur në praktikë është ai i vendimeve gjyqësore të dhëna mbi padi rivendikimi, pra, padi për kërkimin e kthimit të sendit, p.sh., tokë etj, dhe ka mbetur pa u ekzekutuar. Në kohën kur kreditori kërkon ekzekutimin e këtij titulli ekzekutiv, brenda afatit të parashkrimit, rezultojnë që toka i ka kaluar në pronësi një personi tjetër, si rezultat i procesit të legalizimit. Ky është një rast klasik i një fakti të ngjarë pas dhënies së vendimit gjyqësor-titull ekzekutiv, pasi ligji për legalizimin e ndërtesave informate ka hyrë në fuqi në një datë të mëvonshme nga ajo kur vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë. Mbi këtë bazë, pronari i ri, i cili rezultojnë të jetë debitor në vendimin gjyqësor, mund të kërkojë që ky i fundit të deklarohet i pavlefshëm.

Një problem që ka dalë në praktikën gjyqësore është edhe ai që ka të bëjë me pretendimin e organeve administrative, vendimet e të cilave sipas ligjeve të veçanta përbejnë tituj ekzekutive. Këto organe kur kërkohet pavlefshmëria e këtyre titujve ekzekutive, siç është rasti i aktit të njoftimit të borxhit doganor, kërkojnë që çështja të nxirret jashtë juridiksionit, me arsyetimin se nuk është ezauruar rruga administrative. Çështjet kanë shkuar në Gjykatë Lartë, e cila ka qartësuar se këto janë konflikte civile për të cilat ka juridiksion të plote gjyqësor.

Së dyti, kundërshtimi i veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, është një mjet tjetër i mbrojtjes ndaj ekzekutimit të detyrueshëm, i cili parashikohet në nenin 610 të K.Pr.Civile, ku, ndër të tjera, thuhet:

“Kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor dhe kundër refuzimit të tij për të kryer një veprim, palët mund të bëjnë ankim në gjykatën që ekzekuton vendimin brenda 5 ditëve nga dita e kryerjes së veprimit apo refuzimit, kur palët kanë qenë të pranishme në kryerjen e veprimit ose kanë qenë thirrur edhe në raste të tjera nga dita që i është njoftuar ose ka marrë dënimin për veprimin ose refuzimin.

Ankimi shqyrtohet brenda 20 ditëve nga gjykata e vendit të ekzekutimit, e cila kur e sheh të nevojshme mund të thërrasë edhe palët.

Përmbaruesi gjyqësor thirret nga gjykata në cilësinë e palës së paditur.”.

116

Në praktikën gjyqësore janë shfaqur paqartësi në kuptimin e kësaj dispozite, sa i takon mënyrës së ngritjes së çështjes: si ankesë/kërkesë apo padi themeli me palë kundërshtare. Në paragrafin e fundit të kësaj dispozite thuhet se gjykata e thërret përmbaruesin gjyqësor si palë e paditur. Këtu mund të ketë një problem të teknikës legjislative, pasi referuar parimeve të së drejtës procedurale civile, të shprehur edhe në nenin 193 të K.Pr.C, gjykata mund të thërrasë persona të tretë në një gjykim dhe jo paditës ose të paditur. Është personi i tretë që, pasi është paraqitur në gjykim dhe ka kuptuar ka natyrën e mosmarrëveshjes, mund të bashkohet me paditësin, me të paditurin ose të bëjë ndërhyrje kryesore, pra, padi më vete, duke gëzuar të gjitha të drejtat që gëzojnë edhe palët e tjera të gjetura në këtë gjykim.

Megjithatë, e rëndësishme është të kuptohet se ligjvënësi ka patur për qëllim që në këtë rast çështja të ndërtohet mbi bazën e një padie themeli me palë kundërshtare, ku është paditësi, ai që kundërshton veprimet e përmbaruesit gjyqësor ai që thërret si të paditur këtë të fundit. Pra, nëse në padinë për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, përmbaruesi gjyqësor mund të thirret në cilësinë e personit të tretë, kur objekt gjykimi janë pikërisht veprimet e tij, atëherë ai thirret si i

paditur.

Vlen të theksohet se këtë çështje e ka trajtuar edhe Gjykata e Larte në vendimin unifikues të saj nr. 13, date 24/03/2004. Në këtë vendim, veç detyrimit të njoftimit të avokaturës së shtetit për të marrë pjesë në të tilla gjykime, Gjykata e Larte vë theksin tek rëndësia që ka verifikimi i nevojshmerise se thirrjes së palëve. Në këtë mënyre Gjykata e Larte, pa mohuar diskrecionin ligjor të gjykatës, duke unifikuar praktikën gjyqësore në këtë drejtim, të lehtë kuptosh, siç citon edhe pakica në këtë vendim, se xhixha e palëve është rregulli dhe e kundërta përjashtimi. Thelbi i ankimeve ndaj veprimeve përmbarimore në mënyrë shumtën e rasteve, siç rezultojnë dhe nga praktika gjyqësore, ka të bëjë me rastet kur përmbaruesi gjyqësor kryen me shume ose me pak nga çka përmbaruesi titull ekzekutiv, si dhe, veçanërisht, refuzon urdhrin e ekzekutimit për arsye të ndryshme.

Se treti, mjeti tjetër i mbrojtjes ndaj ekzekutimit të detyrueshëm është padia për kërkimin e sendit nga personi i trete, parashikuar në nenin 612 të K.Pr.Civile, ku thuhet se:

117

“Çdo person i tretë që pretendon se është pronar i sendit mbi të cilin bëhet ekzekutimi, mund të ngrejë padi për të ushtruar të drejtën e tij dhe kur është rasti për të përjashtuar sendin nga sekuestrimi dhe shitja.

Padia ngrihet kundër kreditorit dhe debitorit në gjykatën e vendit të ekzekutimit të vendimit. Në këto raste, gjykata mund të vendosë si masë të përkohshme pezullimin e ekzekutimit me ose pa garanci.”

Kjo padi, që në thelbin e saj përbën një padi rivendikimi, haset me rralle në praktikën gjyqësore. Në këtë rast ndërgjyqësia është e përcaktuar dhe nëse padia vjen me një ndërgjyqësi jo të formuar drejt i takon gjykatës ta bëjë një gjë të tillë, qoftë edhe kryesisht. Duke qenë një padi rivendikimi, për rrjedhojë, në gjykimin e saj ndiqen të njëjtat rregulla lidhur me të provuarit dhe themelin e çështjes. Ajo që duhet kuptuar është se kjo padi ngrihet atëherë kur ekzekutimi mbi sendin e paluajtshëm pritet të fillojë ose sapo ka filluar, pasi në të kundërt mund të ngrihet padia sipas nenit 580 të K.Pr.C.

Këtu është me vend të thuhet se kreditori legjitimohet të kundërshtojë në gjykatë të gjitha ato veprime juridike të kryera prej debitorit, që kanë patur për qëllim pakësimin e sasisë ose vleftës së pasurisë së tij në dëm të kreditorit, gjë të cilën mund ta ketë bërë para se përmbaruesi gjyqësor të ketë vënë sekuestrim mbi sendin e tjetërsuar. Kjo është e ashtuquajtura padia pauliane, që parashikohet në nenin 607 të Kodit Civil.

118

V. Hapja e dosjes (përshkrimi i etapave dhe dokumentacionit të nevojshëm që duhet të përmbajë kjo e fundit, duke referuar templatet e listuar në aneksin 2)

Gjate ushtrimit të aktivitetit për ekzekutimin e titujve ekzekutiv Përmbaruesit Gjyqësor Privat si dhe Shoqëritë Përmbarimore Private kane detyrimin ligjor të mbajtjes në mënyrë të rregullt të dokumentacionit për çdo dosje përmbarimore.

Për këtë është e nevojshme që i gjithë shërbimi përmbarimor privat të ketë në praktike procedure të njëjta për përmbajtjen e dosjes së çështjes përmbarimore

Dosja përmbarimore mund të jete me kapak kartoni ose plastike sipas dëshirës ose vete iniciativës që kane përmbaruesit gjyqësor privat.

Dosja përmbarimore në kapakun e saj do të përmbajë :

“DHOMA KOMBETARE E PERMBARUESVE GJYQESOR PRIVAT”

Emrin e përmbaruesit gjyqësor ose shoqërisë përmbarimore.

Logon e shoqërisë ose dhe të përmbaruesit në se ky e përdor atë.

Nr. e dosjes që i korrespondon numrit të heshtjes përmbarimore të regjistruar në

rregjisterin e titujve

Data e hapjes se dosjes që korrespondon me datën e regjistrimit të çështjes përmbartimore

Numrin e vendimit ose të titullit ekzekutiv

Datën vendimit ose të titullit ekzekutiv

Nr. e Vendimit për Lëshimin e Urdhrit të ekzekutimit

Datën e Vendimit për Lëshimin e Urdhrit të ekzekutimit

Emrin e mbiemrin e palës kreditore

Emri e Mbiemrin e palës debitorë

Objekti i ekzekutimit

Tarifën e plote të paguar

Datën e mbylljes se dosjes

Në pjesën e brendshme dosja përmbartimore duhet të përmbaje të gjithë inventarin e dokumentacionit si ajo që paraqitet nga palët në ekzekutim ashtu dhe inventarin e shkresave, vendimet dhe proces verbalet që merr përmbartuesi gjyqësor Privat.

119

Sugjerim : *Këshillojmë që inventari i veprimeve përmbartimore të behet menjëherë mbasi të jete kryer veprimi konkret.*

Ne momentin mbas kryerjes se ekzekutimit përmbartuesi gjyqësor privat Ben përmbjlljen e dosjes dhe e kalon dosjen përmbartimore në arkivin e vet personale.

Një moment i rëndesishem është dhe krijimi i arkivues se shkruar dhe në të ardhmen do të krijohet dhe arkiva elektronike e veprimtarisë përmbartimore që do të kryej përmbartuesi gjyqësor privat ose shoqëria përmbartimore private.

Arkiva personale (shkresore) do të jete e mirmbajtur mire dhe e sigurte si dhe duhet të jete në ambient me vete.

Vënia në shërbim të klientit

Shërbimi Përmbartimor gjyqësor vihet në shërbim të palës kreditore menjëherë, por është e nevojshme që nga ana e palës kreditore të plotësohen kërkesat e përcaktuara nga ligji.

Kërkuesi i shërbimit (kreditori) duhet të paraqes përmbartuesit gjyqësor në përputhje me nenin 515 të K.Pr.Civile këto dokumenta :

- Titullin ekzekutiv (vendim gjykate ose akt tjetër i barazuar nga ligji si titull ekzekutiv)
- Vendimin e Lëshimit të Urdhrit të ekzekutimit në forme origjinale
- Kërkesën drejtuar përmbartuesit ose shoqërisë përmbartimore për vënien në ekzekutim të titullit
- Tarifën për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv.
- Ne rast se pala kreditore përfaqësohet nga person tjetër aktin e përfaqësimit.

Ne rast se objekti i ekzekutimit është vendimi për sigurimin e padisë duhet të behet kujdes pasi këta vendime vihen në ekzekutim pa vendim lëshim urdhri ekzekutimi

Ne përputhje me nenin 40 të ligjit nr.10031 date 11.12.2008 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat” përmbartuesi gjyqësor dhe pala kreditore ose kërkuese e shërbimit lidhin

120

ndërmjet tyre kontratën e shërbimit. Modeli i kësaj kontrate është miratuar nga Ministri i Drejtësisë.

Nga ana e përmbartuesit gjyqësor mbasi është paraqitur dokumentacioni si dhe është lidhur kontrata me palën kreditore në përputhje me nenin 516 të K.Pr.Civile është i detyruar të beje

njoftimin për regjistrimin e heshtjes përmbartimore në regjistrin qendror pranë ministrisë së Drejtësisë.

Në rast se objekti i ekzekutimit të titullit ekzekutiv është kthim shume përmbartuesi gjyqësor duhet të kontrolloje regjistrin qendror dhe në rast se ka ceshtje në proces ekzekutimi me të njëjtin debitor me të njëjtin objekt pezullon ceshtjen dhe ja kalon dosjen përmbartimore përmbartuesit që e ka regjistruar praktikën i pari.

Megjithatë duhet të behet kujdes që përmbartuesi gjyqësor që merr në ekzekutim ceshtjen duhet të ketë në konsiderate dhe palët në proces si dhe pasurit e tyre dhe për ketë mendojmë të sjellim një shembull :

Psh Nëse do të shikojmë që kemi një kompani që ka në pronësi të saj disa asete dhe këto asete i ka lënë si garanci nëpërmjet kontratave Hipotekore në tre banka të ndryshme atëherë lind pyetje kush do të jete përmbartuesi gjyqësor që do të kryej veprimet përmbartimore nëse palët kreditore paraqesin kërkesat për ekzekutim në tre përmbartues? Në ketë rast shikohet që kemi të bëjmë me një pale debitorë si dhe me objekt të njëjte ekzekutimi (kthim shume).

Nëse do të zbatonim ketë dispozite në mënyre struktë do të kishim për ekzekutim një përmbartues gjyqësor ai që ka pranuar i pari kërkesën për ekzekutim. Por nëse do të marrim për konsiderate asetet e shoqërisë debitorë shikojmë që kolaterale të ndare lejojnë që për ekzekutimin e këtyre titujve ekzekutiv të ekzekutohen nga përmbartues të ndryshëm, por me kushtin e vetëm që në konkurrim të jene vetëm kredit dhe jo detyrime të tjera private .

VI. MARRËDHËNIET E SHËRBIMIT PËRMBARTIMOR ME INSTITUCIONET E PERFESHIRA NE PROCESIN E EKZEKUTIMIT TË TITUJVE EKZEKUTIV

121

Për rritjen e efikasitetit të ekzekutimit të saktë dhe efikas të vendimeve gjyqësore, si pjese e procesit të rregullt gjyqësor, duhet që ndërmjet institucioneve shtetërore dhe jo vetëm të krijohen marrëdhënie të qëndrueshme bashkëpunimi.

Gjatë procesit ët vënies në ekzekutim të titujve të pronësisë, pjesëmarrja e institucioneve përkatëse të cilat administrojnë të dhëna mbi pasuri apo të drejta të cilat kthehen në objektet ekzekutimi për shkak të procedurave të parashikuara ane Kodin procedurës Civile, me qëllim përmbushjen e ekzekutimit të titujve, bëhet e paevitueshme.

Detyrimi i institucioneve shtetërore por jo vetëm për të dhëne informacion përmbartueseve gjyqësor, në funksion të përmbushjes se detyre të tyre për ekzekutimin e titujve ekzekutiv është parashikuar si në dispozitat e ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008 “Për përmbartimin gjyqësor privat”⁵, ashtu dhe të ligjit nr. 8730, datë 08.01.1998 “Për përmbartimin gjyqësor shtetëror”. ⁶
Marrëdhënie të Shërbimit përmbartimor me ZRPP

Përmbartuesit gjyqësor kanë të drejtë të marrin informacion nga personat fizikë dhe juridikë, privatë dhe shtetërorë, lidhur me gjendjen pasurore të debitorit.

Gjatë procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm për përmbushjen e një detyrimi në të holla, në pamundësi të realizimit të tij me mjetet monetare, përmbartuesi gjyqësor sikurse u përshkrua më sipër, fillon punën për identifikimin e pasurive të tjera të debitorit.

Me qëllim identifikimin e pasurive të paluajtshme të debitorit, përmbartuesi gjyqësor, përveç informacionit të paraqitur nga kreditori, duhet të kontrollojë saktësinë e këtij informacioni, duke kërkuar informacion nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Me paraqitjen e kërkesës për informacion mbi pasuritë e debitorit, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, përgjegjëse për administrimin dhe mbajtjen e informacionit në lidhje me regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe të drejtave reale të tjera të lidhura me të, është e detyruar që të përmbushë kërkesën për informacion dhe të përcjellë informacion e kërkuar parë

përmbarduesit gjyqësor. Afati i përcjelljes së këtij informacioni nga ZRPP referuar përcaktimeve

⁵ Neni 46 i ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008 “Për përbarimin gjyqësor privat” .

⁶ Neni 26 i ligjit nr. datë 08.01.2011 “Për përbarimin gjyqësor shtetëror” .

122

të bëra në Urdhrit nr. 561, datë 03.06.2010 të Kryeregjistruesit “Për saktësimin e afateve të trajtimit dhe përpunimit të aplikimeve”, nuk duhet ti kalojë 3 ditët.

ZRPP referuar përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar⁷, ka detyrim për dhënien e informacionit cilitdo personi të interesuar kundrejt kryerjes së pagesës përkatëse të parashikuar në VKM nr. 556/1996 “Për përcaktimin e tarifave të zyrës së regjistrimit”, i ndryshuar. Kërkesat për informacion të paraqitura nga përmbarduesit gjyqësor, kryhen në funksion të përmbushjes së një detyrimi të përcaktuar në nenin 563 të Kodit të Procedurës Civile, dhe detyrimi i ZRPP-së për përmbushjen e tyre buron nga përcaktimet e lartpërmendura ligjore. Në këto kushte këto kërkesa të përmbardueseve gjyqësor nuk mund të trajtohen si kërkesa e tjera formale të paraqitur personat juridik apo fizik, pasi kryhen në funksion të përmbushjes së një detyre funksionale të shërbimit përbarimor privat dhe për to nuk mund të aplikohet pagesa e tarifës.

Me qëllim realizimin e ekzekutimit mbi sendet e paluajtshme, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, detyrohet që brenda 10 ditëve të njoftimit të urdhrit të sekuestrimit, të kryejë pasqyrimin e regjistrimit të këtij vendimi, në seksionet përkatëse të regjistrave ku figuron e regjistruar pasuria e paluajtshme.

Aktualisht në ZRPP janë të administruara dy lloj regjistrash të pasurive të paluajtshme, të cilat pasqyrojnë të dhënat për pasuritë e paluajtshme:

□ *regjistrat e ashtuquajtuara të hipotekës*, ku figurojnë të regjistruara vetëm titujt e pronësisë në vite duke filluar që nga viti 1912;

□ *Kartelat apo regjistrat e krijuar gjatë regjistrimit fillestar*, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar.

Lëshimi i dokumenteve nga regjistri hipotekor (*vërtetim pronësie + hartë treguese*), kryhet kur pasuria e sekuestruar ndodhet në një zonë kadastrave ku nuk ka përfunduar regjistrimi fillestar, pra ku nuk janë identifikuar të gjitha pasuritë në hartën treguese të regjistrimit. Ndërsa *lëshimi i kopjeve të kartelave*, kryhet kur pasuria e sekuestruar ndodhet në zonë kadastrave ku ka përfunduar regjistrimi fillestar. Përfundimi i regjistrimit fillestar ndodh kur të gjitha pasuritë e

⁷ Neni 30 i ligjit 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

123

një zone të caktuar i janë nënshtruar procedurave të regjistrimit dhe janë identifikuar në Hartën treguese të regjistrimit, duke e lidhur vendndodhjen e këtyre pasurive me titujt e regjistruar tashme në librat e hipotekës, apo të paraqitura për herë të parë për regjistrim.

Pikërisht për të mundësuar ekzekutimin e vendimit të sekuestro nga ZRPP, duhet të identifikohen të dhënat gjeografike të pasurisë objekt sekuestrimi. Për këtë arsye dhe në parashikimet e KPrC parashikohet detyrimi i përmbarduesit gjyqësor që në aktin e sekuestrimit të përcaktojë të paktën tre kufij të sendit të paluajtshëm, vendi i ndodhjes së tij. Gjithashtu në Udhëzimin nr. 1, datë 21.01.2007 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, parashikohet që dokumentacioni i nevojshëm për regjistrimin e një vendimi gjyqësor apo akti administrativ (të cilët përbëjnë dhe llojet e titujve ekzekutivë objekte të ekzekutimit nëpërmjet të cilëve mund të shprehet dhe të përmbarduesit gjyqësor), duhet të përmbajë të dhënat e mjaftueshme për identifikimin e pasurisë objekt regjistrimi.

Pas paraqitjes së vendimit të sekuestrimit, punonjësit e ZRPP janë të detyruar që në seksionet përkatëse të regjistrave të administruara prej tyre, ku shënohen kufizimet apo ndalimet e

veprimeve mbi pasuritë, të kryejnë regjistrimin e vendimit të sekuestrimit. Sekuestrimi i pasurisë kryhet në seksionin e regjistrimit hipotekarë i cili ka shënimin “Barrë mbi pasurinë”, apo në seksionin E të kartelës së pasurisë, në të cilin shënohen hipotekat, kufizimet e pasurive, vendimet gjyqësore. Regjistrimi i kufizimit në seksionet përkatëse të regjistrave të pasurive të paluajtshme, pasjellë bllokimin e të gjitha veprimeve mbi këtë pasuri, duke ndaluar kryerjen e regjistrimit të çdo akti tjetër të paraqitur për regjistrim pas aktit të sekuestrimit.

ZRPP në cilësinë e mbajtëses dhe administratores së regjistrave të pasurive të paluajtshme kryen regjistrimin e të gjithë titujve të pronësisë në referim të përcaktimeve të bëra në nenin 193 të Kodit Civil. Në rastet kur titujt e pronësisë janë bërë objekt gjykimesh gjyqësore dhe janë kthyer në tituj ekzekutivë, ZRPP ndodhet shpesh here dhe në cilësinë e debitorit, pasi titulli ekzekutiv përmban detyrimin e saj për të kryer regjistrimin e pasurisë objekt ekzekutimi, pavarësisht nëse kjo e fundit ka qenë apo jo pjesëmarrës në cilësinë e palës së paditur në procesin gjyqësor nga i cili buron titulli ekzekutiv.

Duhet theksuar se detyrimi i ZRPP-së për të kryer regjistrimin e titujve të pronësisë buron nga përcaktimet e bëra në nenin 193 të Kodit Civil. Për rrjedhojë përfshirja e ZRPP-së (*kur kjo e fundit nuk ka qenë palë në gjykim*) në disponimet e urdhrave të vënies në ekzekutim të titujve të 124

pronësisë nuk është e domosdoshme, përse kohë që kjo zyrë me paraqitjen për regjistrim të një titulli ekzekutiv që përmban humbjen e apo fitimin e pronësisë në favor të një të treti fillon procedurat për regjistrimin e tij konform përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. Tek këto procedura përfshihet dhe kryerja nga ZRPP e verifikimit të elementeve të formës dhe përmbajtjes të akteve administrative apo vendimeve gjyqësore, sipas përcaktimeve të bëra në Udhëzimin nr.1, datë 13.07.2007 “Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”. Në mungesë të ndonjërit nga elementët e formës dhe përmbajtjes, ZRPP mund të refuzojë regjistrimin e aktit të paraqitur për regjistrim, duke shprehur qëndrimet e saj refuzues nëpërmjet të ashtuquajturit “Urdhër refuzimi”.

Gjithsesi bashkëpunimit dhe bashkëveprimit të përmbarueseve gjyqësor me zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në kuadër rritjes se performancës se ekzekutimit të titujve të pronësisë duhet të jetë i pandërprere dhe i niveleve më të larta.

Marrëdhëniet me bankat

Bankat në cilësinë e institucioneve më të mëdha kredidhënëse dhe pranuese të depozitave monetare apo fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku, luajnë një rol shumë të rëndësishëm në fushën e ekzekutimit të titujve ekzekutivë.

Në funksion të vënies në ekzekutim të titujve ekzekutiv që kanë si objekt përmbushjen e një detyrimi në të holla, bashkëpunimi i institucioneve bankare me shërbimin përmbarimor gjyqësor është jo vetëm i domosdoshëm por edhe i detyrueshëm.

Përmbaruesit gjyqësor kërkojnë nga bankat informacion mbi llogari e debitorëve nëse kanë depozita ose kredi në emër të tyre në bankën përkatëse, dhe kjo e fundit është e detyruar të informojë përmbaruesin gjyqësor në lidhje me informacionin e kërkuar. Për vijimin e procedurave të ekzekutimit, marrja e këtij informacioni nga bankat është i një rëndësie të madhe e për këtë fakt, bashkëpunimi i ngushtë reciprok është shumë i rëndësishëm pasi dhe vetë bankat janë subjekte të procedurave të ekzekutimit si kreditor apo dhe debitor.

125

Në funksion të këtij bashkëpunimi është miratuar nga Banka e Shqipërisë dhe Udhëzimi nr. 2, datë 24.09.2003 “Për mënyrën e zbatimit të ekzekutimit të detyrimeve mbi shumatat e llogarive në Banka”, në të cilin janë mirë përcaktuar procedurat që kryen banka për realizimin e dhënies

se informacionit të kërkuar ashtu sikundër janë përcaktuar dhe dokumentet apo të dhënat e nevojshme që duhet të vihen në dispozicion institucioneve bankare nga përmbaruesit gjyqësor me qëllim dhënien e informacionit dhe ekzekutimin e detyrimeve monetare.

Institucionet bankare, meqenëse janë dhe institucionet kredidhënëse me të mëdha, janë klientë potencialët të shërbimit përmbarimor gjyqësor të cilit do ti drejtohen për përmbushjen e të ashtëquajturave kredi të këqija. Mënyrat e ekzekutimit të këtyre kredive ekzekutive janë trajtuar më sipër, por ajo që është e rëndësishme të theksohet është nevoja e rritjes së efikasitetit të bashkëpunimit me të gjithë faktorët e përfshirë në procesin e ekzekutimit të kredive ekzekutive, me qëllim përshpejtimin e procedurave të përmbushjes së këtyre të fundit.

Marrëdhëniet me Policinë e Shtetit

Në funksion të ekzekutimit të titujve ekzekutive, objekti i detyrimit të të cilave ldihet me kryerjen apo moskryerjen e veprimeve të caktuara nga debitorët apo persona të tretë, lind i nevojshëm një bashkërendim i punës më policinë e shtetit dhe shërbimin përmbarimor gjyqësor. Ky bashkëpunim duhet të jetë i vazhdueshëm dhe efikas, i cili referuar dhe ndryshimeve të bëra në Kodin e Procedurës Civile (*neni 523*), është i detyrueshëm për vijimin e procedurave të ekzekutimit.

Konkretisht lind i nevojshëm bashkëpunimi me policinë e shtetit në raste kur për ekzekutimin e detyrueshëm është e nevojshme të çelet banesa ose ndonjë ndërtesë tjetër e debitorit, dhe duhet të kryhet mbështetja e përmbaruesit gjatë procedurave të ekzekutimit. Në këto raste përmbaruesi gjyqësor duhet të bëjë njoftimin përkatës pranë organeve të policisë së shtetit me qëllim që të bëhet e mundur prania e forcave të rendit në momentin e ekzekutimit të vendimit. Përmbaruesi Gjyqësor Privat duhet të kërkojë mbështetjen e forcave të policisë vetëm në ato raste kur e çmon të arsyeshme që gjatë kryerjes së procedurave të ekzekutimit të titujve ekzekutiv do të ketë pengesa apo rezistencë për kryerjen e detyres, bazuar kjo në nenin 523, të Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 31, germa c, të Ligjit nr. 10 031, datë 11.12.2008 “Për Shërbimin e Përmbarimit Gjyqësor Privat”.

126

Bashkëpunimi të detyrueshëm të midis Policisë së Shtetit dhe përmbaruesit gjyqësor, i parashikuar tashmë dhe në dispozitat e KPrC, i ka paraprirë dhe nënshkrimi i marrëveshjeve midis Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë si dhe Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve privatë, në funksion të bashkërendimit të punës për ekzekutimin e titujve ekzekutivë.

Kjo akt– marrëveshje mbi bashkëpunimin dhe bashkëveprimin e veprimtarisë së strukturave të Policisë së Shtetit dhe Shërbimit Përmbarimor privatë, ka si objekt të saj mbështetjen e Përmbaruesve Gjyqësor Privatë gjatë kryerjes së veprimeve të tyre procedurale për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, Kodit Civil, akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, me synim parandalimin e veprimeve kundërshtuese apo kriminale, mbrojtjen, ndihmën e ndërsjellë, si dhe sigurinë e personelit gjatë kryerjes së detyrave në përputhje me ligjin, duke ruajtur secila palë pavarësinë institucionale. Strukturat e Policisë së Shtetit në nivel qendror dhe vendor të bashkëpunojnë me organet drejtuese të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësor Privat dhe të gjithë Përmbaruesit Gjyqësor Privat për të siguruar ndihmën dhe mbështetjen e nevojshme gjatë dhe pas ekzekutimit të titujve ekzekutivë, me qëllim zbatimin e ligjit duke respektuar pavarësinë e tyre dhe shmangien e konflikteve civile që mund gjenerojnë ngjaje të dhunshme apo në vepra penale.

Marrëdhëniet me institucione të tjera

Shërbimi përmbarimor gjyqësor gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij për ekzekutimin e titujve ekzekutiv, në varësi të llojit të detyrimit të përcaktuar për tu përmbushur, në zbatimin të titullit

ekzekutiv, duhet të bashkëpunojë dhe me institucione të tjera shtetërore, përveç atyre të cituara më lart.

Në rastet kur për ekzekutimin titullit ekzekutiv është e nevojshme të kryhen disa veprime nga ana e debitorit si: të prishet objekti, të lirohet trualli, të pezullohen punimet, përmbaruesit gjyqësor ka të drejtë të kërkojë mbështetjen e *inspektorati ndërtimor* pranë pushtetit vendor dhe Inspektorati Kombëtar, të cilët detyrohen të mbështesin përmbaruesin gjyqësor gjatë procedurave të ekzekutimit, me objekt kryerjen e veprimeve të sipërcituara.

127

Gjithashtu në raste kur për ekzekutimin e detyrueshëm është e nevojshme të çelet banesa ose ndonjë ndërtesë tjetër e debitorit dhe në kohën e përcaktuar për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, nuk paraqitet debitori dhe pas njoftimeve të kryera nga përmbaruesi gjyqësor, ky i fundit me qëllim mospengimin e procedurave të vënies në ekzekutim duhet të njoftojë paraprakisht *organet e qeverisjes vendore* për kohën e kryerjes së ekzekutimit, me qëllim që përfaqësuesi i tyre të detyrohet të jetë i pranishëm në raste të mospranisë së debitorit.

Gjithashtu prania e përfaqësuesit të qeverisjes vendore është e domosdoshme të kërkohej dhe në raste kur kemi të bëjmë me ekzekutimin mbi sendet e luajtshme, pasi në mungesë të debitorit, apo të një personi madhor të familjes së tij, inventarizimi i sendeve të luajtshme duhet të kryhet në prani të një përfaqësuesi të njësisë së qeverisjes vendore.

Ndërsa në rastet e ekzekutimit të titujve ekzekutivë, me objekt “Takim dhe kujdestari fëmije”, përmbaruesi gjyqësor është i detyruar të kërkojë *asistencën e psikologut*, kur ky i fundit është i detyruar në bazë të ligjit për bashkëpunim .

128

ANEKS A

Formate të dokumenteve që lëshohen nga Përmbaruesi gjyqësor

Në manualin e përdorimit lidhur me procedurat përmbarimor është synuar që të jepet për orientim përmbaruesit gjyqësor templates të ndryshme të cilat do të shërbejnë për të krijuar përmbaruesit një njohuri të përgjithshme lidhur me mënyrën e komunikimit të shkresave me palët si dhe me vendimet që përmbaruesi gjyqësor i kërkohej në bazë të ligjit të marri gjatë ekzekutimit të titujve ekzekutiv.

Në njoftimin për ekzekutim vullnetar formati është ndarë në katër seksione.

Në seksionin e parë: që është dhe seksioni i cili përben kokën e shkresës është menduar që të jepet Republika e Shqipërisë , Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësor Private duke vendosur secili përmbarues identitetin e tij si dhe adresën numër kontakti telefonik si dhe emailin e përmbaruesit ose të shoqërisë përmbarimore. Këto të dhëna i bëjnë të mundur Shoqërisë përmbarimore ose përmbaruesit gjyqësor indentifikimin e tij nga palët në proces ekzekutimi si dhe në rast komunikimi japin informacionin e duhur çdo kujt që ka interes të kontaktojë me shoqerën ose përmbaruesin gjyqësor.

Në seksionin e dytë: të template është dhëne mënyra se si është venë në ekzekutim titulli ekzekutiv me kërkesë të palës kreditore është dhëne kush janë palët kreditor, debitor dhe objekti i ekzekutimit si dhe numri i dosjes dhe numri i protokollit si dhe data kur është dërguar njoftimi. Këto të dhëna përveç që janë kërkesa të ligjit janë dhe të dhëna orientuese për këdo që përfshihet në leximin e njoftimit përmbarimor .

Në seksionin e tretë : Është pjesa konstatuese ku përmbaruesi gjyqësor përshkruan titullin ekzekutiv jep të dhëna të plota për titullin ekzekutiv . Vendoset data dhe numri i titullit si dhe organi që e ka lëshuar, shkallet gjyqësore që ai ka ndjekur. Përmbaruesi vendos dhe të dhëna për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit dhe gjykatën që e ka lëshuar.Në në ketë pjesë përmbaruesi gjyqësor vendos veprimin konkret që detyrohet të kryej gjyq humbësi ose pala debitorë. Pra

është e nevojshme që dipozitivi i titullit ekzekutiv të vendoset tërësisht në mënyrë që pala debitorë ose pala që detyrohet të kryejë një veprim të caktuar të printohet për detyrimin e saj.
129

Në seksionin e Katërt: Në në këtë seksion është pjesa e cilapërcakton vendimmarrjen e përmbauesit gjyqësor i cili pasi ka konstatuar është i detyruar që në bazë të ligjit të urdhëroje ose të marri vendim për kryerjen e një veprimi të caktuar si për sekuestrimin, për shpalljen në ankand ose për pushimin , pezullimin e ekzekutimit të titullit e kështu me radhe.

Ky seksion është dhe seksioni ku templates kanë ndryshime nga njëra tjetra pasi siç thamë më sipër aty jepen nga përmbauesi gjyqësor veprimi që do të kryhet . Por le të bëjmë një shikim ku ndryshojnë duke dhe për orientim ndryshimin nga një ri në tjetrin.

Në këtë seksion njoftimi për ekzekutim vullnetar ndryshon pasi përmbauesi gjyqësor nuk vendos fjalën urdhërim por i kërkon palës debitorë të kryej në vullnetin e lire ekzekutimin e titullit në mënyrë vullnetare.

Gjithashtu në template njoftimin për ekzekutimin e detyrueshëm është i ndryshueshem nga template e tjerë pasi përmbauesi gjyqësor urdhëron palën debitorë të qëndroje në objekt pasi do të kryhet ekzekutimi i detyrueshëm, në këtë pjesë përmbauesi përcakton datën e orën sakte kur do të kryhet ekzekutimi i detyrueshëm. Gjithashtu përmbauesi gjyqësor njofton dhe institucionet si Njesinë e Qeverisjes Vendore si dhe Punonjesit e rendit duke i dhënë atyre dijeni të plotë për ditën orën si dhe për vendin e ekzekutimit.Në Në këtë rast përcaktimi i vendit të ekzekutimit ka shumë rëndësi pasi nga praktika ka rezultuar që pala debitorë ka adrese tjetër ndryshe nga ajo e vendit të ekzekutimit dhe në ndonjë rast është krijuar mos paraqitje në ekzekutim të punonjësve të rendit .

Një dallim të theksuar ka në këtë seksion rasti kur kemi të bëjmë me sekuestrimin e pasurisë së palëve debitorë.Në Në këtë seksion përmbauesi gjyqësor në këtë rast jep vendimin e sekuestrimit duke vendosur se kujt i është pala që i sekuestronhet çfarë është sekuestruar duke vendosur të dhëna të plota për sendin ose pasurinë e palujtshme të sekuestruar. Për pasurin e palujtshme është e nevojshme që përmbauesi gjyqësor të japi dhe kufijtë e pasurisë që sekuestron .

Njoftimin e palës debitorë që në rast mos sekuestrimi sendi ose pasuria e palujtshme do të shitet në ankand. Gjithashtu në këtë vendim vendoset dhe e drejta e ankimit që ka në bazë të ligjit pala debitorë ose dhe personave të tjerë.

Një dallim të dukshëm në këtë seksion ka dhe template për vendimin e Shpalljes së Ankandit.Në Në këtë seksion përmbauesi gjyqësor shpall ankandin për pasurin e palujtshme ose të luajtshme që kërkon të shpallë në ankand duke vendosur të dhëna të plota të sendit ose të pasurisë.

130

Në këtë rubrike përmbauesi gjyqësor përcakton datën, orën si dhe vendin e zhvillimit të ankandit. Gjithashtu ai përcakton çmimin me të cilën fillon ankandi duke i bërë të ditur ofertuesve që ankandi që zhvillohet është një ankand me vlere progresive dhe si i tille shpallet fitues ofertuesi që ka ofruar çmimin me të lartë.Në në rastin e ankandit të p[asurisë se paluajtshme përmbauesi gjyqësor në këtë rubrike përcakton dhe kushtet për pjesëmarrje në ankand duke i bërë të ditur çdo ofertuesi që si kusht për pjesëmarrje është derdhja e garancisë prej 10 % të çmimit fillestar.

Ky seksion ndryshon dhe për pjesë të tjera që përmbauesi gjyqësor merr vendimet e tij.Në Në këtë seksion është e këshillueshme që përmbauesi gjyqësor të japi në mënyrë të rregullt dhe konkrete të gjithë informacionin e nevojshme si për palët në proces ekzekutimi ashtu dhe për çdo person tjetër që kërkon të informohet për veprimin përmbauesit.

Në fund të çdo tempates është përcaktuar dhe vendosja e emrit dhe mbiemrit të përmbauesit që kryen veprimin përmbauesit si dhe të vulës që subjekti përmbauesit ka si shoqëri

përmbartimore ose si person fizik.

131

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

(Emri i Shoqërisë ose përmbartuesit gjyqësor privat)

Adresa: “ Adresa e përmbartuesit ose shoqërisë përmbartimore” Nr.tel

Nr. _____ Regj. _____, më ___/___/ 2011

LAJMËRIM PËR EKZEKUTIM VULLNETAR

Drejtuar : (emri i subjektit debitor)

Adresa : (adresa e plotë e palës debitorë që doni të njoftoni)

Pranë zyrës së Përmbartimit Gjyqësor Privat të (emri i shoqërisë ose emri i përmbartuesit gjyqësor) me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përmbartimore me numër _____ regj dhe me palë :

Kreditor :

Debitor :

Me objekt :

KONSTATOVA:

Në titullin ekzekutiv (vendim i Gjykatës së rrethit gjyqësor _____ ose titulli ekzekutiv) me nr. (vendimi ose titulli) datë (data e vendimit ose e titullit ekzekutiv) është vendosur detyrimi i juaj _____ (Shënohet pjesa detyruese ose kryerja e një veprimi të caktuar).

Për titullin ekzekutiv është lëshuar nga Gj.Rr.Gj. _____ është lëshuar vendimi i Urdhrit të ekzekutimit nr. (vendimi) datë (data e vendimit të urdhrit ekzekutimit).

Në zbatim të ligjit është e detyrueshme njoftimi i juaj si palë debitorë për ekzekutimin e titullit në mënyrë vullnetare dhe në rast se ekzekutimi nuk kryet, në jemi të detyruar që ekzekutimin ta kryejmë në mënyrë të detyrueshme.

Për këtë arsye

Në bazë të neneve 517, 518, 525, të K.Pr.Civile

K E R K O J M E :

132

Kryerjen e ekzekutimit të titullit ekzekutiv në mënyrë vullnetare **brenda (5) ose (10) ditësh, duke filluar ky afat nga dita e marrjes dijeni.**

Ju detyroheni të paguani shumën tarifë e shërbimit përmbartimor në masën (shumën e parapaguar deri në atë moment nga pala kreditore).

Derdhja e shumës ose e shumave do të kryhet në llogarinë e përmbartuesit gjyqësor ose të shoqërisë përmbartimore me nr.llogarie _____ pranë Bankes _____.

Mbas kalimit të këtij afati, jemi të detyruar të kalojmë ekzekutimin e titullit në ekzekutim në mënyrë të detyrueshme. Në rast se ekzekutimi kalon në ekzekutim të detyrueshëm në ngarkimin tuaj do të jenë të gjitha shpenzimet si dhe tarifë e plotë e shërbimit.

PËRMBARUESI GJYQËSOR

(Emri i përmbartuesit që kryen veprimin)

V U L A

(vula e shoqërisë ose përmbartuesit)

133

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

(Emri i Shoqërisë ose përmbartuesit gjyqësor privat)

Adresa: “ Adresa e përmbartuesit ose shoqërisë përmbartimore” Nr.tel

Nr. _____ Regj. _____ .më ___/___/ 2011

VENDIM Nr.

**“PËR KALIMIN MENJËHERË NË EKZEKUTIM TË
DETYRUESHËM”**

Pranë zyrës se Përmbartimit Gjyqësor Privat të (emri i shoqërisë ose emri i përmbartuesit gjyqësor) me kërkesë të palës kreditore në datë _____ regjistruar çështja përmbartimore me numër _____ regj dhe me palë :

Kreditor :

Debitor :

Me objekt :

Unë përmbartuesi gjyqësor privatpasi shqyrtova materjalin e dosjes përmbartimore :

KONSTATOJ

Në titullin ekzekutiv (vendim i Gjykatës së rrethit gjyqësor _____ ose titulli ekzekutiv) me nr. (vendimi ose titulli) datë (data e vendimit ose e titullit ekzekutiv) është vendosur detyrimi i juaj _____ (Shënohet pjesa detyruese ose kryerja e një veprimi të caktuar). Për titullin ekzekutiv nga Gj.Rr.Gj. _____ është lëshuar vendimi i Urdhrit të ekzekutimit nr. (vendimi) datë (data e vendimit të urdhrimit ekzekutimit).

Nga informacioni grumbulluar kryesisht nga deklaratimet e dhëna me shkrim nga pala kreditore, e cila pretendon se **nga ana e debitorit gjatë afatit për ekzekutim vullnetar mund të kryhen veprime në lidhje me për tjetërsimin e objektit të ekzekutimit.**

134

Në këto kushte gjykoj se mosveprimi në kohë do të bënte të pamundur ekzekutimin e titullit ekzekutiv, si rrjedhojë për të garantuar ekzekutimin është e nevojshme fillimi i ekzekutimit të titullit ekzekutiv në mënyrë të detyrueshme.

Për këto arsye

si dhe në bazë të neneve 518 e 519 të K.Pr.Civile

V E N D O S A

Fillimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv Vendim i Gj.Rr. _____ (ose lloji i titullit ekzekutiv) Nr. _____ datë _____ në ekzekutim të detyrueshëm.

Ekzekutimi i detyrueshëm fillon me (përshkrim të veprimit të ekzekutimit të detyrueshëm)

Një kopje e këtij vendimi së bashku me urdhrin për vendosjen e sequestro ose kufizimit të veprimit _____ (plotësohet lloji i veprimit konkret) i dërgohet për veprim Bankave të Nivelit të Dytë ose Z.V.Rr.P.Paluajtshme, ose D.R.Sh.T.Rrugor (institucionit ku do të kryhet veprimi konkret).

Kundra këtij vendimi në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile palët e interesuara kanë të drejtë që brenda 5 ditëve nga marrja në djeni të paraqesin ankim në gjykatën e shkallës së parë.

PËRMBARUESI GJYQËSOR

(Emri i përmbartuesit që kryen veprimin)

V U L A

(vula e shoqërisë ose përmbartuesit)

135

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

(Emri i Shoqërisë ose përmbartuesit gjyqësor privat)

Adresa: “ Adresa e përmbartuesit ose shoqërisë përmbartimore” Nr.tel

Nr. _____ Regj. _____ .më ___/___/ 2011

U R D H Ë R

“PËR VËNIEN E SEKUESTROS NE LLOGARIN E PALES DEBITORE”

Drejtuar: _____

Adresa : _____

Pranë zyrës se Përmbartimit Gjyqësor Privat të (emri i shoqërisë ose emri i përmbartuesit gjyqësor privat) me kërkesë të palës kreditore në datë _____ regjistruar çështja përmbartimore me numër _____ regj dhe me palë :

Kreditor :

Debitor :

Me objekt :

KONSTATOJ

Në titullin ekzekutiv (vendim i Gjykatës se rrethit gjyqësor _____ ose titulli ekzekutiv) me nr. (vendimi ose titulli) datë (data e vendimit ose e titullit ekzekutiv) është vendosur detyrimi _____ (Shënohet pjesa detyruese). Për titullin ekzekutiv nga Gj.Rr.Gj. _____ është lëshuar vendimi i Urdhrit të ekzekutimit nr. _____ (vendimi) date _____ (data e vendimit të urdhrit ekzekutimit).

Nga ana e jone është njoftuar pala debitorë për kryerjen e ekzekutimit të titullit në mënyrë vullnetare por ajo nuk ka vepruar për kryerjen e ekzekutimit dhe për rjedhoje mbeshtetur në ligj ekzekutimi I titullit ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm . Për rjedhoje duhet të vendoset masa 136

e sekuestro mbi llogarin e palës debitorë (ose të palës se trete) në masën e detyrimit prej _____ lekë.

Për këtë arsye :

Në **bazë** të neneve 527, 593 e në vijues të K.Pr.Civile

U R D H Ë R O J M Ë

Vendosjen e masës së sekuestro në llogarinë e palës debitorë apo personit të tretë (vendos emrin e debitorit ose palës tretë) në shumën e detyrimit prej _____ lekë objekt detyrimi, plus tarifen e shërbimit përmbartimor në masën _____ leke (tarifa e plote). Shuma e sekuestruara do të kalohen në llogarin e përmbartuesit gjyqësor ose në llogarin e palës kreditore me një urdherese të dyte nga ana e jone. Për veprimin apo mosveprimin tuaj,duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri do të merren të gjitha masat e parashikuara në neni 598 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vend do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.

Ky urdhër mbahet e ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marrja djeni.

PËRMBARUESI GJYQËSOR

(Emri i përmbartuesit që kryen veprimin)

V U L A

(vula e shoqërisë ose e përmbartuesit)

137

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

(Emri i Shoqërisë ose përmbartuesit gjyqësor privat)

Adresa: “ Adresa e përmbartuesit ose shoqërisë përmbartimore” Nr.tel

Nr. _____ Regj. _____ .më ___/___/ 2011

K O M U N I K I M

“EKZEKUTIMI TE DETYRUSHEM”

Drejtuar: _____ (Emri i debitorit ose personit të trete)

Adresa : _____ (adresa e plotë e debitorë ose personit të trete).

Pranë zyrës së Shoqërisë Përmbaremore Gjyqësore Private (emri i shoqërisë ose emri i përmbareuesit gjyqësor) me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përmbaremore me numër _____ regj dhe me palë :

Kreditor :

Debitor :

Me objekt :

K O N S T A T O V A

Në titullin ekzekutiv (vendim i Gjykatës së rrethit gjyqësor _____ ose titulli ekzekutiv) me nr. (vendimi ose titulli) datë (data e vendimit ose e titullit ekzekutiv) është vendosur detyrimi i juaj të _____ (Shënohet pjesa detyruese).

Për titullin ekzekutiv nga Gj.Rr.Gj. _____ është lëshuar vendimi i Urdhrit të ekzekutimit nr. _____ (vendimi) date _____ (data e vendimit të urdhrit ekzekutimit).

Në datë ___/___/2010 jeni njoftuar për kryerjen e ekzekutimit në mënyrë vullnetare, por nga ana e juaj nuk është vepruar për ekzekutimin e titullit dhe për rjedhoje ekzekutimi I titullit në bazë dhe nenit 519 të K.Pr.Civile ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm.

Për këto arsye

Në në bazë të nenit, 519, 523, 540, 602 të K.Pr.Civile,
138

U R D H E R O J M E

Rastet e zgjidhjes së kontratës

1. Kontrata quhet e zgjidhur kur:

- a) Vërtetohet shfuqizimi i titullit ekzekutiv;
- b) Përmbaruesi Gjyqësor Privat e ka të pamundur të kryejë detyrën, për arsye shëndetësore për një periudhë të gjatë kohe;
- c) Përmbaruesi Gjyqësor Privat për arsye studimore, e ka të pamundur të kryejë detyrën e tij, për një periudhë të gjatë kohe;
- ç) Përmbaruesit Gjyqësor Privat i hiqet ose pezullohet çertifikata e ushtrimit të profesionit, me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë;
- d) Palet kontraktuese me vullnet të lirë deklarojnë zgjidhjen e kësaj kontrate.

2. Në rastin e zgjidhjes së kontratës sipas pikës 1 të këtij neni, Shoqëria Përmbarimore/Përmbaruesi Gjyqësor Privat i kthen kreditorit dosjen e plotë përmbarimore si dhe pagesat e shërbimit, duke zbritur shpenzimet e kryera deri në atë çast.

Neni 13

Zgjidhja e kontratës për shkak të falimentimit

- 1. Në rast të falimentimit të Shoqërisë Përmbarimore/Përmbaruesit Gjyqësor Privat, ky është i detyruar që të njoftojë me shkrim palën kreditore, për zgjidhjen e kontratës dhe e fton atë të tërheqë dosjen e plotë përmbarimore.
- 2. Në rastin e zgjidhjes së kontratës për shkak të falimentimit, kreditori ka të drejtën e marrjes së pagesave të shërbimit, me përjashtim të shpenzimeve të kryera deri në atë çast, sipas legjislacionit në fuqi për procedurat e falimentimit.

Neni 14

Mosparaqitja e palës kreditore

Në rast se pala kreditore nuk paraqitet pranë Shoqërisë Përmbarimore/ Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pas kalimit të afati 10 ditor, për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm, ose nuk paraqitet kur është thirrur me shkrim, atëherë Shoqëria Përmbarimore/ Përmbaruesi Gjyqësor Privat, ka të drejtë të pezullojë ekzekutimin.

Neni 15

Njoftimi midis palëve

174

- 1. Çdo njoftim i bërë mes palëve sipas kontratës, duhet të bëhet me shkrim në adresën e mëposhtme:

a) Kreditori

Adresa: _____

Tel: _____

Përfaqësuar nga z. _____

b) Shoqëria Përmbarimore/ Përmbaruesi Gjyqësor Privat

Adresa: _____

Tel: _____

Përfaqësuar nga z. _____

2. Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 16

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë realizimit të kësaj kontrate, palët janë të detyruara ta zgjidhin me marrëveshje.
2. Nëse nuk arrihet marrëveshja, palët mund t'i drejtohen gjykatës së shkallës së parë të rrethit gjyqësor ku Shoqëria Përmbartimore/ Përmbartuesi Gjyqësor Privat ka selinë.

Neni 17

Dokumentacioni bashkëlidhur kontratës

Kësaj kontrate, si pjesë përbërëse e saj, i bashkëlidhen dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesa e palës që kërkon vënien në ekzekutim;
175
2. Titulli ekzekutiv nr. _____ datë _____ (origjinal ose i noterizuar);
3. Urdhëri i ekzekutimit nr. _____ datë _____ (origjinal);
4. Mandat pagesën e tarifës;
5. Sipas rastit, prokurën e personit, që përfaqëson kreditorin.

Neni 18

Parashikime të fundit

1. Kontrata hartohet në 2 (dy) kopje, me të njëjtën vlerë ligjore, ku njëra mbahet nga Shoqëria Përmbartimore/ Përmbartuesi Gjyqësor Privat dhe tjetra mbahet nga kreditori. Kopjes origjinale të kontratës që mban kreditori, i bashkëlidhet fotokopja e akteve të parashikuara në nenin 17 të kësaj kontrate.
2. Kontrata nënshkruhet në çdo fletë, nga të dyja palët kontraktore.

Neni 19

Hyrja në fuqi dhe përfundimi

1. Kjo kontratë hyn në fuqi menjëherë, me nënshkrimin nga palët kontraktuale.
2. Kontrata konsiderohet e përfunduar kur titulli ekzekutiv është ekzekutuar tërësisht.

Vendi dhe data e nënshkrimit: _____, ____/____/____.

KREDITORI

(emër, mbiemër, firmë)

SHOQËRIA PËRMBARTIMORE/PËRMBARTUESI GJYQËSOR PRIVAT

(vula)

(emër, mbiemër, firmë)

176

ANEKS B

LISTË E AKTEVE LIGJORE DHE NËNLIGJORE QË RREGULLOJNË VEPRIMTARINË E SHËRBIMIT PËRMBARTIMOR

- Kodi i procedurës Civile (kapitulli i ekzekutimit të tuajve ekzekutiv nenet 510 – 617);
- Ligji nr.10031 date 11.12.2008 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat);
- Udhëzimi nr. 1240/5 date 15.09.2009 “Për tarifën e shërbimit përmbartimor gjyqësor privat”;

Udhëzim Nr.2, datë 24.9.2003 “Për mënyrën e zbatimit të ekzekutimit të detyrimeve mbi shumat e llogarive në banka”;

Kodi penal (Neni 320 Pengimi i ekzekutimi);

Kontrata e Shërbimit e miratuar nga Ministri i Drejtësisë

Kodi i Etikës së Përmbauesve gjyqësor privat

Pjesë nga Kodi i Procedurës Civile miratuar me ligjin nr. Nr.8116, datë 29.3.1996 (nenet 510- 617)

177

EKZEKUTIMI I DETYRUESHËM

TITULLI I PARË

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 510

Titujt ekzekutivë

(Ndryshuar shkronja “d” me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 105)

(Shtuar shkronja “d” me ligjin nr.9953, datë 14.7.2008 neni 1)

(Ndryshuar shkronja a me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 15)

Ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv.

Janë tituj ekzekutivë:

a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm;

b) vendimet penale të formës së prerë në pjesën që bëjnë fjalë për të drejta pasurore;

c) vendimet e gjykatave e të arbitrazheve të shteteve të huaja që u është dhënë fuqi sipas dispozitave përkatëse të këtij Kodi;

ç) vendimet e një gjykate arbitrazhi në Republikën e Shqipërisë;

d) aktet noteriale që përmbajnë detyrim në të holla, si dhe aktet për dhënien e kredive bankare ose aktet për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare;

dh) kambialet, çeqet e letrat me urdhër që barazohen me ato;

e) aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përmbaimit për ekzekutimin e tyre.

Neni 511

Urdhri i ekzekutimit

(Shtuar paragrafi i fundit me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 106)

(Ndryshuar fjalia e dytë e paragrafit të parë dhe paragrafi i fundit

178

me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 16)

Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim me kërkesën e kreditorit. Për këtë qëllim lëshohet urdhri i ekzekutimit, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së kreditorit, i cili jepet:

a) për rastet e parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b” të nenit të mësipërm, nga gjykata që ka dhënë vendimin;

b) për vendimet e gjykatave të shteteve të huaja e të gjykatave të arbitrazhit të huaj që u është dhënë fuqi zbatimi sipas dispozitave të këtij Kodi nga gjykata e apelit;

c) për rastet e parashikuara nga shkronja “ç” e nenit të mësipërm nga gjykata e vendit ku është dhënë vendimi;

ç) për rastet e parashikuara nga shkronjat “d”, “dh” dhe “e” nga gjykata e vendit ku është caktuar të bëhet ekzekutimi.

Nuk lëshohet urdhri i ekzekutimit për vendimin e sigurimit të padisë dhe për gjobat e dhëna nga gjykata, të cilat ekzekutohen drejtpërdrejt nga zyra e përbarimit, pas njoftimit të vendimit.
Neni 512

Ankimi për mosdhënien e urdhrin të ekzekutimit

Kundër vendimit me të cilin refuzohet dhënia e urdhrin të ekzekutimit, mund të bëhet ankim sipas rregullave mbi ankimet e veçanta.

Neni 513

Urdhri i ekzekutimit për pasuri dhe persona të veçantë

Urdhri i ekzekutimit lëshohet vetëm në një kopje.

Kur duhet të dorëzohen disa pasuri të veçanta ose kur titulli ekzekutiv është dhënë në dobi ose kundër disa personave, mund të lëshohen urdhra ekzekutimi të veçantë, duke shënuar se cila pjesë e titullit duhet të ekzekutohet për çdo urdhër ekzekutimi.

Neni 514

Lëshimi i dublikatës së urdhrin të ekzekutimit

179

Kur urdhri i ekzekutimit humbet ose zhduket, gjykata që e ka lëshuar, me kërkesë të kreditorit, mund t'i lëshojë këtij dublikatë në bazë të titullit ekzekutiv.

Kërkesa shqyrtohet në këshill gjyqësor pasi debitorit t'i jetë dorëzuar një kopje e saj.

Kur humbet ose zhduket vetë titulli ekzekutiv dhe nuk ka mundësi që përmbajtja e tij të nxirret nga aktet e organeve që kanë lëshuar titullin ekzekutiv, kreditori mund të ngrëjë padi kundër debitorit, sipas rregullave të përgjithshme.

Neni 515

Vënia në ekzekutim

(Ndryshuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 17)

Urdhri i ekzekutimit vihet në ekzekutim nga shërbimi përbarimor gjyqësor, shtetëror ose privat, me anë të përbaruesit gjyqësor, në bazë të kërkesës së kreditorit.

Kreditori, përveç kërkesës për ekzekutim, duhet të paraqesë:

- a) titullin ekzekutiv (origjinal ose i noterizuar);
- b) urdhrin e ekzekutimit (origjinal);
- c) pagesën e tarifës së vënies në ekzekutim;
- ç) sipas rastit, prokurën e personit, që përfaqëson palën kreditore.

Kur nuk plotësohen në rregull dokumentet e mësipërme për vënien në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit, përbaruesi i lë kërkesit një afat 5-ditor për plotësimin e mangësive. Kur kërkesi nuk plotëson këto mangësi brenda afatit të caktuar, dokumentacioni i kthehet atij. Kur mangësitë janë shmangur në afatin e caktuar, kërkesa për vënien në ekzekutim quhet e regjistruar nga data që është paraqitur pranë përbaruesit gjyqësor.

Vënia në ekzekutim e urdhrin të ekzekutimit bëhet brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës së kreditorit.

Vendimi i gjykatës për masën e sigurimit të padisë dhe gjobat e gjykatës vihen në ekzekutim brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes për ekzekutim.

Tarifa për vënien në ekzekutim të urdhrin ekzekutiv nuk parapaguhet në raste të parashikuara me ligj apo akte të tjera normative.

Neni 516

180

Kompetenca tokësore e përbaruesit gjyqësor

(Shtuar fjalia e fundit me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 18)

Kërkesa për zbatimin e urdhrave të ekzekutimit i drejtohet përbaruesit gjyqësor të vendit

ku ndodhen:

a) sendet e luajtshme ose të paluajtshme ose paratë, ndaj të cilave drejtohet ekzekutimi;

b) banimi i personit të tretë të detyruar kur ekzekutimi drejtohet kundër kredisë që ka për të marrë debitori nga ky person;

c) vendi i ekzekutimit të detyrimit për kryerjen ose moskryerjen e një veprimi të caktuar.

Kur përmbauesi gjyqësor konstaton se nuk është kompetent për të vënë në ekzekutim kërkesën, ia dërgon këtë përmbauesit gjyqësor kompetent, pasi vë më parë sekuestër mbi sendin ose mbi kredinë e debitorit.

Konflikti për kompetencë nuk lejohet, por përmbauesi gjyqësor ka të drejtë të parashtrojë moskompetencën e tij në gjykatën e shkallës së parë ku e ushtron veprimtarinë, e cila e shqyrton atë në këshill gjyqësor. Kundër vendimit të tij lejohet ankim i veçantë. Ky nen nuk zbatohet për personat, përmbauesit gjyqësorë, që ushtrojnë veprimtarinë publike të shërbimit përmbaues gjyqësor, të organizuar mbi baza private.

Neni 516/a

(Shtuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 19)

Në çastin e fillimit të procedurës së ekzekutimit, përmbauesi gjyqësor, në bazë të nenit 515 të këtij ligji, duhet të regjistrojë, në regjistrin qendror pranë Ministrisë së Drejtësisë, çdo kërkesë.

Çdo përmbaues gjyqësor është i detyruar të njihet me të dhënat e regjistrit.

Nëse me fillimin e procedurës me objekt “Ekzekutim detyrimesh në të holla” përmbauesi gjyqësor, nga të dhënat e marra nga regjistri qendror, vëren se kreditorë të tjerë janë në procedurë ekzekutimi ndaj të njëjtit debitor, me të njëjtin objekt, atëherë pezullon procedurën e nisur dhe drejton kreditorin e tij te përmbauesi gjyqësor, i cili ka regjistruar i pari kërkesën për ekzekutim.

Në këtë rast, përmbauesi gjyqësor, që ka regjistruar i pari kërkesën, vijon procedurën e ekzekutimit, në përputhje edhe me nenin 534 e në vijim të këtij Kodi.

181

Me pezullimin e procedurës së ekzekutimit, tarifa e vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit, së bashku me dokumentacionin, i kthehen kreditorit.

Ky nen nuk zbatohet kur në cilësinë e palës debitorë është shteti.

Neni 517

Lajmërimi për ekzekutimin vullnetar

(Ndryshuar paragrafi II me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 107)

(Ndryshuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 20)

Përmbauesi gjyqësor, kur fillon ekzekutimin, i dërgon debitorit një lajmërim për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban urdhri i ekzekutimit, duke i caktuar për këtë një afat prej 5 ditësh, kur objekti i tij është pagë ose detyrim për ushqim dhe prej 10 ditësh në të gjitha rastet e tjera.

Me marrjen e lajmërimit për ekzekutim vullnetar, debitori është i detyruar të deklarojë, me shkrim, gjendjen e tij pasurore, si dhe sendet ose kredi që persona të tretë i detyrohen, nëse kjo kërkohet nga përmbauesi gjyqësor.

Me kërkesën e debitorit, gjykata e shkallës së parë e vendit të ekzekutimit, në raste të veçanta, duke marrë parasysh gjendjen pasurore të debitorit ose rrethanat e tjera të çështjes, pasi dëgjon edhe kreditorin mund të shtyjë afatin e ekzekutimit të detyrimit në të holla ose ta ndajë këtë detyrim në këste. Vendimi jepet në seancë gjyqësore, brenda 20 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. dhe kundër tij mund të bëhet ankim i veçantë.

Neni 518

Përmbajtja e lajmërimit

Lajmërimi duhet të përmbajë një shkurtim të përmbajtjes së urdhrit të ekzekutimit, vendin

dhe adresën e kreditorit, dhe paralajmërimin që i bëhet debitorit se do të fillojë ekzekutimi i detyrueshëm, në qoftë se ekzekutimi nuk ekzekutohet vullnetarisht prej tij brenda afatit të caktuar në lajmërim.

Në rast se debitori vdes pas vënies në ekzekutim të titullit, por para se të jenë përfunduar së kryeri veprimet e nevojshme të ekzekutimit, përmbaruesi gjyqësor, para se të vazhdojë veprimet 182

e tij, duhet t'u dërgojë trashëgimtarëve të debitorit të vdekur, kur këta janë njohur, një lajmërim të ri për të ekzekutuar këta vullnetarisht detyrimin që përmban urdhri i ekzekutimit.

Neni 519

Fillimi i ekzekutimit të detyrueshëm

Ekzekutimi i detyrueshëm nuk mund të fillojë para se të kenë kaluar afatet e parashikuara nga neni 517 i këtij Kodi, përveç kur ka rrezik se me kalimin e afatit, ekzekutimi do të bëhet i pamundshëm. Në këtë rast, përmbaruesi gjyqësor mund të fillojë menjëherë nga ekzekutimi i detyrueshëm.

Neni 520

Efektet e urdhrin të ekzekutimit ndaj trashëgimtarëve

Urdhri i ekzekutimit kundër debitorit trashëgimtarëve vihet në ekzekutim mbi pasurinë e trashëgimtarëve të tij, por brenda masës së pasurisë së trashëguar prej tyre nga trashëgimtarësi.

Neni 521

Ekzekutimi ndaj personit të tretë

(Ndryshuar me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 108)

Urdhri i ekzekutimit kundër debitorit mund të vihet në ekzekutim edhe kundër personit të tretë, që për sigurimin e detyrimit ka ngarkuar me barrë sipas ligjit një send të tij, kur kreditori kërkon ekzekutimin mbi këtë send.

Neni 522

Ekzekutimi ndaj debitorit që nuk i dihet banimi

(Ndryshuar me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 109)

(Ndryshuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 21)

Kur banimi i debitorit nuk dihet, gjykata e shkallës së parë e vendit të ekzekutimit, me kërkesën e përmbaruesit gjyqësor, pasi sqarohet edhe vetë për këtë rrethanë, brenda 10 ditëve 183

nga data e paraqitjes së kërkesës së përmbaruesit gjyqësor i emëron debitorit një përfaqësues, i cili shpërblehet fillimisht nga kreditori sipas nenit 525 të këtij Kodi.

Neni 523

Detyrimi për bashkëpunim

(Ndryshuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 22)

Kur për ekzekutimin e detyrueshëm është e nevojshme të çelet banesa ose ndonjë ndërtesë tjetër e debitorit, pa praninë e tij ose të një personi madhor të familjes së tij, me kërkesë të përmbaruesit gjyqësor, detyrohet të jetë i pranishëm përfaqësuesi i njësisë së qeverisjes vendore. Në çdo rast, përmbaruesi gjyqësor kërkon edhe pjesëmarrjen e dy dëshmitarëve të tjerë.

Në rast nevoje, me kërkesë të përmbaruesit gjyqësor, Policia e Rendit detyrohet ta mbështesë atë gjatë procedurave të ekzekutimit.

Kur për ekzekutimin e detyrueshëm është e nevojshme të prishet objekti, të lirohet trualli, të pezullohen punimet, me kërkesë të përmbaruesit gjyqësor, inspektorati ndërtimor pranë pushtetit vendor dhe Inspektorati Kombëtar detyrohen të mbështesin përmbaruesin gjyqësor gjatë procedurave të ekzekutimit.

Për ekzekutimin e titujve ekzekutivë, me objekt "Takim dhe kujdestari fëmije", përmbaruesi

gjqësor kërkon asistencën e psikologut, kur ky i fundit është i detyruar në bazë të ligjit për bashkëpunim.

Neni 524

Procesverbali i përmbartuesit

Përmbartuesi gjyqësor, për çdo veprim të kryer prej tij, është i detyruar të mbajë procesberval, në të cilin përmenden dita dhe vendi i kryerjes së veprimit, kërkesat dhe deklaratimet e bëra nga palët, sendet e marra, shuma e nxjerrë dhe shpenzimet e bëra për ekzekutimin.

Neni 525

Shpenzimet e ekzekutimit

(Ndryshuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 23)

184

Tarifat e përcaktuara për ekzekutimin e urdhrit ekzekutiv paguhen fillimisht nga kreditori dhe pas përfundimit të procedurës së ekzekutimit i ngarkohen debitorit. Shpenzimet e tjera gjatë procedurës së ekzekutimit paguhen nga pala, që i ka shkaktuar ato.

Neni 526

Ekzekutimi ndaj personit të huaj

Ekzekutimi i detyrueshëm ndaj personit të huaj publik mund të bëhet vetëm me leje të Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 526/a

Fusha e zbatimit

(Shtuar me ligjin nr.8535, datë 18.10.1999, neni 1)

Dispozitat e përgjithshme për ekzekutimin e detyrueshëm zbatohen për të gjitha llojet e titujve ekzekutivë.

Me ligj mund të vihen rregulla të posaçme për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë të caktuar, duke respektuar kërkesat e neneve 510, 511, 516, 520, 521, 523, 524, 545, 561 dhe 562 të këtij Kodi, edhe sikur të jenë tituj të fushave të veçanta të ekzekutimit të detyrueshëm sipas këtij Kodi.

TITULLI II

EKZEKUTIMI NË FUSHA TË VEÇANTA

KREU I

EKZEKUTIMI I DETYRIMEVE NË TË HOLLA KUNDREJT PERSONAVE FIZIKË E JURIDIKË

185

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 527

Vënia e sekuestro

Kur kërkohet ekzekutimi i një detyrimi në të holla, përmbartuesi gjyqësor, me kalimin e afatit të lajmërimit për ekzekutim (neni 517), fillon ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit dhe mbi sendet e luajtshme dhe të paluajtshme të tij, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Neni 528

(Shtuar fjalia e fundit me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 24)

Me kërkesën e debitorit, sekuestroja mund të vihet edhe mbi një pasuri tjetër të tij të ndryshme nga ajo që ka treguar kreditori, kur përmbartuesi gjyqësor çmon se kjo plotëson kërkesën e kreditorit. Me kërkesë të debitorit, sekuestroja mund të vihet, përveç pasurive të rënduara me peng dhe hipotekë, edhe mbi një pasuri tjetër të tij, të ndryshme nga ajo që ka treguar kreditori, kur përmbartuesi gjyqësor çmon se ajo plotëson kërkesën e kreditorit.

Neni 529

Sendet mbi të cilat nuk mund të vihet sekuestroja

(Shtuar pika 8 me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 25)

Përfshihen nga sekuestrimi i pasurisë së debitorit:

1. sendet e përdorimit personal të debitorit dhe të familjes së tij si: veshjet, shtresat, mbulesat, mobiljet për aq sa ato janë të nevojshme për jetesën e tyre;
2. ushqimet dhe lëndët djegëse që i nevojiten debitorit dhe familjes së tij për tre muaj;
3. dekoratat dhe sende kujtimi, letra, shkresa të familjes dhe librat profesionalë;
4. librat, veglat muzikore, mjetet e artit që nevojiten për veprimtarinë shkencore dhe artistike të debitorit dhe të familjes së tij;
- 186
5. deri 3 dynymë tokë, 2 kafshë për punimin e tokës, 1 lopë, 6 dele ose 6 dhi, fara për mbjelljen e ardhshme, si dhe ushqimi i këtyre kafshëve për 3 muaj për personat që jetojnë me punë bujqësore ose blegtorale;
6. ndihma që u jepet nënave me shumë fëmijë ose të vetme, pensionet e pleqërisë, të invaliditetit ose familjarë ose bursa e studimit përveç kur detyrimi është për ushqim. **Në këtë rast nuk mund të sekuestrohet më shumë se 1/2 e shumës së pensionit ose të bursës;**
7. frutat natyrore një muaj para se ato të piqen.
8. Sendet e nevojshme të punës për sigurimin e jetesës.

Neni 530

Shtrirja e sekuestro mbi shpërblimin nga sigurimi

Në qoftë se sendet e sekuestruara janë të siguruara, sekuestrimi shtrihet edhe në shpërblimin që u takon nga sigurimi.

Neni 531

Detyrimet e debitorit pas vënies së sekuestro

Nga çasti i vënies së sekuestro, debitori nuk ka të drejtë të disponojë sendin e luajshëm ose të paluajshëm ose kredinë apo të ndryshojë, dëmtojë ose të zhdukë sendin, përndryshe ka përgjegjësi, sipas dispozitave të Kodit Penal. Ky detyrim shtrihet edhe mbi personat që kanë në posedim sendin e debitorit.

Neni 532

Llogaria në bankë e zyrës së përmbarrimit dhe e përmbarruesit gjyqësor

(Ndryshuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 26)

Shumat e nxjerra, me rastin e ekzekutimit ndaj debitorit, ndaj personit të tretë që i detyrohet debitorit, ndaj blerësit të sendit të shitur në dyqanet me shitje të lirë ose në ankand, derdhen në bankë në llogari të zyrës së përmbarrimit ose në llogari të përmbarruesit gjyqësor.

Neni 533

187

Sekuestroja e pagës së debitorit

(Ndryshuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 27)

Pasi zbritet kontributi për sigurimet shoqërore dhe taksat mbi të ardhurat, përmbarruesi gjyqësor sekuestron pagën e debitorit, por pa cenuar minimumin jetik, të përcaktuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 534

Pjesëmarrja e kreditorëve të tjerë

Në çdo fazë të ekzekutimit, gjersa nuk është përgatitur nga përmbarruesi gjyqësor projekti i ndarjes së shumave të nxjerra, mund të marrin pjesë në ekzekutim edhe kreditorët e tjerë të po atij debitori.

Marrja pjesë e kreditorëve të tjerë në ekzekutim bëhet me kërkesë të tyre të shkruar së cilës i bashkëngjitet urdhri i ekzekutimit ose një vendim nga përmbaruesi gjyqësor se urdhri i ekzekutimit i është bashkëngjitur një çështjeje tjetër që është në ekzekutim.

Neni 535

Kreditori që merr pjesë në ekzekutim bashkë me kreditorët e tjerë ka po ato të drejta që ka edhe kreditori, i cili ka vënë i pari sekuestron mbi sendet ose kreditë e debitorit, përveç kur ekzistojnë shkaqe të ligjshme të referimit.

Veprimet e ekzekutimit, të kryera para se kreditori të marrë pjesë bashkë me kreditorët e tjerë, krijojnë të drejta edhe për ata.

Neni 536

Shteti quhet gjithmonë si kreditor që merr pjesë bashkë me kreditorët e tjerë për detyrimin që po ai debitor i ka shtetit dhe të cilët rrjedhin nga tatimet dhe nga kredi të tjera, shuma e të cilëve i është njoftuar përmbaruesit gjyqësor, para se të bëhet ndarja e shumave të tjera. Për këtë

188 qëllim, përmbaruesi gjyqësor njofton seksionin përkatës të financës për çdo ekzekutim të filluar prej tij dhe për çdo ndarje që ai bën.

Neni 537

Projekti i ndarjes së shumave

(Ndryshuar me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 112)

Kur shuma e nxjerrë nga ekzekutimi nuk mjafton për të paguar të gjithë kreditorët, përmbaruesi gjyqësor përgatit projektin e ndarjes, duke veçuar më parë shumat që nevojiten për kreditë që paguhen me preferim dhe nga pjesa tjetër që mbetet, paguan kreditë e tjera në përpjesëtim me shumat e tyre.

Neni 538

Përmbaruesi gjyqësor njofton për përgatitjen e projektit të ndarjes së shumave të nxjerra debitorin dhe kreditorët, të cilët i thërret për këtë qëllim në një ditë të caktuar prej tij.

Në qoftë se brenda 5 ditëve nga dita e paraqitjes prej përmbaruesit gjyqësor të projektit të ndarjes nuk bëhet ankim, ndarja quhet përfundimtare dhe përmbaruesi gjyqësor i dorëzon çdo kreditori shumën që i takon.

Neni 539

Ankimi kundër projektit të ndarjes së shumave

(Ndryshuar me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 126)

Në rast se kundër projektit të ndarjes së shumave të nxjerra bëhet ankim, çështja së bashku me ankesën i dërgohet gjykatës së shkallës së parë e cila vendos në seancë gjyqësore, duke thirrur debitorin dhe kreditorët. Kundër vendimit të gjykatës për ndarjen e shumave të nxjerra mund të bëhet ankim i veçantë në gjykatën e apelit.

KREU II

189

EKZEKUTIMI MBI SENDET E LUAJTSHME

Neni 540

Inventarizimi

(Shtuar fjalia e fundit me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 28)

Sekuestroja mbi sendet e luajtshme të debitorit bëhet me inventarizimin e tyre nga përmbaruesi gjyqësor. Përmbaruesi gjyqësor bën sekuestrimin e pasurive të luajtshme, mbi të cilat vendoset një etiketë e shërbimit të përmbarimit.

Neni 541

Inventarizimi përfshin vetëm sendet që ndodhen në shtëpinë e debitorit, si dhe ato që

ndodhen në një lokal tjetër që është i përbashkët për debitorin dhe personat e tretë, përveç se kur del se ato janë të një personi tjetër.

Për inventarizimin mbahet procesverbal.

Neni 542

Përmbajtja e procesverbalit të inventarizimit

(Shtuar shkronja "c" me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 112)

Procesverbali i inventarizimit duhet të përmbajë:

- a) shënimin e urdhrin të ekzekutimit, në bazë të të cilit vihet sekuestroja;
 - b) emrin, emrin e atit dhe mbiemrin e përmbartuesit gjyqësor, të debitorit, kreditorit dhe të personave të tjerë që janë të pranishëm në inventarizim;
 - c) vendin ku kryhet inventarizimi dhe koha e kryerjes së tij;
 - ç) pretendimet e personave të tretë në lidhje me sendet e inventarizuara;
 - d) përshkrimin e hollësishëm të sendeve dhe vlerësimin e tyre;
 - dh) kujt i lihen për ruajtje sendet;
- 190
- e) nënshkrimin e personave që marrin pjesë në inventarizim.

Neni 543

(Ndryshuar me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 113)

Inventarizimi bëhet në prani të debitorit. Në mungesë të debitorit, inventarizimi bëhet në prani të një personi madhor të familjes së tij dhe, kur nuk ndodhet një person i tillë, në prani të një përfaqësuesi të njësisë së qeverisjes vendore. Në çdo rast inventarizimi bëhet duke qenë të pranishëm edhe dy dëshmitarë.

Neni 544

Vlerësimi i sendeve të inventarizuara

Sendet e inventarizuara vlerësohen nga përmbartuesi gjyqësor në bazë të vlerësimeve të ekspertëve, në bazë të çmimeve të tregut, duke u zbritur përqindja përkatëse e konsumimit ose e vjetërsisë së tyre.

Neni 545

Detyrimet e debitorit për sendet e lëna në ruajtje

Sendet e inventarizuara mund t'i lihen në ruajtje debitorit, i cili ka të drejtë edhe t'i përdorë, por me kusht që të mos pakësohet vlefata e tyre. Kur debitori refuzon t'i pranojë për ruajtje, përmbartuesi gjyqësor emëron në këtë detyrë një person tjetër, duke i caktuar këtij një shpërblim. Debitori ose personi i tretë, të cilëve u janë lënë në ruajtje sendet e inventarizuara, duhet të japin llogari për të ardhurat dhe shpenzimet e bëra për sendin. Këta janë përgjegjës, sipas dispozitave të Kodit Penal, për disponimin, dëmtimin ose shkatërrimin e tyre.

Neni 546

Ekzekutimi mbi sendet në bashkëpronësi

(Ndryshuar me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 114)

191

Kur ekzekutimi bëhet mbi sendet që janë në bashkëpronësi të debitorit dhe të personave të tjerë, përmbartuesi gjyqësor, pasi bën inventarizimin e gjithë pasurisë së përbashkët, i bën kërkesë gjykatës kompetente të vendit të ekzekutimit, e cila cakton dhe ndan pjesën që i takon debitorit, sipas rregullave të parashikuara nga nenet 369-374 të këtij Kodi. Mbi këtë pjesë bëhet pastaj ekzekutimi nga përmbartuesi gjyqësor.

Neni 547

Pavlefshmëria e disponimit pas vënies së sekuestro

Çdo diskonim i sendit të luajshëm nga ana e debitorit pas vënies së sekuestro është i

pavlefshëm kundrejt kreditorëve që kanë kërkuar ekzekutimin, përveç kur me disponimin sendi ka kaluar në pronësi të një tjetri që ka qenë në mirëbesim (neni 166 i Kodit Civil).

Neni 548

Sekuestrimi mbi sendet e çmueshme

Sendet e çmueshme si ari, argjendi, platini dhe metalet e grupit të platinit në shufra, copë, monedha dhe artikuj të bërë prej tyre, gurët e çmueshëm, margaritarët dhe artikujt e bërë prej tyre, si dhe valuta e huaj, dokumentet e pagesës në valutë të huaj si kambiale, çeqe, mandate e letra të tjera të kësaj natyre, si dhe tituj të huaj me vleftë, si aksione, obligacione e kuponët përkatës i jepen për ruajtje një banke.

Neni 549

Procedura e shitjes

Përmbauesi gjyqësor, pas vënies së sekuestro, i dërgon një lajmërim debitorit se sendet e sekuestruara do të shiten, në *qoftë se brenda pesë ditëve* ai nuk ekzekuton detyrimin.

Neni 550

192

Shitja e sendeve bëhet me anë të ankandit ose në dyqanet me shitje të lirë, ndërsa sendet e çmueshme (neni 548), të depozituara në bankë, i shiten asaj dhe merret kundërvlera e tyre nga përmbauesi gjyqësor, në bazë të kursit zyrtar në kohën e pagesës së tyre.

Neni 551

(Shfuqizuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 29)

Neni 552

Caktimi i çmimit

(Ndryshuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 30)

Çmimi i sendit të sekuestruar caktohet nga përmbauesi, në bashkëpunim me kreditorin dhe debitorin. Kur ka kundërshtime ndërmjet tyre, thirret një ekspert.

Neni 553

Shitja e lirë e sendit

(Shtuar paragrafi I me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 115)

(Ndryshuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 31)

Përmbauesi e dërgon sendin për shitje në dyqane me shitje të lirë. Caktimi i shpërblimit për shitjen bëhet në marrëveshje ndërmjet përmbauesit gjyqësor dhe shitësit. Shpërblimi nxirret nga vlera e sendit të sekuestruar pas shitjes së tij.

Në qoftë se brenda 2 muajve sendi nuk shitet në shitje të lirë, përmbauesi gjyqësor, duke marrë edhe pëlqimin e palëve, vendos nëse duhet të vazhdojë me shitjen e lirë edhe për 30 ditë të tjera apo të kalojë në procedurë ankandi.

Neni 554

Ankandi

(Ndryshuar me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 116)

(Ndryshuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 32)

193

Përmbauesi gjyqësor, pasi njofton palët se sendi, për shkak të natyrës ose të gjendjes, nuk mund të pranohet në shitje të lirë, organizon shitjen me ankand të sendit, sipas çmimit të përcaktuar në nenin 552 të këtij Kodi.

Neni 555

(Shtuar fjalia e parë me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 33)

Çmimi fillestar i ankandit të parë është 80 për qind e çmimit të caktuar sipas nenit 552 të këtij ligji. Kur sendi shitet në ankand, përmbauesi gjyqësor shpall në zyrën e tij, në vendin ku

ndodhet sendi dhe në vendin e caktuar për shitjen në ankand, një lajmërim ku duhet të tregohet çmimi me të cilin do të fillojë shitja në ankand, vendi, dita dhe ora që do të bëhet shitja. Shitja nuk mund të bëhet para se të kenë kaluar pesë ditë nga shpallja.

Neni 556

Shitja në ankand e sendit bëhet ditën e caktuar në lajmërim dhe përfundon me mbarimin e orarit zyrtar të asaj dite.

Blerës quhet ofertuesi që ka dhënë çmimin më të lartë. Blerësi duhet ta paguajë çmimin menjëherë.

Në ankand nuk mund të marrin pjesë personat që tregohen në nenin 709 të Kodit Civil.

Për të gjitha veprimet e shitjes në ankand mbahet procesverbal.

Neni 557

Ankandi i dytë

(Ndryshuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 34)

Në rast se në ankandin e parë nuk është paraqitur asnjë ofertues, atëherë, brenda 10 ditëve nga përfundimi i tij, përmbaruesi gjyqësor përcakton çmimin e ri, jo më të ulët se 30 për qind të çmimit fillestar, të caktuar në ankandin e parë dhe cakton një ankand të dytë për shitjen e sendit.

Në rast se në ankandin e dytë nuk është paraqitur asnjë ofertues, përmbaruesi i propozon në fillim kreditorit, që, kundrejt kredisë, të marrë sendin me çmimin e ankandit të dytë. Në rast se

194

kreditori nuk pranon ta marrë sendin, përmbaruesi heq sekuestron mbi këtë send, duke ia kthyer atë debitorit dhe vijon procedurat përmbarimore mbi pasuri të tjera të tij.

Neni 558

Radha e shitjes së sendeve në ankand

Debitori ka të drejtë të caktojë radhën, sipas së cilës duhet të shiten sendet në ankand. Në qoftë se nga shitja e një ose disa sendeve nxirret një shumë e cila mjafton për të shlyer kredinë e kreditorit dhe shpenzimet e tjera që kanë lidhje me kredinë, ankandi përfundon dhe sendet e tjera nuk shiten.

Neni 559

Kalimi i pronësisë së sendit të shitur

Blerësi i sendit të shitur në dyqanin e shitjes me shitje të lirë ose në ankand bëhet pronar i tij edhe sikur sendi të mos ishte në pronësi të debitorit.

Kundër shitjes nuk mund të bëhet ankim dhe as të kundërshtohet vlefshmëria e saj, përveç rastit të parashikuar nga paragrafi i tretë i nenit 556 të këtij Kodi.

KREU III

EKZEKUTIMI MBI SENDET E PALUAJTSHME, MBI MJETET E LUNDRIMIT E TË FLUTURIMIT

Neni 560

Vënia e sekuestro

(Ndryshuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 35)

Ekzekutimi i vendimit të gjykatës apo të titujve të tjerë ekzekutivë mbi sendet e paluajtshme të debitorit bëhet me vendosjen e sekuestro mbi to.

Sekuestroja vihet me regjistrimin e saj në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të aktit të përmbaruesit gjyqësor, në të cilin shënohet lloji, natyra dhe të paktën tre kufij të sendit të

195

paluajtshëm, vendi i ndodhjes së tij, si dhe hipotekat dhe të drejtat reale që mund të jenë vënë mbi të. Akti i përmbaruesit gjyqësor regjistrohet nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së tij.

Një kopje e aktit të përmbauesit gjyqësor i komunikohet debitorit.

Neni 561

Sekuestroja mbi mjetet e lundrimit

Kur sekuestrohet një anije, në procesverbalin përkatës përmenden emri e kombësia e pronarit të anijes, emri i anijes, përshkrimi e kapaciteti i saj, si dhe të dhëna të tjera lidhur me regjistrimin e saj. Kopja e procesverbalit të sekuestrimit, si për anijet shqiptare ashtu dhe për ato të huaja, i jepet personit që mban regjistrin detar të anijes, si dhe drejtorit të portit ku është vendosur sekuestrimi, i cili njofton menjëherë pronarin e anijes.

Sekuestrimi ndalon lundrimin e anijes.

Neni 562

Sekuestroja mbi mjetet e fluturimit

Kur sekuestrohet një mjet fluturimi, në procesverbalin përkatës përmendet emri dhe kombësia e pronarit, shenjat dalluese të mjetit, vendin e regjistrimit, kapacitetin e të dhëna të tjera të kësaj natyre.

Kopja e procesverbalit të sekuestrimit i jepet komandantit të aeroportit ku është bërë sekuestrimi i mjetit.

Sekuestrimi ndalon fluturimin e mjetit. Komanda e aeroportit kur mjete i fluturimit është i huaj, njofton menjëherë zyrën ku është regjistruar mjete i fluturimit.

Neni 563

Verifikimi i të drejtës së pronësisë të debitorit

Përpara vendosjes së sekuestro, përmbauesi gjyqësor sigurohet nëse sendi i paluajtshëm është në pronësi të debitorit. Për këtë, përmbauesit gjyqësor duhet t'i paraqiten dokumente

196
pronësie ose edhe vetë ai kërkon informata nga zyra e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme dhe, në mungesë të tyre, nga organet financiare dhe të pushtetit lokal.

Neni 564

Vlerësimi i sendit të sekuestruar

(Ndryshuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 36)

Nëse kreditori dhe debitori, brenda një jave, nuk arrijnë një marrëveshje për vlerën e sendit, mbi të cilin është vendosur sekuestroja, përmbauesi gjyqësor, brenda 15 ditëve, përcakton me vendim vlerën e tij, bazuar në aktin e ekspertimit, të paraqitur nga një ekspert i licencuar dhe në vlerën reale të pasurisë në treg, në çastin e vënies së sekuestro mbi të.

Përmbauesi gjyqësor, brenda 10 ditëve nga data e caktimit të vlerës, njofton kreditorin dhe debitorin për çmimin e caktuar. Kundër vendimit të përmbauesit palët mund të bëjnë ankim të veçantë.

Neni 565

Detyrimet e debitorit për sendin e lënë në ruajtje

Sendi që sekuestrohet i lihet në ruajtje debitorit derisa të bëhet shitja e tij, duke qenë i detyruar debitori të kujdeset për të, si për sendin e tij.

Në rast se debitori nuk kujdeset si duhet për sendin e lënë në ruajtje, përmbauesi gjyqësor emëron një person tjetër për ruajtjen e tij, duke i caktuar një shpërblim. Emërimi dhe caktimi i shpërblimit bëhen në marrëveshje midis përmbauesit dhe personit tjetër. Shpërblimi nxirret nga vlera e sendit të sekuestruar, pas shitjes së tij.

Debitori ose personi tjetër, të cilëve u është lënë në ruajtje sendi i paluajtshëm i sekuestruar, duhet të japë llogari për të ardhurat e realizuara dhe shpenzimet e bëra për sendin. Ata përgjigjen sipas nenit 320 të Kodit Penal për veprime që bëhen pengesë për ekzekutimin e vendimit të gjykatës.

Neni 566

197

Pavlefshmëria e veprimeve juridike të debitorit për sendet e sekuestruara

Çdo veprim i debitorit, që përbën diskonim të sendit të paluajtshëm pas regjistrimit të sekuestro në zyrën e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, është i pavlefshëm kundrejt kreditorëve që kanë kërkuar ekzekutimin.

Neni 567

Procedura e shitjes në ankand

Pas vënies së sekuestro, përmbaruesi gjyqësor i dërgon lajmërim debitorit se sendi i sekuestruar do të shitet, në qoftë se brenda 10 ditëve të njoftimit ai nuk e përmbush detyrimin. Me kalimin e afatit të mësipërm, përmbaruesi gjyqësor bën shpalljen për shitjen e sendit në ankand.

Neni 568

(Ndryshuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 37)

Shpallja për shitjen në ankand afishohet në zyrën e përmbaruesit gjyqësor dhe në vendin ku ndodhet sendi i paluajtshëm gjykatë, komunë, bashki, njësitë bashkiake dhe në një vend apo vende të tjera publike, që ai i çmon të përshtatshme. Shpallja duhet të përmbajë emrin, atësinë dhe mbiemrin e pronarit të sendit, nëse për sendin është vënë hipotekë dhe për çfarë shume të hollash, çmimin e sendit me të cilin do të fillojë shitja, vendi, dita kur do të përfundojë shitja në ankand. Shitja nuk mund të bëhet para se të kenë kaluar 15 ditë nga shpallja e ankandit.

Për shpalljen e shitjes në ankand duhet të njoftohen edhe kreditorët që kanë hipotekë. Çmimi fillestar në ankand është 80 për qind i çmimit të përcaktuar, sipas nenit 564 të këtij ligji.

Neni 569

(Ndryshuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 38)

198

Shitja e sendit bëhet në zyrën e përmbaruesit gjyqësor ose në një vend tjetër publik, nëse është i përshtatshëm për zhvillimin e ankandit. Ajo vazhdon 15 ditë dhe përfundon me mbarimin e orarit zyrtar të ditës së fundit që tregohet në shpalljen për shitjen në ankand.

Neni 570

Secili ofertues që merr pjesë në ankand, përpara fillimit të ankandit duhet të depozitojë si garanci në zyrën e përmbarimit një shumë të hollash të barabartë me 10 për qind të çmimit të sendit të caktuar në shpallje. Kreditori nuk le garanci, në rast se kredia e tij e kalon masën e garancisë.

Neni 571

Procesverbali për zhvillimin e ankandit

Për zhvillimin e ankandit mbahet procesverbal, në të cilin ofertuesit shënojnë, kundrejt nënshkrimit, çmimin që japin për sendin, pavarësisht nga çmimi që ka dhënë më parë. Kur ofertuesi vepron me përfaqësues, duhet të paraqitet edhe prokura noteriale.

Neni 572

Pavlefshmëria e shitjes në ankand

Debitori, përfaqësuesi i tij ligjor, përmbaruesi gjyqësor si edhe personat e tjerë që tregohen në nenin 709 të Kodit Civil, nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ankand.

Kur sendi blihet nga një person që nuk ka të drejtë të marrë pjesë në ankand, shitja është e pavlefshme. Në këtë rast, shuma e lënë si garanci nga blerësi kalon në dobi të shtetit dhe sendi me kërkesë të secilit kreditor mund të shitet përsëri në ankand, duke vepruar sipas rregullave të caktuara në këtë kapitull.

Neni 573

Shpallja e fituesit të ankandit

(Ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 39)

199

Në përfundim të ankandit, përmbaruesi gjyqësor shpall fituesin. Blerës i sendit është ai ofertues që ka dhënë çmimin më të lartë.

Pronësia mbi sendin i kalon blerësit vetëm pasi të ketë paguar të gjithë çmimin, duke zbritur prej tij shumën e lënë si garanci.

Garancitë e lëna nga persona të tjerë që kanë marrë pjesë në ankand, u kthehen atyre menjëherë pas përfundimit të ankandit.

Rregullat e hollësishme për zhvillimin e ankandit përcaktohen me udhëzim të Këshillit të Ministrave.

Neni 574

Afati i pagimit të çmimit të blerjes

(Ndryshuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 40)

Blerësi duhet të paguajë çmimin e sendit të blerë brenda 15 ditëve nga mbarimi i ankandit.

Me pagimin e çmimit dhe taksës mbi aktet për shitjen e sendit, përmbaruesi gjyqësor jep vendim për kalimin e sendit në pronësi të blerësit. Nga kjo ditë, blerësi fiton të gjitha të drejtat që kishte mbi sendin debitorit.

Neni 575

Vënia në posedim të sendit të blerë

(Ndryshuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 41)

Blerësi vihet në posedim të sendit nga përmbaruesi gjyqësor brenda 10 ditëve nga pagimi i çmimit të sendit si kundrejt debitorit ose personit të cilit i është lënë në ruajtje, ashtu edhe kundrejt çdo personi të tretë që ka në posedim sendin. Personi i tretë për heqjen e sendit nga posedimi, mund të mbrohet vetëm me padinë për njohjen e së drejtës së pronësisë mbi sendin.

Neni 576

Moskthimi i garancisë

200

Blerësi, që nuk paguan çmimin brenda afatit të caktuar në nenin 574 humbet të drejtën e kthimit të shumës së lënë si garanci, e cila kalon në dobi të shtetit dhe për shitjen e sendit bëhet një ankand i ri, duke vepruar sipas rregullave të caktuara në këtë kre.

Neni 577

Përsëritja e ankandit

(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 42)

Në rast se në ankandin e parë nuk është paraqitur asnjë ofertues, atëherë, brenda 10 ditëve nga përfundimi i tij, përmbaruesi gjyqësor përcakton çmimin e ri të sendit, jo më të ulët se 20 për qind të çmimit fillestar të caktuar në ankandin e parë. Ankandi i dytë për shitjen e sendit zhvillohet jo më vonë se 15 ditë nga data e caktimit të çmimit të ri.

Në rast se në ankandin e dytë nuk është paraqitur asnjë ofertues, atëherë përmbaruesi i propozon në fillim kreditorit që, kundrejt kredisë, të marrë sendin me çmimin e ankandit të dytë. Në rast se kreditori nuk pranon ta marrë sendin, përmbaruesi gjyqësor heq sekuestron mbi sendin e sekuestruar dhe vijon procedurat përmbarimore mbi pasuri të tjera të debitorit.

Kur kreditorët që kërkojnë të marrin sendin kundrejt kredisë janë disa, përmbaruesi gjyqësor deklaron blerës kreditorin që brenda 3 ditëve nga propozimi jep çmimin më të lartë se çmimi i caktuar për ankandin e ri.

Neni 578

Ekzekutimi mbi një send të paluajjtshëm në bashkëpronësi

(Ndryshuar paragrafi I me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni117)

Kur ekzekutimi bëhet mbi një send të paluajjtshëm që është në bashkëpronësi, për detyrimin që ka ndonjë nga bashkëpronarët bëhet sekuestrimi i sendit. Përmbaruesi gjyqësor i bën kërkesë gjykatës për veçimin e pjesës takuese të debitorit bashkëpronar dhe mbi këtë pjesë bëhet ekzekutimi. Sendi mund të shitet në tërësi, kur për këtë kanë dhënë pëlqimin të gjithë bashkëpronarët e tjerë. Pëlqimi duhet të jepet me akt noterial.

Kur sendi është në bashkëpronësi dhe debitorët janë të gjithë bashkëpronarët, për sekuestron dhe shitjen e sendit vepohet njëloj sikur sendi të ishte në pronësi të një debitorit të vetëm.

201

Neni 579

Diferenca midis detyrimit dhe çmimit të sendit

Kur shuma e realizuar nga shitja në ankand është më e madhe se shuma e kredisë së kreditorit apo kreditorëve, diferenca i kthehet debitorit, pasi zbriten shpenzimet e bëra për ruajtjen e sendit apo për zhvillimin e ankandit.

Neni 580

Kundërshtimi i pronësisë së sendit të shitur në ankande të veprimeve të përmbaruesit gjyqësor

Shitja e sendit të paluajjtshëm në ankand nuk ndalon personin e tretë i cili pretendon se është pronari i tij që ta kërkojë sendin me padi.

Kundër shitjes në ankand mund të bëhet ankim në gjykatë në formën e kundërshtimit të veprimeve të përmbaruesit gjyqësor. Vlefshmëria e shitjes në ankand mund të kundërshtohet me anë padie, sipas rregullave të përgjithshme, vetëm për rastin e parashikuar nga neni 556 i këtij Kodi.

KREU IV

EKZEKUTIMI MBI KREDITË E DEBITORIT DHE MBI SENDET QË PERSONAT E TRETË I DETYROHEN DEBITORIT

Neni 581

Deklarimi i pasurive të debitorit

(Ndryshuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 43)

Përpara se të vihet sekuestroja, përmbaruesi gjyqësor sigurohet për ekzistencën e kredive të debitorit dhe të sendeve, që personat e tretë i detyrohen atij.

202

Për këtë përmbaruesi gjyqësor njofton me shkresë personin e tretë dhe debitorin. Me marrjen e lajmërimit, pala debitorë duhet të deklarojë pranë përmbaruesit gjyqësor se informacioni i paraqitur, për pasuritë e tij/saj apo të lëna në posedim personave të tretë, është i saktë e i plotë. Me marrjen e lajmërimit të sekuestrimit, personi i tretë ndalohet t'ia dorëzojë debitorit kredinë dhe sendet e tij.

Kur debitorit është person juridik, deklarimi i pasurisë mund të bëhet nga një anëtar i organit drejtues, që, sipas ligjit ose statutit, ka të drejtën e përfaqësimit kundrejt të tetëve ose, në rastin e procedurave të shpërndarjes apo të falimentimit të personit juridik, mund të bëhet nga likuidatori apo administratori i falimentimit.

Ndaj debitorit, i cili jep deklaram të rremë, zbatohet neni 320 i Kodit Penal.

Neni 582

Përpara se të vihet sekuestro mbi këto sende, përmbaruesi gjyqësor sigurohet mbi ekzistencën e kredive të debitorit dhe të sendeve që personat e tretë i detyrohen atij, në bazë të

dokumenteve dhe të dhënave të tjera të siguruara kryesisht nga përmbauesi.

Neni 583

Kundërshtimi i personit të tretë

(Ndryshuar paragrafi II, III me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 118)

Personi i tretë, brenda pesë ditëve nga lajmërimi i sekuestrimit, është i detyruar t'i përgjigjet përmbauesit gjyqësor:

- a) nëse pranon se kredia ose sendet, mbi të cilat është vendosur sekuestroja, janë të debitorit dhe nëse është gati të shlyejë kredinë ose të dorëzojë sendet;
- b) nëse mbi kredinë ose mbi sendet kanë pretendime edhe persona të tjerë;
- c) nëse mbi kredinë ose mbi sendet është vënë sekuestër edhe në bazë të një urdhri tjetër ekzekutimi.

203

Personi i tretë dhe, kur ky është institucion apo ndërmarrje shtetërore, personi përkatës, që nuk jep përgjigje brenda afatit të mësipërm, dënohen nga përmbauesi gjyqësor me gjobë nga 1 000 deri në 50 000 lekë. Kjo pasojë duhet të përmendet në lajmërimin e sekuestrimit. Kundër vendimit të përmbauesit mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga komunikimi i tij.

Neni 584

Kur personi i tretë në përgjigjen e tij nuk kundërshton që kredia ose sendet të jenë të debitorit, detyrohet t'ia dorëzojë këto përmbauesit gjyqësor, i cili vepron sipas rregullave të mësipërme.

Neni 585

Kur personi i tretë në përgjigjen e tij kundërshton që kredia ose sendet të jenë të debitorit, ekzekutimi mbi to nuk mund të vazhdojë dhe kreditori duhet të ngrejë padi për të vërtetuar se kredia ose sendet që ka personi i tretë janë të debitorit të tij.

Neni 586

Kredia e siguar me peng ose me hipotekë

Kur kredia e sekuestruar është siguar me peng, personi që mban sendin mbi të cilin është vënë peng detyrohet të mos ia dorëzojë këtë send asnjë personi pa urdhrin e përmbauesit gjyqësor.

Kur kredia e sekuestruar është *siguar me hipotekë, në regjistrat e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme duhet të bëhet shënim për vënien e sekuestro.*

Neni 587

Sekuestroja mbi shpërblimet e tjera

204

Sekuestroja mbi pagën shtrihet jo vetëm në pagën që tregohet në lajmërimin e sekuestrimit, por edhe në çdo shpërblim tjetër që debitori merr nga e njëjta punë ose nga një punë tjetër, në të njëjtin person fizik apo juridik, shtetëror apo privat.

Kur debitori ndërron vendin e punës, lajmërimi i sekuestrimit i dërgohet qendrës së re të punës nga qendra ku punonte më parë debitori dhe quhet se i është dërguar nga përmbauesi gjyqësor. Në këtë rast si dhe në rastin që debitori pushohet nga puna duhet të lajmërohet përmbauesi gjyqësor brenda pesë ditëve.

Neni 588

Përgjegjësia për moszbatimin e urdhrit të përmbauesit

(Ndryshuar paragrafi I, shtuar paragrafi II me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 119)

Kur personi kompetent, në qendrën e punës në të cilën punon debitori, nuk bën ndalesat nga

paga e debitorit, sipas lajmërimit të përmbaruesit gjyqësor ose nuk lajmëron përmbaruesin gjyqësor për kalimin e debitorit në një punë tjetër ose për pushimin e tij nga puna, dënohen nga përmbaruesi gjyqësor me gjobë deri në 30 000 lekë.

Kundër vendimit të përmbaruesit mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga komunikimi i tij.

Personi i dënuar ka të drejtë të kërkojë shkarkimin e tij nga dënimi, sipas rregullave të caktuara në nenin 169 të këtij Kodi.

KREU V

EKZEKUTIMI I DETYRIMEVE NË TË HOLLA NDAJ INSTITUCIONEVE BUXHETORE

Ekzekutimi ndaj detyrimeve të shtetit

Neni 589

205

(Ndryshuar me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 120)

(Ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 44)

Ekzekutimi i detyrimeve në të holla ndaj institucioneve buxhetore bëhet vetëm në llogarinë e tyre përkatëse bankare, në kredi që ata kanë te të tretët dhe kur nuk ka të tilla në llogari të thesarit. Nuk lejohet ekzekutimi i detyrueshëm mbi *pasurinë e luajtshme e të paluajtshme të institucionit buxhetor*.

Kur institucioni buxhetor nuk ka gjendje në llogarinë bankare, as kredi te të tretët dhe as në thesar, i kërkohet organit epror financiar përkatës të caktojë fondin e nevojshëm e kapitullin e buxhetit të subjektit nga do të shlyhet detyrimi ose financim të veçantë nga Buxheti i Shtetit.

Kur detyrimi i shteti është në metale të çmuara, ekzekutimi bëhet me pëlqimin paraprak të Ministrisë të Financave.

Këshilli i Ministrave nxjerr udhëzim për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit.

Neni 590

Ekzekutimi i detyrueshëm ndaj kredive të caktuara të debitorit të huaj bëhet vetëm kur nuk ka ndalim ose kufizim me ligj të veçantë ose me marrëveshje ndërkombëtare shtetërore.

Neni 591

Ekzekutimi ndaj detyrimeve të shtetit

(Shfuqizuar me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 121)

Neni 592

Ekzekutimi kur personi juridik shpërndahet ose falimenton

Kur detyrimi rëndon mbi një person juridik që shpërndahet ose falimenton, ekzekutimi bëhet nëpërmjet organit që realizon këto veprime, sipas dispozitave të veçanta.

206

KREU VI

EKZEKUTIMI MBI SHUMAT E LLOGARIVE NË BANKA

Neni 593

Detyrimet e bankave për të informuar zyrat e përmbarimit

(Ndryshuar paragrafi II me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 122)

(Ndryshuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 45)

Përmbaruesi gjyqësor, njofton të gjitha bankat shtetërore dhe private të cilat janë të detyruara të informojnë zyrën përkatëse të përmbarimit kur kanë llogari, depozita ose kredi në emër të debitorit, në të kundërt përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal.

Neni 594

Vënia e sekuestro mbi llogarinë e debitorit

Banka, me të marrë urdhrin e ekzekutimit, ve sekuestro mbi llogarinë, depozitat dhe kreditë e debitorit në masën e nevojshme për ekzekutimit e detyrimit, pa pezulluar pagimin e kredive që sipas nenit 605 të Kodit Civil paguhen me preferim ndaj kredisë për të cilën është vënë sekuestro.

Neni 595

(Ndryshuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 26)

Shumat e nxjerra nga llogaria, depozitat dhe kreditë e debitorit kalojnë në llogarinë e kreditorit në të njëjtën bankë ose në një bankë tjetër ose kur nuk ka të tilla në llogari të zyrës së përmbartimit ose në llogari të përmbartuesit gjyqësor.

Neni 596

Rastet e kthimit të urdhrin të ekzekutimit debitorit

(Shfuqizuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 46))

207

Neni 597

Respektimi i radhës së referimit

(Ndryshuar me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 123)

Kur shuma e llogarive, depozitave ose kredive nuk është e mjaftueshme për të shlyer detyrimet e paraqitura për ekzekutim, përmbartuesi gjyqësor respekton radhën e referimit që përcaktohet në nenin 605 të Kodit Civil.

Neni 598

Sanksionet dhe ankimi ndaj tyre

Kur përmbartuesi ka bazë të dyshojë se banka pa vend nuk e ekzekuton detyrimin tërësisht ose pjesërisht, shkel afatet e ekzekutimit, ose nuk respekton radhën e referimit, përmbartuesi ka të drejtë të verifikojë në vend dokumentacionin bankar në prani të punonjësit të ngarkuar nga organi drejtues i bankës, duke mbajtur procesverbalin përkatës.

Kur konstatohen shkelje apo parregullsi përmbartuesi fikson në procesverbal veprime dhe afate të detyrueshme për bankën.

Për shkeljet dhe parregullsitë përmbartuesi ka të drejtë të zbatojë masat e parashikuara në nenin 588 të këtij Kodi, sipas rastit, ndaj punonjësit bankar fajtor ose ndaj organit drejtues të saj, që ka urdhëruar veprime të parregullta.

Neni 599

(Ndryshuar me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 126)

Kundër vendimit të dënimit me gjobë mund të bëhet ankimi i veçantë në gjykatën e shkallës së parë brenda pesë ditëve nga marrja e dënimit.

Neni 600

Banka nxjerr udhëzimet e nevojshme

208

Banka e Shqipërisë nxjerr udhëzimet e nevojshme për mënyrën e zbatimit të dispozitave të mësipërme, të detyrueshme për të gjithë sistemin bankar.

KREU VII

EKZEKUTIMI I DETYRIMIT PËR DORËZIMIN E NJË SENDI TË CAKTUAR

Neni 601

Vënia në posedim e sendit të luajtshëm

Kur sendi i luajtshëm, për të cilin është dhënë vendim, nuk është dorëzuar vullnetarisht nga debitori, brenda afatit të caktuar në lajmërimin e përmbartuesit gjyqësor, merret në mënyrë të detyrueshme prej tij dhe i dorëzohet kreditorit.

Kur sendi nuk ndodhet pranë debitorit ose është prishur, ose pranë tij ndodhet vetëm një pjesë, merret nga debitori vlefata e sendit ose e pjesës që mungon. Kur në urdhrin e ekzekutimit nuk tregohet vlefata e sendit, kjo caktohet nga gjykata e vendit të ekzekutimit, pasi të dëgjohen palët dhe, në rast nevojë, të pyeten edhe dëshmitarë dhe ekspertë. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë.

Neni 601/a

(Shtuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 47)

Sendet e luajtshme, që ndodhen brenda sendit të paluajtshëm, të vënë në posedim, sipas nenet 602 të këtij Kodi, duhet të zhvendosen në përgjegjësinë e përmbaruesit dhe t'i dorëzohen debitorit ose familjarëve të tij menjëherë. Në rast se debitori ose familjarët e tij nuk janë të pranishëm gjatë lirimit, përmbaruesi mund t'i magazinojë pasuritë e luajtshme në:

a) mjedisin e liruar, në marrëveshje me kreditorin, për një periudhë kohe prej 2 muajsh;
b) në mjediset, që disponon shërbimi përmbarimor, për ruajtjen e sendeve, për një periudhë kohe prej 2 muajsh;

209

c) në një vend neutral, ku sendet e luajtshme mund të ruhen në mënyrë të sigurt, për një periudhë kohe prej 2 muajsh;

ç) në rezervat e shtetit, sipas rregullave në fuqi për ruajtjen e sendeve.

Për magazinimin e sendeve, sipas shkronjave "b" dhe "c" të këtij neni, shpenzimet paguhën nga debitori në çastin e marrjes në dorëzim të sendeve.

Nëse brenda 2 muajve nga lirimi, debitori nuk i kërkon sendet e tij të luajtshme, sipas shkronjave të mësipërme, apo nuk paguan të gjitha shpenzimet e lirimit dhe të magazinimit, sipas shkronjave "b" dhe "c" të këtij neni, sendet e luajtshme, të sekuestrueshme, do të shiten nga përmbaruesi gjyqësor, sipas dispozitave të pjesës IV të kreut II të këtij Kodi. Përmbaruesi, pasi zbret nga shuma e përfitur nga shitja me ankand të gjitha shpenzimet për lirim dhe magazinimin e sendeve të debitorit, derdh pjesën që mbetet në një llogari bankare, në emër të debitorit. Sendet e pasekuestrueshme i kthehen debitorit, pavarësisht vendit se ku ruhen, pa i kërkuar atij që të paguajë shpenzimet.

Sendet e luajtshme, të ndodhura brenda sendit të paluajtshëm, që nuk mund të shiten dhe nuk kërkohen nga debitori, asgjësohen apo i kalojnë institucioneve shtetërore ose enteve publike shtetërore kalim kapital.

Neni 602

Vënia në posedim e sendit të paluajtshëm

Kur sendi i paluajtshëm, për të cilin është dhënë vendim, nuk është liruar vullnetarisht nga debitori brenda afatit të caktuar në lajmërimin e përmbaruesit gjyqësor, kreditori vihet në posedim të sendit. Për këtë përmbaruesi gjyqësor, të paktën tri ditë përpara, i njofton debitorit ditën dhe orën, në të cilën do të vërë kreditorin në posedim të sendit.

Në ditën dhe orën e caktuar përmbaruesi gjyqësor, i pajisur me urdhrin e ekzekutimit, shkon në vendin ku ndodhet sendi dhe vë kreditorin në posedim të tij, duke porositur personat e tjerë të cilët mbajnë sendin që ta njohin si pronar kreditorin.

Neni 603

Vënia në posedim e sendit të ndodhur te personi i tretë

210

Kur përmbaruesi gjyqësor konstaton se sendi i paluajtshëm ndodhet në posedim të një personi të tretë, i cili ka fituar për vete posedimin e sendit, pas fillimit të çështjes për të cilën është dhënë vendimi që ekzekutohet, e vë kreditorin në posedim të sendit, duke treguar në vendim se si ka konstatuar kohën në të cilën personi i tretë ka fituar posedimin.

Neni 604

Përgjegjësia penale e debitorit dhe e personit të tretë

Kur debitori ose personi i tretë, të cilit i është hequr posedimi i sendit të paluajjtshëm, vihet përsëri me çdo mënyrë të paligjshme në posedimin e këtij sendi, përmbaruesi gjyqësor, me kërkesën e kreditorit, i heq atij përsëri posedimin e sendit.

Në këto raste, debitori ose personi i tretë kanë përgjegjësi, sipas dispozitave të Kodit Penal.

KREU VIII

EKZEKUTIMI I DETYRIMIT PËR KRYERJEN E NJË VEPRIMI TË CAKTUAR

Neni 605

Rastet kur lejohet kreditori të kryejë vetë ekzekutimin

Kur debitori nuk ekzekuton detyrimin e tij, që ka të bëjë me një veprim që mund ta kryejnë edhe persona të tjerë, kreditori mund të kërkojë nga përmbaruesi gjyqësor që të lejohet ta kryejë vetë këtë veprim për llogari të debitorit.

Neni 606

Sanksionet për moskryerjen e veprimit nga debitori

(Ndryshuar me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 124)

Ndaj debitorit që refuzon, kryen në mënyrë të parregullt, nuk respekton afatet ose kryen të kundërtën e asaj që me vendim të gjykatës është i detyruar, kur nuk ka vend për përgjegjësi

211

penale, përmbaruesi gjyqësor ka të drejtën e gjobitjes deri 50 000 lekë në çdo rast deri në ekzekutimin e detyrimit.

Kundër vendimit të përmbaruesit gjyqësor mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga komunikimi i tij.

Ndaj personave të tjerë, që sipas urdhrit të ekzekutimit ose ligjit janë të detyruar të kryejnë veprime të caktuara, në rastet e përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni, përmbaruesi gjyqësor ka të drejtën e gjobitjes deri në 50. 000 lekë.

Kundër vendimit të përmbaruesit mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga komunikimi i tij.

Neni 607

(Shfuqizuar me ligjin nr.8431, datë 14.12.1998, neni 12)

Neni 608

Ankimi

(Shfuqizuar me ligjin nr.8431, datë 14.12.1998, neni 12)

KREU IX

MJETET E MBROJTJES KUNDËR EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE

Neni 609

Pavlefshmëria e titullit ekzekutiv

(Ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 48)

Debitori mund të kërkojë në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit që të deklarohet se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm ose se detyrimi nuk ekziston, ose ekziston në një masë më të vogël ose është shuar më pas.

Kur titulli ekzekutiv është një vendim gjyqësor ose vendim arbitrazhi, debitori mund të kundërshtojë ekzekutimin e titullit vetëm për fakte të ngjara pas dhënies së këtyre vendimeve.

212

Në këto raste, gjykata shqyrton çështjen brenda 5 ditëve dhe mund të vendosë pezullimin e vendimit me ose pa garanci. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë.

Neni 610

Kundërshtimi i veprimeve të përmbauesit gjyqësor

(Shtuar paragrafi III me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 125)

(Ndryshuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 49)

Kundër veprimeve të përmbauesit gjyqësor dhe kundër refuzimit të tij për të kryer një veprim, palët mund të bëjnë ankim në gjykatën që ekzekuton vendimin brenda 5 ditëve nga dita e kryerjes së veprimit apo refuzimit, kur palët kanë qenë të pranishme në kryerjen e veprimit ose kanë qenë thirrur edhe në raste të tjera nga dita që i është njoftuar ose ka marrë dijeni për veprimin ose refuzimin.

Kundër veprimeve të personave, përmbauesit gjyqësorë, që ushtrojnë veprimtarinë publike të shërbimit përmbauesit gjyqësor të organizuar mbi baza private, pala debitorë mund të paraqesë ankim në gjykatën, ku ekzekutohet titulli ekzekutiv, brenda 5 ditëve nga data e kryerjes së veprimit.

Ankimi shqyrtohet brenda 20 ditëve nga gjykata e vendit të ekzekutimit, e cila kur e sheh të nevojshme mund të thërrasë edhe palët.

Përmbauesi gjyqësor thirret nga gjykata me cilësinë e palës së paditur.

Neni 611

Ankimi ndaj vendimit të gjykatës

Ankimi kundër veprimeve ose refuzimit të përmbauesit gjyqësor nuk pezullon ekzekutimin, përveç kur gjykata vendos ndryshe.

Kundër vendimit të gjykatës bëhet ankim i veçantë.

Neni 612

Padia për kërkimin e sendit nga personi i tretë

213

Çdo person i tretë që pretendon se është pronar i sendit mbi të cilin bëhet ekzekutimi, mund të ngrejë padi për të ushtruar të drejtën e tij dhe kur është rasti për të përjashtuar sendin nga sekuestrimi dhe shitja.

Padia ngrihet kundër kreditorit dhe debitorit në gjykatën e vendit të ekzekutimit të vendimit. Në këto raste, gjykata mund të vendosë si masë të përkohshme pezullimin e ekzekutimit me ose pa garanci.

Neni 613

Efektet juridike ndaj personit të tretë

Kur gjykata pranon se personi i tretë është pronar i sendit të luajtshëm të sekuestruar, por në kohën që vendimi ka marrë formë të prerë sendi është shitur në dyqanin me shitje të lirë ose në ankand, personi i tretë ka të drejtë të kërkojë nga përmbauesi gjyqësor çmimin e shitjes, në qoftë se nuk i është dhënë kreditorit, në të kundërt ka të drejtë të kërkojë prej debitorit atë që ka përfituar nga shitja e sendit.

Kur vërtetohet se kreditori ka ditur në kohën e shitjes së sendit të luajtshëm se debitori nuk ishte pronar i tij, ai detyrohet t'i kthejë pronarit të mëparshëm çmimin që ka marrë nga shitja e sendit dhe në qoftë se sendi i është dhënë atij në vend të kredisë së tij, detyrohet t'i kthejë sendin. Në këto raste kreditori ruan të drejtën e tij të kredisë kundrejt debitorit.

Neni 614

Kur gjykata pranon se personi i tretë është pronar i sendit të paluajtshëm të shitur në ankand dhe në bazë të vendimit që ka marrë formë të prerë, sendi i merret blerësit, ky ka të drejtë të kërkojë nga përmbauesi gjyqësor çmimin që ka paguar në qoftë se ky nuk i është dhënë kreditorit. Kur ky i është dhënë kreditorit ka të drejtë të kërkojë prej tij si dhe nga debitori atë pjesë të çmimit që ka marrë nga shitja e sendit.

Blerësi ka të drejtë, po ashtu, të kërkojë nga organi shtetëror kompetent që t'i kthehen

shumat që ai kishte paguar si taksë për kalimin e sendit në pronësi të tij.

Kur sendi i paluajtshëm i është dhënë kreditorit kundrejt kredisë së tij, në bazë të vendimit të gjykatës, sendi i merret këtij, ky ruan të drejtën e tij, të kredisë kundrejt debitorit.

214

KREU X

PEZULLIMI E PUSHIMI I EKZEKUTIMIT

Neni 615

Pezullimi i ekzekutimit

(Ndryshuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 50)

Ekzekutimi pezullohet:

a) me vendim të gjykatës;

b) me kërkesë të kreditorit;

c) me rastet e parashikuara nga shkronjat “c” dhe “ç” të nenit 297 të këtij Kodi, me përjashtim të shitjes në ankand të një sendi të paluajtshëm, për të cilin është shpallur lajmërimi; ç) në raste të tjera të parashikuara nga ligji.

d) kur përmbaruesi gjyqësor, vetë ose me kujdesin e kreditorit, nuk gjen pasuri të debitorit, brenda 6 muajve nga fillimi i ekzekutimit;

dh) kur kreditori nuk paraqitet, pa shkaqe të arsyeshme, brenda 3 muajve nga njoftimi i dytë shkresor, bërë nga përmbaruesi gjyqësor.

Pas rënies së masës së pezullimit, ekzekutimi vazhdon nga veprimi procedural i mbetur në çastin e pezullimit.

Neni 616

Pushimi i ekzekutimit

(Shfuqizuar shkronja d me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 51)

Ekzekutimi pushon:

a) kur debitori i paraqet përmbaruesit gjyqësor dëftesën me nënshkrimin e kreditorit, të vërtetuar rregullisht, se ka paguar shumën që shënohet në urdhrin e ekzekutimit ,ose kuitancë të zyrës postare ose shkresë të bankës me të cilat vërtetohet se shuma që shënohet në urdhrin e ekzekutimit është derdhur në dobi të kreditorit;

b) kur kreditori heq dorë me shkresë nga ekzekutimi;

215

c)kur urdhri i ekzekutimit shfuqizohet;

ç) kur me vendim të gjykatës që ka marrë formën e prerë, është pranuar padia e debitorit sipas nenit 610 të këtij Kodi, ose e personit të tretë sipas nenit 613 të këtij Kodi;

d) shfuqizuar.

Neni 617

Ankimi kundër pezullimit dhe pushimit të ekzekutimit

(Ndryshuar fjalia e parë e paragrafit të tretë me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 52)

Pezullimi i ekzekutimit, përveç rastit kur vendoset nga gjykata, si dhe pushimi i ekzekutimit vendosen nga përmbaruesi gjyqësor.

Kundër këtyre vendimeve mund të bëhet ankim në gjykatën e shkallës së parë (neni 611 i këtij Kodi).

Kur vendimi i pushimit të ekzekutimit merr formën e prerë, përmbaruesi gjyqësor e heq sekuestron e vënë mbi sendet e luajtshme ose të paluajtshme dhe në rastin e parashikuar nga shkronja “b” e nenit 616 të këtij Kodi, i kthen urdhrin e ekzekutimit kreditorit, i cili ka të drejtë të paraqesë kërkesë të re për ekzekutim brenda kohës së parashkrimit. Në këtë rast, parashkrimi i ri fillon nga dita që vendimi për pushimin e ekzekutimit ka marrë formën e prerë.

KREU XI

DISPOZITA TRANZITORE DHE TË FUNDIT

Neni 618

Çështjet që janë në gjykim në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Kodi do të gjykohen sipas kodit të mëparshëm derisa vendimi të marrë formën e prerë sipas nenit 451 të këtij Kodi.

Neni 619

216

Rekurset kundër vendimeve të gjykatës së apelit dhe kërkesat për mbrojtje të ligjmerisë përpara Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë të regjistruara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Kodi do të shqyrtohen sipas dispozitave të kodit të mëparshëm.

Neni 620

Me hyrjen në fuqi të këtij Kodi shfuqizohen: ligji nr.6341, datë 27.6.1981 “Për Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”, ligji nr.7537, datë 17.12.1991 “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”, ligji nr.7922, datë 19.4.1995 “Për një ndryshim në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”, kreu XI/ “Amortizimi” nenet 59a, 59b, 59c të ligjit nr.7782, datë 26.1.1994 “Për disa ndryshime në dekretin nr.3702, datë 8.7.1963 “Për Çekun”, si dhe çdo dispozitë tjetër që vjen në kundërshtim me këtë Kod.

Dispozita kalimtare

(Shtuar me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 127)

Çështjet civile që janë në gjykim ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që sipas Kodit të Procedurës Civile duhet të gjykohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, për të cilat ky ligj parashikon gjykimin e tyre me një gjyqtar, do të vazhdojnë të gjykohen nga i njëjti trup gjykues derisa vendimi të marrë formë të prerë.

Kërkesat që kanë të bëjnë me përjashtimin e gjyqtarit, kërkesëpaditë me objekt kundërshtimi i të tretit, rishikimi i vendimit, si dhe rekurset në interes të ligjit, të paraqitura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë të gjykohen sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile.

Dispozitë kalimtare

(Parashikuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 53)

217

Çështjet që janë në procedurë ekzekutimi në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të ekzekutohen sipas procedurave ligjore të mëparshme, derisa ekzekutimi i urdhrit ekzekutiv të jetë pezulluar, pushuar ose të ketë përfunduar.

Neni 621

Ky Kod hyn në fuqi më 1 qershor 1996.

Shpallur me dekretin nr.1474, datë 18.4.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.

Pjesë nga Kodi Penal i miratuar me ligjin Nr.7895, datë 27.1.1995 (neni 320)

Neni 320

Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës

Fshehja, tjetërsimi, konsumimi, dëmtimi apo shkatërrimi i sendeve për të cilat është marrë një vendim prej gjykatës, ose kryerja e veprimeve të tjera të bëra me qëllim që të mos ekzekutohet ose të pengohet ekzekutimi i vendimit gjyqësor, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 320/a

Mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura i vendimit të gjykatës

(Shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 78)

218

Mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura i një vendimi penal ose civil të gjykatës, nga punonjësi i ngarkuar me ekzekutimin e vendimeve, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Kur kjo vepër kryhet me qëllim fitimi ose çdo interes tjetër të dhënë ose të premtuar, si dhe për të favorizuar persona që kanë interes për mosekzekutimin e vendimit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

219

LIGJ

Nr.10 031, datë 11.12.2008

PËR SHËRBIMIN PËRMBARIMOR GJYQËSOR PRIVAT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i ligjit

Ky ligj ka si objekt të përcaktojë mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Privat, kriteret që duhet të përmbushin shtetasit për të ushtruar detyrën e përmbaruesit gjyqësor privat, statusin, masat disiplinore, detyrat, përgjegjësitë, tarifatat, si dhe marrëdhëniet me institucionet shtetërore dhe me subjektet e tjera publike dhe private.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për përmbaruesit gjyqësorë privatë, që kryejnë veprimet e tyre procedurale për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, Kodit Civil, akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, si dhe për subjektet e tjera private dhe shtetërore, që përfshihen në procesin e ekzekutimit.

220

Neni 3

Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor

Shërbimi Përmbarimor në Republikën e Shqipërisë organizohet në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, sipas ligjit nr.8730, datë 18.1.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor” dhe në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat.

Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Privat rregullohet sipas këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore.

KREU II

SHËRBIMI PËRMBARIMOR GJYQËSOR PRIVAT

Neni 4

Subjektet që ushtrojnë Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat

Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Privat ushtrohet nga persona fizikë, të licencuar sipas dispozitave të këtij ligji.

Një ose më shumë përmbarues gjyqësorë privatë, për të ushtruar veprimtarinë e tyre,

mund të organizohen në një shoqëri tregtare, parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Vetëm përbaruesit gjyqësorë të licencuar mund të jenë ortakë, aksionarë ose administratorë të një shoqërie përbaruese private.

Përbaruesit gjyqësorë privatë dhe shoqëritë përbaruese private duhet të regjistrohen në Ministrinë e Drejtësisë, siç parashikohet në këtë ligj.

Neni 5

Funksioni publik i Shërbimit Përbarimor Gjyqësor Privat

Për efekt të këtij ligji, Shërbimi Përbarimor Gjyqësor Privat është një funksion i pavarur me karakter publik, i cili ushtrohet nga përbaruesit gjyqësorë privatë dhe shoqëritë përbaruese private.

221

Përbaruesit gjyqësorë privatë ose shoqëritë përbaruese private, në ushtrimin e funksioneve të tyre, i nënshtrohen zbatimit të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, Kodit Civil dhe ligjeve të tjera për ekzekutimin e titujve ekzekutivë.

Neni 6

Statusi ligjor i përbaruesit gjyqësor privat

Përbaruesi gjyqësor privat kryen dhe mban detyrën në emër të tij dhe nën përgjegjësinë vetjake. Vetëm personat e licencuar, sipas kritereve dhe rregullave të përcaktuara në këtë ligj mund të kryejnë procedura ekzekutimi brenda funksionit të Shërbimit Përbarimor Gjyqësor Privat.

Neni 7

Juridiksioni territorial i Shërbimit Përbarimor Gjyqësor Privat

Përbaruesi gjyqësor privat ose shoqëritë përbaruese private ushtrojnë funksionet e tyre procedurale përbarimore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 8

Papajtueshmëritë

Përbaruesi gjyqësor privat nuk mund të ushtrojë funksione publike, të praktikojë profesionin e noterit, avokatit ose çdo profesion tjetër, i cili është i papajtueshëm me ushtrimin e paanshëm të profesionit të tij.

Shoqëritë përbaruese private duhet të kenë si objekt të veprimtarisë së tyre tregtare vetëm ekzekutimin e titujve ekzekutivë.

Neni 9

Konflikti i interesit

Përbaruesi gjyqësor privat është i detyruar të mos pranojë kërkesën ose të heqë dorë

222

nga ekzekutimi kur ky ka filluar, nëse ai ka marrë dijëni ose duhet të kishte marrë dijëni për ekzistencën e një shkakut, që tregon një konflikt interesi, kur:

a) ka një interes personal, të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me të apo të afërmit e tij, në çështjen për të cilën kërkohet ose ka filluar ekzekutimi;

b) përbaruesi gjyqësor privat është kujdestar apo përfaqësues i njëjës prej palëve në proces ekzekutimi;

c) ai vetë, bashkëshortja ose të afërmit e tij deri në shkallën e dytë janë në konflikt gjyqësor, në marrëdhënie kredie ose huaje me njëjës prej palëve në proces ekzekutimi;

ç) përbaruesi gjyqësor privat është ortak ose aksionar në një shoqëri tjetër, e cila është palë në proces ekzekutimi;

d) ekziston një arsye serioze dhe e mjaftueshme që tregon një situatë konflikti interesi.

Nëse rrethana të tilla vërtetohen te një ortak, aksionar apo administrator i një shoqërie

përmbarese private, kjo shoqëri është e detyruar që të mos pranojë kërkesën apo të heqë dorë nga ekzekutimi, kur ky ka filluar.

Neni 10

Përgjegjësitë e Ministrit të Drejtësisë

Ministri i Drejtësisë ushtron përgjegjësitë e mëposhtme:

- a) jep, pezullon ose heq licencat e përmbareseve gjyqësorë privatë;
- b) kontrollon, nëpërmjet strukturave të Ministrisë së Drejtësisë, zbatimin e këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, lidhur me veprimtarinë e përmbareseve gjyqësorë privatë;
- c) miraton Kodin e Etikës së përmbareseve gjyqësorë privatë;
- ç) fillon procedimin disiplinor ndaj përmbareseve gjyqësorë privatë dhe, kur është rasti, merr masa disiplinore;
- d) miraton komisionin vlerësues për provimin e kualifikimit të përmbareseve gjyqësorë privatë;
- dh) miraton modelin e kontratës, që do të lidhet midis përmbareseve gjyqësorë privatë dhe palës së interesuar;
- e) përcakton, në bashkëpunim me Ministrin e Financave, tarifat përkatëse për kryerjen e shërbimit të përmbareseve gjyqësorë privatë;
- 223
- ë) përcakton një të deleguar në mbledhjet e Këshillit Drejtues pa të drejtë vote;
- f) organizon provimin e kualifikimit për përmbareseve gjyqësorë privatë.

KREU III

LICENCIMI DHE REGJISTRIMI

Neni 11

Organi licencues

Ministri i Drejtësisë është autoriteti shtetëror, i cili i jep licencën personave që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre si përmbareseve gjyqësorë privatë, në përputhje me rregullat funksionale dhe organizative të këtij ligji.

Asnjë person nuk mund të fitojë titullin dhe të ushtrojë funksionin e përmbareseve gjyqësorë privatë, pa u pajisur më parë me licencën përkatëse nga Ministri i Drejtësisë.

Neni 12

Kushtet për licencimin e përmbareseve gjyqësorë privatë

Një person, që kërkon të licencohet si përmbareseve gjyqësorë privatë, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të ketë arsimin e lartë juridik;
- ç) të ketë eksperiencë pune 3 vjet si jurist;
- d) të ketë kaluar me sukses provimin e kualifikimit si përmbareseve gjyqësorë privatë;
- dh) të mos të jetë i dënuar për kryerjen e një vepre penale, me vendim të formës së prerë.

Neni 13

Provimi i kualifikimit

Provimi i kualifikimit, për ushtrimin e veprimtarisë si përmbareseve gjyqësorë privatë,

224

zhvillohet para një komisioni të caktuar nga Ministri i Drejtësisë.

Përbërja e komisionit, rregullat për funksionimin e tij, modalitetet, procedurat dhe mënyra e zhvillimit të provimit, si dhe tematika e provimit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 14

Përfshirja nga detyrimi i dhënies së provimit të kualifikimit

Përfshihen nga detyrimi për të dhënë provimin e kualifikimit ata persona, që u është pezulluar licenca e ushtrimit të veprimtarisë, në bazë të nenit 22 të këtij ligji.

Neni 15

Marrja e licencës dhe regjistrimi

Pas zhvillimit të provimit të kualifikimit, lista e kandidatëve fitues shpallet publikisht në mjediset e Ministrisë së Drejtësisë.

Pas shpalljes së listës, kandidatët fitues regjistrohen, me kërkesën e tyre, në regjistrin e përmbaruesve gjyqësorë privatë dhe pajisen me licencën përkatëse.

Neni 16

Regjistrimi i shoqërive përmbaruese private

Kur një apo më shumë përmbarues gjyqësorë privatë të licencuar krijojnë një shoqëri tregtare, në përputhje me legjislacionin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, personi juridik regjistrohet pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 17

Njoftimi i ndryshimit të vendit të ushtrimit të veprimtarisë

Kur përmbaruesi gjyqësor privat apo shoqëritë përmbaruese private ndryshojnë të dhënat, sipas nenit 19 të këtij ligji, duhet të njoftojnë menjëherë shkresërisht Ministrinë e Drejtësisë.

Struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Drejtësisë duhet të pasqyrojë ndryshimet përkatëse në regjistër.

Neni 18

Betimi i përmbaruesit gjyqësor privat

Përmbaruesi gjyqësor privat, para se të fillojë detyrën e tij, betohet përpara Ministrit të Drejtësisë apo personit të autorizuar prej tij, sipas formulës:

“Betohem se detyrat e përmbaruesit gjyqësor privat do t'i kryej në përputhje me ligjin, duke i qëndruar besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, do të ruaj sekretin profesional dhe gjatë veprimtarisë sime do të udhëhiqem nga parimet e profesionalizmit, paanësisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut”.

Neni 19

Regjistri i përmbaruesve gjyqësorë privatë

Regjistri i përmbaruesve gjyqësorë privatë krijohet pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Ky regjistër ndahet në dy pjesë.

Në pjesën e parë regjistrohen të dhënat e personave fizikë si më poshtë:

- a) identiteti;
- b) vendbanimi;
- c) numri i licencës;
- ç) data e fillimit të veprimtarisë përmbarimore;
- d) adresa e vendit, ku zhvillon veprimtarinë përmbarimore.

Në pjesën e dytë regjistrohen të dhënat e personave juridikë si më poshtë:

- a) emërtimi i shoqërisë;
- b) lloji i shoqërisë;
- c) selia e shoqërisë;
- ç) emri/emrat e administratorit/administratorëve;
- d) emrat e përmbaruesve gjyqësorë privatë, të punësuar në shoqëri.

Kur një përmbarues gjyqësor privat fillon ose shkëput marrëdhëniet e punës me personin

juridik, ky i fundit njofton me shkrim strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Drejtësisë. Struktura përgjegjëse është e detyruar të bëjë shënimet përkatëse në regjistrë.

Neni 20

Punësimi i përmbauesve gjyqësorë të palicencuar

Shoqëritë përmbauese private dhe përmbauesit gjyqësorë privatë nuk do të caktojnë apo autorizojnë asnjë person, që të veprojë në emër të tyre në një procedurë ekzekutimi, në rast se ky nuk është i licencuar sipas këtij ligji, apo i është hequr licenca.

KREU IV

ÇREGJISTRIMI

Neni 21

Çregjistrimi nga regjistri i profesionit të përmbauesit gjyqësor privat

Përmbauesit gjyqësor i hiqet licenca dhe çregjistrohet nga regjistri në rastet kur:

- a) heq dorë me kërkesën e tij nga ushtrimi i profesionit të përmbauesit gjyqësor privat;
- b) humbet apo i kufizohet zotësia për të vepruar;
- c) dënohet penalisht me një vendim të formës së prerë të gjykatës;
- ç) i nënshtrohet procedurës së falimentimit;
- d) ndaj tij jepet masa disiplinore e heqjes së licencës;
- dh) nuk paraqet kërkesë për rifillimin e veprimtarisë, në rast se licenca është pezulluar.

Neni 22

Pezullimi i veprimtarisë përmbaimore

Kur përmbauesi gjyqësor privat emërohet apo zgjidhet në detyra shtetërore, administrative, publike, me kërkesën e tij, apo me nismën e Ministrit të Drejtësisë, licenca për ushtrimin e veprimtarisë pezullohet për aq kohë sa zgjat detyra.

Për rifillimin e veprimtarisë përmbaimore, subjekti fizik i drejtohet Zyrës së Regjistrimit të

227
përmbauesve gjyqësorë privatë, e cila, me miratimin e Ministrit të Drejtësisë, brenda 5 ditëve kryen veprimet përkatëse.

Kur me kalimin e një viti nga mbarimi i detyrës, subjekti fizik nuk paraqet kërkesë për rifillimin e veprimtarisë, ai çregjistrohet nga regjistri i profesionit të përmbauesit gjyqësor privat.

KREU V

ORGANET DREJTUESE DHE KOMPETENCAT E DHOMËS KOMBËTARE TË PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

Neni 23

Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë

Përmbauesit gjyqësorë privatë organizohen në shkallë vendi, nëpërmjet përfaqësimit profesional në Dhomën Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë.

Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë është person juridik, që ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur nga shteti.

Neni 24

Anëtarësimi

Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë përbëhet nga përmbauesit gjyqësorë, të cilët janë pajisur me licencë nga Ministri i Drejtësisë.

Neni 25

Detyrat e Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë

Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë ka kompetencat e mëposhtme:

- a) siguron zbatimin e kritereve profesionale dhe etike, me të cilat duhet të veprojnë përmbauesit gjyqësorë privatë, gjatë ushtrimit të funksionit të tyre;
- b) nxjerr direktiva, lidhur me funksionimin e veprimtarisë së përmbauesve gjyqësorë 228 privatë;
- c) mbikëqyr ushtrimin e profesionit të përmbauesit gjyqësor privatë;
- ç) zgjedh organet drejtuese të Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë;
- d) harton modelin e kontratës, që do të lidhet midis përmbauesit gjyqësor privatë dhe palës së interesuar, përpara fillimit të procedurave të ekzekutimit;
- dh) cakton kuotat, që duhet të derdhen përmbauesit gjyqësorë privatë në llogarinë e Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë;
- e) përfaqëson Shërbimin Përmbauesor Gjyqësor Privat në marrëdhënie me Ministrinë e Drejtësisë, organet e tjera të administratës shtetërore, organizmat ndërkombëtarë dhe palët e treta.

Neni 26

Organet drejtuese të Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë

Organet drejtuese të Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë janë asambleja e përgjithshme dhe këshilli drejtues.

Neni 27

Asambleja e përgjithshme

Organi më i lartë i përfaqësimit dhe vendimmarrjes së Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë është asambleja e përgjithshme.

Asambleja e përgjithshme përbëhet nga të gjithë përmbauesit gjyqësorë privat, që janë të pajisur me licencë.

Mbledhjet e asamblesë së përgjithshme organizohen kur janë të pranishëm jo më pak se 1/2 e përmbauesve gjyqësorë privatë.

Neni 28

Kompetencat e asamblesë së përgjithshme

Asambleja e përgjithshme ka këto kompetenca:

229

- a) zgjedh këshillin drejtues të përmbauesve gjyqësorë privatë, kryetarin, nënkryetarin dhe sekretarin e përgjithshëm;
- b) miraton çdo vit buxhetin e Dhomës së Përmbauesve Gjyqësorë Privatë;
- c) miraton statutin e ushtrimit të veprimtarisë së përmbauesit gjyqësor privat;
- ç) miraton rregulloren e organizimit të mbledhjeve dhe rregulloren e zgjedhjes së anëtarëve të këshillit drejtues;
- d) miraton Statutin e Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë;
- dh) çdo akt tjetër që është i nevojshëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë së Shërbimit Përmbauesor Gjyqësor Privat.

Vendimet e asamblesë së përgjithshme merren me shumicë votash.

Neni 29

Këshilli drejtues

Këshilli drejtues përbëhet nga 7 përfaqësues të zgjedhur nga asambleja e përgjithshme.

Neni 30

Kompetencat e këshillit drejtues

Këshilli drejtues ka këto kompetenca:

- a) harton Statutin e Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë;
 - b) miraton programet e trajnimit vazhdues të përmbauesve gjyqësorë privatë;
 - c) kujdeset për funksionimin normal të përmbauesve gjyqësorë privatë si person juridik apo ortakëri ose shoqëri tregtare;
 - ç) jep mendime, kur i kërkohet, për projektligje dhe rregullore, që kanë të bëjnë me profesionin e përmbauesit gjyqësor privat;
 - d) miraton rregulloren për trajtimin e ankesave dhe për çdo çështje në kompetencë të tij;
 - dh) bashkërendon dhe përkrah nismat, që kanë si qëllim përmirësimin dhe ngritjen profesionale;
 - e) thërret mbledhjen e asamblesë së përgjithshme;
 - ë) bashkëpunon me strukturat drejtuese të Dhomës së Avokatisë dhe Dhomës së Noterisë
- 230
- për probleme, që kanë të bëjnë me çështjet e ekzekutimit.

KREU VI

TE DREJTAT, DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE MBROJTJA E VEÇANTË E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË TË LICENCUAR

Neni 31

Të drejtat e përmbauesit gjyqësor privat

Përmbauesi gjyqësor privat ka të drejtat e mëposhtme:

- a) të pranojë lirisht kërkesat e subjekteve fizike apo juridike për ekzekutimin e titujve ekzekutivë, me përjashtim të rastit kur konstaton se është në situatën e konfliktit të interesit;
- b) të kërkojë, kur e konsideron të nevojshme për veprimtarinë e tij procedurale, çdo informacion, që ka të bëjë me gjendjen pasurore të debitorit apo vendndodhjen e tij, të nevojshëm për procedurat e ekzekutimit, nga institucione shtetërore, persona juridikë apo fizikë, në përputhje me ligjin;
- c) të ketë mbështetjen e forcave të rendit, kur e çmon të domosdoshme, gjatë procedurave të ekzekutimit;
- ç) të zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratën e lidhur me palën kreditore, kur kjo e fundit nuk përmbush detyrimet e veta;
- d) të aplikojë sanksionet e parashikuara në ligj, ndaj subjekteve fizike apo juridike, që pengojnë në mënyrë të paligjshme procedurën e ekzekutimit, në përputhje me nenin 46 të këtij ligji.

Neni 32

Detyrat e përmbauesit gjyqësor privat

Përmbauesi gjyqësor privat ka këto detyra:

- a) të veprojë me ndershmëri, paanësi, profesionalizëm dhe kurdoherë në interes të palës kërkuese, pa cenuar në mënyrë të paligjshme të drejtat dhe interesat e palës tjetër;
 - b) të zbatojë me përpikëri dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe aktet e tjera ligjore
- 231
- e nënligjore;
- c) të kryejë për subjektet fizike ose juridike veprimet e nevojshme, që synojnë realizimin e së drejtës së tyre dhe mbrojtjen e interesave të tyre të ligjshëm;
 - ç) të informojë për çdo veprim procedural palët në proces ekzekutimi, si dhe të japë sqarimet e nevojshme për veprimet e kryera;
 - d) të këshillojë palën kreditore për pasojat juridike, që rrjedhin nga veprimet procedurale, me qëllim që të mos dëmtohen interesat e tyre;
 - dh) të ruajë sekretin profesional dhe të mos zbulojë të dhëna, që i kanë mësuar gjatë

veprimtarisë së tyre profesionale ose nga dokumentet, që i janë vënë në dispozicion nga palët në proces ekzekutimi, përveç kur dhënia e këtij informacioni është detyrim ligjor;

e) të sigurojë pranë një shoqërie sigurimi veprimtarinë e tij profesionale;

ë) të mbajë regjistrin, në përputhje me dokumentacionin standard, të miratuar nga Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, ku evidentohen të gjitha aktet dhe veprimet procedurale të kryera gjatë veprimtarisë së ekzekutimit;

f) të derdhë në mënyrë të rregullt detyrimet tatimore;

g) të marrë masat dhe veprimet e nevojshme për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, në respekt të dinjitetit njerëzor, duke vënë në balancë nevojat e debitorëve dhe interesat e kreditorëve.

Neni 33

Praktika të ndaluara të përmbauesit gjyqësor privat

Përmbauesi gjyqësor privat gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, nuk duhet të kryejë veprime që cenojnë, shqetësojnë apo abuzojnë me subjektet, që u nënshtrohen procedurave të ekzekutimit.

Veçanërisht është e ndaluar:

a) përdorimi i paligjshëm i forcës ndaj subjekteve fizike, që i nënshtrohen ekzekutimit të detyruar apo pasurisë së tyre;

b) kërcënimi fizik apo presioni psikologjik ndaj subjektit, palë në procedurë ekzekutimi;

c) përdorimi i fjalëve të pahijshme, që cenojnë reputacionin apo dinjitetin e subjekteve,

232 që i nënshtrohen ekzekutimit të detyruar;

ç) angazhimi në ndonjë praktikë të ndaluar, ose përdorimi i ndonjë metode të pandershme në mbledhjen e detyrimeve, në kundërshtim me dispozitat ligjore;

d) çdo veprim tjetër me karakter mashtrues, i cili do të komprometonte rëndë besimin e palëve dhe figurën morale të përmbauesit gjyqësor privat.

Neni 34

Mbrojtja e veçantë e përmbauesit gjyqësor privat

Kur përmbauesi gjyqësor privat, gjatë ushtrimit të detyrës së tij ose për shkak të saj i rrezikohet jeta, familja apo prona, shteti i garanton mbrojtje të veçantë. Kushtet dhe mënyra e përfitimit të kësaj mbrojtjeje përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 35

Publiciteti i veprimtarisë

Përmbauesi gjyqësor privat mund të reklamojë publikisht veprimtarinë e tij, por pa cenuar konkurrencën e ndershme dhe praktikën e ligjshme tregtare.

Neni 36

Konfidencialiteti

Përmbauesi gjyqësor privat, i cili merr informacionet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, ruan fshehtësinë e tyre dhe nuk duhet t'ua japë këto informacione të tetëve, përveç:

a) organeve të rendit publik, prokurorisë ose gjykatës;

b) strukturave të tjera shtetërore, lidhur me çështjet pasurore të debitorëve;

c) përmbauesve të tjerë, vetëm nëse informacioni është i nevojshëm për procedurat e ekzekutimit;

ç) kreditorit, i cili ka depozituar për ekzekutim një titull ekzekutiv;

d) kur personi, për të cilin kërkohet informacioni, jep pëlqimin.

233

Neni 37

Llogaria bankare e përmbaruesit gjyqësor privat

Përmbaruesi gjyqësor privat duhet të hapë llogari rrjedhëse bankare, të deklaruar dhe të kryejë, gjatë punës së tij, në këtë llogari të gjitha veprimet financiare, që kanë të bëjnë me procedurat e ekzekutimit.

Neni 38

Dorëzimi i dokumentacionit pas çregjistrimit të përmbaruesit gjyqësor privat

Kur përmbaruesi gjyqësor privat çregjistrohet dhe ka në proces ekzekutimi çështje përmbarimore të papërfunduara, ai detyrohet t'i kthejë gjithë dokumentacionin palës së interesuar, si dhe tarifën e parapaguar për veprimet procedurale të papërfunduara prej tij. Përmbaruesi gjyqësor privat, pas çregjistrimit detyrohet të dorëzojë në Ministrinë e Drejtësisë dokumentacionin e krijuar për çdo veprim procedural, si dhe vulën e tij. Rregulla të hollësishme për procedurën dhe afatet e dorëzimit të dokumentacionit përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 39

Vula dhe dokumenti i identifikimit

Përmbaruesi gjyqësor privat ka vulën e vet personale, që përmban emrin e tij ose të shoqërisë dhe vendoset në çdo dokument që ai krijon gjatë veprimtarisë së tij profesionale. Përmbaruesi gjyqësor privat pajiset me dokument identifikues, të cilin e paraqet në çdo rast të ushtrimit të detyrës.

Dokumenti përdoret vetëm gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të saj.

Dokumenti i identifikimit duhet të përmbajë emrin, mbiemrin e përmbaruesit gjyqësor privat, stemën e Republikës së Shqipërisë, logon e Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, selinë ku do të ushtrojë veprimtarinë përmbaruesi gjyqësor privat, institucionin që e lëshon dhe NIPT-in.

Forma dhe përmbajtja e vulës përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

234

KREU VII

MARRËDHËNIET ME PALËT NË PROCES EKZEKUTIMI

DHE ME TË TRETËT

Neni 40

Marrëdhëniet me palën kreditore

Marrëdhëniet ndërmjet përmbaruesit gjyqësor privat dhe palës kreditore rregullohen mbi bazën e kontratës së lidhur mes tyre. Hollësitë, në lidhje me detyrimet reciproke, përcaktohen në kontratën e lidhur mes përmbaruesit gjyqësor privat dhe kreditorit.

Pala kreditore ka të drejtë të kërkojë nga përmbaruesi gjyqësor privat çdo informacion, lidhur me veprimet procedurale dhe ecurinë e procesit të ekzekutimit.

Neni 41

Marrëdhënia kontraktore

Kur marrëdhëniet kontraktore ndërmjet përmbaruesit gjyqësor privat dhe palës kreditore zgjidhen nga përmbaruesi, ai i kthen palës kreditore dokumentacionin ligjor, si dhe pjesën e shumës së marrë si parapagim për procedurën e ekzekutimit.

Kur pala kreditore vendos të zgjidhë kontratën, pa shkaqe të arsyeshme, përpara përfundimit të procedurës së ekzekutimit, përmbaruesi gjyqësor i kthen dokumentacionin ligjor palës kreditore, vetëm në rast të përmbushjes së detyrimit për çdo shpenzim të kryer deri në atë çast.

Neni 42

Vlefshmëria e akteve dhe veprimeve procedurale

Aktet dhe veprimet procedurale të kryera nga përmbauesi gjyqësor privat, përpara çastit të zgjidhjes së kontratës, konsiderohen ligjërisht të vlefshme dhe procesi i mëtejshëm i ekzekutimit nga një përmbaues tjetër gjyqësor privat fillon nga veprimi procedural i mbetur në 235

kohën e ndërprerjes së procesit të ekzekutimit.

Neni 43

Heqja dorë nga procedura e ekzekutimit

Kur përmbauesi gjyqësor privat vendos të heqë dorë nga vazhdimi i veprimeve procedurale, për shkak të konfliktit të interesit, ai detyrohet të njoftojë 15 ditë përpara palën kreditore. Gjatë kësaj periudhe përmbauesi gjyqësor privat është i detyruar që të kryejë veprimet procedurale eventuale. Pas kalimit të afatit të sipërpërmendur, përmbauesi gjyqësor privat i kthen palës kreditore dokumentacionin e lidhur me çështjen, si dhe, kur është rasti, tarifën e parapaguar për procedurën e ekzekutimit.

Neni 44

Marrëdhëniet me palën debitorë dhe personin e tretë

Pala debitorë, personat e barazuar me të ose personi i tretë detyrohet të lejojë përmbauesin gjyqësor privat të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme, të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, për ekzekutimin e detyrueshëm.

Me fillimin e veprimeve procedurale debitori, me kërkesën e përmbauesit gjyqësor privat, është i detyruar të deklarojë mbi pasuritë e tij dhe saktësinë e të dhënave të tyre. Ndaj debitorit, që fsheh apo i jep fiktive të dhënat mbi pasuritë e tij, përmbauesi gjyqësor privat, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi, zbaton sanksionet e parashikuara në ligj.

Pala debitorë, personat e barazuar me të ose personi i tretë ka të drejtë të kundërshtojë veprimet e përmbauesit gjyqësor privat në gjykatë, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile. Në këtë rast, përmbauesi gjyqësor privat thirret në gjykim me cilësinë e palës së paditur.

Neni 45

Përgjegjësitë ndaj palëve në proces ekzekutimi dhe të tetëve

236

Kur përmbauesi gjyqësor privat e zhvillon veprimtarinë e tij në kundërshtim me ligjin, mban përgjegjësi për dëmin që u shkakton palëve në proces ekzekutimi, si dhe për dëmin ndaj të tetëve.

Neni 46

Marrëdhëniet me të tretët

Personat fizikë dhe juridikë, privatë dhe shtetërorë, janë të detyruar që t'i japin përmbauesit gjyqësor privatë të gjithë informacionin e nevojshëm të kërkuar prej tij, lidhur me gjendjen pasurore të debitorit. Ndaj subjekteve fizike apo juridike, që fshehin në mënyrë të qëllimshme të dhënat e kërkuara nga përmbauesi gjyqësor, ky i fundit është i detyruar të bëjë kallëzim penal, në përputhje me nenin 320 të Kodit Penal.

Në raste të veçanta, përmbauesi gjyqësor ka të drejtë që të kërkojë ndihmën e Policisë së Shtetit, të institucioneve të tjera shtetërore apo subjekteve private, për të mundësuar procedurat e ekzekutimit. Organet shtetërore ose publike janë të detyruara të ndihmojnë përmbauesit gjyqësorë privatë në ushtrimin e funksioneve, sipas ligjit, sa herë që kërkohet ndihma e tyre. Ndaj subjekteve fizike ose juridike që, sipas ligjit, janë të detyruara të kryejnë veprime të caktuara, përmbauesi gjyqësor privat ka të drejtën e zbatimit të sanksioneve të parashikuara në nenin 606 të Kodit të Procedurës Civile.

KREU VIII

TARIFAT

Neni 47

Përcaktimi i tarifave

Masa e tarifës dhe llojet e shërbimeve përbarimore të tarifuar përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave, pasi merret dhe mendimi i Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë.

Për fillimin e procedurave të ekzekutimit dhe kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale nga Shërbimi Përbarimor Gjyqësor Privat, paguhen tarifat përkatëse, të miratuara 237

me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave.

Neni 48

Tarifa shtesë

Për veprime përbarimore teknikisht dhe ligjërish specifike, komplekse, apo që kërkojnë kohë, përmbauesi gjyqësor privat ka të drejtë të kërkojë pagimin e një tarife shtesë. Kjo tarifë paguhet, sipas rastit, me një kësht të vetëm ose me disa kështe. Masa e tarifës shtesë dhe llojet e shërbimeve përbarimore të tarifuar përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave, pasi merret dhe mendimi i Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë.

Neni 49

Rastet e pakthyeshmërisë së tarifës

Në rastet e ekzekutimeve të pasuksesshme, kur nga përmbauesi gjyqësor privat janë kryer në mënyrë të rregullt dhe të ligjshme të gjitha veprimet procedurale, tarifat e parapaguara janë të pakthyeshme.

Kur pala kreditore ka paguar vetëm tarifën e fillimit të procedurës përbarimore dhe detyrimi përmbushet në mënyrë vullnetare nga pala debitorë, brenda afateve ligjore, tarifa e fillimit të procedurës është e pakthyeshme.

KREU IX

PROCEDIMI DISIPLINOR

Neni 50

Fillimi i procedimit

Të drejtën për të nisur procedimin disiplinor ndaj përmbauesit gjyqësor privatë e ka Ministri i Drejtësisë, me nismën e vet ose sipas ankesës së paraqitur nga palët në proces 238

ekzekutimi.

Procedimi disiplinor kundër përmbauesit gjyqësor privat mund të fillojë kur konstatohen shkelje të detyrës apo veprime të parregullta gjatë ushtrimit të veprimtarisë së përmbauesit gjyqësor privat.

Ankimi administrativ te Ministri i Drejtësisë nuk i heq të drejtën ankuesit që të ndjekë rrugën gjyqësore për të rivendosur të drejtën e tij.

Neni 51

Procedura

Për shqyrtimin e procedimit disiplinor ndaj përmbauesit gjyqësor privat, Ministri i Drejtësisë krijon komisionin disiplinor të përmbauesve gjyqësorë privatë.

Komisioni disiplinor përbëhet nga:

- a) Kryetari i Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, ose një përfaqësues i autorizuar prej tij, në cilësinë e kryetarit;
- b) Kryetari i Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Privatë, në cilësinë e anëtarit;

c) 1 avokat i caktuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatëve, në cilësinë e anëtarit. Komisioni disiplinor i përmbauesve gjyqësorë privatë, brenda dhjetë ditëve pune nga dita e konstatimit të shkeljes, fillon procedimin disiplinor dhe njofton përmbauesin gjyqësor privat që ka kryer shkeljen, për t'u paraqitur në seancën dëgjimore në ngarkim të tij. Komisioni disiplinor i përmbauesve gjyqësorë privatë, pasi ka përfunduar hetimin administrativ dhe vërteton shkeljen e kryer, i paraqet Ministrit të Drejtësisë raportin përfundimtar, së bashku me propozimin për masën disiplinore. Mënyra e organizimit, funksionimi dhe masa e shpërblimit për anëtarët e komisionit disiplinor, përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë. Ministri i Drejtësisë, brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së raportit përfundimtar dhe propozimit për masën disiplinore, merr një nga masat disiplinore, të parashikuara në nenin 54 të këtij ligji.

239

KREU X

SHKELJET DHE MASAT DISIPLINORE

Neni 52

Shkeljet disiplinore

Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë shkelje disiplinore.

Konsiderohen shkelje nga përmbauesi gjyqësor privat veprimet ose mosveprimet e mëposhtme:

- a) shkelja në mënyrë të përsëritur e rregullave ligjore e nënligjore, që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së tij;
- b) mospërmbyllja me faj e veprimeve përmbauesore, që kanë cenuar të drejtën e palëve në proces ekzekutimi;
- c) mosrespektimi i dispozitave të kodit të etikës së përmbauesit gjyqësor privat;
- ç) shkelja e besimit të palës kontraktuese, nëpërmjet kryerjes së veprimeve korruptive me palën tjetër, për të mos ekzekutuar apo vonuar ekzekutimin e titullit ekzekutiv;
- d) konflikti i interesit në një procedurë ekzekutive;
- dh) mosevidentimi në mënyrë të rregullt i të gjitha akteve dhe veprimeve procedurale të kryera gjatë veprimtarisë së ekzekutimit;
- e) shkelja e kërkesave të këtij ligji për konfidencialitetin, sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave që merr, si rezultat i ushtrimit të veprimtarisë së vet gjatë procedurës së ekzekutimit;
- ë) refuzimi për të mos lejuar strukturat përgjegjëse shtetërore për të ushtruar kontroll ndaj veprimtarisë procedurale të tij.

Neni 53

Njoftimi i masës disiplinore

Urdhri për dhënien e masës disiplinore duhet të jetë i arsyetuar dhe i njoftohet të

240

interesuarit me shkrim jo më vonë se 15 ditë nga data e daljes së urdhrin të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 54

Masat disiplinore

Për kryerjen e shkeljeve të parashikuara në nenin 52 të këtij ligji, Ministri i Drejtësisë jep masat disiplinore si më poshtë:

- a) për shkeljen e përcaktuar në shkronjat “a”, “b” dhe “ç” heqje të licencës dhe çregjistrimin nga regjistri;
- b) për shkeljen e përcaktuar në shkronjat “c”, “d” dhe “dh” me gjobë nga 30 000 deri 50

000 lekë;

c) për shkeljen e përcaktuar në shkronjat “e” dhe “ë” me pezullim të licencës nga tre muaj deri në dy vjet.

Masat disiplinore jepen brenda 6 muajve nga data e konstatimit të shkeljes, por jo më vonë se 3 vjet nga çasti i kryerjes së saj. Në këtë rast parashkrimi i masës fillon pas afateve të përcaktuara.

Masat disiplinore jepen sipas një procedure, e cila garanton të drejtën për t'u informuar, dëgjuar dhe mbrojtur.

Neni 55

E drejta e ankimit

Kundër vendimit të Ministrit të Drejtësisë përmbaruesi gjyqësor privat mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

Vendimi i Ministrit të Drejtësisë, pas kalimit të afatit të ankimit, ose kur lihet në fuqi nga gjykata, evidentohet në regjistrin e përmbaruesve gjyqësorë privatë.

Neni 56

Shlyerja e gjobave

Në rastin e masës disiplinore me gjobë, përmbaruesi gjyqësor privat, brenda 2 muajve, 241

duhet të shlyej masën e gjobës, në të kundërt, ndaj tij zbatohet masa disiplinore e pezullimit të licencës, deri në çastin e shlyerjes së saj.

Përmbaruesi gjyqësor privat, nëse nuk është dakord me masën e gjobës, ka të drejtën e ankimit gjyqësor.

Neni 57

Derdhja e gjobës në Buxhetin e Shtetit

Gjoha e vendosur kundër subjekteve që pengojnë ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë derdhet në Buxhetin e Shtetit.

Neni 58

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5982, datë 29.12.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

242

UDHËZIM

Nr.1240/5, datë 15.9.2009

PËR CAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET E OFRUARA NGA SHËRBIMI PËRMBARIMOR GJYQËSOR PRIVAT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe paragrafit të dytë të nenit 47 dhe nenit 48 të ligjit nr.10031, datë 11.12.2009 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë

UDHËZOJNË:

I. Shpërblimi i subjekteve përmbaruese

1. Tarifa vihet për një veprim procedural të një subjekti përmbarues.
2. Subjekti përmbarues ka të drejtë të vendosë një tarifë në masën dhe sipas procedurës së parashikuar në këtë akt.

II. Parime për përcaktimin e tarifës përmbarimore

1. Tarifa i një subjekti përmbarimor përbëhet nga një tarifë normale, përveç tarifës shtesë që mund të vihet sipas kushteve të nenit 48 të ligjit nr.10031, datë 11.12.2009 “Për shërbimin

përmbartimor privat” dhe shpenzimeve, sipas nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile. Norma e tarifës bazë të subjektit përmbartimor përcaktohet si një shumë fikse, bazuar në vlerën e tarifës dhe shpenzimeve të nevojshme për kryerjen e një veprimi përmbartimor.

2. Në rastet e parashikuara me ligj, një subjekt përmbartimor ka të drejtë të kërkojë tarifë shtesë për kryerjen e veprimeve përmbartimore.

III. Shpenzimet sipas nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile

Shpenzimet sipas nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile përbëhen nga shpenzimet e nevojshme për kryerjen e procedurës përmbartimore për ekzekutimin e një titulli ekzekutiv, duke përfshirë:

1. shpenzimet për administrimin e të dhënave të nevojshme për kryerjen e procedurave të ekzekutimit;

2. shpenzimet për korrespondencën në lidhje me procedurën përmbartimore;

243

3. shpenzimet në lidhje me transportin, magazinimin, ruajtjen e sendeve të sekuestruara dhe shpenzime të tjera në lidhje me ruajtjen e pasurisë;

4. shpenzimet në lidhje me hapjen, inventarizimin, mbylljen, lëvizjen, prishjen dhe pastrimin e ambienteve ose subjekteve të tjera në proces ekzekutimi;

5. shpenzimet në lidhje me praninë e detyruar të debitorit;

6. shpenzimet e organizimit të ankandit, duke përfshirë shpenzimet në lidhje me pagesën e çmimit të blerjes.

Shpenzimet e ndihmës ligjore të përdorura nga subjekti përmbartimor ose paditësi, me qëllim zgjidhjen e çështjeve ligjore, që kanë dalë me fillimin e procedurës përmbartimore ose gjatë gjykimit, nuk janë konsideruar të jenë shpenzime të nevojshme. Shpenzimet e menaxhimit të zyrës së subjektit përmbartimor nuk konsiderohen të jenë shpenzime të nevojshme.

IV. Personat që duhet të paguajnë tarifën e subjektit përmbartues

1. Debitori, ndaj të cilit ka filluar procedura e ekzekutimit të urdhrit të ekzekutimit, detyrohet t’i paguajë tarifën subjektit përmbartimor në përfundim të procesit të ekzekutimit. Në rastet e ekzekutimeve të pasuksesshme, personi përgjegjës për pagimin e tarifës është kreditori.

2. Debitori solidar është në mënyrë solidare përgjegjës për pagesën e tarifës së subjektit përmbartues.

3. Me kërkesë të një debitori ose kërkuesi, një subjekt përmbartues paraqet provë dokumentuese për kostot e përmbartimit.

V. Mbledhja e tarifave përmbartimore

1. Në rast të përmbushjes së detyrimeve financiare ose përmbushjes së detyrimeve jo financiare, tarifat mbledhen me përfundimin e veprimeve përmbartimore, përveç rasteve të parashikuara në ligj.

2. Në rast të përmbushjes së detyrimit përpara përfundimit të afatit të ekzekutimit vullnetar, tarifa bazë e subjektit përmbartues, që është paguar nga debitori, kthehet në masën e gjysmës së shumës të parashikuar në këtë udhëzim.

3. Nëse ky detyrim financiar, që i nënshtrohet ekzekutimit të detyrueshën mbledhet pjesërisht, subjekti përmbartues mund të mbledhë, si tarifë të tij/saj, vetëm një shumë proporcionale me vlerën e mbledhur të detyrimit.

4. Tarifa shtesë për një veprim përmbartimor specifik mbledhet menjëherë pas kryerjes së veprimit përmbartimor, siç është parashikuar në nenin 48 të ligjit.

244

VI. Parapagimi i tarifës përmbartimore

1. Një subjekt përmbartues është i detyruar të marrë parapagim nga kreditori kërkuesi

përpara procedurës së ekzekutimit, siç parashikohet në ligj. Nëse kreditori kërkuesi nuk parapaguan, një subjekti përmbarues nuk i lejohet të fillojë procedurën e ekzekutimit. Në këtë rast, subjekti përmbarues i kthen kreditorit (kërkuesit) menjëherë dokumentet ligjore të paraqitura prej tij.

2. Parapagimi nuk kërkohet nga:

a) një person fizik që paraqet për ekzekutim një vendim të marrë gjatë procedimit gjyqësor, ku personi fizik ka qenë plotësisht ose pjesërisht i çliruar nga pagesa për ndihmë juridike ose pagesa e një tarife shtetërore, për shkak të paaftësisë pagueuse;

b) një person fizik që paraqet për ekzekutim një vendim të marrë gjatë procedimit penal me të cilin shlyhet një detyrim për kompensim të një dëmi të shkaktuar personit fizik në një vepër penale;

c) një person fizik që paraqet për ekzekutim një pretendim për detyrim ushqimor.

3. Nëse ka kreditorë të ndryshëm për vënien në ekzekutim të një urdhri ekzekutimi, ata parapaguajnë sipas marrëveshjes reciproke.

VII. Procedura për marrjen dhe kthimin e parapagesës të tarifës për subjektin përmbarues

1. Parapagimi i në tarife të subjektit përmbarues bëhet në llogarinë bankare zyrtare të një subjekti përmbarues. Një subjekt përmbarues i lëshon kreditorit një faturë për parapagesën, që përcakton të dhënat e dokumentit të ekzekutimit dhe emrin e debitorit.

2. Nëse një tarifë e subjektit përmbarues mbledhet nga debitori plotësisht, subjekti përmbarues i kthen kreditorit parapagesën brenda dhjetë ditë pune pas marrjes së tarifës nga debitori.

3. Nëse procedura e ekzekutimit përfundon pa shlyerjen e detyrimit ose debitori ka përmbushur pretendimin në lidhje me kreditorin në përputhje me kërkesat përpara se ai të paraqesë një ankesë të subjektit përmbarues, parapagesa nuk i kthehet kreditorit dhe subjekti përmbarues mban tarifën për mbulimin e kostove të procedurës së ekzekutimit. Kreditori informohet me shkrim nga subjekti përmbarues për refuzimin e kthimit të parapagesës.

VIII. Tatimi mbi vlerën e shtuar

1. Tatimi mbi vlerën e shtuar i shtohet tarifës së mbledhur nga një subjekt përmbarues privat.

245

2. Tarifat përmbarimore i nënshtrohen ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”.

IX. Normat e tarifave që duhen paguar bazuar në vlerën e padisë

1. Nëse urdhri i ekzekutimit për pagesën nga debitori të një shume deri në 500 000 lekë për kreditorin dorëzohet për ekzekutim, parapagesa e tarifës të subjektit përmbarues llogaritet sipas vlerës së detyrimit dhe normës së tarifës së subjektit përmbarues, të përcaktuar në tabelën e mëposhtme:

Vlera e padisë për pagesë deri

në...lekë

Norma e tarifës së

subjektit përmbarues në

lekë.

Tarifa bazë

Parapagesa e tarifës së subjektit

përmbarues në lekë.

Tarifa për veprime procedurale

10 000 6000 5000

20 000 7000 5200
30 000 8000 5300
40 000 9000 5400
50 000 10 000 5500
60 000 11 000 5600
70 000 12 000 5700
80 000 13 000 5800
90 000 14 000 5900
100 000 15 000 6000
150 000 17 000 6500
200 000 18 000 7000
250 000 20 000 7500
300 000 22 000 8000
350 000 24 000 8500
400 000 26 000 9000
450 000 28 000 9500

246

500 000 30 000 10 000

2. Nëse paraqiten për ekzekutim nga kërkuesi dokumentet ligjore për pagimin e detyrimit nga debitori të një shume që kalon 500 000 lekë, tarifa e subjektit përmbaues llogaritet si më poshtë:

- a) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 500 001 deri në 600 000 lekë, është 5.8% e vlerës së padisë;
- b) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 600 001 deri në 700 000 lekë është 5.6% e vlerës së padisë;
- c) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 700 001 deri në 800 000 lekë është 5.4% e vlerës së padisë;
- d) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 800 001 deri në 900 000 lekë është 5.2% e vlerës së padisë;
- e) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 900 001 deri në 1 000 000 lekë është 5.0% e vlerës së padisë;
- f) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë 1 000 001 deri në 2 000 000 lekë është 4.8% e vlerës së padisë;
- g) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 2 000 001 deri në 4 000 000 lekë është 4.6% e vlerës së padisë;
- h) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 4 000 001 deri në 6 000 000 lekë është 4.4% e vlerës së padisë;
- i) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 6 000 001 deri në 8 000 000 lekë është 4.2% e vlerës së padisë;
- j) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë prej 8 000 001 deri në 10 000 000 lekë është 4.0% e vlerës së padisë;
- k) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 10 000 001 deri në 20 000 000 lekë është 3.8% e vlerës së padisë;
- l) Tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 20 000 001 deri në 30 000 000 lekë është 3.6% e vlerës së padisë;
- m) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 30 000 001 deri në 40 000 000 lekë është 3.4% e vlerës së padisë;

n) tarifa e subjektit përmbareues për një vlerë padie prej 40 000 001 deri në 50 000 000 lekë është 3.2% e vlerës së padisë;

s) tarifa e subjektit përmbareues për një vlerë prej 50 000 001 deri në 60 000 000 lekë është 3.0% e vlerës së padisë;

t) tarifa e subjektit përmbareues për një vlerë prej 60 000 001 deri në 70 000 000 lekë është 2.8% e vlerës së padisë;

v) tarifa e subjektit përmbareues për një vlerë prej 70 000 001 deri në 80 000 000 lekë është 2.6% e vlerës së padisë;

x) tarifa e subjektit përmbareues për një vlerë padie prej 80 000 001 deri në 90 000 000 lekë është 2.4% e vlerës së padisë.

3. Norma e tarifës së subjektit përmbareues për një padi, vlera e së cilës është më e madhe se 90 000 000 lekë është 2 160 000 lekë+0.1% për një vlerë që kalon 90 000 000 lekë.

4. Parapagimi i një tarife të subjektit përmbareues është 20 000 lekë për vlerat e padisë, të specifikuar në nënndarjen 2 të këtij seksioni dhe 30 000 lekë për vlera të padisë të specifikuar në nënndarjen 3 të këtij seksioni.

X. Veprimet përmbareimore me norma tarifë për objekte të pavlerësueshme

1. Tarifa e subjektit të përmbareimit paguhet mbi bazën e një norme fikse për veprimet e mëposhtme përmbareimore:

a) reklamimin e një sendi të luajtshëm;

b) lirim sendi të paluajtshëm;

c) marrje fëmije dhe lejimi i së drejtës së vizitës;

d) organizimi i ankandit;

e) zbatimi i një vendimi gjykate, nëpërmjet të cilit debitori duhet të përmbushë një detyrim të caktuar.

2. Për një veprim të përcaktuar në pikat 1,a,c, dhe e të këtij seksioni, tarifa e subjektit përmbareimor është një shumë e barabartë me gjysmën e minimumit zyrtar të pagës mujore dhe parapagimi i një tarife të subjektit përmbareimor është një shumë e barabartë me një të tretën e pagës minimale zyrtare mujore.

3. Në rastin e një ankandi, tarifa e subjektit përmbareimor do të jetë një shumë e barabartë me pagën minimale mujore zyrtare.

Tarifa do të paguhet nga bashkëpronari që bën ofertën më të mirë.

4. Tarifa për lirimin e sendit të paluajtshëm është e barabartë me shumën e dy pagave minimale zyrtare mujore.

XI. Tarifa që kërkohet për paditë me objekt detyrimi ushqimor

1. Tarifa bazë që paguhet për një padi me objekt detyrim ushqimor është një shumë e plotë që përputhet me normën minimale të detyrimit ushqimor të përcaktuar me ligj. Kjo tarifë arkëtohet së bashku me pagesën e parë mujore. Nëse debitori paguan vetëm një pjesë të pagesës së detyrimit ushqimor, subjekti i përmbareimit arkëton një tarifë që është në raport me shumën e pretenduar.

2. Nëse debitori i pezullon pagesat e detyrimit ushqimor, si rezultat i të cilave kryhen veprime përmbareimore shtesë, me qëllim që të sigurohet përmbushja e mëtejshme e pretendimit, subjekti i përmbareimit ka të drejtë të kërkojë një tarifë shtesë në një shumë që përputhet me gjysmën e normës minimale të detyrimit ushqimor të parashikuar me ligj.

3. Nëse ka vonesa në pagesat e detyrimit ushqimor dhe është përcaktuar shuma e katër papambetjeve, tarifa për arkëtimin e shumës së borxhit llogaritet sipas tabelës së normës së

tarifave.

4. Me transferimin e një çështjeje përmbartimore nga një subjekt përmbartimor në një tjetër, nuk kërkohet pagesa e përsëritur e tarifës bazë nga debitori, me kusht që subjekti përmbartues që transferon çështjen ta ketë arkëtuar këtë tarifë.

XII. Tarifat për sigurimin e padisë

1. Një tarifë për ekzekutimin e një vendimi të ndërmjetëm, për sigurimin e padisë, bazohet në vlerën e padisë dhe paguhet si më poshtë:

- a) nëse vlera e padisë është deri në 500 000 lekë, tarifa është një shumë e barabartë me një të katërtën e pagës minimale mujore zyrtare;
- b) nëse vlera e padisë është ndërmjet 500 001 dhe 2 000 000 lekë, tarifa është një shumë e barabartë me gjysmën e pagës mujore minimale zyrtare;
- c) nëse vlera e padisë është më shumë se 200 000 lekë, tarifa është një shumë e barabartë me pagën minimale zyrtare mujore.

2. Nëse vendimi për sigurimin e një padie ka të bëjë me një pretendim jomonetar ose vlera e padisë nuk është e përcaktuar, në rastin e ekzekutimit të një vendimi me këtë objekt ose të revokimit të tij, tarifa e subjektit përmbartimor është një shumë e barabartë me një të tretën e 249

pagës minimale zyrtare mujore.

3. Nëse një vendim për sigurimin e padisë ka të bëjë me një pretendim monetar dhe jomonetar, normat e tarifave të përshkruara në nënseksionet 1 dhe 2 të këtij seksioni merren në total.

4. Në rastin e ekzekutimit të një vendimi për sigurimin e padisë ose me revokimin e tij, tarifat e subjektit përmbartimor paguhen nga personi që ka bërë kërkesë për zbatimin e masës për sigurimin e padisë.

5. Tarifat e subjektit përmbartimor bëhen të arkëtueshme me paraqitjen, në rastin e ekzekutimit të detyruar, të një vendimi për sigurimin e padisë. Nëse një paditës nuk paguan tarifën e subjektit përmbartimor, ky i fundit nuk lejohet të nisë procedime përmbartimore.

XIII. Tarifat e pagueshme për kopjen e dokumenteve dhe lëshimin e certifikatave

1. Një person, që kërkon lëshimin e një kopjeje paguan për këtë kopje. Kjo dispozitë nuk zbatohet për një autoritet administrativ ose pjesëmarrës në procedim që ka të drejtë të marrë një raport mbi kryerjen e një veprimi përmbartimor, nëse ky dokument i lëshohet personit për herë të parë.

2. Tarifa e subjektit përmbartimor, për përgatitjen e një kopjeje të një dokumenti është:

- a) 20 lekë për një faqe formati A4;
- b) 25 lekë për një faqe format A3.

3. Një subjekt përmbartimor merr një tarifë prej 200 lekësh për lëshimin e një certifikate në lidhje me një veprim përmbartimor. Nëse certifikata jepet në lidhje me një çështje me objekt detyrim ushqimor, tarifa i subjektit përmbartimor është 60 lekë.

XIV. Tarifa shtesë e subjektit përmbartimor.

1. Një subjekt përmbartimor ka të drejtë të kërkojë një tarifë shtesë mbi bazën dhe në masën e parashikuar në ligjin përmbartimor privat, për veprimet përmbartimore teknikisht, ligjërishit komplekse ose që kërkojnë kohë. Tarifa shtesë përcaktohet në formën e një shume të plotë ose tarifë me orë. Tarifa shtesë i shtohet tarifës bazë dhe subjekti përmbartimor ka të drejtë të kërkojë pagesën e kësaj tarife vetëm nëse debitori nuk ka përmbushur detyrimin gjatë afatit të përmbushjes vullnetare dhe subjekti përmbartimor kryen një veprim përmbartimor për të cilën ai ose ajo ka të drejtë të marrë një tarifë shtesë.

2. Përveç kur parashikohet ndryshe me ligj, tarifa shtesë arkëtohet së bashku me tarifën

bazë.

250

XV. Tarifa shtesë për veprimet e sekuestrimit

1. Një subjekt përbarimor arkëton një tarifë shtesë në masën 0.1% të vlerës së sendit të sekuestruar për një veprim sekuestrimi të kryer jashtë zyrës së subjektit përbarimor që përbëhet nga sekuestrimi i sendeve të luajtshme në posedim të debitorit ose për një veprim sekuestrimi në lidhje me një send të paluajtshëm.

2. Vendimi që urdhëron pagesën e një tarife shtesë nxirret pas veprimit të sekuestrimit dhe vlerësimit të sendit. Në rastin e një mosmarrëveshjeje në lidhje me sendin e sekuestruar ose çmimin e tij, vendimi që urdhëron pagesën e një tarife shtesë nxirret pas zgjidhjes së mosmarrëveshjes me kusht që sendi të mbetet i sekuestruar dhe të jetë vlerësuar.

XVI. Tarifa shtesë për mënyrat e shitjes së sendeve pasurore

Një subjekt përbarimor merr një tarifë shtesë në një shumë prej 1% të çmimit të shitjeve të sendeve pasurore për shitjen e tyre në ankand ose në një mënyrë tjetër të lejuar nga ligji.

XVII. Tarifa shtesë në formën e tarifave për orë

Në rastin e kryerjes së një veprimi përbarimor jashtë zyrës së subjektit përbarimor, të përcaktuar në nënndarjen IX dhe XI të këtij udhëzimi, subjekti përbarimor ka të drejtën të kërkojë një tarifë prej 1000 lekë duke filluar nga ora e dytë e veprimit. Detyrimi për pagesën e tarifës shtesë i lëshohet një personi që e ka shkaktuar atë dhe duhet të bëjë pagesën menjëherë pas kryerjes së veprimit përbarimor.

Tarifat për shërbimet e ofruara nga shërbimi përbarimor gjyqësor privat zbatohen me fillimin e aktivitetit të përbaruesve gjyqësorë privatë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ministri i Drejtësisë

Enkelejd Alibeaj

Ministri i Financave

Ridvan Bode

251

UDHËZIM

Nr.2, datë 24.9.2003

Për mënyrën e zbatimit të ekzekutimit të detyrimeve mbi shumat e llogarive në banka

Në mbështetje të nenit 600 të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", Banka e Shqipërisë nxjerr udhëzimin me këtë përmbajtje:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i mënyrës së ekzekutimit të detyrimeve mbi shumat e llogarive në bankat e nivelit të dytë, në bazë të titujve ekzekutivë të përcaktuar në nenin 510 të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Përkufizime

Sa herë që përdoren në këtë udhëzim, termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

"Bankë"- personin juridik që kryen veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë, sipas licencës së dhënë nga Banka e Shqipërisë.

"Debitor" - çdo klient të bankës, që ka pranë saj llogari në emër të tij dhe kundrejt të cilit është lëshuar një kërkesë për vënien sekuestro nga ana e përbaruesit gjyqësor.

252

“Llogari” – çdo llogari që përdoret nga klienti debitor në marrëdhëniet me bankën dhe që mund të përdoret për kryerje pagesash në ngarkim të debitorit, llogari rrjedhëse, krediti, depozitë, llogari buxhetore etj.

“Vënie sekuestro”- bllokimin e përkohshëm të shumave në llogari, me qëllim sigurimin e padisë, në përputhje me nenin 206 të Kodit të Procedurës Civile dhe/ose

nxjerrjen e shumave nga llogaritë dhe kalimin e tyre në llogarinë e përmbaruesit gjyqësor, në zbatim të neneve 510 dhe 511 të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 3

Detyrimi i bankave për të bllokuar llogaritë dhe për të informuar zyrën e përmbarimit

3.1 Në zbatim të neneve 593 dhe 594 të Kodit të Procedurës Civile, zyra e përmbarimit ka të drejtë të kërkojë të informohet dhe të urdhërojë bllokimin e llogarive të debitorit në të gjitha bankat që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë.

3.2 Kërkesa/urdhri për informim dhe bllokimin e llogarisë paraqitet në formën zyrtare dhe duhet të përmbajë minimalisht:

a) Të dhëna të sakta për identifikimin e klientit:

- emrin, mbiemrin, atësinë, datëlindjen dhe adresën e banimit (për individët);

- emërtimin dhe numrin e vendimit të regjistrimit në regjistrin tregtar (për personat fizikë dhe për shoqëritë tregtare);

- emërtimin, si dhe numrin e aktit përkatës për njohjen e personalitetit juridik (për personat e tjerë juridikë).

b) Shumën maksimale të detyrimit për t’u paguar.

253

c) Afatin e vlefshmërisë për bllokimin e llogarisë.

3.3 Banka është e detyruar, menjëherë, por jo me vonë se 10 ditë kalendarike nga marrja e kërkesës/urdhrit:

a) të informojë me shkrim zyrën e përmbarimit dhe të bllokojë llogarinë e debitorit deri në shumën e kërkuar;

b) të informojë me shkrim zyrën e përmbarimit për rastet kur klientët nuk kanë llogari pranë saj.

3.4 Në zbatim të pikës 3.2 të këtij neni, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit nxjerr formën standarde të urdhrit të bllokimit, një kopje e të cilës mund t’i dërgohet bankave për dijeni paraprakisht.

Neni 4

Kërkesat që duhen plotësuar për vënien e sekuestros

4.1 Në zbatim të nenit 527 dhe të nenit 594 të Kodit të Procedurës Civile, banka vë sekuestron mbi llogarinë e debitorit, deri në masën e nevojshme për ekzekutimin e detyrimit, kundrejt paraqitjes nga zyra e përmbarimit të këtyre dokumenteve:

a) Kërkesa/urdhri i zyrës së përmbarimit për vendosjen e masës së sekuestros, me të dhënat e nevojshme për identifikimin e debitorit dhe destinacionin e shumës së sekuestruar, dhe që duhet të përmbajë:

- të dhënat për identifikimin e debitorit, sipas përcaktimit të bërë në shkronjën (a) të pikës 3.2 të këtij udhëzimi;

- shumën e saktë të detyrimit;

- të dhënat e sakta për emërtimin, numrin e llogarisë dhe bankën për kalimin e shumës së sekuestruar;

254

- radhën e preferimit, në zbatim të nenit 605 të Kodit Civil.

Në zbatim të kësaj pike, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit nxjerr formën standarde të urdhrimit të sekuestrimit, një kopje e të cilës mund t' u dërgohet bankave për dijeni paraprakisht.

b) Vendimi gjyqësor, si dhe çdo akt tjetër, i cili në zbatim të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile konsiderohet titull ekzekutiv.

c) Dokumenti që vërteton lajmërimin e debitorit për ekzekutimin vullnetar të detyrimit dhe për marrjen dijeni nga ana e tij.

4.2 Dokumentet që i dërgohen bankës janë, sipas rastit, origjinale ose të noterizuara, ose të vërtetuara “njësia me origjinalin” nga sekretaria e gjykatës ose fotokopje të vërtetuara me vulën e zyrës së përmbartimit.

4.3 Kërkesa/urdhri për vënie në sekuestro mund të bëhet edhe pa zbatuar nenin 3 të këtij udhëzimi, në rastet kur zyra e përmbartimit ka dijeni të plotë për ekzistencën e llogarive të debitorit dhe nuk e gjykon të nevojshme marrjen e informacionit.

Neni 5

Procedura e vënies së sekuestros

5.1 Banka kontrollon dokumentacionin e paraqitur dhe në rast se konstaton mangësi, në formë ose në përmbajtje, praktika i kthehet zyrtarisht zyrës së përmbartimit me vërejtjet e konstatuara, jo më vonë se tri ditëpune nga dita e mbërritjes së tyre në bankë, ndërsa llogaria e debitorit mbahet e bllokuar edhe 10 ditë kalendarike të tjera nga dita e nisjes së përgjigjes, në pritje të rregullimit të mangësive nga zyra e përmbartimit. Në mungesë të përgjigjes nga ana e zyrës së përmbartimit brenda këtij afati, kërkesa/urdhri për sekuestrim konsiderohet se nuk është bërë.

5.2 Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur konsiderohet i rregullt, banka vë sekuestron në llogarinë e debitorit, jo më vonë se tri ditëpune nga dita e marrjes së kërkesës/urdhrit për sekuestro.

255

5.3 Vënia e sekuestros dhe/ose bllokimi i llogarisë së debitorit nuk pezullon pagimin e kredive që, sipas nenit 605 të Kodit Civil, paguhen me preferim ndaj kërkesës/urdhrit për sekuestro. Kur shuma e llogarive nuk është e mjaftueshme për të shlyer detyrimet e paraqitura për ekzekutim, banka njofton përmbartuesin gjyqësor, i cili respekton radhën e preferimit që përcaktohet në nenin 605 të Kodit Civil.

5.4 Në rastet kur shuma e disponueshme në llogari në ditën e kryerjes së veprimeve, në përputhje me pikën 5.2 të këtij neni, nuk është e mjaftueshme për të plotësuar të gjithë shumën e detyrimit, veprohet për vënien e sekuestros pjesore, deri në shumën e disponueshme në llogari.

5.5 Me vënien e sekuestros pjesore në llogari, praktika konsiderohet e mbyllur për bankën dhe informohet zyra e përmbartimit, sipas rastit, zyrtarisht ose me kreditimin e llogarisë së saj.

5.6 Zyra e përmbartimit ka të drejtë të rikërkojë vënien në sekuestro për praktikën e kthyera me të njëjtën bankë ose me banka të tjera, duke e nisur praktikën nga e para, deri në përmbushjen e plotë të detyrimit, duke zbatuar të gjitha kërkesat e parashikuara në nenin 4 të këtij udhëzimi.

5.7 Kur banka është në pamundësi për vënien e sekuestros në afatin e parashikuar në pikën 5.2 të këtij neni, tërësisht ose pjesërisht, për mungesë gjendjeje ose për shkak preferimi në zbatim të nenit 605 të Kodit Civil, ajo e kthen praktikën pa veprim dhe njofton zyrën e përmbartimit, jo më vonë se dy ditëpune, pas mbarimit të afatit treditör të përcaktuar në pikën 5.2 të këtij neni.

Neni 6

Procedura për pezullimin e ekzekutimit të kërkesës/urdhrit

6.1 Pezullimi i kërkesës/urdhrit për vënien e sekuestros bëhet vetëm kundrejt paraqitjes së vendimit të gjykatës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit, në përputhje me kriteret e caktuara në nenet 206, 471, 479 dhe 615 të Kodit të Procedurës Civile.

6.2 Vendimi për pezullimin e ekzekutimit të vendimit mund të paraqitet në bankë nga zyra e

përmbarimit ose nga debitori ose përfaqësuesi i autorizuar i tij.

256

6.3 Me marrjen e vendimit për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nga debitori ose nga përfaqësuesi i autorizuar i tij, banka njofton menjëherë zyrën e përmbarimit, por jo më vonë se tri ditëpune nga marrja e tij.

6.4 Pezullimi nuk ka pasojë heqjen e masës së bllokimit sipas kërkesës /urdhrit të zyrës së përmbarimit, në kuptimin e nenit 3 të këtij udhëzimi.

6.5 Afati për pezullimin e urdhrin dhe bllokimi i llogarisë vazhdon deri në përfundimin e procesit të rigjykimit nga gjykata.

Neni 7

Verifikimi i dokumentacionit bankar nga përmbaruesi gjyqësor

7.1 Në kuptim të nenit 598 të Kodit të Procedurës Civile, përmbaruesi gjyqësor ka të drejtë të verifikojë në vend dokumentacionin bankar në prani të punonjësit të ngarkuar nga administratorët e bankës, kur ai ka bazë të dyshojë se banka:

- nuk ekzekuton pa arsye detyrimin tërësisht ose pjesërisht;
- shkel afatet e ekzekutimit;
- nuk respekton radhën e preferimit.

7.2 Verifikimi i kryer në kuptimin e këtij neni dokumentohet me procesverbalin e rastit, një ekzemplar i të cilit mbetet në bankë.

Neni 8

Dispozita të fundit

257

8.1 Me zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen të gjitha bankat dhe degët e bankave në Republikën e Shqipërisë.

8.2 Të gjitha bankat dhe degët e bankave, subjekte të këtij udhëzimi, detyrohen të afishojnë këtë udhëzim në sportelet e tyre.

8.3 Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, udhëzimi “Për mënyrën e zbatimit të ekzekutimit të detyrimeve mbi shumat e llogarive e depozitave në banka”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.39, datë 31.3.1999, shfuqizohet.

8.4 Ky udhëzim u miratua me vendimin nr.43, datë 11.6.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare .

KRYETARI

Shkëlqim Cani

258

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

MINISTRI

U R D H Ë R

Nr. 3851, Datë 08/05/2009

PËR

MIRATIMIN E “KODIT TË ETIKËS TË PËRMBARUESVE GJYQËSORË SHTETËRORË DHE PRIVATË”.

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, nenit 10, shkronja “c” të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, nenit 10, pika 2 të ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbarimit gjyqësor”, nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së

Drejtësisë”, të ndryshuar”, si dhe nenit 124 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

I. Miratimin e “Kodit të Etikës të Përmbauesve Gjyqësorë Shtetëror dhe Privat”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhëri.

II. Revokimin e Urdhrit nr. 200, datë 17.01.2005 “Për miratimin e Kodit Etik të Përmbauesve Gjyqësor”.

III. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Përmbaimit dhe struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Drejtësisë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

ENKELEJD ALIBEAJ

KREU I

FUSHA E VEPRIMIT

259

Neni 1

Qëllimi i Kodit të Etikës

1. Për qëllim të këtij Kodi të Etikës, “Përmbaues” është një person i autorizuar për të zbatuar një proces përmbaimit, pavarësisht se ky përmbaues është apo nuk është i punësuar nga shteti.
2. Për Përmbauesit, Kodi i Etikës përcakton një sërë rregullash, në bazë të së cilave ata shprehin vullnetin dhe përgjegjshmërinë e tyre gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre.

Neni 2

Zbatimi i Rregullave të Kodit të Etikës

1. Dispozitat e Kodit të Etikës janë të detyrueshme për zbatim nga përmbauesit në të gjitha situatat dhe do të trajtohen në të gjitha format e trajnimeve profesionale, me qëllim që të bëhen pjesë e punës së tyre, të rrisin efikasitetin e shërbimeve të ofruara në plotësimin e misionit për ekzekutimin e titujve ekzekutivë dhe në materializimin e të drejtave të palëve, të siguruara në një proces të rregullt gjyqësor.
2. Ndaj përmbauesve, që shkelin parimet dhe rregullat e përshkruara në këtë Kod, merren masa disiplinore.
3. Procedimi disiplinor nuk kushtëzohet dhe është i pavarur nga shkelje të natyrës civile apo penale, të kryera nga përmbauesit.

KREU II

PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 3

Trajtim i barabartë

Përmbauesit duhet të evitojnë çdo paragjykim në lidhje me racën, seksin, fenë, kombësinë, gjendjen shoqërore dhe ekonomike, moshën, çrregullimet mendore apo fizike, etj, të lidhura me palët në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë.

Neni 4

Parimet

1. Përmbauesit veprojnë në bazë të parimeve të ligjshmërisë duke respektuar në mënyrë objektive liritë dhe të drejtat e sanksionuara ligjërisht, të palëve në një proces ekzekutimi.

260

2. Përmbauesi privat kërkon që stafi i tij/i saj t'i shmangen paragjykimeve apo njëanëshmërisë dhe të veprojnë në përputhje me parimet e Kodit të Etikës.

3. Përmbauesit duhet të jenë të ndershëm dhe kompetentë në kryerjen e detyrave të tyre, të

veprojnë gjithmonë sipas standardeve etike të njohura, në përputhje me parimet e përgjithëshme, legjislacionin, rregulloret dhe marrëveshjet e tjera, që rregullojnë veprimtarinë e tyre.

Neni 5

Paanshmëria dhe ndershmëria

1. Përmbauesit veprojnë në mënyrë profesionale, të paanëshme dhe të ndershme në punën e tyre. Ata nuk duhet të influencohen nga interesat private, politike apo presionet e çfarëdo lloj natyre.
2. Gjatë zbatimit të detyrave të tyre përmbauesit, drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë, nuk duhet të kërkojnë apo pranojnë asnjë dhuratë, favor apo përfitime të tjera për veten e tyre, për anëtarët e familjes apo të afërmit e tyre natyralë apo ligjorë, të cilat do të paragjykonin paanëshmërinë e funksionit të tyre publik dhe privat dhe do të konsideroheshin si shpërblime të padrejta për shkak të detyrës së tyre.
3. Përmbauesit duhet të refuzojnë marrjen e dhuratave, favoreve dhe çdo lloj përfitimi material, kur jepen nga palët në proces ekzekutimi dhe që ndikojnë në paanëshmërinë e ushtrimit të detyrave të tyre.
4. Kur përmbauesit konstatojnë se palët në një proces përbarimi, apo çdo person tjetër, përdorin si presion fizik dhe psikologjik, për të shkelur parimet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, ata informojnë menjëherë organet drejtuese administrative dhe Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor kompetent në juridiksion.

Neni 6

Konflikti i interesit

1. Në rast se përmbauesi, gjykon se ka një konflikt interesi, informon palët në proces ekzekutimi në mënyrën e duhur.
2. Konflikt interesi konsiderohet çdo rrethanë apo ndërthurje rrethanash, mbi bazën e të cilit ngrihet një dyshim i arsyeshëm, si rezultat i te cilit interesi personal i përmbauesit mund të ndikojë në paanshmërinë e tij/të saj gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare të tij/të saj.

Neni 7

Trajnimet

Përmbauesit i nënshtrohen trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme, të lidhura me objektin e veprimtarisë së tyre.

261

KREU III

PËRMBARUESIT GJYQËSOR

Neni 8

Marrëdhëniet ndërmjet përmbauesve gjyqësor

Marrëdhëniet ndërmjet përmbauesve karakterizohen nga respekti reciprok. Ata punojnë me një shpirt bashkëpunimi gjatë kryerjes të aktiviteteve të tyre dhe kontribuojnë për krijimin e një fryme pune miqësore dhe të zellshme, në zyrën dhe ambientet ku ata punojnë.

Neni 9

Kontakti me publikun

Gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre, në kontakt me njerëzit, ata identifikojnë veten duke treguar shënjat dalluese juridike të përmbauesit shtetëror apo privat dhe arsytën e vizitës.

Neni 10

Përfaqësimi

Përmbauesi, në ushtrimin e funksionit institucional të tij/të saj, duhet të paraqitet me një veshje

të përshtatshme, dinjitoze dhe të prezantojë me besueshmëri autoritetin që ai/ajo përfaqëson.

Neni 11

Përdorimi i armës

Përmbarduesit veprojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi, në fushën e përdorimit të armës, që ka të bëjë me mënyrën, shkaqet dhe rrethanat për përdorimin e saj.

Neni 12

Aktivitete të tjera

1. Përmbarduesit do të angazhohen në aktivitete të tjera, vetëm në atë masë sa këto të mos jenë shkak për kryerjen me objektivitet të funksioneve të tyre profesionale.

2. Në rast dyshimesh, të lidhura me aktivitetet e lejuara për ata, ata konsultohen me organet e tyre drejtuese.

KREU IV

262

Procedurat e ekzekutimit

Neni 13

Zbatimi i procedurave të ekzekutimit

1. Përmbarduesit veprojnë me përgjegjësi në lidhje me balancimin e interesave të kreditorit, ndërsa njohin dhe marrin parasysh kërkesat e debitorëve në vështirësi ekonomike.

2. Gjatë kryerjes së funksionit të tyre, përmbarduesit ndërmarrin veprime në mënyrën më të përshtatshme dhe efektive, që i përgjigjen sa më mirë palëve në proces ekzekutimi, në raport me objektivat e përmbardimit.

Neni 14

Shërbimi ndaj palëve në procedurë ekzekutimi

1. Përmbarduesit do të jenë në shërbim të palëve, që marrin pjesë në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë, të përmbushin siç duhet misionin e tyre, duke siguruar ndihmën dhe asistencën

e nevojshme në fushën e zbatimit të titujve ekzekutivë.

2. Përmbarduesit duhet ti karakterizojë ndjenja e një efikasiteti dhe integriteti sa më të lartë, në ekzekutimin e titujve ekzekutivë, me qëllim që të sigurojë një balancë ndërmjet interesave të palëve në një proces ekzekutimi.

Neni 15

Orari i punës

Përmbarduesit, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, në raport me palët në proces ekzekutimi apo çdo pale të tretë të përfshirë në këtë proces, si rregull, respektojnë orarin normal të punës, përveç rastit kur këto detyra është e nevojshme të realizohen jashtë këtij orari të punës.

Neni 16

Përdorimi i dhunës

Përmbarduesit në asnjë rast nuk mund të përdorin dhunë fizike dhe psikologjike dhe as ndonjë veprim tjetër, që do të cënonte seriozisht autoritetin e tyre, dinjitetin e palëve apo të çdo personi tjetër, të lidhur me zbatimin e titujve ekzekutivë.

KREU V

KONFIDENCIALITETI

Neni 17

263

Konfidencialiteti

1. Përmbarduesit nuk përdorin apo publikojnë asnjë informacion konfidencial rreth palëve në proces ekzekutimi, për nevojë të ushtrimit të funksioneve të tyre me subjektet, që nuk janë palë

në proces, ose që nuk kanë kompetencën ligjore të nevojshme.

2. Ata kanë për detyrë të ruajnë informacionet e marra gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre. Këto të dhëna nuk do të shpërndahen, nëse nuk parashikohen ndryshe nga Ligji.

3. Përveç rasteve parashikuar në ligj, përmbaruesi, për asnjë arsye, nuk u jep palëve të treta, përfshirë median e shkruar apo vizive, asnjë të dhënë për informacione konfidenciale, me të cilët ai/ajo është njohur për shkak të kryerjes së detyrave zyrtare të tij/të saj.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Ky Kod hyn në fuqi menjëherë.